



FAKULTETI I STUDIMEVE ISLAME I PRISHTINËS

BULETINI

REVISTË HULUMTUESE, SHKENCORE
E FAKULTETIT TË STUDIMEVE ISLAME

7

BULETINI

**REVISTË HULUMTUESE, SHKENCORE
E FAKULTETIT TË STUDIMEVE ISLAME**

7

Boton: Fakulteti i Studimeve Islame - Prishtinë

Redaktor përgjegjës:

Prof. asoc. dr. Fahrush Rexhepi, dekan

Redaksia:

Prof. asoc. dr. Sulejman Osmani - redaktor

Prof. ass. dr. Zija Abdullahu - anëtar

Prof. ass. dr. Lulzim Esati - anëtar

Prof. ass. dr. Musa Vila - anëtar

Prof. ass. dr. Sadik Mehmeti - anëtar

Prof. ass. dr. Islam Hasani - anëtar

Dr. Ajni Sinani - anëtar

Dr. hfz. Safet Hoxha - anëtar

Mr. Besa Ismaili - anëtar

Mr. Vedat Shabani - sekretar i redaksisë

Redaktor gjuhësor:

Arjan Koçi

Realizimi kompjuterik:

Nuhi Simnica

Shtypi:

Shtypshkronja "Iliri" - Prishtinë



FAKULTETI I STUDIMEVE ISLAME I PRISHTINËS

BULETINI

REVISTË HULUMTUESE, SHKENCORE
E FAKULTETIT TË STUDIMEVE ISLAME

7

Prishtinë
2020

Prof. asoc. dr. Fahrush REXHEPI

THEKSIME TË KOMPLEKSITETIT TË ÇËSHTJES KOMBËTARE NË BURIMET THEMELORE TË ISLAMIT

Abstrakt

Për kuptimin dhe përkufizimin e nocionit komb, në arabisht “kavm”, kanë shkruar shumë hulumtues, studiues e teoricienë. Për këtë term ka shumë kuptime e përkufizime me ndryshime të rëndësishme për çështjen teorike të problemit në fjalë. Dihet se të gjithë teoricienët e sqarimit të nocionit komb janë nisur nga pozitat ideologjike të klasës dhe të orientimeve politike që u përkisnin, por edhe nga interesat e vendit që përfaqësonin.

Termi apo nocioni *komb*, nga arabishtja “kavm”¹, përmendet edhe në Kuran, që nënkupton se Islami e njeh ekzistimin e kombit dhe i jep rëndësi çështjes kombëtare dhe tipareve të tij, kurse nocioni nacionalizëm, i cili po ashtu nënkupton shprehjen *komb*, rrjedh nga fjalët latine “*natio*” dhe “*nitus*”, që kanë kuptimin lindje, vendlindje, prejardhje, fis, popull (or). Përmes nocionit komb fillimisht përcaktoheshin fiset, pastaj në mesjetë pjesëtarët e një bashkësie të vogël fshatare, në periudhën e kohës së re bashkësitë e njerëzve me pikëpamje të përbashkëta për vlera si historia, kultu-

¹ Kuran: Ibrahim, 4.

ra dhe gjuha si dhe grupet e njerëzve që e ndjenin përbashkësinë politike me njëri-tjetrin në një hapësirë të kufizuar gjeografike, të cilën e bashkëbanonin². Shkencëtarët që cilët merren me këtë çështje dhe që studiojnë politikën e nacionalizmit, e kanë përkufizuar këtë term në mënyra të ndryshme. Sipas këtij përcaktimi organizimi i përbashkët politik dhe uniteti kulturor janë faktorët kryesorë për formimin e kombit.

Fjalë kyçe: Komb, nocion, fe, kulturë, nacionalizëm, argumente fetare.

Hyrje

Në këtë punim do të prezantojmë mendimet e disa shkencëtarëve lidhur me faktorët kryesorë të formimit të kombit.

Karlton Hejzi thotë: *“Kombi është një grup i pavarur politik me trashëgimi kulturore dhe me pikëpamje të përbashkëta ndaj botës”*.³

Hans Kohni thotë: *“Faktor për formimin e kombit është koekzistenca e një grupi të posaçëm në një sferë të vetme. Rritja dhe jeta e një rrethi të caktuar natyror dhe gjeografik krijon unitetin më të madh të solidaritetit fisnor midis individëve. Komb do formojë vetëm ai grup që mbi këto baza ndien interes dhe dobi të përbashkët”*.⁴

Kurse Salo Baroni⁵ rreth “shprehjes “komb” mendon për një grup njerëzish që jetojnë në të njëjtin vend dhe janë bashkuar për shkak të organizimeve politike të përbashkëta.

² <https://pashtriku.beepworld.de/>. Mr. Sabri KİÇMARI, “Kombi, definimi, tiparet dhe identiteti i Kombit”, 21.04.2021.

³ H. Calton Hayes, *Ese për nacionalizëm*, New York, 1926, 9. (cituar sipas dr. Ali Muhamed Nakavi, *Islami dhe nacionalizmi*, Prishtinë, 1997, 47). Titulli i origjinalit, dr. Ali Muhamed Nakavi: *Islam and nationalism*, përktheu: Vullnet Poskha.

⁴ Hans Kohn, *Ideja e nacionalizmit, Studimi mbi origjinën dhe prapaskenën e tij*, New York, 1944, 14.

⁵ Po aty.

Sipas shkollës gjermane mbështetja themelore e kombit është gjuha, kurse sipas asaj franceze mënyra e jetesës së përbashkët është themeli kryesor i kombit. Ndërkaq sipas shkollës marksiste baza themelore e kombit është jeta e përbashkët ekonomike. Ndërsa filozofi gjerman Immanuel Kant duke shpjeguar nocionin komb merr parasysh dy tipare kryesore: bashkësinë qytetare të njerëzve dhe prejardhjen e tyre⁶.

Në kuptimin politik ish-kancelari gjerman Willy Brandt, si një nga projektuesit e strategjisë së bashkimit të Gjermanisë, shihte në nocionin e kombit si të bashkuara të vërtetën historike dhe vullnetin politik. Sipas Brandtit “kombi përfshin dhe ka kuptim më të gjerë se gjuha dhe kultura e përbashkët, si rregullim shtetëror dhe shoqëror. Kombi formohet mbi bazën e ndjenjës së përbashkësisë së vazhdueshme të njerëzve të një populli”⁷.

Për sa i përket realitetit historik të formimit të kombit shqiptar, më shumë i përgjigjet teza e përgjithësuar se “*kombi paraqet bashkësinë stabile historike të njerëzve e formuar mbi bazë të bashkësisë së gjuhës, të territorit, të jetës ekonomike dhe konstitucionit psikik të shprehur në kulturën kombëtare të përshkuar me vetëdijen e përkatësisë së tërësisë së përbashkët*”⁸.

Edhe teoritë e arabëve lidhur me termin komb kanë ngjashmëri me ato të evropianëve dhe nuk ndryshojnë nga dijetarët perëndimorë⁹. Nga këto thënie mund të shprehemi se kombi është një bashkim individësh, të cilët janë mbledhur së bashku për shkak të territorit, të gjakut, të gjuhës, të kulturës, të historisë dhe të organizimeve të përbashkëta poli-

⁶ <https://pashtriku.beepworld.de/>. Mr. Sabri KIÇMARI, “Kombi, definimi, tiparet dhe identiteti i Kombit”, 21.04.2021.

⁷ Po aty.

⁸ Dr. M. Pirraku, *Kultura Kombëtare Shqiptare deri në Lidhjen e Prizrenit*, Prishtinë, 1989, 256.

⁹ Dr. Xhumua El-Huli, *El Itixhatat El Fikrije El Muasire, ve mevkif el Islam minha*, Medine, 1986 m-1407h, f. 116.

tike. Kurse bazat e nacionalizimit janë besnikëria dhe dashuria ndaj një grupi të brendshëm (të quajtur komb dhe atdhe). Kjo do të thotë se bazë e unitetit të një kombi nuk është religjioni, ideologjia, por gjuha, territori, raca, traditat dhe kultura. Pra, nacionalizmi e konsideron sovranitetin si mjet për të mbrojtur vendin dhe qytetarët e tij e jo për të përkrahur ndonjë ideologji apo sistem të veçantë. Gjithashtu edhe ekonomia mbështetet në interesat dhe mirëqenien kombëtare, jo në atë që duhet të jetë e arsyeshme.

Koncepti i nacionalizmit

Koncepti i nacionalizmit apo i ndjenjave kombëtare për kombin çdoherë e ka tërhequr vëmendjen e shoqërisë, prandaj do të ishte me rëndësi që së pari t'i bëhej një analizë nga aspekti shkencor për të kuptuar deri në ç' masë burimet themelore të Islamit (Kurani dhe Hadithi) i pranojnë parimet e tilla. A ka ndonjë mospajtim ndërmjet Islamit dhe nacionalizmit? A është e mundshme që njeriu të jetë edhe besimtar mysliman edhe nacionalist? Përderisa disa tipare të nacionalizmit mund t'i vishen sistemit fisnor të qyteteve greke para disa mijëvjeçarëve, nacionalizmi si një shkollë politike, sociale dhe ideologjike lindi në Perëndim si pasojë e *Revolucionit Francez*.

Zhan Zhak Ruso ishte përkrahësi më i madh i kësaj shkolle, duke insistuar që njeriu si synim më të lartë të tij të ketë shtëpinë dhe vendin ku është rritur. Ai besonte se atdheu është zemra dhe qendra e dashurisë dhe e besnikërisë së njeriut dhe grupit të njerëzve. Trajta kryesore e shkollës së nacionalizmit u sendërtua pas *Revolucionit Francez*, kur për herë të parë u zbatua në praktikë. Në atë kohë u shtuan emocionet për atdheun, për flamurin, për heronjtë kombëtarë, për racën dhe për gjuhën franceze¹⁰.

¹⁰ Dr. A.M. Nakavi, *Islami dhe nacionalizmi*, f. 13.

Me zhvillimin e *Revolucionit Francez*, idetë e nacionalizmit në Perëndim fituan popullaritet të madh duke lënë anash nocionet e lirisë dhe të demokracisë. Napoleon Bonaparti ishte një përkrahës i patundur i nacionalizmit, ide përmes së cilës ai kishte përgatitur terrenin për politikën e tij agresive dhe ekspansioniste, duke mbjellë te populli francez frymën e dominimit, ku pas kësaj shumë popuj u kontaminuan nga ndjenja e nacionalizmit¹¹. Shekulli XIX u quajt “*koha e artë*” e nacionalizmit¹².

Duke pasur parasysh shtrirjen dhe përkrahjen e tij, që nga Amerika, Anglia, Italia, përfshirë këtu edhe gjithë Evropën Qendrore dhe Perëndimore, prijësit më të mëdhenj të nacionalizmit gjatë këtij shekulli ishin *Xhuzepe Garibaldi* në Itali, *Viktor Hygo* në Francë dhe *Oto Bismarku* në Gjermani. Nacionalizmi gjatë këtij shekulli solli ngjarje të mëdha dhe kështu u pavarësuan shumë popuj që më parë ishin koloni të huaja, si të Portugalisë, të Spanjës në Amerikën Qendrore, të cilat u pavarësuan nën udhëheqjen e *Simon Bolivarit* e të *Hose Martinit*. Mirëpo ndjenjat më të forta nacionaliste të ndikuara nga qeveritë perëndimore na paraqiten nëpër kolonitë evropiane të Perandorisë Osmane, çka çoi deri në pavarësimin e shteteve të ndryshme si Greqia, Bullgaria, Hungaria, Finlanda etj..¹³

Manifestimi më i qartë i nacionalizmit u shfaq në gjysmën e parë të shekullit XX në Evropë dhe në Japoni dhe rezultoi me një luftë të paparë deri atëherë. Dijetarë të shumtë janë të mendimit se shkaqet kryesore të *Luftës së Parë Botërore* dhe të *Luftës së Dytë Botërore* ishin pikërisht ndjenjat nacionaliste, nxitës të të cilave ishin Musolini në Itali, Hitleri në Gjermani, Peroni në Argjentinë, Frankoja në Spanjë etj.. Më vonë gjatë gjysmës së dytë të këtij shekulli nacionalizmi filloi të shfaqet edhe në vendet e Botës së Tretë.

¹¹ Po aty, 14.

¹² H. Kohen, *Ideja e Nacionalizmit...*, f. 116.

¹³ Dr. A.M. Nakavi, f. 15.

Bota Islame dhe nacionalizmi

Për sa i përket botës islame, nacionalizmi në fund të shekullit XIX ishte një shkollë e importuar nga Perëndimi. Pas bisedave të ideologut Sejid Xhemaluddinit me sulltan Abdulhamidit lidhur me unitetin e muslimanëve të botës, uniteti dhe solidariteti i turqve dhe i arabëve brenda Perandorisë Osmane do të parandalonte depërtimin e vlerave dhe idealeve të Perëndimit në zonat strategjike të Lindjes së Mesme. Fuqitë kolonizuese duke e parandier këtë rrezik filluan të mbjellin idenë e nacionalizmit dhe zgjimin e ndjenjave kombëtare në mesin e turqve dhe arabëve me qëllim të pengimit të unitetit në baza fetare islame, duke e përçarë Perandorinë Osmane me qëllim që ndikimi i osmanlinjve të zëvendësohej nga kolonizimi perëndimor.

Nuk ishte i rastësishëm fakti që nacionalizmi së pari u ngjall në pjesët e Perandorisë Osmane e jo në tokat muslimane që ishin nën dominimin e Francës dhe Britanisë¹⁴.

Rol të rëndësishëm në përhapjen e ideve nacionaliste në botën islame dhe në Perandorinë Osmane luajtën edhe organizata (bashkësi) dhe individë të ndryshëm hebrenj, qëllimi kryesor i të cilëve ishte nxitja e ndjenjave nacionaliste në mesin e turqve për të futur përçarje ndërmjet turqve dhe arabëve, për të hapur pastaj rrugën për okupimin e Palestinës.

Rol kryesor në këtë çështje pati organizata hebreje Mason¹⁵, e cila ishte themeluar në dekadencë të shtetit osman. Kjo organizatë përbëhej prej hebrenjve autoritativë, të pasur dhe me famë. Qendra e saj ishte në Selanik. Organizata e masonëve si dhe individë të tjerë hebrenj nën petkun e nacionalizmit arritën të rrëzonin Abdulhamidin nga pushteti dhe të përgatitin terrenin për ngjalljen e armiqësive ndërmjet turqve

¹⁴ Po aty, f. 27, 28.

¹⁵ Abdullaha Nasih Ulvan, *El-Kavmijetu fi mizan el islam*, 1980, f. 10.

dhe arabëve dhe gjithë kjo u përcoll me krijimin e lëvizjes së xhonturqve (turqve të rinj) në vitin 1908.

Këto pra ishin zhvillimet e para të nacionalizmit në botën islame, që u pasuan nga paraqitja e nacionalizmit izraelit dhe ambiciet e tyre për pushtimin e Jerusalemit (Kudsit).

Gjithashtu ndikim në paraqitjen e ndjenjave nacionaliste të arabëve ka pasur edhe lënia anash e ndjenjave islame nga turqit dhe animi kah çështja e kombit, dukuri kjo që nuk ishte e pranishme në fillim të sundimit të tyre.

Kombi nga këndvështrimi islam

Sa u përket burimeve themelore të fesë islame, Kuranit dhe hadithit, ato i lejojnë ndjenjat patriotike siç janë dashuria ndaj babait, djalit apo familjes a kombit, por deri në atë masë ku nuk i kundërvihen ndjenjës më të lartë të njeriut. Islami paraqet një sistem të pavarur shpirtëror, praktik, politik e shoqëror, që në vetvete përfshin besimin. Prandaj, është e natyrshme që ndërmjet tij dhe shkollës së nacionalizmit të ketë kundërthënie, pasi nacionalizmi nuk ndalet vetëm në këto gjëra të thjeshta.

Nacionalizmi çmon vetëm traditat historike, kulturën, qytetërimin, idetë dhe fytyrat historike të popullit të vet, ndërsa vizioni i Islamit nuk mbështetet vetën në kufij e raca, fise dhe popuj, por synimi i tij është uniteti universal. Burimet themelore të Islamit i kanë flakur bazat e nacionalizmit duke theksuar se gjuha, ngjyra, raca nuk janë të vetmet kritere për bashkim dhe privilegj¹⁶. Në periudhën e paraqitjes së Islamit fiset arabe ishin organizata e vetme sociale dhe politike e tyre. Bazë e unitetit ishin gjaku dhe lidhjet fisnore, pra format më të vrazhda të nacionalizmit dhe racizmit. Mirëpo, me paraqitjen e shpalljes - Kuranit,

¹⁶ Dr. A.M. Nakavi, *Islami dhe nacionalizmi*, f. 83, 84.

Islami i eliminoi idetë e tilla dhe organizimet fisnore me parullën e stuhishme “Nuk ka Zot tjetër pos Allahut”¹⁷.

I Dërguari i Zotit, Muhamedi a.s., nën hijen e Islamit themeloi një shoqëri me shtrirje universale dhe pa klasa, me një fjalë i bashkoi popujt e ndryshëm duke i mënjanuar dallimet e tyre fisnore dhe duke i flakur ndasitë në baza nacionale. Kështu u bë bashkimi ndërmjet Selman Farisiut nga Persia, Suhejb romakut dhe Bilalit nga Etiopia, të cilët pranuan Islamit.

Islami i drejtohet gjithë njerëzimit si një bashkësi e vetme shoqërore e njerëzore. Ftesa e tij nuk është vetëm për një komb, për një racë apo për një rajon, por për tërë shoqërinë njerëzore.

يَا أَيُّهَا النَّاسُ اتَّقُوا رَبَّكُمُ الَّذِي خَلَقَكُمْ مِنْ نَفْسٍ وَاحِدَةٍ وَخَلَقَ مِنْهَا زَوْجَهَا
وَبَثَّ مِنْهُمَا رِجَالًا كَثِيرًا وَنِسَاءً

“O ju njerëz! Keni frikë Zotin tuaj që ju ka krijuar prej një vetjeje (njeriu) dhe nga ajo krijoi palën (shoqen) e sajë, e prej atyre dyve u shtuan shumë burra e gra”.¹⁸

Dallimet në racë, fis, komb dhe familje nuk kanë autenticitet legjitim dhe nuk janë të vetmet baza të unitetit. Ato janë kuptime të lehtësimit të marrëdhënieve njerëzore.

يَا أَيُّهَا النَّاسُ إِنَّا خَلَقْنَاكُمْ مِنْ ذَكَرٍ وَأُنْثَىٰ وَجَعَلْنَاكُمْ شُعُوبًا وَقَبَائِلَ لِتَعَارَفُوا ۗ
إِنَّ أَكْرَمَكُمْ عِنْدَ اللَّهِ أَنْفَاكُمُ ۗ إِنَّ اللَّهَ عَلِيمٌ خَبِيرٌ

*“O ju njerëz, vërtet ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj dhe fise që të njiheni ndërmjet jush, e s’ka dyshim tek Allahu, më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (nga të këqijat), e Allahu është shumë i dijshtëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë”*¹⁹.

¹⁷ Po aty.

¹⁸ Kuran, En Nisaë: 1.

¹⁹ Kuran, El Huxhurat: 13.

Nga këto ajete kuranore shohim se Allahu i drejtohet mbarë njerëzimit pa dallim race, fisi, kombi e territori. Ndarja në fise, në grupe e popuj është bërë me qëllim që njëri me tjetrin të njihen më mirë e jo për t'u mburrur, as për të shfaqur urrejtje ndërmjet popujve e as për të shkaktuar kundërshtime. Ndarjen e njerëzimit dhe pretendimin për superioritet në baza kombëtare dhe rajonale Kurani e kundërshton ashtu siç e ka kundërshtuar faraonin:

إِنَّ فِرْعَوْنَ عَلَا فِي الْأَرْضِ وَجَعَلَ أَهْلَهَا شِيَعًا يَسْتَضَعِفُ طَائِفَةً مِّنْهُمْ يُدَبِّحُ
أَبْنَاءَهُمْ وَيَسْتَحْيِي نِسَاءَهُمْ ۗ إِنَّهُ كَانَ مِنَ الْمُفْسِدِينَ

“Me të vërtetë, faraoni ka ngritur kryet lart në tokë, e popullin e saj e ka grupëzuar dhe një grup prej tyre e shtyp, ashtu që djemtë e tyre ua mbyt, e gratë e tyre ua lë të jetojnë. Vërtet, ai ishte prej më shkatërrimtarëve”.²⁰

Nga kjo shihet se Kurani, si burim themelor i fesë islame, mesazhin e vet ia drejton tërë njerëzimit dhe të gjithë i gjykon objektivisht pa marrë parasysh qëndrimet dhe dallimet në baza kombëtare.

Misioni i tij nuk është i trajtës kombëtare, por është universal dhe synon që t'i çlirojë të gjitha marrëdhëniet ndërmjet qenieve njerëzore. Madje dhe vetë Profeti Muhamed a.s., të cilit i ka zbritur Kurani, ishte i Dërguar i Zotit në tokë jo për popuj dhe për vende të caktuara, por për mbarë njerëzinë:

وَمَا أَرْسَلْنَاكَ إِلَّا كَافَّةً لِّلنَّاسِ بَشِيرًا وَنَذِيرًا وَلَكِنَّ أَكْثَرَ النَّاسِ لَا يَعْلَمُونَ

“Ne nuk të dërguam ty ndryshe vetëm se për të gjithë njerëzit, myzhdedhënës dhe tërheqës i vërejtjes, por shumica e njerëzve nuk e dinë”.²¹

²⁰ Kuran, El Kasas: 4.

²¹ Kuran, Sebe`ë: 28.

وَمَا أَرْسَلْنَاكَ إِلَّا رَحْمَةً لِّلْعَالَمِينَ

Dhe citati tjetër: *“E ne të dërguam ty (Muhamed) vetëm si mëshirë për të gjitha krijesat”*.²²

Që misioni i Profetit Muhamed a.s. nuk ishte i përkufizuar në popuj dhe në kombe të veçanta e shohim edhe nga mesazhet që ai u dërgoi në vitin e gjashtë të shpërnguljes së tij në Medinë, mbretit romak Heraklit, atij të Persisë, Kisras, atij të Etiopisë, Nexhashiut, dhe të Egjiptit, Mukavkisit, duke i ftuar që të pranojnë Islamin²³.

Profeti Muhamed a.s. gjithnjë e ka theksuar unitetin e njerëzve dhe e ka gjykuar ndarjen e tyre në bashkësi të kufizuara racore dhe nacionale: *“Nuk ka dallim ndërmjet arabëve dhe popujve jo arabë, të gjithë janë djem të Ademit”*²⁴. Dhe hadithi tjetër:

النَّاسُ بَنُو آدَمَ ، وَأَدَمُ خُلِقَ مِنْ تَرَابٍ

“Të gjithë njerëzit janë djem të Ademit, ndërsa Ademi është krijuar prej dheut”.²⁵

Një hadith tjetër i Pejgamberit a.s. thotë:

أَلَا لَا فَضْلَ لِعَرَبِيٍّ عَلَى أَعْجَمِيٍّ وَلَا لِعَجَمِيٍّ عَلَى عَرَبِيٍّ وَلَا لِأَحْمَرَ عَلَى أَسْوَدَ وَلَا أَسْوَدَ عَلَى أَحْمَرَ إِلَّا بِالتَّقْوَى

“Nuk mund të ketë superioritet të arabëve ndaj joarabëve, të joarabëve ndaj arabëve, për të bardhët ndaj zezakëve dhe për zezakët ndaj të bardhëve, përpos kur kemi të bëjmë me dëlirësinë (përluljen) dhe sinqeritetin”.²⁶

Kurani e thekson shumë qartë se baza të unitetit të një kombi nuk mund të jenë vetëm gjaku, kultura, tradita dhe gjuha, por edhe besimi:

²² Kuran, El Enbija: 107.

²³ Safiju Rrahman El-Mubarekfuri, *Err-rrahikul Mahtum*, Bejrut, 1988, f. 336.

²⁴ Sahih Muslim, botoi Daru Es Selam, Riad, 2006 nr. 673.

²⁵ Tirmidhiu, Darul kutub el ilmije, Bejrut-Liban, 2010, nr. 3955.

²⁶ Musnedi i imam Ahmedit (redaktoi: Shuajb Arnauti), botoi Muessesetu errisaleti, Bejrut-Liban, hadithi, nr. 22978.

وَأَعْتَصِمُوا بِحَبْلِ اللَّهِ جَمِيعًا وَلَا تَفَرَّقُوا ۗ وَادْكُرُوا نِعْمَتَ اللَّهِ عَلَيْكُمْ إِذْ كُنْتُمْ
 أَعْدَاءً فَأَلَّفَ بَيْنَ فُلُوبِكُمْ فَأَصْبَحْتُمْ بِنِعْمَتِهِ إِخْوَانًا وَكُنْتُمْ عَلَىٰ شَفَا حُفْرَةٍ مِّنَ
 النَّارِ فَأَنْقَذَكُمْ مِنْهَا ۗ كَذَلِكَ يُبَيِّنُ اللَّهُ لَكُمْ آيَاتِهِ لَعَلَّكُمْ تَهْتَدُونَ

*“Dhe kapuni që të gjithë ju për litarin (fenë dhe Kuranin) e Allahut, e mos u përçani! Përkujtoni nimetin e Allahut ndaj jush, kur ju (para se ta pranoni fenë islame) ishit të armiqësuar, e Ai bashkoi zemrat tuaja dhe ashtu me dhuntitë e Tij aguat të jeni vëllezër. Madje ishit në buzë të greminës së xhehenemit, e Ai ju shpëtoi prej tij. Po kështu Allahu ua sqaron juve argumentet e veta që ju të gjeni të vërtetën e lumtur”.*²⁷

Sipas burimeve islame, marrëdhëniet ndërnjerëzore i nënshtrohen besimit, madje edhe ato familjare, të babait, të burrit, të gruas, të djalit. Ndërkaq ata që nuk besojnë, përkundër afërsisë së tyre familjare, janë të huaj. Ja si e përshkruan Kurani këtë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَتَّخِذُوا آبَاءَكُمْ وَإِخْوَانَكُمْ أَوْلِيَاءَ إِنِ اسْتَحَبُّوا الْكُفْرَ
 عَلَىٰ الْإِيمَانِ ۗ وَمَن يَتَّخِذْهُم مِّنكُمْ فَأُولَٰئِكَ هُمُ الظَّالِمُونَ

*“O ju që besuat, mos u ofroni miqësi (dashuri) prindërve tuaj, as vëllezërve tuaj, nëse ata vlerësojnë mosbesimin kundër besimit. E kush prej jush miqësohet me ta, ata janë mizorë...”*²⁸

Këto citate kuranore na bëjnë të qartë se Islami nuk bazohet dhe nuk kufizohet në kufijtë gjeografikë, racorë apo gjuhësorë, por në ato të besimit në Zot dhe ky parim i besimit është i pasqyruar edhe në sistemin juridik të Islamit, ku asnjë jobesimtar nuk mund ta trashëgojë pasurinë e besimtarit. Edhe shoqëria që Muhamedi a.s. themeloi në Medinë, bazohej në besim dhe ishte një shoqëri e cila në tërësi i kundërvihej parimit të nacionalizmit. P.sh. në betejën e Bedrit, në vitin e dytë të hixhretit (shpërnguljes së Muhamedit a.s në Medinë) dhe në

²⁷ Kuran, Ali Imran: 103.

²⁸ Kuran, Et Tevbe: 23.

betejat e tjera, si ajo e Uhudit dhe e Hendekut, i Dërguari i Zotit luftoi krah për krah me ensarët²⁹ e Medinës, të cilët konsideroheshin të huaj për Profetin Muhamed a.s.. Gjatë këtyre luftërave gjaku dhe territori iu nënshtruan besimit. Hudhejfa sulmoi të atin, Ebu Bekri nxori shtatën kundër djalit të vet, Abdurrahmanit, etj.. Në këtë mënyrë shkëputeshin lidhjet e farefisnisë vetëm për shkak të besimit. Gjatë çlirimit të Mekës, Muhamedi a.s. u priu ensarëve (që ishin të huaj), që të çlironin vendlindjen e tij, me ç’rast të huajt vranë shumë kushërinj të tij³⁰.

Në Islam territori nuk i takon asnjë grupi, por vetëm Zotit, ndërsa të gjitha qeniet njerëzore janë vetëm zëvendës. Të drejtën më të madhe për të udhëhequr në tokë e kanë ata që i kryejnë detyrat ndaj Zotit sepse kufijtë nuk janë gjeografikë, por janë kufij të besimit. Kurani këtë çështje e citon në shumë vende, duke shtuar se asnjë popull nuk ka monopol mbi asnjë territor dhe se e tërë bota i takon vetëm Zotit (xh.sh.):

قُلِ اللَّهُمَّ مَالِكَ الْمُلْكِ تُؤْتِي الْمُلْكَ مَنْ تَشَاءُ وَتَنْزِعُ الْمُلْكَ مِمَّنْ تَشَاءُ وَتُعْزِزُ
مَنْ تَشَاءُ وَتُذِلُّ مَنْ تَشَاءُ ۗ بِيَدِكَ الْخَيْرُ ۗ إِنَّكَ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ

*“Thuaj: “O Allah, Sundues i çdo sendi, Ti ia jep pushtetin atij që do, Ti ia heq prej dore pushtetin atij që do dhe e përul atë që do, e lartëson atë që do. çdo e mirë është në dorën Tënde, vërtet, Ti ke mundësi për çdo gjë”.*³¹

قُلْ مَنْ بِيَدِهِ مَلَكُوتُ كُلِّ شَيْءٍ وَهُوَ يُجِيرُ وَلَا يُجَارُ عَلَيْهِ إِنْ كُنْتُمْ
تَعْلَمُونَ ﴿٨٨﴾ سَيَقُولُونَ لِلَّهِ قُلْ فَأَنَّى تُسْحَرُونَ

*“Thuaj: “E kujt është toka dhe çdo gjë që ka në të, nëse jeni që e dini?” Ata do të thonë: “E Allahut”. Atëherë thuaju: “Përse, pra nuk mendoni?”.*³²

²⁹ Ndihmësit, mikpritësit, banorët e Medinës.

³⁰ Dr. A.M. Nakavi, *Islami dhe nacionalizmi*, 103, 104.

³¹ Kuran, Ali Imran: 26.

³² Kuran, El Mu`minunë: 88, 89.

هُوَ الَّذِي جَعَلَكُمْ خَلَائِفَ فِي الْأَرْضِ

*“Ai është që ju bëri sundues (zëvendësues) në tokë”.*³³

وَإِذْ قَالَ رَبُّكَ لِلْمَلَائِكَةِ إِنِّي جَاعِلٌ فِي الْأَرْضِ خَلِيفَةً

*“Unë po krijoj (po përcaktoj) në tokë një zëvendës”.*³⁴

Meqë Ai është Zoti i tërë botës, Ai e ka bërë njeriun zëvendës të Tij, prandaj bota u takon të gjitha qenieve njerëzore, veçanërisht besimtarëve. Pra, begatitë e tokës u takojnë të gjithë njerëzve, jo vetëm një grupi të veçantë:

وَلَقَدْ كَتَبْنَا فِي الزَّبُورِ مِنْ بَعْدِ الذِّكْرِ أَنَّ الْأَرْضَ يَرِثُهَا عِبَادِيَ الصَّالِحُونَ

*“Ne e kemi shënuar në Zebur (në librat e shenjtë) pas shënimit (në Lehti Mahfudh), se me të vërtetë tokën do ta trashëgojnë robërit e Mi të mirë”.*³⁵

Kurani tërë kohën flet për tërë botën e jo vetëm për arabët apo jo-arabët, sepse hapësira i takon mbarë njerëzimit. Poeti Muhamed Iqbal thotë: “Çdo vend që i takon Zotit, është edhe yni”³⁶.

Profeti Muhamed a.s., duke iu drejtuar fisit të vet Benu Hashim, fton: “O beni Hashim, do jini njerëzit për veprat e tyre, e jo për farefisninë”.

Që ndasitë në baza nacionale dhe racore janë të dëmshme për njerëzimin dëshmon edhe historia e qindvjeçarit të fundit e vendeve nacionaliste perëndimore. Gjermani krenohet se është gjerman duke thënë se “Gjermania është mbi të gjitha”, ndërsa Musolini deklaronte: “Dashuria për Italinë paraqet fenë më të lartë”. Ndërsa amerikanët mendojnë se “SHBA-të i ka zgjedhur vetë Zoti”, ndërsa anglezi beson se

³³ Kuran, El En`amë: 165.

³⁴ Kuran, El Bekare: 30.

³⁵ Kuran, El Enbija: 105.

³⁶ Dr. A.M. Nakavi, *Islami dhe nacionalizmi*, f. 107.

“Sundimi i botës është e drejtë të cilën britanikëve ua ka dhënë Zoti vetë³⁷”. Islami i hedh poshtë idetë e këtilla.

Islami dhe kombi - të dyja së bashku

Ekzistojnë edhe mendime të kundërta lidhur me pikëpamjet e Islamit ndaj çështjes së kombit. Sipas disa nacionalistëve mund të ndiqen të dy konceptet, edhe Islami edhe çështja kombëtare. Në mesin e dijetarëve që mendojnë kështu janë Tahtavi dhe Mustafa Kamili nga Egjipti, Nakik Kamili nga Turqia, Ebul Kelam Azadi dhe Husejn Ahmed Medeni nga India. Këta dijetarë mendonin se dy ideologjitë mund të jenë në pajtueshmëri me njëra-tjetrën.

Ish-kryeministri i Irakut, *Abdurrahman El-Bezzazi*, në librin e tij “*Islami dhe populli arab*” pohon se “*njeriu mund të jetë musliman dhe nacionalist arab*³⁸”. Në kuadër të kësaj kundërthënieje ne marrim dhe analizojmë edhe disa citate të tjera kuranore, të cilat termin komb e theksojnë, por edhe çështjen kombëtare nuk e lënë krejtësisht anash. P.sh., Kurani flet për vlerën e kombit arab dhe vlerën e gjuhës arabe kur thotë: “*Libër që citatet e tij janë shkoqitur, duke qenë Kuran arabisht për një popull që di të kuptojë*”³⁹. Citati tjetër thotë:

لَقَدْ جَاءَكُمْ رَسُولٌ مِّنْ أَنْفُسِكُمْ عَزِيزٌ عَلَيْهِ مَا عَنِتُّمْ حَرِيصٌ عَلَيْكُمْ بِالْمُؤْمِنِينَ
رَءُوفٌ رَّحِيمٌ

“Ju erdhi i Dërguar nga mesi juaj. Atij i vjen rëndë për vuajtjet tuaja. I brengosur për besimtarët, i butë dhe i mëshirshëm”.⁴⁰

³⁷ Po aty, f. 114.

³⁸ Po aty, f. 116, 117, 119.

³⁹ Kuran, Fussilet: 2.

⁴⁰ Kuran, Et Tevbe: 128.

وَإِنَّهُ لَذِكْرٌ لَّكَ وَلِقَوْمِكَ ۖ وَسَوْفَ تُسْأَلُونَ

“Dhe se ajo (shpallja) është lëvdatë e madhe për ty (Muhamed) dhe për popullin tënd dhe për këtë (lëvdatë) më vonë do të përgjigjeni”.⁴¹

Nga shprehjet kuranore “juve ju erdhi i Dërguari nga lloji juaj” dhe “zbritëm Kuranin arabisht” dhe citati: “shpallja (Kurani) është lëvdatë e madhe për ty (Muhamed) dhe për popullin tend”, veçojmë se kemi të bëjmë me një privilegj të popullit arab dhe të gjuhës së tyre, që nënkuptojnë për njohjen e kombit dhe të popujve nga burimi themelor i Islamit (Kurani).

Lidhur me këtë çështje mund të marrim si shembull edhe disa fjalë (hadithe) të Pejgamberit a.s.:

قال رسول الله ﷺ : إن الله اصطفى كنانة من ولد إسماعيل واصطفى قريشاً من

كنانة واصطفى من قريش بني هاشم واصطفاني من بني هاشم

“Me të vërtetë Zoti ka zgjedhur (kenanët nga Ismaili dhe i ka zgjedhur kurejshët nga kenanët dhe i ka zgjedhur benu Hashimët nga kurejshët (të bijtë e Hashimit) dhe më ka zgjedhur mua nga bijtë e Hashimit”.⁴²

Gjithashtu në një hadith tjetër të Profetit Muhamed a.s., të cilin e transmeton Muhamed ibn Is’hak Es-Senai, ai thotë: “Zoti ka krijuar shtatë qiej dhe nga këta ka zgjedhur një, të parin, dhe në të ka vendosur të banojë kë ka dashur nga krijesat e Tij. Pastaj ka krijuar krijesat dhe prej tyre ka zgjedhur bijtë e Ademit dhe nga bijtë e Ademit ka zgjedhur arabët dhe nga arabët ka zgjedhur fisin Medar dhe nga Medarët ka zgjedhur Kurejshët dhe nga Kurejshët ka zgjedhur bijtë e Hashimit, Dhe mua më ka zgjedhur nga bijtë e Hashimit (Hashimi, gjyshi i Muhamedit a.s), dhe unë jam më i zgjedhuri. Kush i do arabët, më ka da-

⁴¹ Kuran, Ez Zuhruf: 44.

⁴² Muslimi, nr. 3605-3606, Ahmedi, vëll. 4, fq. 107.

shur mua dhe unë e dua atë dhe kush i kundërshton arabët, më ka kundërshtuar mua dhe unë i kundërshtoj ata”⁴³.

Në hadithin tjetër të transmetuar nga Ebu Tahir El-Selefi dhe Ibën Fejmi, Muhamedi a.s. thotë: “*Dashuria ndaj Ebu Bekrit dhe ndaj Omerit është pjesë e besimit dhe kundërshtimi ndaj këtyre të dyve është pjesë e mosbesimit. Dashuria ndaj arabëve është pjesë e besimit, kurse kundërshtimi ndaj tyre është pjesë e mosbesimit*”⁴⁴.

Megjithëse ndoshta këto thënie profetike kanë pasur për qëllim obligimet ndaj fesë islame, apo janë bërë në emër të obligimit ndaj Islamit, nga këto thënie shohim se në burimet themelore të Islamit ekziston privilegji dhe theksohet çështja e kombit. Këtë e shohim më qartë edhe në citatin kuranor:

وَكَذَلِكَ جَعَلْنَاكُمْ أُمَّةً وَسَطًا لِتَكُونُوا شُهَدَاءَ عَلَى النَّاسِ وَيَكُونَ الرَّسُولُ عَلَيْكُمْ شَهِيدًا

“Dhe ashtu (sikur ju udhëzua në fenë islame) Ne ju bëmë ju një popull të drejtë (një mes të zgjedhur për të qenë ju dëshmitarë në Ditën e Gjykimit) ndaj njerëzve dhe për të qenë i Dërguari dëshmitar ndaj jush”.⁴⁵

Nga komenti i këtij citati kuranor kuptojmë se shprehja “*Ne ju bëmë ju një popull të drejtë*” aludon për arabët si popull i privilegjuar dhe shprehja tjetër “*një mes të zgjedhur*” aludon për Shamin dhe Hixhazin, atdheun e Pejgamberit a.s. dhe të popullit të tij, vende të cilat shtrihen ndërmjet lindjes dhe perëndimit.

Nga fakti se Kurani dhe hadithi (burimet themelore të Islamit) e theksojnë çështjen e kombit dhe të atdheut në shumë vende, nënkuptojmë se këto burime nuk janë kundër që njerëzit të punojnë për të mirën e vendit të tyre, për të mirën e popullit, familjes dhe të rrethit në të ci-

⁴³ Abdullaha Nasih Ulvan, *El-Kavmijetu fi mizan el islam*, 1980, f. 76.

⁴⁴ Po aty.

⁴⁵ Kuran, El Bekare: 143.

lin jetojnë. Pastaj edhe vetë ligji (sheriati) islam nuk lejon që zekati të jepet jashtë vendit dhe rrethit të vet, por preferon që në radhë të parë të plotësohen nevojat e të afërmve dhe vendasve të atij vendi. Pra, parimet islame nuk ndalojnë që njeriu ta dojë atdheun e vet, në të cilin jeton, dhe i lejohet njeriut që edhe pikën e fundit të gjakut ta japë në mbrojtje të vendit të vet, të popullit të vet, të nderit dhe të pasurisë së vet. Edhe Muhamedi a.s. e ka dashur vendlindjen dhe popullin e vet. Kur u shpërngul nga Meka, ai e shikoi atë duke thënë:

أَنَّ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ نَظَرَ إِلَى مَكَّةَ ، فَقَالَ : إِنَّكَ لِأَحَبُّ أَرْضِ اللَّهِ إِلَى اللَّهِ ، وَلَوْلَا أَنَّ قَوْمِي أَخْرَجُونِي مِنْكَ مَا خَرَجْتُ

*“Unë e di se ti (Meka) je vendi më i dashur për Allahun dhe sikur populli im të mos më largonte nga ajo, unë nuk do të largohesha nga Meka”.*⁴⁶

Lidhur me këtë temë Kurani citon:

فَأَقِمْ وَجْهَكَ لِلدِّينِ حَنِيفًا فِطْرَةَ اللَّهِ الَّتِي فَطَرَ النَّاسَ عَلَيْهَا لَا تَبْدِيلَ لِخَلْقِ اللَّهِ ...

*“Feja (natyrshmëria) e Allahut në të cilën i krijoi njerëzit, s’ka ndryshim (mos ndryshoni) të asaj natyrshmërie të krijuar nga Allahu”.*⁴⁷

Në burimin themelor të Islamit, në Kuran, gjejmë në shumë vende termin “kavm”, popull, komb, si:

وَمَا أَرْسَلْنَا مِنْ رَّسُولٍ إِلَّا بِلِسَانٍ قَوْمِهِ لِيُبَيِّنَ لَهُمْ

*“Ne asnjë nga të Dërguarit nuk i dërguam ndryshe vetëm në gjuhën e popullit të vet, ashtu që ai t’u shpjegojë atyre (në atë gjuhë)”.*⁴⁸

⁴⁶ El Bezar, El Bahru ez Zehar, Darul kutub el ilmije, Bejrut-Dimeshk, vëll. 11, fq. 17.

⁴⁷ Kuran, Er Rrum: 30.

⁴⁸ Kuran, Ibrahim: 4.

Nga ky citat kuranor kuptojmë edhe të drejtën për përdorimin e gjuhës së secilit popull, që është njëri prej komponentëve kryesorë të kombit. Allahu i Madhërishëm e ka marrë përsipër që të përcaktojë shkallën e së drejtës së përdorimit të gjuhës, kornizat e së cilës askush nuk bën t’i shkelë e as t’i dhunojë. Kështu në Kuran thuhet:

وَمِنْ آيَاتِهِ خَلْقُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَاخْتِلَافُ أَلْسِنَتِكُمْ وَأَلْوَانِكُمْ ۚ إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ لِّلْعَالَمِينَ

“Dhe në mesin e argumenteve të Tij, që dëshmojnë për ekzistencën e Allahut, janë edhe krijimi i qiejve dhe i tokës si dhe llojlojshmëria e gjuhëve dhe ngjyrave tuaja. Në këto pa dyshim se ka fakte për dijetarët”.⁴⁹

Vetë fakti që ky citat kuranor përmend ekzistimin e gjuhëve, të ngjyrave e të racave të ndryshme që ka në botë, na jep të kuptojmë të drejtën e njeriut për përdorimin e gjuhës amtare në rrafshet e ndryshme të jetës. Kurani i Madhërishëm, që është universal për mbarë njerëzimin, gjuha e të cilit aplikohet vetëm në rrafshet e caktuara të jetës fetare, lë hapësirë edhe për përdorimin e gjuhëve të tjera në rrafshet e ndryshme të jetës.

As’habët (shokët e Profetit Muhamed a.s.) edhe në praninë e tij shpeshherë thurnin vargje dhe poezi, duke lavdëruar kombin arab dhe atdheun e tyre, dhe Profeti nuk reagonte ndaj tyre. Kështu feja islame dhe Kurani i urdhërojnë njerëzit që të mbrojnë vendin dhe shtëpitë e veta:

أُذِنَ لِلَّذِينَ يُقَاتَلُونَ بِأَنَّهُمْ ظَلَمُوا ۚ وَإِنَّ اللَّهَ عَلَىٰ نَصْرِهِمْ لَقَدِيرٌ

“Atyre që po sulmohen me luftë, u është dhënë leja të luftojnë, për shkak se u është bërë e padrejtë, e Allahu ka fuqi për t’u ndihmuar atyre”.⁵⁰

⁴⁹ Kuran, Er Rrum: 22.

⁵⁰ Kuran, El Haxhxh: 39.

Ndërsa në ajetin tjetër thuhet:

الَّذِينَ أُخْرِجُوا مِنْ دِيَارِهِمْ بِغَيْرِ حَقٍّ إِلَّا أَنْ يَقُولُوا رَبُّنَا اللَّهُ ۗ وَلَوْلَا دَفْعُ اللَّهِ
النَّاسَ بَعْضُهُمْ بِبَعْضٍ هَادَمَتْ صَوَامِعُ وَبِيَعٌ وَصَلَوَاتٌ وَمَسَاجِدُ يُذَكَّرُ فِيهَا
اسْمُ اللَّهِ كَثِيرًا ۗ

“(U lejuan të luftojnë) ata që vetëm pse thanë: “Allahu është Zoti ynë!” , u dëbuan prej shtëpive të tyre pa kurrfarë të drejte. E sikur Allahu të mos i zmbrapste disa me disa të tjerë, do të rrënoheshin manastiret, kishat, harvat edhe xhamitë, që në to përmendet emri i Allahut”.⁵¹

Nga kjo kuptojmë se Islami e lejon mbrojtjen e atdheut, të kombit, të pasurisë, të familjes, të kulturës, të traditës, të gjuhës, por është kundër urrejtjes dhe fanatizmit ndaj të tjerëve, pavarësisht përkatësisë fetare apo kombëtare. Muhamedi a.s. thotë:

لَيْسَ مِنَّا مَنْ دَعَا إِلَىٰ عَصَبِيَّةٍ وَلَيْسَ مِنَّا مَنْ قَاتَلَ عَلَىٰ عَصَبِيَّةٍ وَلَيْسَ مِنَّا مَنْ
مَاتَ عَلَىٰ عَصَبِيَّةٍ

“Nuk është nga ne kush propagandon dhe krijon urrejtje dhe fanatizëm dhe lufton në emër të fanatizmit dhe urrejtjes dhe nuk është prej nesh ai që vdes për qëllime të fanatizmit”⁵².

Madje kur e kanë pyetur Muhamedin a.s. se a është fanatizëm kur njeriu e do kombin e vet, ai është përgjigjur “jo”, por “është fanatizëm kur dikush ndihmon popullin e vet kur ai është në rrugë jo të drejtë.” (Transmeton Ebu Davudi)⁵³.

Shprehjen e nacionalizmit apo dashurinë ndaj kombit të vet e vërejmë edhe te Pejgamberi a.s., pastaj te kalifët muslimanë, te luftëtarët e

⁵¹ Kuran, El Haxhxh: 40.

⁵² Ebu Davud, botoi, Darus Selam, Riad, nr. 5121 Ky është teksti të cilin e transmeton Ebu Davudi, ndërsa hadithe me tematikë të ngjashme transmeton Buhariu, nr. 4905 , dhe Muslimi, nr. 1850- 2584.

⁵³ Po aty.

Islamit si dhe te shokët e Profetit. Ja se si Hafiz Ali Korça e përshkruante Profetin Muhamed a.s. në vjershën e tij *“Muslimanizma dhe nasjonalizma”* dhe të ushqyerit me dashuri për kombin e vet: *“I madh peygamberi nur (dritë) i gjithësisë unë jam arab (arab) thosh faqe nje-rzisë”, Nder të math e njihte kombësinë e vetë. Që këtë e thotë Kurani vetë”. “Nasjonalist them peygamberët ishin se librat në gjuhët e veta i kishin.”*⁵⁴

Kurse për kalifin e parë musliman Ebu Bekrin r.a. dhe për ndjenjat e tij nacionaliste Hafiz Ali Korça shkruante: *“Edhe Ebu-Beqri kombin e lëvdonte, fenë-mëmëdhenë të dyja i donte”*⁵⁵.

Kurse për kalifin e dytë Omerin r.a. citonte: *“Ç’tha Omer-Faruku në hytbe një ditë, kur i jepte bindje popullit dhe dritë”. “Përgëzohem unë tha me kombësinë, ne faltë Zoti atdhen Arbërinë”*⁵⁶. Hafiz Ali Korça shokët e Pejgamberit a.s. i përshkruante me këto fjalë: *“Gjithë sahabët ishin fetarë të sakët. Secili prej syresh atdhetar m’i flakët”*.⁵⁷

⁵⁴ “Zani i Naltë”, *Muslimanizma dhe nasionalizma*, nr. 41, janar, Tiranë, 1924.

⁵⁵ “Zani i Naltë”, *Muslimanizma dhe nasionalizma*, nr. 41, janar, Tiranë, 1924, f. 105.

⁵⁶ Po aty.

⁵⁷ Po aty, f. 106.

Conclusions

The Islamic religion invites us for dialogue, for peace, for interpersonal tolerance, invites us for cooperation and international recognition of people, regardless of nation, language, race, color, country and religion, for mutual development between us in every point of view.

As a starting point, we take the Qur'an again, where it says:

قُلْ يَا أَهْلَ الْكِتَابِ تَعَالَوْا إِلَى كَلِمَةٍ سَوَاءٍ بَيْنَنَا وَبَيْنَكُمْ أَلَّا نَعْبُدَ إِلَّا اللَّهَ
وَلَا نُشْرِكَ بِهِ شَيْئًا وَلَا يَتَّخِذَ بَعْضُنَا بَعْضًا أَرْبَابًا مِنْ دُونِ اللَّهِ

Say, 'O Prophet', "O People of the Book! Let us come to common terms: that we will worship none but Allah, associate none with Him, nor take one another as lords instead of Allah."

From this point of view, we are aware, that the Qur'an requires people to adhere to the principles according to which there is no disagreement on the basis of divine faith, and these principles are: man's reverence for Allah, the need of all people for peace, without violence and without hostility; efforts for the common benefit of people in scientific, social and economic aspects; finding solutions that are in the interest of humanity.

Islam makes a step further in its relation to members of other faiths, promoting peace and peaceful resolution of issues of common interest. As for the general relations between people, Islam obliges for peace in these relations and emphasizes the causes of the division of people into nations, as a means of recognition and rapprochement between themselves, and not as a reason of division of favoring one over the other.

In this way the religion of Islam (Qur'an and Hadith) have removed from the consciousness of its believers what has been rooted in the ancient nations, and also in the consciousness of many population of today, the supremacy in dignity and rights of one nation over the other, or deprivation of their natural rights to life, liberty and independence. Islam, therefore, rejects supremacy, national nor class superiority nor racial superiority, but proclaims equality between people.

Indeed, this is the culmination of what genuine contemporary society and its thinkers aim for, and this is the last requirement that contemporaries want to include in their constitutions as natural human rights on the path to peace. Therefore, in the Islamic administration there has been no difference in rights between Muslims and non-Muslims, as there are, even today cases in many countries with different religions and multinational societies that boast of their democratic constitutions.

Burime dhe literatura:

1. Kuran.
2. H Calton Hayes, *Ese për nacionalizëm*, New York, 1926. Cítuar sipas dr. Ali Muhamed Nakavi, *Islami dhe nacionalizmi*, Prishtinë, 1997. Titulli i origjinalit, dr. Ali Muhamed Nakavi: *Islam and nationalism*, përktheu Vullnet Poshka.
3. Hans Kohn, *Ideja e nacionalizmit, Studimi mbi origjinën dhe prapaskenën e tij*, New York, 1944.
4. Dr. M. Pirraku, *Kultura Kombëtare Shqiptare deri në Lidhjen e Prizrenit*, Prishtinë, 1989.
5. Dr. Xhemua El Huli, *El Itixahat El Fikrije El Muasire, ve mevkif el Islam minha*, Medine, 1986 m-1407h.
6. Dr. A. M. Nakavi, *Islami dhe nacionalizmi*, 1997.
7. Abdullaha Nasih Ulvan, *El-Kavmijetu fi mizan el islam*, 1980.
8. Safiju Rrahman el-Mubarekfuri, *Err-rrahikul Mahtum*, Bejrut, 1988.
9. Sahih Muslim, botoi: Daru Es Selam, Riad, 2006.
10. Tirmidhiu, Darul kutub el ilmije, Bejrut-Liban, 2010.
11. Musnedi i imam Ahmedit, (redaktoi: Shuajb Arnauti) botoi, Muessesetu errisaleti, Bejrut-Liban.
12. El Bezar, El Bahru ez Zehar, Darul kutub el ilmije, Bejrut-Dimeshk.
13. Ebu Davud, botoi Darus Selam, Riad.
14. “Zani i Naltë”, *Muslimanizma dhe nasionalizma*, Tiranë, 1924.
15. <https://pashtriku.beepworld.de/>. Mr. Sabri KIÇMARI, “Kombi, definimi, tiparet dhe identiteti i Kombit”.

Dr. hfz. Safet HOXHA

TERMINOLOGJIA NË SHKENCËN E KIRAETEVE DHE NËNFUSHAVE TË SAJ

Abstrakt

Shkenca e kiraeteve (leximeve) është njëra nga shkencat më të vështira dhe më komplekse në fushën e studimeve kuranore. Përderisa studimi i saj u bë ekskluzivisht nga specialistët, ajo si lëndë nuk zbriti në nivelin e masave (publikut) dhe nuk u përhap në mesin e tyre si një kulturë, dije e zotëruar. Ndër arsyet e kësaj vështirësie është se zakonisht shoqërohet me memorizimin e Kuranit Fisnik dhe ky memorizim kërkon një përpjekje të veçantë dhe të vazhdueshme, e cila nuk është e mundur për shumë njerëz, veçanërisht në epokën tonë bashkëkohore, në të cilën mbështetja te kujtesa nuk është më një metodë edukimi dhe njerëzit kanë hequr dorë nga memorizimi për shkak të lehtësisë së kthimit të referencat e shumta që kanë në dispozicion t'i përdorin.

Për më tepër, kjo shkencë ka terma të veçantë, disa prej të cilave përfshihen në fonologji, si veçoritë e shkronjave dhe vendartikullimet e tyre, e disa prej tyre përmbajnë thelbin e vetë kësaj shkençe, të tilla si el-kirae, er-rivaje, et-tarik, el-usul, el-fersh, el-vakf, el-imal, en-nakl, etj., të cilat janë terma të shpërndarë në shkrime të ndryshme në literaturën e kiraeteve.

Dhe si një kontribut për përpjekjet e përsëritura të bëra në këtë fushë ofroi një sërë termash të shkencës së kiraeteve dhe nënfushave të saj, siç është texhvidi, resmi, adul ajeti dhe dabti, me shpresë që të ndihmohen ata që janë duke u marrë me mësimin e leximit të Kuranit.

Nga shqyrtimi që u kemi bërë rrugëve të ndërtimit të termave bazë të kiraeteve, del se një çështje me interes të veçantë studimi është rruga semantike, meqë termat e krijuar shfaqen si lidhje të gjuhës së përgjithshme me leksikon terminologjik të fushës përkatëse. Për studimin e leksikut në fjalë si leksik bazë, por edhe i përbashkët për nënfushat e tjera të kiraeteve, vlerë të veçantë merr veçimi dhe identifikimi i këtij leksiku. Një vend më vete zënë termat bazë, edhe për mjaft terminologji të fushave e nënfushave të reja të leximeve si rregullat e texhvidit, resmit etj..

***Fjalët kyçe:** kira'at, texhvid, resm, dabt, adul ajeti.*

Hyrje

Njëra nga mënyrat e drejtpërdrejta të standardizimit të terminologjisë është njësimi i termave në formë dhe në përmbajtje prej termave të shkencave të tjera. Për realizimin e kësaj detyre bashkëpunojnë gjuhëtarët, terminologët, specialistët e fushës e të tjerë.

Punimi mundohet të hedhë dritë mbi kuptimin e terminologjisë së kiraeteve dhe fushave të përfaqësuara me të, por pa u marrë me ndikimet apo huazimet, ecurinë e kësaj terminologjie dhe mbi karakteristikat e tjera.

Studimet e bëra në fushën e kiraeteve janë të pakta në shqip dhe pothuajse mungojnë. Ka studime të shumta si në fushat e tjera, por nuk ka shumë studime të mirëfillta që hulumtojnë terminologjinë e kësaj fushe.

Metodologjia e përdorur në këtë punim është metodologji e përzier, për vetë faktin që është studim përkthyes i gjuhës dhe i terminologjisë së përdorur në shkencën e kiraeteve dhe nënfushave të saj, duke mos u marrë me aspekte të ndryshme gjuhësore.

Kryesisht është bërë punë kërkimore për gjetjen e kuptimeve të termave të përdorur në këtë shkencë dhe nënfushat e saj, që edhe sot përdoren nga profesionistët e leximeve (kurrat).

Në këtë punim ne do të parashtrojmë sfondin teorik në të cilin janë mbështetur studiuesit e kiraeteve, veçanërisht hartuesit e termave të ndryshme në trajtimin e përdorimit të tyre.

Çështja e standardizimit të terminologjisë është pothuajse aq e vjetër, sa edhe vetë terminologjia dhe ka dalë si nevojë e qartësisë sa më të madhe. Standardizimi dhe normëzimi i termave në fusha të ndryshme të veprimtarisë njerëzore i ka shpënë përpara këto dhe shkencën në përgjithësi në hapërim më të shpejtë siç ndodhi edhe me kiraetet.

Këta terma, të cilët janë në gjuhën arabe, gjuhë universale e shkencës dhe e fesë, duhen standardizuar dhe përdorur në gjuhë të tjera anembanë botës, pra dhe në shqipe, që të shmangen paqartësitë në kuptim dhe që të mund të shfrytëzohen sa më mirë nga lexuesit e Kuranit.

Një terminologji e standardizuar sjell lehtësi të dukshme në përdorimin e literaturës profesionale e shkencore si dhe në komunikimet ndërmjet institucioneve shkencore të mbarë botës. Përpilimi i fjalorëve terminologjikë, veçanërisht në fushat e shkencës që nuk janë të lëvruara sa duhet, nuk është punë e lehtë; përveçse kërkon nga përpiluesi të njohë mirë fushën përkatëse, kërkon edhe mjete e kohë.

Në disa fusha të shkencës ekzistojnë rregulla të caktuara për emërtimin e përpiktë të nocioneve të asaj fushe, si dhe organizma e institucione të caktuara që merren me kodifikimin e këtyre emërtimeve.

Terminologjia profesionale është tërësia e termave të një profesioni. Çdo profesion ka terminologjinë e vet, e cila përdoret dhe kuptohet

nga njerëzit e atij profesioni dhe në shumë raste është e panjohur për njerëzit e tjerë. Mësimi i kiraeteve bëhet në dy rrugë apo metoda.

Tariku'l-Infirad: Në këtë metodë mësimdhënieje për të përfunduar studimet e kiraeteve lexohet nga një hatme për secilin rivajet, që do të thotë lexohen të njëzet rivajeteve të ndara.

Tariku'l-Indiraxh: Sipas kësaj metode bëhet vetëm një hatme, por për secilin ajet lexohen të gjitha dallimet që ndodhen në rivajete. Kështu evitohet leximi i çdo ajeti për secilin rivajet nëse nuk ka ndryshime në lexim. Sepse shumë ajete lexohen njësoj në të gjitha rivajetet. Kjo është një metodë më e shkurtër që përdoret gati në të gjitha shkollat e mësimi të kiraeteve si në nivelin e mesëm ashtu edhe në atë të lartë.

Kiraetet janë të përmbledhura në aspektin e numrit të tyre në dy tarikë rrugë (lloje):

Tariku'l-Ashera: Në Tarikun Ashera përfshihen të dhjetë imamët. Transmetimet e shtatë të parëve janë mutevatir, kurse ato të tre të fundit janë ahad.

Këtu mund të përmendim edhe ndarjen e asheras në dy lloje:

El-Asheratu's-Sugra, në të cilën studiohen vetëm dallimet në leximin e dhjetë imamëve dhe ravive të tyre. Ndryshe quhet edhe vetëm "Ashera"¹, El-Asheratu'l-Kubra, në të cilën përveç dallimeve në lexim të dhjetë imamëve dhe ravive të tyre, përfshihen edhe ato të tarikëve. Ndryshe quhet edhe "Ashera dhe Takrib".

Tariku's-Seb'a: Në Tarikun Seb'a përfshihen shtatë imamët e parë, transmetimet e të cilëve janë mutevatir.

Nga këndvështrimi i atribuimeve të kiraeteve në libra ose persona ndodhen tre tarikë:

Tariku't-Tejsir: Tariku Tejsir përfshin studimin e kiraeteve që ndodhen në veprën "Et-Tejsir" të Ed-Daniut.

¹ Muhamed Abdul Adhim Ez-Zerkanî, *Menahilul Urfan fi ulumul el-Kuran Darul ihja turathil el-arabij*, Bejrut, 1995, 1416 h, vëll. I, fq. 430-431.

Tariku'sh-Shatibijje: Tariku Shatibijje përfshin studimin e kiraeteve që ndodhen në veprën “Hirzu'l-Emani” të imam Esh-Shatibiut.

Ed-Dure el Mudije: Tre kiraete plotësim i shtatëshit të Esh-Shatibijjes nga imam Ibn el-Xhezeriu. Tariku't-Tajjibe: Tariku Tajjibe përfshin studimin e kiraeteve që ndodhen në veprën “Tajjibetu'n-Neshr” të imam Ibn el-Xhezeriut.

Terma për rangun e lexuesve të Kuranit

Dallimet mes lexuesve të Kuranit dihen në bazë të dijes që posedojnë për rivajetet e njohura të leximit të Kuranit. Kështu që një lexues rangohet sipas numrit që njihet nga këto rivajete. Ai mund të jetë:

- **El-mukriu**, i cili ka studiuar Kuranin përmendësh pastaj ka mësuar dhe përcjellë te të tjerët².
- **El-kariu** (القارئ) është ai që ka mësuar Kuranin përmendësh. El-kariu ndahet në tre grupe:
 1. El-kariu el-mubtediu (القارئ المبتدئ), ka për qëllim atë që di një deri në tre rivajete.
 2. El-kariu el-mutevesitu (القارئ المتوسط), ka për qëllim atë që di katër deri në pesë rivajete.
 3. El-kariu el-muntehi (القارئ المنتهي), ka për qëllim atë që di mbi pesë rivajete apo më të njohurat prej tyre.
- **Kurra:** Është shumësi i fjalës kariun, që do të thotë lexues, kurse në shkencën e kiraeteve, emërtohet personi që di shtatë ose dhjetë kiraete. Ky term është përdorur edhe në trevat tona për atë që ka ditur kiraetet.
- **Imam:** quhen dijetarët transmetues të kiraeteve, të cilët janë shquar në këtë fushë në një periudhë të caktuar dhe kanë fituar besimin e të

² Ahmed bin Muhamed el-Bena, *Ithaf Fudalai el-Besher fil Karaati erbeati el-Asher*, Alimul kutub, 1987, fq. 19.

gjithë dijetarëve të tjerë. Ata janë dhjetë imamë: Nafi, Ibni Kethiri, Ebu Amri, Ibni Amiri, Asimi, Hamze, Kisaiu, Ebu Xhaferi, Jakubi dhe Halefi.

- **Ravi:** Ravi do të thotë *transmetues* dhe me këtë term emërtohen nxënësit transmetues të kiraeteve të imamëve. Këta nuk janë nxënësit e tyre të vetëm, por më të spikaturit në leximin e Kuranit sipas formës që mësuesit e tyre ua kanë transmetuar tekstin kuranor. Për secilin imam janë nga dy ravij, këta janë: Kalun, Versh, Kunbul, El Bezzi, Ed-Duri, Es-Susi, Hisham, Ibni Dhekvan, Shube, Hafs, Halef, Halad, El-Lejth, Ed-Duri, Ibni Verdani, Ibni Xhemaz, Ruvejs, Revh, Is'hak dhe Idris.
- **Tariku** ashtu si çdo imam kishte nxënësin e tij, por edhe transmetuesit kanë nxënësit e tyre. Ata emërtohen me fjalën tarik, që në fjalor do të thotë rrugë. Në këtë rast, numri i secilit ravi është i kufizuar me dy, por mund të kenë edhe më tepër.

Terma sipas të cilëve cilësohet leximi i Kuranit

1. **El-kiraetu (القراءة)** quhet leximi i imamve të kiraeteve, p.sh. si kiraeti i imam Nafiut, kiraeti i imam Asimit etj..
2. **Er-rivajetu (الرواية)** quhet leximi apo transmetimi nga nxënësit e imamëve. p.sh. si rivajeti i Vershit, rivajeti i Hafsit etj..
3. **Et-tariik (الطريق)** quhet çdo lexim që është marrë nga transmetuesit-nxënësit e imamëve të kiraeteve. P.sh. si tariik el-Esbahani për transmetimin nga rivajeti i Vershit, etj..

فإن نسب الخلاف إلى الإمام يقال: قراءة، وإن نسب إلى أحد راوييه يقال:

(راوية)، وإن نسب إلى تلميذ الراوي أو من اشتهر بنقل روايته يقال: طريق³

Nëse thirret në emer të imamit i thuhet; Kiraet (lexim) nëse emërohet me njërin nga dy transmetuesit i thuhet; rivajet (transmetim). E

³ *Es-Seb'atu fi el-Kiraat*, li ibni Muxhahid, Daru Ammar, Oman, 2000, fq. 49 dhe më pas.

nëse vjen nga njëri prej nxënësve të transmetuesve, i thuhet tariik (rrugë).

4. **El-veh'h** (الوجه)⁴, dallimet në leximet e lejuara, si leximi i besmeles mes sureve, lidhja me besmele, pa besmele dhe pa besmele me sek-te etj..

Terma për rangun e vërtetësisë së leximeve

1. **Mutevatir** (المُتَوَاتِرُ) quhet kiraeti i transmetuar prej një grupi personash, të cilët e kanë të pamundur të unifikohen në gënjeshtër. Janë shtatë kiraete.
2. **Ahad** (الْأَحَادُ) është kiraeti me transmetim të saktë, por që nuk përputhet me gjuhën arabe ose me njërin prej mus'hafeve të Osmanit r.a., ose nuk është i njohur ashtu si kiraeti mutevatir. Këto janë tri kiraete.
3. **Shadh** (الشَّادُّ) është kiraeti me transmetim të pasaktë (i vetmuar). Janë katër kiraete.

Terma të përgjithshme në shkencën e kiraeteve

1. **El-usul** (الأصول)⁵ janë dispozita të rregullave të përgjithshme, si rregullat e imales, taklilit, zgjatimeve, idgameve etj..
2. **Fersh** (الفرش)⁶ janë dispozitat e leximeve sa u përket fjalëve të caktuara, si; maliki, sirat, tasla, etj..
- El-fet'h (الفتح) në këtë rast nuk nënkuptohet zanorja e shkurtër *fet'ha* (َ), por kuptohet shqiptimi i *elifit*, që bëhet afërsisht si bashkëtingëllorja A.

⁴ Ebul Fetah el-Kadij, *El-Buduru ez-Zahir'h fi el-Kiraati el-Ashir'h*, v.2, fq. 8,9

⁵ Ahmed bin Umer el-Hamevi, *El-Kavaid vel isharat fi Usulil el Kiraat*, fq. 42.

⁶ Ibn el-Xhezeri, Ebu'l-Hajr Muhammed b. Muhammed, *En-Neshr fi'Kirâeti'l-Ashr*, Dâru'l-Kutubi'l-Ilmijje, Bejrut, I-II, Lubnân-Bejrût (pa datë) I, 9.

3. **El-imaletu (الإمالة)** është përafrimi i fet'has kah kesreja, pra elifin nga jaun⁷ هي تقريب الفتحة من الكسرة، والألف من الياء⁷.
4. **Et-taklil (التقليل)** është shqiptimi i elifit mes fet'hit dhe imales, d.m.th. mes shqiptimit të qartë dhe animit kah jauni.
5. **En-nakl (النقل)** është bartja e vokalit të hemzes në shkronjën para-orake.
6. **Es-sekte (السكرت)** do të thotë heshtje dhe në terminologji quhet ndërprerja e zërit përkohësisht, por vazhdon mbajtja e frymëmarrjes së mbetur, me qëllim të vazhdimit të leximit.
7. **Et-tes'hil (التسهيل)** është shqiptimi i hemzes mes qartësisë së saj dhe vokalit të shkronjes që është e ngjitur me të me një lehtësim të saj.
8. **Es-siletu (الصلة)**⁸ ka për qëllim zgjatjen në mimin e shumësit dhe hasë së peremrit në veten e tretë njëjës.
9. **El-iskat evil hadhf (الإسقاط أو الحذف)** eliminimi i hemzes, ashtu që nuk i mbetet asnjë gjurmë.
10. **Er-revm (الروم)**⁹ bëhet me theksimin e zanores me zë të ulët aq sa e dëgjon i afërti e jo i largëti. Revmi mbahet, kur është me kesre dhe dame.
11. **El ishmam (الإشمام)** do të thotë bashkimi i buzëve pas sukunit, bëhet kur është me dame, pra kur dame nuk lexohet, por ndalemi në sukun, i cili më parë ka qenë dame. Qëllimi është për të sinjalizuar zanoren e bashkëtingëllores, po të kishte vazhduar leximi. Pra, Revmi është për dëgjim, Ishmami për shikim. Revmi sinjalizon pjesërisht zanoren. Ishmami sinjalizon vokalin e zanores po të kishte vazhduar leximi.

⁷ Ahmed bin Umer el-Hamevi, *El-Kavaid vel isharat fi usulil el kiraat*, fq. 47.

⁸ Alij Muhamed, *El-Idea fi bejan Usulil Kiraeti*, fq. 62.

⁹ Po aty, fq. 556.

Ishmami është 4 llojesh:

1. Ishmami siç ishte definicioni.
2. Bashkimi i buzëve paralel me bashkimin e shkronjave, si p.sh. **تَأَمَّنَا**. Pra, bëhet bashkimi i buzëve paralel me sukunin e nunit të parë dhe para bashkëngjitjes së nunit të dytë. Ky lloj Ishmami është sikur Ishmami në fund të shkronjës, vetëm se në këtë rast bëhet në mes të fjalës.
3. Ishmami i shkronjës me shkronjë. Kjo do të thotë përzjerja e fonemës me një fonemë tjetër, sikurse përzjerja e fonemës së shkronjës Sad me fonemën e shkronjës Zaun në **صراط** (sipas kiraetit të Hamzës).
4. Ishmami i zanores me zanore, kjo do të thotë përzjerja e fonemës së zanores së kesres me dame, si në rastin **قيل و غيض** (sipas kiraetit të Kesaiut dhe Hishamit).

Terminologjia në shkencën e texhvidit

1. **Et-texhvid** (**التَّجْوِيد**)¹⁰, respektimi i rregullave të lëximit në tërësi që janë të shtjelluara në këtë shkencë, si artikulimi i përpiktë i shkronjave, respektimi i vendndaljeve, mbajtja e tingujve siç kërkojnë rregullat e parapara me tingull hundor dhe pa të, etj..
2. **Et-tertilë** - lexim i përpiktë i rrjedhshëm si në shqiptim të shronjave ashtu dhe njohjen e vendndaljeve.
3. **Et-tahkikë** (**التَّحْقِيق**) - leximi duhet të jetë shumë më i ngadalshëm se te tertili. Kjo formë e lëximit preferohet kur profesori (hoxha) ua mëson formën e lëximit nxënësve në klasë.
4. **El-hader** (**الْحَدْر**) - lexim më i shpejtë i ajeteve faqeve të Kuranit.
5. **Et-tedvir** (**التَّدْوِير**) - lexim mes *tertilit* dhe *hadrit*, pra lexim mesatar.
6. **Et-tatriib** (**التَّطْرِيب**) - lexim sipas tonaliteteve muzikore.

¹⁰ Ibni el-Xhezeri, *Et-Temhid Fi ilmi et-Texhvid*, Muesesetu el Kurtube, Kajro, 2001, fq. 49.

7. **Et-tahziin** (التَّحْزِين) - lexim në vaj sikur po qan.
8. **Et-te'asuf** (التَّعْسُف) - lexim me mundim apo artikulum shumë i theksuar i shkronjave.
9. **Et-tefkik** (التَّفْكِك) - ndërpreja e theksit në shkronjat e fjalës.
10. **Et-ter'aid** (التَّرْعِيد) - dridhje në të lexuar sikur po belbëzon. Kjo hyn në ndalesat e leximit.¹¹
11. **Et-terkis** (التَّرْقِيس) - leximi sipas notave muzikore të rimuara si këndoinë këngëtarët.
12. **El istiadhe** (الاستعاذة) - leximi i formulës *eudhu bilahi mine shejtani rrahim*.
13. **El besmele** (البسملة) - leximi i formulës *Bismilahi er-Rrahmani er-Rahim*.
14. **El siletu** (الصلة)¹² - ka për qëllim zgjatjen në mimin e shumësit dhe ha-së së peremrit në vetën e tretë.
15. **El idgam** (الإدغام) - shkrirja e një shkronje në tjetrën. Idgami ndahet në idgam el-kebir, që është kur shkronja e parë është e vokalizuar dhe bëhet idgam në tjetrën. Ky idgam gjendet te rivajeti i es-Susiut, ndërsa idgam es-sagir shkronja e parë është me sukun dhe shkrihet në tjetrën, ky idgam gjendet te të gjitha rivajetet pos atij që u cek më parë.
16. **El med** (المد)¹³ - zgjatimet, në terminologji med do të thotë zgjatja e zërit në tri shkronjat zgjatuese (و، ي، ا).
17. **El-lijnë** do të thotë lehtësi, butësi apo artikulimi i shkronjës në vendin e tij me lehtësi, me butësi, pa shtrëngim dhe pa preokupim të gjuhës هو إطالة الصوت بأحد حروف المد واللين .
- **El mutasil** (المد المتصل) - zgjatimi i ngjitur kur hemzeja vjen pas vokalit të gjatë në të njëjtën fjalë

¹¹ Ebul Fetah es-Sejid Axhemi, *Hidajetu el-Karii*, el-Mursefî, fq. 105-108.

¹² Ibrahim Atvetu Aved, *Mukadimetu ibrazi el-meanii sherh es-Shatibijeti*, Kajro, 1997, fq. 13.

¹³ Dr. Abul Aziz el-Kariu, *Kasidetani fi tevidi el-Kur'an*, Darul el-Kutubi'el-Ilmijje, Bejrut, 2002, fq. 9.

18. **El munfasil (المد المنفصل)** - zgjatimi i ndarë, kur hemzeja vjen pas vokalit të gjatë në tjetrën fjalë.
19. **El bedel (البدل)** - zgjatimi i zëvendësimit bëhet kur hemzeja vjen në fillim të fjalës, zgjatet dy tone të të gjitha rivajetet, pos Vershit, i cili e zgjat 2, 4, 6, tone.
Sukuni është shkaktar i dy zgjatimeve të tjera, e ato janë medi ived (i kompensimit) dhe medi arid (للعرض) i rastit (këto zgjatime bëhen vetëm në të ndalur, ndërsa nëse vazhdohet leximi nuk bëhet zgjatim fare, por këndohet shkurt (kasr).
20. **Medi ferk (مد الفرق)** - zgjatimi i dallimit. Ferk do të thotë dallim, për të dalluar formën lajmëruese me formën pyetëse, atëherë e zgjasim aq shumë (6 vokale), edhe pse është hemzetul vasli (i cili bën lidhjen), e gjatë lidhjes kërkon shkurtimin, pra jo zgjatimin në këto raste, obligohet që sa më shumë të zgjatet.
21. **Medi temkin (مد التمكين)** - zgjatimi i shkoqitjes, kur dy jaun pranë njëra-tjetrës ose dy “va va” (për të mos i bashkëngjitur, atëherë e zgjasim për t’i dalluar.
22. **Medi et-te’adhim (مد التعظيم)**, zgjatimi i madhërimit, ndryshe quhet zgjatim i hiperbolizimit, pra kur të jetë emri i Allahut me fet’ha këndojmë gjatë, e zgjasim atë. “Në esencë fet-hatun këndohet shkurt, mirëpo e këndojmë gjatë për të demonstruar zëshëm madhështinë e Zotit.
23. **Medi lazim (المد اللازم)** - është zgjatje e domosdoshme, quhet lazim për arsye se u ndalëm apo e vazhduam leximin, patjetër duhet të zgjatet 6 vokale.
Medi lazëm është dy llojesh: i fjalëve dhe i shkronjave.
24. **El vakf (الوقف)**¹⁴, ndalim i leximit, quhet ndërprerja e përkohshme e frymëmarrjes dhe leximit me qëllim që të vazhdohet prej aty ose

¹⁴ Po aty.

- të përsëritet ndonjë fjalë para vendit të ndalimit. Ndalimi bëhet në fund të ajetit si dhe në mes të ajetit, por nuk bëhet në mes të fjalës.
25. **Kat'ë** (القطع), përfundimi i leximit, do të thotë ndërprerja e leximit deri në leximin e ardhshëm, pra ndërprerja e leximit e kalimit në një veprim tjetër, kur për fillimin e leximit të sërishëm kërkohet leximi i istiadhes.
26. **Iklabi** (الاقلاب)¹⁵ do të thotë shndërrim i nuni sukunit dhe tenvinit në shkronjën Mim, kur ndodhen para ب, pa marrë parasysh a janë në një fjalë apo dy.
27. **Ihfa** (الإخفاء) do të thotë mbulim apo fshehje e shkronjës duke e ruajtur gunnen-tingullin hundor, para shkronjave të ihfas, në mënyrë të tillë që të qëndrojnë mes idhharit dhe idgamit.¹⁶
28. **El kalkaleh** (القلقلة) kuptohet shpërthimi i shkronjës gjatë shqiptimit, me kusht që shkronja të jetë me sukun burimor ose të rastit.¹⁷
29. **El xhehr** (الجُهر)¹⁸ të dukshme të hapta janë shkronjat për shkak të mbështetjes së fuqishme në vendnyjëtimin e tyre.
30. **El hems** (الهَمْس) ka kuptimin e qarkullimit të lirshëm të rrymës së ajrit me rastin e nyjëtimin të tingullit, për shkak të mbështetjes së dobët të organeve në pengesën ku shqiptohet shkronja.
31. **El sheddetu** (الشَّدَّة) shqiptimi i fortë për shkak të qarkullimit të rrymës së zërit me rastin e shqiptimit të tingullit.
32. **El rehavetu** (الرَّخَاوَةُ) d.m.th lëvizje e lirshme e rrymës së zërit me rastin e nyjëtimin të tingullit, për shkak të mbështetjes së dobët në vendin ku përfitohet bashkëtingëllorja dhe të pamundësisë së ngushtimit të rrymës së ajrit në të.

¹⁵ Prof. Ahmed bin Ahmed bin Muhamed Abdilah et-Tavijl, *Fenut tertil ve ulu-muhuu*, f. 779.

¹⁶ Imad Ali Xhumah, *Ahkamu et-Tilaveti ve Texhvidi el-Mujessiri*, f. 22.

¹⁷ Abdurrahman bin Seidilah Ijtani, *El muftjd fi ilmi et-texhvid*, Darul Furkan Oman, 2001, f.142.

¹⁸ *En-Neshr fi kiraati el ashere Darul Fikr* (pa datë), fq. 387, 393.

33. **El isti'lau** (الاستيلاء) ka kuptimin e zbritjes së gjuhës nga qiellza në pozitën e vet normale, me rastin e shqiptimit të tingullit.
34. **El itbak** (الاطباق) - ka të bëjë me mbylljen, me puqjen, me ngjitjen, me bashkimin ndërmjet dy gjërave, ka kuptimin e ngritjes së prapashpinës së gjuhës dhe mesit të saj në qiellzë, duke e bërë mbylljen deri në atë shkallë, saqë mes tyre rrymës së zërit i pamundësohet qarkullimi i tij i lirë.
35. **El infitah** (الانفتاح) - ka të bëjë me ndarjen, me shkëputjen etj., ky term përkufizohet me krijimin e një shtegu mes gjuhës dhe qiellzës së sipërme gjatë nyjëtimit të tingullit bashkëtingllor në mënyrë që aty rryma e zërit të mos hasë në pengesë dhe as të mos ngushtohet.
36. **El idhlak** (الاذلاق) - ka të bëjë me diçka të zëshme, të mprehtë, të rrjedhshme, të shpejtë etj., ka kuptimin e nyjëtimit të zëshëm, të shpejtë dhe të rrufeshëm të tingujve bashkëtingllorë, për shkak të nyjëtimit të tyre në majën e gjuhës, ose në dy buzët.
37. **El ismat** (الاصمات) - ka të bëjë me ndalesën, me pengimin etj., ka kuptimin e tingujve bashkëtingëllorë të shurdhët, të cilëve u ndalohet ndërtimi i fjalëve përtej tri bashkëtingëllorëve, nëse nuk marrin pjesë asnjë nga tingujt e zëshëm e të rrjedhshëm.
38. **Es-safir** (الصَّافِرُ) - ka të bëjë me një zë të hollë e fishkëllyes, i cili përftohet në mes të dhëmbëve të poshtëm dhe të sipërm si dhe majës së gjuhës, duke u ngushtuar aty shtegu i rrymës së zërit.
39. **El-lin** (اللِّينُ) - ka kuptimin e nyjëtimit shumë të lehtë dhe pa kurrfarë ngarkese në organet përkatëse të tingujve وُ dhe ي .
40. **El inhiraf** (الانحراف)¹⁹ - ka të bëjë me shmangien e rrymës së zërit të tingullit në vendnyjëtimit të tij, për mosqarkullim të tij të plotë, për shkak të rezistencës së gjuhës në pozitën e vet, e cila dikton që zëri të përcillet nga të dyja anët e gjuhës.

¹⁹ Imad Ali Xhumah, *Ahkamu et-telavetu ve texhvid el-mujessira*, Daru Nefais, 2004, fq. 35.

41. **Et-tekrir** (التكرير) - ka të bëjë me dridhjen e anësoreve të gjuhës me rastin e nyjëtimit të tingullit ر , duke i prekur trysat e dhëmbëve të sipërm dy ose tri herë. Mënyra e ruajtjes nga përsëritja e këtij tingulli bashkëtingëllor realizohet duke kontaktuar fuqishëm majën e gjuhës me trysat e sipërme të dhëmbëve vetëm një herë deri në atë shkallë sa të pengohet vazhdimësia e përsëritjes me rastin e shqiptimit të tij.
42. **Et-tefeshi** (التفشي) - ka kuptimin e shpërndarjes së ajrit dhe të zërit në mes gojës dhe qiellzës së sipërme me rastin e nyjëtimit të tingullit ش , përderisa të shtrihet deri te vendnyjetimi i tingullit ظ , më konkretisht deri te dhëmballët e dhëmbëve të sipërm.
43. **El istitaletu** (الاستطالة) - ka kuptimin e shtrirjes së vendit të nyjëtimit dhe bashkë me të, edhe të rrymës së zërit, që nga fillimi i dy skajeve të gjuhës ose të njëjës prej tyre, derisa të lidhen në vendin e nyjëtimit të tingullit ل . Bashkëtingëllorja që ka këtë tipar qenësor është shkronja ض .

Terminologjia e adul ajetit dhe dabit

1. **El fasiletu** (الفاصلة)²⁰ është fjala e fundit në ajete. Po ashtu quhet edhe *er-ru'us el-ajeti*, kryet e ajeteve هي آخر كلمة في الآية، ويعبر عنها برأس الآية
2. **Ed-dabtu** (الضبط)²¹ çdo shenjë në mus'haf e cila është shtuar (në shkrimin e parë) si vokalizimi, pikëzimi dhe shenjat e tjera të zgjatjes.
3. **Es-shekl** (الشكل) vënia e shenjave të vokaleve. I pari që ka vendosur shenjat e vokaleve ka qenë Ebu Esved ed-Duelij. Pozita e saj është kompozicioni, forma. Thuhet *شُكِّلَ الْكِتَابُ* - e ka formësuar lib-

²⁰ Abdu Rrezak bin Alij Musa, *Murshidul Hulan*, fq. 30.

²¹ Ebul Fetah el-Kadij, *Nefa'isu el-Bejan*, fq. 25-26.

rin, që do të thotë e ka përmbledhur atë, e ka përpiluar atë në atë formë të përkryer në renditje dhe përmbajtje²².

4. **El i'xham (الإعجام)** është pikëzimi i jashtëm (الإعجام) i origjinës së shkronjës (bazës së shkronjës), e cila na jep të kuptojmë dallimin ndërmjet shkronjave, si p.sh. shkronja ت T dhe ث Th dallimi në mes tyre dhe shkronjes ث që i është shtuar një pikë më shumë për ta dalluar.
5. **Nukat (نُقَاطٌ)** pikat, pikëzimi është i prejardhur prej pikëzimit të shkronjës, që do të thotë pjesë e përbërjes së saj. Pikë në njëjës dhe pikat në shumës, nga rrjedhin pikat e mus'hafit تَنْقِيطٌ, që do të thotë pikat نُقَاطٌ²³.
6. **El ardatul e'hira (العرضة الأخيرة)** me këtë ka për qëllim leximin e fundit nga Xhebraili a.s. tek i Dërguari i Allahut a.s. dhe ai është leximi i vërtetuar në mus'hafet tani.

يُقصد بهذا المصطلح آخر قراءة أقرأها جبريل عليه السلام رسول الله صلى الله عليه وسلم، وهي القراءة المثبتة في المصاحف اليوم

7. **El imam (الإمام)**²⁴ është quajtur mus'hafî që u ruajt tek Othmani r.a.

المصحف الذي بقي عند الخليفة عثمان بن عفان - رضي الله عنه.

8. **Er-resm (الرَّسْم)**²⁵ është forma e shkrimit të mushafit i cili u shkruajt në kohën e h. Othmanit r.a.

²² *Mu'xhemul Vesit- muxhma el-Lugatul Arabijeh* (1/491), botimi i Devhas.

²³ Ibni Mendhur, *Lisanul Arab*, Darul Mearif 2011 (9/294), pjesa e pikave.

²⁴ Ibrahim bin Ahmed, *Delil el-Hajran ala Mevrid edh-Dhm'an fi feni er-Resmi ve ed-Dabti*, v. 1, fq. 25.

²⁵ Salih Muhamed Salih Atije, *Resmul mus'haf, ihsaun ve dirasetun*, Tarabulus, 2001, v. 2, fq. 45.

Terminologjitë e vokalizimit

1. Vendosja e një zeroje të rrumbullakët në formë sukuni (°) mbi shkronjën e mangët, e cila nënkupton se ajo shkronjë është e tepërt në tekst dhe nuk lexohet fare, as kur është në lidhje me fjalinë tjetër e as kur është në ndalje, p.sh.: ²⁶ **أُولَئِكَ يَتْلُوا صُحُفًا** ²⁷ **بَنَيْنَاهَا بِأَيْدٍ**
2. Vendosja e një zeroje të zgjatur në formë vertikale (ٓ) mbi *elif* dhe pas tij vjen shkronja e vokalizuar, në këtë rast ajo zero (ٓ) tregon për shkronjën shtesë (të tepërt), që gjatë leximit lidhet dhe nuk ndahet në të, si p.sh.: ²⁸ **أَنَا خَيْرٌ مِّنْهُ** ²⁹ **لَكِنَّا هُوَ اللَّهُ**
3. Vendosja e shkronjës *Ha* (ح) të vogël (pa pikë) mbi çdo shkronjë, quhet sukun dhe lexohet veç shkronja. si p.sh.: ³⁰ **قَدْ سَمِعَ**
4. Shkrija e shkronjës, e cila është me *sukun* në shkronjën që pason dhe që bëhet me *teshdid*, në këtë rast e para hyn në shkronjën e dytë dhe kështu formohet një shkrije e tërsishme, p.sh.: ³¹ **أَجِيبَتْ دَعْوَتُكُمَا**
5. Shkrija e shkronjës kur vjen shkronja pas saj pa *teshdid* do të thotë shkrija e shkronjës së parë në të dytën, e kjo është *idgam nakis* (shkrije e mangët) si p.sh.: ³² **إِنَّ رَبَّهُم بِهِمْ**
6. Vendosja e shkronjës (م) të vogël në vend të zanores së dytë që është me tenvin ose mbi shkronjën nun (ن) dhe mosdyfishimi i shkronjës (ب) do të thotë transferim i *tenvinit* (dyfishimit) dhe shkronjën nunun (ن) në shkronjën mim (م) si p.sh.: ³³ **عَلِيمٌ بِذَاتِ الصُّدُورِ**
7. Vendosja e dy zanorëve mbi njëra-tjetrën³⁴ si (dy fet'ha, dy dame, dy kesre) **— ٓ —** tregon shqiptim të qartë, p.sh.: ³⁵ **سَمِيعٌ عَلِيمٌ**

²⁶ Kuran, Edh-Dharijat: 47.

²⁷ Kuran, El-Bejjine: 2.

²⁸ Kuran, El-A'raf: 12.

²⁹ Kuran, El-Kehf: 38.

³⁰ Kuran, El-Muxhadele: 1.

³¹ Kuran, En-Nur: 33.

³² Kuran, El-Adijjat: 11.

³³ Kuran, Al-Imran: 119.

³⁴ Salih Muhamed Salih Atije, Resmul mus'haf, ihsaun ve dirasetun, v. 2, fq. 239.

³⁵ Kuran, El-Bekare: 181.

8. Pasimi i të dy zanorëve kështu: ۞ dhe vendosja e *teshdidit* në fjalën tjetër tregon shkrirjen e plotë të saj, si p.sh.: حُشِبٌ مُسْنَدَةٌ³⁶
9. Pasimi i të dy zanorëve pa *teshdid* do të thotë një shkrirje e mangët-e e pjesëshme, p.sh.: شَهَابٌ ثَاقِبٌ³⁷ وَجُوهٌ يَوْمِئِذٍ³⁸
10. Shkronjat e vogëla në formë simbolesh, në afërsi të shkronjës bu-rimore në mus'hafin e Othmanit r.a. nënkuptojnë leximin e saj të domosdoshëm, si p.sh.: ذُلِكَ الْكِتَابُ³⁹ يَلُؤُونَ أَلْسِنَتَهُمْ⁴⁰. Dijetarët (hu-lumtuesit) në fushën e vokalizimit gjithnjë këto simbole i kanë da-lluar me ngjyrë të kuqe nga shkronjat e mus'hafit, që është me ngjyrë të zezë, mirëpo shtypshkronjat moderne i kanë bërë më të vogla në mënyrë që të tregojnë qëllimin e tyre.

Në qoftë se vendoset shkronja *sin* (س) përfundi shkronjës *sad* (ص) nënkupton shqiptimin me *sin* (س) në të veçantë, si p.sh.: أَلْمُصَيِّطُونَ, e nëse është mbi, tregon shiptimin me *sad*, ndonëse në disa mus'haf është e kundërta.⁴¹

13. Vendosja e këtij simboli (لآ) do të thotë një zgjatim shtesë nga zgjatimi natyral si p.sh.: أَلْم⁴²
14. Rrethi me një zbrazetirë në mes (◉) në të cilin shkruhet numri nënkupton përfundimin e ajetit dhe njëherazi numëron ajetet në sure, si p.sh.:

إِنَّا أَعْطَيْنَاكَ الْكُوثَرَ ◉ فَصَلِّ لِرَبِّكَ وَأَحْزَرَ ◉ إِنَّ شَانِئَكَ هُوَ الْأَبْتَرُ ◉⁴³

Ky simbol nuk lejohet të vendoset para ajetit, por ky simbol vjen gjithnjë pas ajetit, siç nuk gjejmë në fillim të asnjë sureje, por në përfundim të çdo sureje.

³⁶ Kuran, El-Munafikun: 4.

³⁷ Kuran, El-Gashije: 8.

³⁸ Kuran, Es-Safat: 10.

³⁹ Kuran, El-Bekare: 2.

⁴⁰ Kuran, Al-Imran: 78.

⁴¹ Kuran, Et-Tur: 37.

⁴² Kuran, El-Bekare: 1.

⁴³ Kuran, El-Kevther

15. Shenja e shumëkëndëshit me një rreth të zbrazur në mes (◊) nënkupton fillimin e çdo xhuzi, pjese, çereku apo pjese të tekstit të mus’hafit.
16. Vendosja e një vije horizontale mbi fjalën sexhde nënkupton domosdoshmërinë e të bërit sexhde.
17. Vendosja e simbolit në formë të *mihrabit* (ﷻ) mbas fjalisë nënkupton vendin e të bërit sexhde, si p.sh:
- وَلِلَّهِ يَسْجُدُ مَا فِي السَّمٰوٰتِ وَمَا فِي الْاَرْضِ مِنْ دَابَّةٍ ۙ وَالْمَلٰٓئِكَةُ وَهُمْ
لَا يَسْتَكْبِرُوْنَ ﴿٥٥﴾ يَخَافُوْنَ رَبَّهُمْ مِّنْ فَوْقِهِمْ وَيَفْعَلُوْنَ مَا يُؤْمَرُوْنَ ﴿٥٤﴾
18. Vendosja e një pike të llojit të veçantë (◊) nën shkronjën ر si në fjalën e Allahut xh.sh.: lexohet me imale: بِسْمِ اللّٰهِ جَرَّلَهَا.⁴⁵
19. Vendosja e një pike të llojit të veçantë gjithashtu mbi pjesën e fundit të shkronjës م dhe shkronjës ن të dyfishuara si në ajetin: مَالِكٌ لَا تَأْمَنَّا عَلَىٰ يُوسُفَ⁴⁶ nënkupton ishmamin.
20. Vendosja e një rrethi (•) të rrumbullakët të mbyllur (pikë e madhe), ky simbol është vendosur mbi *hemzen* e dytë në fjalën e Allahut xh.sh.:⁴⁷ ءَاعْجَمِيَّ وَعَرَبِيَّ që nënkupton tes’hilin (se na jep një mundësi lehtësuese në shqiptim mes *hemzes* dhe *elifit*).
21. Vendosja e shkronjës س në shkronjën e mbrame në disa fjali nënkupton leximin me sekte.

⁴⁴ Kuran, En-Nahl: 49-50.

⁴⁵ Kuran, Hud: 41.

⁴⁶ Kuran, Jusuf: 11.

⁴⁷ Kuran, Fusilet: 44.

Shenjat që tregojnë ndalim apo vazhdim të leximit

Gjatë leximit të Kuranit do të hasim mbi disa shenja që tregojnë a është mirë të ndalemi a të mos ndalemi, si p.sh.:

- * Në fund të çdo ajeti mund të ndalemi pa marrë parasysh shenjat. ﴿ ose ﴿ është i njëjtë me pikën tonë (.) dhe vjen në fund të çdo ajeti.
- * م , tregon se të ndalurit në atë fjalë është i domosdoshëm.
$$إِنَّمَا يَسْتَجِيبُ الَّذِينَ يَسْمَعُونَ وَالْمَوْتَى يَبْعَثُهُمُ اللَّهُ ⁴⁸$$
- * لا , tregon se nuk guxojmë të ndalemi, por nëse jemi ndalur, duhet përsëri ta lexojmë atë fjalë në vazhdim të dytë, përveç nëse është në fund të ajetit.
$$ثُمَّ لَا يُتَّبِعُونَ مَا أَنْفَقُوا مَنَّا وَلَا أَدَّى لَهُمْ أَجْرُهُمْ عِنْدَ رَبِّهِمْ ⁴⁹$$
- * ج , tregon lejueshmërinë e ndaljes dhe mosndaljes.
$$وَاعْلَمُوا أَنَّ فِيكُمْ رَسُولَ اللَّهِ لَوْ يُطِيعُكُمْ فِي كَثِيرٍ مِنَ الْأَمْرِ لَعَنِتُّمْ ⁵⁰$$
- * قلى , tregon se ndalimi është shumë i përshtatshëm.
$$قُلْ رَبِّي أَعْلَمُ بِعِدَّتِهِمْ مَا يَعْلَمُهُمْ إِلَّا قَلِيلٌ قلى فَلَا تَمَارٍ فِيهِمْ ⁵¹$$
- * صلى , tregon se është mirë të vazhdojmë.
$$قُلْنَا اهْبِطُوا مِنْهَا جَمِيعًا صلى فَإِنَّمَا يَأْتِيَنَّكُمْ مِنِّي هُدًى ⁵²$$
- * : : tri pika të përsëritura dy herë tregojnë se nëse ndalemi në fjalën e parë, mos të ndalemi në të dytën, e nëse në të parën nuk ndalemi, të ndalemi në të dytën.
$$ذَلِكَ الْكِتَابُ لَا رَيْبَ فِيهِ هُدًى لِّلْمُتَّقِينَ ⁵³$$
- * مد , tregon se harfi nën të cilin qëndron kjo shenjë duhet lexuar gjatë dhe shenja
- * قصر tregon se harfi nën të cilin qëndron kjo shenjë duhet lexuar shkurt.

⁴⁸ Kuran, El-En'am: 36.

⁴⁹ Kuran, El-Bekare: 262.

⁵⁰ Kuran, El-Huxhurat: 7.

⁵¹ Kuran, El-Kehf: 22.

⁵² Kuran, El-Bekare: 38.

⁵³ Kuran, El-Bekare: 2.

Përfundim

Kuptimet e kësaj terminologjie janë komplekse (jashtëgjuhësore dhe brendagjuhësore) dhe kërkojnë të bëhen studime të veçanta të gjera e të thella. Nga sa thamë më lart del se lënda e gjerë dhe e pasur që përmendëm krijon mundësinë për ta studiuar atë dhe për të nxjerrë edhe rrugët për përzgjedhjen e një pjese prej termave të shqipëruar si lexim, shkrirje, fshehje, lehtësim etj.. Studimin e kemi mbështetur me literaturë perkatëse dhe përmes shqyrtimit të saj kemi nxjerrë në dukje arritjet e terminologjisë në përgjithësi, në tri apo katër nënfusha të kërkuara, sipas autorëve kryesorë të tyre. Pra, argumenti thelbësor i këtij punimi mbështetet në idenë kryesore se arritjet më të shënuara të terminologjisë duhet të jenë baza e duhur shkencore e të gjitha dijeve të njësuar, që duhet të marrin nxënësit përmes leximeve në këto fusha.

Abstrakt

Each science has its terminology, and the term is the key to the sciences, and the science of Qur'anic readings has its own terms that show the truth of this noble science, and reveal its spaces, and related issues and investigations. This is the collection of terms related to the science of Qur'anic readings. I have made efforts to mention them briefly without much elaboration.

Literatura:

1. Ahmed bin Umer el-Hamevi, *El-Kavaid vel isharat fi usulil el kiraat*, Darul le-Fikr, Damask, 1996.
2. Abul Fetah el-Kadij, *El-Buduru ez-Zahir'h fi el-Kiraati el-Ashir'h*, Daru Ammar, Oman, 2000.
3. Ahmed bin Muhamed el-Bena, *Ithaf Fudalai el- besher fil karaati erbeati el-ashere*, Alimul kutub, 1987.
4. Alij Muhamed, *El-Idea fi bejan Usulil Kiraeti*, Mektebetu el Ezher, 1991.
5. Abdurrahman bin Seidilah Ijtani, *El mufid fi ilmi et-texhvid*, Darul Furkan Oman, 2001.
6. Imad Ali Xhumah, *Ahkamu et-telavetu ve texhvid el-mujessira*, Daru Nefais, 2004
7. Abdu Rrezak bin Alij Musa, *Murshidul Hulan*, Darul Furkan, Oman, 1999.
8. Ahmed bin Ahmed bin Muhamed Abdilah et-Tavil, *Fenut tertil ve ulumuhu*, Darul kutub, 2001.
9. Dr.Abul Aziz el-Kariu, *Kasidetani fi texhvidi el-Kur'an Darul el-Kutubi'el-Ilmije*, Bejrut, 2002.
10. *Menahilul Urfan fi ulumul el-Kuran*, Muhamed abdul Adhim Ez-Zerkanî, Darul ihja turathil el-arabij, Bejrut, 1995, 1416 h.
11. Ibni El-Xhezeri, *Et-Temhiid Fi almi e-Texhvid*, Muesesetu el kurtube, Kajro, 2001.
12. Ibn el-Xhezerî, Ebu'l-Hajr Muhammed b. Muhammed, *en-Neshr fi '-Kirâeti'l-Ashr*, Darul Fikr (pa datë).
13. Ibrahim Atvetu Aved, *Mukadimetu ibrazi el-meanii sherh es-Shatibijeti*, Kajro, 1997.
14. Ibrahim bin Ahmed, *Delil el-Hajran ala Mevrid edh-Dhm'an fi feni er-Resmi ve ed-Dabti*, Darul kutub ilmije, Bejrut, 1996.
15. Sujutij, *El-Itkan fi ulumul el-Kuran*, Darul el-Kutubi'el-Ilmije, Bejrut, 1996.
10. Mexhmaul Vesiit, *Mexhma el-Lugat el-Arabijeh*, botimi i Devhas, 2002.
16. Ibni Mendhur, *Lisanul Arab*, Darul Mearif, 2011.
17. Salih Muhamed Salih Atije, *Resmul mus'haf, ihsaun ve dirasetun*, Tarablus, 2001.
18. *Es-Seb'atu fil el-Kiraat*, li ibni Muxhahid, Daru Ammar, Oman, 2000.

Prof. ass. dr. Zija ABDULLAHU

KONCEPTI KURANOR NDAJ “*TJETRIT*”

Abstrakt

Kurani famëllartë erdhi për rregullimin e jetës së myslimanëve, por assesi nuk e anashkaloi jetën njerëzore, kështu që shpalli rregulla, norma e ligje për të gjithë njerëzit, qofshin ata besimtarë të besimit islam apo jo.

Madje myslimanit në mënyrë graduale ia bëri të qartë se si të sillet me *tjetrin*. Duke filluar nga tërheqja e vëmendjes se i tërë njerëzi mi është i një origjine, pastaj se Zoti është jo vetëm mëshirues i njerëzisë, por i tërë gjithësisë. Në vazhdim, ia përkujton nderin e njeriut, që e posedon vetëm si qenie njerëzore, pa marrë parasysh besimin e tij. Dallimet njerëzore qofshin në besim, gjuhë, komb e racë janë për ta begatuar jetën njerëzore duke e shtuar bashkëpunimin ndërnjerëzor. Ky dallim duhet të respektohet sepse është vullnet hyjnor. Ishte dëshirë e Tij që të ketë dallime ndërmjet njerëzve dhe çdo orvatje e njeriut për ta zhdukur këtë dallim, qoftë edhe me dhunë, ka qenë e dështuar. Duke pasur parasysh gjithë këto çështje, të cilat nuk mund të tejkalohen, Allahu xh.sh. vendosi norma ndaj tjetrit, të cilave myslimani duhet t’u përmbahet, siç janë liria e besimit dhe e adhurimit, bashkëpunimi në të mirë dhe dobi të të dy palëve dhe largimi nga çdo marrëdhënie që çon në dëm. Madje, edhe në ndihmën e tyre, kushdo qofshin ata, qofshin edhe idhujtarë e jo vetëm ithtarë të Librit, nën kushtëzimin e mos-

armiqësisë ndaj myslimanëve. Më pastaj, drejtësia ndaj tyre, edhe atëherë kur myslimani është i mllëfosur ndaj tyre, vazhdon me përmbajtjen ndaj marrëveshjeve që ka bërë me ta dhe me ftesë për dialog në çështje në të cilat mund të jetë dobia e të dy palëve, por pse jo edhe në çështje të besimit, nëse shfaqet interesim për të.

Fjalët kyçe: *Tjetri, Kuran, origjinë njerëzore, normë, liri, bashkëpunim, dialog.*

Hyrje

Kurani fisnik ndonëse iu shpall mbarë njerëzimit, tashmë konsiderohet si libër i veçantë i myslimanëve, duke i udhëzuar në njohjen e Zotit një dhe adhuruar vetëm Atë. Në të gjenden urdhëresa e ndalesa, norma e ligje për sjelljen ndërmjet myslimanëve.

Megjithëse Kurani është i myslimanëve dhe për myslimanët, kjo a do të thotë se trajtesat e tij izoloohen vetëm brenda rrethit të tyre apo i tejkalon kufijtë e rrethit të tyre dhe flet për mbarë njerëzimin, pra, flet edhe për “tjetrin”¹, që nuk është mysliman? Kurani si e shikon, sa e pranon dhe si e konsideron *tjetrin*? Meqë për myslimanët posedon ligje dhe norma, sa e përfshijnë *tjetrin* këto ligje dhe norma? Si i udhëzon myslimanët të sillen dhe bashkëpunojnë me *tjetrin*? Deri ku shtrihen kufijtë e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit me *tjetrin*? Apo myslimani tërësisht është i lirë në sjelljet e tij me tjetrin, qoftë në aspektin pozitiv qoftë në atë negativ?

Këto përgjigje dhe shqyrtime të tjera ndaj tjetrit do t’i shohim në trajtesat kuranore ndaj tjetrit dhe udhëzimet e normat që ia caktoi myslimanit në sjelljet e tij me tjetrin, duke mos ia lënë atë dëshirës dhe te-kave të tij momentale, apo nënshtrimit ndaj situatës në të cilën gjendet.

¹ Me *tjetrin* nënkuptohet çdo njeri tjetër që nuk është i besimit islam, pa marrë parasysh besimin tjetër të cilit i takon, është fetar, ateist apo idhujtar.

1. Përkujtimi i origjinës së njëjtë njerëzore

Kurani famëlartë përpos udhëzimeve, urdhëresave, normave dhe ligjeve që ka vendosur për marrëdhëniet ndërmjet myslimanëve, vendosi edhe norma e ligje për myslimanin se si duhet të sillet me "tjetrin", që nuk është mysliman. Para së gjithash ai është libër dhe normë për mbarë njerëzimin, duke i ftuar të gjithë njerëzit që ta pranojnë nënshttrimin ndaj Zotit një dhe vetëm Atë ta adhurojnë. Kurani myslimanët i udhëzon dhe i orienton që të tjerët t'i trajtojnë sa më butë dhe sa më mirë, pa marrë parasysh besimet e tyre, sepse njerëzorja është thelbi ku bazohen marrëdhëniet e njeriut me njëri-tjetrin.

Duke u nisur nga ky këndvështrim gjithëpërfshirës njerëzor, Kurani famëlartë ia përkujton myslimanit origjinën e përbashkët të njeriut dhe se ai edhe nëse ndryshon në besim, kulturë komb e racë, krijimin e ka të së njëjtës origjinë, si në të kaluarën edhe në të tashmen dhe të ardhmen. Në ajetin vijues, para se t'ia shpalosë njeriut origjinën e elementit të krijimit, sikur ia bën me dije se këtë njohuri njeriu nuk do ta arrijë përpos me lexim. Para së gjithash e urdhëron të lexojë e më pastaj ia drejton vëmendjen tek origjina e përbashkët njerëzore. Allahu xh.sh. thotë:

﴿افْرَأْ بِاسْمِ رَبِّكَ الَّذِي خَلَقَ (۱) خَلَقَ الْإِنْسَانَ مِنْ عَلَقٍ﴾

"Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (gjithçka), e krijoi njeriun nga një droçkë gjaku!"²

Pra, Kurani fisnik që nga ajetet e para të shpalljes së tij e përgatiti myslimanin që të jetë i nivelit universal e të mos mbyllet vetëm në rrethin e ngushtë të shoqërisë së tij besimtare, por i foli për mbarë njerëzimin, duke ia përkujtuar origjinën e njëjtë të të gjithë njerëzve dhe se mbarë njerëzimi ka vetëm një esencë. Çdo njeri para së gjithash duhet të trajtohet si njeri, pa marrë parasysh dallimet në besime, raca, kombe, gjuhë dhe regjione gjeografike. Allahu xh.sh. thotë:

² Kuran, El-Alak: 1-2.

﴿حَمْدُ اللَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ﴾

“Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve!”³

Ky ajet shkon edhe më tutje, e tejkalon gjininë njerëzore duke përfshirë tërë gjithësinë, me tërë krijesat që gjenden në të. Ai është Zot i të gjitha botëve, është Krijuesi, Mëshiruesi dhe Furnizuesi i të gjithëve. “Është Zot i besimtarit dhe i jobesimtarit. Ai i solli të gjithë në këtë ekzistencë, prandaj u jep nga begatitë e Tij me mëshirën që ka ndaj tyre, e jo me atë që meritojnë... Dielli lind për besimtarin dhe jobesimtarin... nuk i ndalon rrezet për jobesimtarin e t’ia japë vetëm besimtarit. Shiu bie për atë që e adhuron Zotin dhe për atë që adhuron idhujt e jo Zotin! Ajrin e thith si ai që thotë: Nuk ka zot tjetër pos Allahut, si ai që nuk e thotë: Të gjitha begatitë janë dhunti e zotimit të Allahut në këtë botë për të gjithë krijesat e Tij, kjo është mëshirë... Pra, Allahu është Zot i të gjithëve, i atyre që e adhurojnë dhe i atyre që mëkatojnë, edhe kjo është mëshirë. Allahu po ashtu është pranues i pendimit, që është mëshirë...”⁴ Ky ajet lexohet në çdo rekat në pesë kohët e namazit, duke ia përkujtuar besimtarit mes të tjerash edhe vullnetin dhe mëshirën e Tij që ka ndaj të gjitha krijesave. Pra, besimtarit nuk i mbetet tjetër pos ta respektojë atë vullnet të Tij, t’i nderojë krijesat e Tij dhe t’i mëshirojë ato sepse që të gjithë janë krijuar vetëm nga Zoti dhe të gjithë kanë një Zot të vetëm, janë të vetëdijsëm për këtë krijesat e tjera apo jo. Në një ajet tjetër Allahu xh.sh. këtë çështje e bën edhe më të qartë, ku thotë:

﴿يَا أَيُّهَا النَّاسُ اتَّقُوا رَبَّكُمُ الَّذِي خَلَقَكُمْ مِنْ نَفْسٍ وَاحِدَةٍ وَخَلَقَ مِنْهَا زَوْجَهَا وَبَثَّ مِنْهُمَا رِجَالًا كَثِيرًا وَنِسَاءً...﴾

“O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj, i Cili ju krijoi prej një njeriu, ndërsa prej atij krijoi bashkëshorten e tij, kurse prej këtyre të dyve krijoi shumë burra e gra...”⁵

³ Kuran, El-Fatiha: 2.

⁴ Muhammed Muteveli-i esh-Sha’ravi, *Tefsiru’l havatir*, Ahbaru’l Jevm, Kairo, 1997, v. I, f. 54.

⁵ Kuran, En-Nisa: 1.

Edhe në këtë ajet Allahu xh.sh. na tërheq vëmendjen e origjinës së mbarë njerëzimit, ngase i tërë njerëzimi, sado që është shtuar me burra e gra, kishte një baba e një nënë. Me këtë mënyrë ajeti përveç të tjerash na zbut zemrat për afrim ndaj njëri-tjetrit në të gjitha mënyrat e mundshme të afrimit. Ndërsa në ajetin vijues e specifikon nderin që i është bërë njeriut, vetëm ngase qenia e tij është njerëzore dhe thotë:

﴿وَلَقَدْ كَرَّمْنَا بَنِي آدَمَ وَحَمَلْنَاهُمْ فِي الْبَرِّ وَالْبَحْرِ وَرَزَقْنَاهُمْ مِنَ الطَّيِّبَاتِ
وَفَضَّلْنَاهُمْ عَلَى كَثِيرٍ مِمَّنْ خَلَقْنَا تَفْضِيلًا﴾

“Në të vërtetë, Ne i kemi nderuar bijtë e Ademit: ua kemi bërë të mundur që të udhëtojnë në tokë dhe në det, u kemi dhënë ushqime të mira e të lejuara dhe i kemi ngritur lart mbi shumë prej atyre që kemi krijuar”.⁶

Ajeti konfirmon dinjitetin dhe nderin njerëzor. Ky nderim iu dhurua nga Zoti i botëve, ndaj nuk ka të drejtë askush t’ia cenojë këtë nder e dinjitet sepse njeriu tashmë e posedon atë si qenie njerëzore. Prandaj, shprehjet e përdorura në zhanrin politik, “ua kemi dhënë të drejtat pakicave, komuniteteve e grupeve etnike të ndryshme”, janë manipulim fjalësh ngase njeriu vetë i posedon këto të drejta, vetëm si qenie njerëzore, të dhuruara nga Zoti i Lartmadhërishëm. Askush nuk ka të drejtë t’i konsiderojë të drejtat e njeriut si meritë e tij e veçantë që ia dhuroi *tjetrit*, ashtu siç nuk ka të drejtë ta konsiderojë rrogën e punëtorit si dhuratë dhe lëmoshë, sepse në realitet ajo është meritë dhe hak i tij. Në suren Huxhurat, Allahu xh.sh. na tregon diversitetin njerëzor në raca, popuj e kombe të ndryshme, dallime ndërnerëzore që ekzistojnë për t’i shërbyer njohjes dhe bashkëpunimit me njëri-tjetrin: Allahu xh.sh. thotë:

⁶ Kuran, El-Isra: 70.

﴿يَا أَيُّهَا النَّاسُ إِنَّا خَلَقْنَاكُمْ مِنْ ذَكَرٍ وَأُنْثَىٰ وَجَعَلْنَاكُمْ شُعُوبًا وَقَبَائِلَ لِتَعَارَفُوا إِنَّ أَكْرَمَكُمْ عِنْدَ اللَّهِ أَتْقَاكُمْ إِنَّ اللَّهَ عَلِيمٌ خَبِيرٌ﴾

*“O njerëz! Në të vërtetë, Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë popuj e fise, për ta njohur njëri tjetrin. Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij. Vërtet, Allahu është i Gjithëdijshtëm dhe për Atë asgjë nuk është e fshehtë”.*⁷

Allahu xh.sh. në këtë ajet jo vetëm që na rikujton origjinën e përbashkët nga prindi i parë i tërë njerëzimit, që është nxitje për afrim sa më të madh, por, për më tepër, larminë dhe dallueshmërinë ndër popuj e fise e konsideron si begati njerëzore për ta njohur sa më shumë njëri-tjetrin, për rrjedhojë, për të bashkëpunuar sa më ngushtë me njëri-tjetrin. Ndërkohë na tërheq vëmendjen dhe na largon nga ndjenja e superioritetit ndaj njëri-tjetrit, si palë, fis, popull, komb e racë pos me devotshmëri, cilësi e cila pandërprerë e nxit njeriun në atë që është më e dobishme për mbarë njerëzinë. Ndërsa në ajetin vijues na kujton origjinën e besimit të përbashkët të të gjithë Pejgamberët e Allahut. Allahu xh.sh. thotë:

﴿أَمِنَ الرَّسُولُ بِمَا أُنزِلَ إِلَيْهِ مِنْ رَبِّهِ وَالْمُؤْمِنُونَ كُلٌّ آمَنَ بِاللَّهِ وَمَلَائِكَتِهِ وَكُتُبِهِ وَرُسُلِهِ لَا نُفَرِّقُ بَيْنَ أَحَدٍ مِنْ رُسُلِهِ وَقَالُوا سَمِعْنَا وَأَطَعْنَا غُفْرَانَكَ رَبَّنَا وَإِلَيْكَ الْمَصِيرُ﴾

*“I Dërguari beson në atë (Kuranin) që i është shpallur nga Zoti i tij e po ashtu dhe besimtarët: të gjithë besojnë në Allahun, engjëjt e Tij, librat e Tij dhe të Dërguarit e Tij (duke thënë): “Ne nuk bëjmë dallim mes asnjërit prej të Dërguarve të Tij”. Ata thonë: “Ne dëgjojmë dhe bindemi. Faljen Tënde kërkojmë, o Zoti Ynë dhe te Ti do të kthehemi!”.*⁸

⁷ Kuran, El-Huxhurat: 13.

⁸ Kuran, El-Bekare: 285.

Edhe në këtë ajet Allahu xh.sh. përpos që e përmend, mes të the-rash, besimin në Pejgamberë si kusht që duhet ta ketë doemos çdo be-simtar, gjithashtu na bën me dije se besimtari nuk mund të bëjë dallime ndërmjet Pejgamberëve të Zotit. Si rezultat i kësaj premise del që ata nuk bëjnë dallime ndërmjet popujve të ndryshëm, sepse siç dihet, ata erdhën në kohëra, vende dhe popuj të ndryshëm.

2. Dallimet ndërnjerëzore janë vullnet i Zotit

Ndër çështjet që shumë njerëz i konsiderojnë si të huaja dhe të papranuara edhe është ajo e dallueshmërisë së *tjetrit*, qoftë në besim, kulturë, komb dhe racë. Në realitet, kjo çështje është aq faktike dhe ak-tuale saqë nuk ka mundësi ikjeje prej saj, deshëm apo s'deshëm, pra-ndaj duhet pranuar si e tillë. Sepse nuk ka mundësi të ndodhë shfarosja e *tjetrit*, që para se gjithash është akt antinjerëzor, por edhe historia e ka dëshmuar se çdo tentativë e tillë është absurditet i llojit të vet. Për më tepër, Allahu xh.sh. myslimanit ia bën me dije se këto dallime ekzi-stuese ndërmjet njerëzve janë vullnet i Tij dhe se çdo kundërshtim ndaj këtij realiteti është kundërshtim ndaj vullnetit hyjnor. Allahu xh.sh. thotë:

﴿لِكُلِّ جَعَلْنَا مِنْكُمْ شِرْعَةً وَمِنْهَاجًا وَلَوْ شَاءَ اللَّهُ لَجَعَلَكُمْ أُمَّةً وَاحِدَةً وَلَكِنْ لِيَبْلُوَكُمْ فِي مَا آتَاكُمْ فَاسْتَبِقُوا الْخَيْرَاتِ إِلَى اللَّهِ مَرْجِعُكُمْ جَمِيعًا فَيُنَبِّئُكُمْ بِمَا كُنْتُمْ فِيهِ تَخْتَلِفُونَ﴾

"...Ne për secilin nga ju kemi sjellë një ligj dhe një rrugë të qar-të. Sikur të donte Allahu, do t'ju kishte bërë një popull të vetëm, por Ai kërkon që t'ju provojë në atë që ju ka dhënë, andaj bëni gara për punë të mira! Të gjithë do të ktheheni tek Allahu e Ai do t'ju lajmërojë për çështjet, rreth të cilave kishit kundërshti".⁹

⁹ Kuran, El-Maide: 48.

Allahu xh.sh. nëse do të dëshironte të mos ekzistonin këto dallime, do ta bënte njerëzimin një popull në të gjitha kohërat. Po ashtu do t'i detyronte të gjithë në Islam, por vullneti i Tij ishte që njerëzit të jenë të lirë dhe të kenë ligje të ndryshme për çdo kohë dhe vend dhe t'i sprovojë me atë që ua ka dhënë, a do ta pasojnë rrugën e vërtetë apo do të devijojnë nga rruga e drejtë? Pra, këto dhunti duhet të shfrytëzohen dhe të garohet gjithmonë në vepra të mira, pa marrë parasysh dallimet njerëzore, më e rëndësishmja është që vepra të cilësohet si e mirë¹⁰. Ajeti në vazhdim e bën edhe më të qartë këtë çështje, ku Allahu xh.sh. thotë:

﴿وَلَوْ شَاءَ رَبُّكَ لَجَعَلَ النَّاسَ أُمَّةً وَاحِدَةً وَلَا يَزَالُونَ مُخْتَلِفِينَ (١١٨)﴾
 ﴿إِلَّا مَنْ رَحِمَ رَبُّكَ...﴾

“Sikur të kishte dashur Zoti yt, të gjithë njerëzit do t'i bashkonte në një bashkësi të vetme, por ata vazhdojnë të jenë të përçarë, përveç atyre, që i ka mëshiruar Zoti yt...”¹¹

Pra, vullneti i Zotit ishte që njerëzit të jenë të ndryshëm, sepse nëse Ai do të dëshironte të kundërtën, do t'i detyronte në një bashkësi të vetme dhe nuk do të kishin zgjedhje tjetër, siç nuk u la zgjedhje krijesave të tjera pos njeriut dhe xhinëve. Duke filluar nga melaqet, që nuk kanë liri zgjedhjeje, e më pastaj e tërë gjithësia është e tillë, nuk ka liri për ta ndjekur apo jo përcaktimin e Allahut xh.sh. sepse të gjitha krijesat në të janë të detyruara t'i përmbahen caktimit të Allahut të Plotfuqishëm. Dielli patjetër lind në momentin e caktuar dhe çdo planet e yll tjetër e ka orbitën e vet që duhet ta ndjekë, madje çdo gjallesë tjetër në tokë i nënshtrohet plotësisht përcaktimit të Allahut, përpos njeriut, i cili është i lirë ta ndjekë udhëzimin hyjnor apo jo, ta adhurojë Zotin apo jo, të bashkëpunojë me të tjerët apo jo. Prandaj i tërhiqet vëmend-

¹⁰ Nasirud-din Abdullah el-Bejdavi, *Envaru't-tenzili ve esraru't-te'vil*, Daru ihjai et-turathi'l-arabi, Bejrut, 1997, v. II, f. 129.

¹¹ Kuran, Hud: 118-119.

ja, për përgjegjësinë që ka ndaj së vërtetës dhe kërcënimit që e pret nëse largohet nga ajo.

Në një ajet tjetër Allahu xh.sh. na bën me dije në mënyrë edhe më të prerë se gjuhët dhe racat e ndryshme që ekzistojnë në mesin e njerëzve, njëkohësisht jo vetëm janë dëshirë e Tij, por janë edhe shenja të cilat na udhëzojnë në njohjen dhe afrimin sa më të madh ndaj Tij sepse në mbarë njerëzimin, me tërë këta miliarda njerëz, nuk mund të gjenden dy njerëz identikë me njëri-tjetrin. Allahu xh.sh. thotë:

﴿وَمِنْ آيَاتِهِ خَلْقُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَاخْتِلَافُ أَلْسِنَتِكُمْ وَأَلْوَانِكُمْ إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ لِّلْعَالَمِينَ﴾

“Ndërmjet shenjave të Tij janë krijimi i qiejve e i Tokës dhe shumëllojshmëria e gjuhëve dhe e ngjyrave (racave) tuaja. Pa dyshim, në këtë ka shenja për ata që dinë”.¹²

Pra, dallueshmëria e njerëzve nuk është vetëm në besim, por edhe në gjuhë e raca të ndryshme. Ekzistimi i mijëra e mijëra gjuhëve dhe i miliarda fytyrave të ndryshme në realitet tregon diturinë dhe fuqinë absolute të Allahut të Lartmadhëruar, që njerëzve t’ua dhurojë këto ndryshime për një jetë sa më të lehtë në njohjen e njëri-tjetrit dhe afirmimin e personaliteteve vetjake.

Në ajetin vijues përpos atyre dallimeve, na tregon edhe dallimin që ka bërë Allahu xh.sh. me mëshirën e Tij ndërmjet njerëzve në aspektin e posedimit të pasurisë, i cili në fakt duhet të shërbejë për shfrytëzim të shërbimeve ndaj njëri-tjetrit dhe kurrsesi për epërsi apo mendjemadhësi. Allahu xh.sh. thotë:

¹² Kuran, Er-Rum: 22.

﴿أَهُمْ يَقْسِمُونَ رَحْمَةَ رَبِّكَ نَحْنُ قَسَمْنَا بَيْنَهُمْ مَعِيشَتَهُمْ فِي الْحَيَاةِ الدُّنْيَا وَرَفَعْنَا بَعْضَهُمْ فَوْقَ بَعْضٍ دَرَجَاتٍ لِيَتَّخِذَ بَعْضُهُمْ بَعْضًا سُخْرِيًّا وَرَحْمَةُ رَبِّكَ خَيْرٌ مِمَّا يَجْمَعُونَ﴾

*“A thua ata e përcaktojnë mëshirën e Zotit tënd? Ne kemi përcaktuar ndër ta gjendjen e jetës në këtë botë; Ne kemi dalluar disa në shkallë më të lartë se të tjerët, që të shfrytëzojnë njëri-tjetrin për shërbime. E mëshira e Zotit tënd është shumë më e dobishme se ajo që ata grumbullojnë”.*¹³

Aspektin e shërbimit dhe të bashkëpunimit me njëri-tjetrin e shpjegojnë edhe më hollësisht ajeti tjetër, ku Allahu xh.sh. thotë:

﴿...وَتَعَاوَنُوا عَلَى الْبِرِّ وَالتَّقْوَىٰ وَلَا تَعَاوَنُوا عَلَى الْإِثْمِ وَالْعُدْوَانِ وَاتَّقُوا اللَّهَ إِنَّ اللَّهَ شَدِيدُ الْعِقَابِ﴾

*“... ju bëjnë popuj e fise, për ta njohur njëri tjetrin. Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij. Vërtet, Allahu është i Gjithëdijshtëm dhe për Atë asgjë nuk është e fshehtë”.*¹⁴

3. Caktoi qëndrimin e myslimanit ndaj tjetrit

Pas atyre sqarimeve dhe shpjegimeve të ekzistimit së dallueshmërisë ndërmjet njerëzve, qoftë në besim, gjuhë, kombe, popuj e raca, dhe se e tërë ajo ishte vullnet hyjnor, myslimanit nuk i mbetet tjetër pos ta pranojë atë vullnet dhe t’i nënshtrohet atij plotësisht. Në vazhdim na e sqaron se çfarë qëndrimi duhet të ketë myslimani ndaj tjetrit.

¹³ Kuran, Ez-Zuhruf: 32.

¹⁴ Kuran, El-Maide: 2.

3.1. Në lirinë e besimit

Mund të themi se liria e besimit është çështje më e theksuar e lirisë së njeriut, madje, ajo është një shenjë e theksuar e dallimit të njeriut nga krijesat e tjera fizike. Për më tepër, dinjiteti njerëzor thuajse qëndron i tëri në këtë liri. Allahu xh.sh. e sqaron se e vërteta është vetëm nga Zoti, megjithatë ndaj kësaj të vërtete njeriu është tërësisht i lirë, ta pranojë apo refuzojë, por do të bartë pasojat e mosnënshtrimit ndaj saj. Allahu xh.sh. thotë:

﴿وَقُلِ الْحَقُّ مِنْ رَبِّكُمْ فَمَنْ شَاءَ فَلْيُؤْمِنْ وَمَنْ شَاءَ فَلْيُكْفُرْ إِنَّا أَعْتَدْنَا لِلظَّالِمِينَ نَارًا أَحَاطَ بِهَا بِمِ سُرَادِقُهَا...﴾

“Dhe thuaj: “E vërteta është nga Zoti juaj. Kush të dojë, le të besojë e kush të dojë, le të mohojë” Ne kemi përgatitur për mohuesit keqbërës një zjarr, që do t’i rrethojë nga të gjitha anët...”¹⁵

Allahu xh.sh. po ashtu thotë:

﴿لَا إِكْرَاهَ فِي الدِّينِ قَدْ تَبَيَّنَ الرُّشْدُ مِنَ الْغَيِّ...﴾

“Në fe nuk ka dhunë, sepse tashmë është dalluar e drejta nga e shtrembra!...”¹⁶

Pra, njeriu tërësisht është i lirë dhe askush nuk ka të drejtë ta dhunojë atë për pranimin e asaj të vërtete, sepse kjo liri është dëshirë hyjnore. Vetë Zoti nuk deshi ta detyronte njeriun në besim, por ia ofroi të gjitha argumentet e së vërtetës, e nëse ai dëshiron, e pranon e nëse jo, e mohon. Por, gjithsesi pas këtij nderimi, me afrimin e argumenteve dhe respektimin e lirisë së tij, ai përsëri është kryeneç, atëherë pa dyshim pason edhe përgjegjësia në botën tjetër.

Në ajetin vijues sqarohet edhe më shumë liria e besimit dhe dëshira e Allahut për ta lënë njeriun tërësisht të lirë ta zgjedhë besimin e tij. Allahu xh.sh. thotë:

¹⁵ Kuran, El- Kehf: 29.

¹⁶ Kuran, El-Bekare: 256.

﴿وَلَوْ شَاءَ رَبُّكَ لَأَمَنَّ مَنْ فِي الْأَرْضِ كُلَّهُمْ جَمِيعًا أَفَأَنْتَ تُكْرِهُ النَّاسَ حَتَّى
يَكُونُوا مُؤْمِنِينَ﴾

“Sikur të donte Zoti yt, do të besonin të gjithë ata që gjenden në tokë. Vallë, ti do t’i detyrosh njerëzit të bëhen besimtarë?!”¹⁷

Dëshira e Zotit është absolutisht për ta lënë njeriun të lirë në zgjedhjen e tij sepse në të kundërtën do të detyronte mbarë njerëzimin t’i nënshtrohet besimit ndaj Tij. Për më tepër, në këtë ajet Allahu xh.sh. sikur e qorton Pejgamberin a.s. në mënyrë indirekte për tentimin e bërë ndaj njerëzve që të bëhen besimtarë. Orvatjen e tij, nga dhembshuria që kishte për njerëzit që të mos shkonin në xhehenem, gati Allahu e konsideroi si mënyrë të dhunës, ndaj ajeti përfundon me pyetje mohuese ndaj detyrimit¹⁸.

3.2. Në lirinë e adhurimit

Pos lirisë së besimit, Allahu xh.sh. na mëson se *tjetrit* i takon edhe liria e adhurimit, këtë përmes një sureje të plotë, me kusht që as myslimanët mos të bëjnë adhurimet e tyre dhe as ata adhurimet e myslimanëve as në të tashmen dhe as në ardhmen, por secili le t’i përmbahet fesë së tij. Allahu xh.sh. thotë:

﴿قُلْ يَا أَيُّهَا الْكَافِرُونَ (١) لَا أَعْبُدُ مَا تَعْبُدُونَ (٢) وَلَا أَنْتُمْ عَابِدُونَ مَا
أَعْبُدُ (٣) وَلَا أَنَا عَابِدٌ مَا عَبَدْتُمْ (٤) وَلَا أَنْتُمْ عَابِدُونَ مَا أَعْبُدُ (٥) لَكُمْ
دِينُكُمْ وَبِي دِينِ (٦)﴾

“Thuaj: "O ju jobesimtarë! Unë nuk adhuroj atë që ju e adhuroni! As ju nuk jeni adhurues të Atij që unë e adhuroj! Dhe unë kurrë nuk do të jem adhurues i asaj që ju adhuroni! Por edhe ju

¹⁷ Kuran, Junus: 99.

¹⁸ Shih: Tefsiru’l Kurtubi, *El-Xhamiu li ahkami’l Kuran*, Daru’l kutubi’l misrije, Kajro, 1384h./1964, v. III, f. 385.

nuk do të jeni adhurues të Atij që unë e adhuroj! Ju keni fenë tuaj (që i përmbaheni), e unë kam fenë time (që i përmbahem)!"¹⁹

3.3. Në bashkëpunim në të mirë dhe dobi

Meqë Allahu xh.sh. na e sqaroi qëndrimin që duhet të kenë myslimanët ndaj besimit dhe adhurimeve të *tjerëve*, në vazhdim na nxit për bashkëpunim dhe mënyrën e tij që duhet ta kemi ndërmjet nesh. Ai bashkëpunim duhet të përqendrohet mbi baza të interesit të ndërsjellë, që është gjithmonë e mira, devotshmëria, paqja dhe mirësjellja e assesi e keqja, mëkati dhe armiqësia. Allahu xh.sh. thotë:

﴿...وَتَعَاوَنُوا عَلَى الْبِرِّ وَالتَّقْوَىٰ وَلَا تَعَاوَنُوا عَلَى الْإِثْمِ وَالْعُدْوَانِ وَاتَّقُوا اللَّهَ ۖ إِنَّ اللَّهَ شَدِيدُ الْعِقَابِ﴾

*“...Ndihmojeni njëri-tjetrin në punë të mira dhe në të ruajturit nga të këqijat dhe jo në gjynahe dhe armiqësi! Frikësojuni Allahut, sepse Ai dënon ashpër”.*²⁰

3.4. Në ndihmë të tyre nën kushtëzimin e mosarmiqësisë

Nëse myslimanët nuk gjejnë dorën e shtrirë të bashkëpunimit në të mirë dhe devotshmëri sepse *tjetri* mund të jetë inferior apo nuk do afërim, në këtë rast a duhet t’i kthehen me të njëjtën mënyrë? Deri ku janë kufijtë e shtrirjes së dorë së bashkëpunimit me *tjetrin*? Çfarë e ndalon myslimanin që sjelljet e tij t’i ndryshojë me *tjetrin* duke e shkëputur bashkëpunimin në të mirë me atë? Ajetet në vazhdim e sqarojnë në mënyrë të detajuar këtë çështje, ndaj Allahu xh.sh. thotë:

¹⁹ Kuran, El- Kafirun: 1-6.

²⁰ Kuran, El-Maide: 2.

﴿لَا يَنْهَاكُمُ اللَّهُ عَنِ الَّذِينَ لَمْ يُفَاتِلُوكُمْ فِي الدِّينِ وَلَمْ يُخْرِجُوكُمْ مِنْ دِيَارِكُمْ أَنْ تَبَرُّوهُمْ وَتُقْسِطُوا إِلَيْهِمْ إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ الْمُقْسِطِينَ﴾ (٨) إِنَّمَا يَنْهَاكُمُ اللَّهُ عَنِ الَّذِينَ قَاتَلُوكُمْ فِي الدِّينِ وَأَخْرَجُوكُمْ مِنْ دِيَارِكُمْ وَظَاهَرُوا عَلَىٰ إِخْرَاجِكُمْ أَنْ تَوَلَّوهُمْ وَمَنْ يَتَوَلَّهُمْ فَأُولَٰئِكَ هُمُ الظَّالِمُونَ ﴿

“Allahu nuk ju ndalon të bëni mirë dhe të mbani drejtësi me ata që nuk ju luftuan për shkak të fesë, e as nuk ju dëbuan prej shtëpive tuaja Me të vërtetë, Allahu i do të drejtët. Allahu ju ndalon t’i bëni miq ata që luftojnë kundër jush për shkak të fesë dhe ju dëbojnë nga vatrata tuaja, si dhe mbështesin të tjerët që t’ju dëbojnë. Kushdo që i bën miq ata, është punëmbropshtë”.²¹

Pra, Allahu xh.sh. kërkon nga myslimani që ai përherë të jetë në ndihmën e tyre, përderisa ata nuk tregojnë armiqësi praktike ndaj tij duke ia luftuar fenë dhe duke e dëbuar nga shtëpia apo i mbështesin të tjerët, në këtë rast nuk ndihmohen. Madje edhe miqësia me ta nën rrethanat e armiqësisë tregon tradhti ndaj myslimanëve, prandaj të tillët konsiderohen si zullumqarë. Duke mos harruar që në çdo rast myslimani duhet të jetë i drejtë dhe të ketë sjellje të drejta sepse pikërisht këto cilësi i do Allahu xh.sh. prej tij.

3.5. Kjo ndihmë është edhe për idhujtarët (*mushrikët*)

Siç dihet në shariatën islam idhujtarët e Librit kanë një trajtim më të veçantë në krahasim me idhujtarët, megjithatë një sjellje korrekte dhe një ndihmë e tillë nuk vlen vetëm ndaj tyre, por edhe ndaj tërë racës njerëzore edhe atëherë kur ata janë idhujtarë. Atyre jo vetëm u duhet ofruar strehim kur e kërkojnë një gjë të tillë (në marrëdhëniet ndërkom-bëtare kërkesë azili), por edhe duhen siguruar duke e përcjellë deri në një vend të sigurt, ku nuk u kanoset jeta. Allahu xh.sh. thotë:

²¹ Kuran, El-Mumtehane: 8-9.

﴿وَإِنْ أَحَدٌ مِنَ الْمُشْرِكِينَ اسْتَجَارَكَ فَأَجِرْهُ حَتَّى يَسْمَعَ كَلَامَ اللَّهِ ثُمَّ أَبْلِغْهُ مَأْمَنَهُ ذَلِكَ بِأَنَّهُمْ قَوْمٌ لَا يَعْلَمُونَ﴾

“Nëse ndonjë nga idhujtarët kërkon mbrojtje nga ti (Muhamed), mbroje, në mënyrë që të dëgjojë fjalën e Allahut, e pastaj përcille në vendin e tij të sigurt. Kështu duhet, sepse ata janë njerëz që nuk dinë”.²²

4. Të zbatohet drejtësia ndaj tyre

Drejtësia në Islam ka një pozitë të lartë, ndaj duhet të shfaqet dhe realizohet në çdo sjellje të myslimanit. Prandaj ajetet që kanë të bëjnë me drejtësinë nuk janë vetëm sqaruese për dobinë e saj, por janë urdhëruese, që na jep të kuptojmë se çështja nuk i përket fare dëshirës njerëzore, por asaj hyjnore, ndaj është urdhër i prerë që nuk lë asnjë dilemë për dëshirën e zbatimit apo jo! Pra, pa marrë parasysh se kush qëndron përballë myslimanit, është besimtar apo jo, është nga ithtarët e Librit apo jo, ai duhet të jetë i drejtë sepse kushti kryesor për të qenë i drejtë ndaj tjetrit është që të jetë njeri. Pra, myslimani është i detyruar të sillet me drejtësi ndaj mbarë njerëzisë. Allahu xh.sh. thotë:

﴿إِنَّ اللَّهَ يَأْمُرُكُمْ أَنْ تُؤَدُّوا الْأَمَانَاتِ إِلَىٰ أَهْلِهَا وَإِذَا حَكَمْتُمْ بَيْنَ النَّاسِ أَنْ تَحْكُمُوا بِالْعَدْلِ إِنَّ اللَّهَ نِعِمَّا يَعِظُكُمْ بِهِ إِنَّ اللَّهَ كَانَ سَمِيعًا بَصِيرًا﴾

“Allahu ju urdhëron që amanetet t’jua ktheni atyre që u përka-sin dhe, kur të gjykoni midis njerëzve, të gjykoni drejt. Vërtet, Allahu ju këshillon mrekullueshëm dhe vërtet, Allahu dëgjon çdo gjë dhe vështron të gjitha punët”.²³

²² Kuran, Et-Tevbe: 6.

²³ Kuran, En-Nisa: 58.

Në ajetin tjetër thotë:

﴿إِنَّ اللَّهَ يَأْمُرُ بِالْعَدْلِ وَالْإِحْسَانِ وَإِيتَاءِ ذِي الْقُرْبَىٰ وَيَنْهَىٰ عَنِ الْفَحْشَاءِ
وَالْمُنْكَرِ وَالْبَغْيِ يَعِظُكُمْ لَعَلَّكُمْ تَذَكَّرُونَ﴾

*“Në të vërtetë, Allahu urdhëron drejtësinë, mirësinë dhe ndihmën për të afërmit, si dhe ndalon imoralitetin, veprat e shëmtuara dhe dhunën. Ai ju këshillon, në mënyrë që ju t’ia vini veshin”.*²⁴

Në këtë ajet Allahu xh.sh. përpos urdhrit me drejtësi, ia bashkëngjet edhe atë të mirësisë, ndihmës së dhënies të “afërmit” pa e përcaktuar besimin e tij, duke ndaluar nga veprat e shëmtuara, të irrituara dhe dhuna sepse ato sjellin vetëm shkatërrim dhe jo përmirësim dhe vetëm e degradojnë qenien njerëzore, nuk e ngrënë në nivelin që e meriton.

Në ajetin tjetër po ashtu vjen urdhri për drejtësi. Allahu xh.sh. thotë:

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا كُونُوا قَوَّامِينَ لِلَّهِ شُهَدَاءَ بِالْقِسْطِ وَلَا يَجْرِمَنَّكُمْ شَنَاٰنُ قَوْمٍ عَلَىٰ أَلَّا تَعْدِلُوا اعْدِلُوا هُوَ أَقْرَبُ لِلتَّقْوَىٰ وَاتَّقُوا اللَّهَ إِنَّ اللَّهَ خَبِيرٌ بِمَا تَعْمَلُونَ﴾

*“O besimtarë! Bëhuni të qëndrueshëm në urdhrat e Allahut dhe bëhuni dëshmues me drejtësi! Le të mos ju nxisë urrejtja ndaj njerëzve për të bërë padrejtësi. Bëhuni të drejtë, se kjo është më afër devotshmërisë dhe frikësojuni Allahut! Pa dyshim, Allahu është i Dijshëm për çdo gjë që punoni ju”.*²⁵

Në këtë ajet, përpos që i urdhëron myslimanët që të jenë të drejtë, i urdhëron po ashtu që të jenë dëshmitarë të së drejtës, madje, edhe atëherë kur këta kanë mllef ndaj tjetrit për një shkak apo tjetër. Pra, edhe në raste të tilla myslimani është i urdhëruar që të sillet me drejtësi sepse ajo është më afër devotshmërisë së Allahut. Ajeti përfundon duke ia

²⁴ Kuran, El-Nahl: 90.

²⁵ Kuran, El-Maide: 8.

bërë me dije njeriut se ai është nën mbikëqyrjen e Allahut dhe nën dritën e Tij, prandaj duhet të jetë i kujdesshëm ndaj këtyre urdhrave.

Në ajetin vijues Allahu xh.sh. kërkon nga myslimani në mënyrë edhe më të hollësishme që ta zbatojë drejtësinë dhe ta deklarojë atë edhe atëherë kur ka të bëjë me ndonjë të afërm të tij sepse zbatimi i drejtësisë është besë me Allahun, ndaj nuk duhet harruar. Allahu xh.sh. thotë:

﴿...وَإِذَا قُلْتُمْ فَاعْدِلُوا وَلَوْ كَانَ ذَا قُرْبَىٰ وَبِعَهْدِ اللَّهِ أَوْفُوا ذَلِكُمْ وَصَّاكُمْ بِهِ لَعَلَّكُمْ تَذَكَّرُونَ﴾

"...Kur të flisni, thoni të vërtetën, qoftë edhe për të afërmit tuaj! Plotësojani besën e dhënë Allahut! Këto ju porosit Ai që të mos harroni".²⁶

5. Përmbajtja ndaj marrëveshjeve me ta

Pos drejtësisë që kërkohet nga myslimani, që ta zbatojë atë në situatat dhe rrethanat e ndryshme në të cilat gjendet, me mikun e me armikun, ai urdhërohet që t'u përmbahet marrëveshjeve që bën me *tjetrin* sepse vepron në emër të Allahut dhe Allahun e bën si garantues apo dorëzënë, prandaj çdo marrëveshje duhet zbatuar me përpikëri. Allahu xh.sh. thotë:

﴿وَأَوْفُوا بِعَهْدِ اللَّهِ إِذَا عَاهَدْتُمْ وَلَا تَنْقُضُوا الْأَيْمَانَ بَعْدَ تَوْكِيدِهَا وَقَدْ جَعَلْتُمُ اللَّهَ عَلَيْكُمْ كَفِيلًا إِنَّ اللَّهَ يَعْلَمُ مَا تَفْعَلُونَ﴾

"Zbatoni besëlidhjen e Allahut, kur ta merrni mbi vete dhe mos e thyeni betimin, pasi ta keni bërë atë, sepse Allahun e keni bërë dorë-zënësin tuaj; vërtet, Allahu e di se çfarë bëni ju".²⁷

²⁶ Kuran, El-En'am: 152.

²⁷ Kuran, El-Nahl: 91.

﴿وَلَا تَشْتَرُوا بِعَهْدِ اللَّهِ ثَمَنًا قَلِيلًا إِنَّمَا عِنْدَ اللَّهِ هُوَ خَيْرٌ لَّكُمْ إِن كُنْتُمْ تَعْلَمُونَ﴾

“Mos e këmbeni besëlidhjen e Allahut me ndonjë vlerë të paktë. Ajo që është tek Allahu, është më e mirë për ju, nëse e dini”.²⁸

﴿الَّذِينَ يُوفُونَ بِعَهْدِ اللَّهِ وَلَا يَنْقُضُونَ الْمِيثَاقَ﴾

“Këta janë ata që i përmbahen besëlidhjes me Allahun dhe nuk e prishin premtimin”.²⁹

Në të gjitha ajetet e lartpërmendura pamë se marrëveshjet pasohen me “besëlidhjen me Allahun”, që nënkupton se çështja nuk ka të bëjë vetëm me njerëzit, por çdo marrëveshje është edhe besëlidhje me të Lartmadhëruarin, që jep të kuptojmë se ato marrëveshje assesi nuk mund të konsiderohen të lehta apo mund të ndodhë që të arrihet edhe në ndonjë mashtrim e thyerje të marrëveshjes sepse myslimani para së gjithash duhet t’i japë llogari Allahut e jo njerëzve.

Në ajetin vijues Allahu xh.sh. na e sqaron edhe më hollësisht çështjen e marrëveshjeve, se sa myslimani duhet t’u përmbahet marrëveshjeve. Madje edhe atëherë kur nga ata kërkon ndihmë ndonjë palë myslimane tjetër, që për myslimanin një ndihmë e tillë është thelbësore në ndihmën e vëllait të tij në fe. Në këtë rast, i duhet përmbajtur marrëveshjes, ndërsa ndihma që kërkon pala myslimane kundër atyre që myslimanët kanë marrëveshje duhet refuzuar. Allahu xh.sh. thotë:

﴿...وَإِنِ اسْتَنْصَرُوكُمْ فِي الدِّينِ فَعَلَيْكُمُ النَّصْرُ إِلَّا عَلَىٰ قَوْمٍ بَيْنَكُمْ وَبَيْنَهُمْ مِيثَاقٌ وَاللَّهُ بِمَا تَعْمَلُونَ بَصِيرٌ﴾

“... E, nëse ju luten që t’i ndihmoni për çështjen e fesë, atëherë jeni të detyruar t’u dilni në ndihmë, përveçse (kur ju duhet të luftoni) kundër një populli me të cilin keni marrëveshje. Allahu e sheh mirë atë që veproni”.³⁰

²⁸ Kuran, El-Nahl: 95.

²⁹ Kuran, Er-R’ad: 20.

³⁰ Kuran, El-Enfâl: 72.

6. Ftesë për mënyrën më të mirë të dialogut

Allahu xh.sh. na porosit që të zhvillojmë dialog me *tjetrin*, në mënyrën më të mirë të mundshme, e cila është fushë e hapur, dhe myslimani duhet të kërkojë mënyrën më të mirë në çdo kohë dhe vend. Pra, ai çdo herë duhet ta ngrejë mënyrën e dialogut duke mos u mjaftuar me mënyrën e paraardhësve të tij, por ajo gjithmonë duhet të jetë e nivelit sa më të lartë në të gjitha aspektet. Po ashtu edhe thirrja për në fenë e Allahut është e kushtëzuar me “urtësi, këshillë të bukur”. Ndërsa “urtësia” ndër të tjera është edhe “vendosje e një çështjeje në vendin e saj, në kohën e saj aq sa duhet”.³¹

Allahu xh.sh. thotë:

﴿وَلَا تُجَادِلُوا أَهْلَ الْكِتَابِ إِلَّا بِالَّتِي هِيَ أَحْسَنُ إِلَّا الَّذِينَ ظَلَمُوا مِنْهُمْ وَقُولُوا آمَنَّا بِالَّذِي أُنزِلَ إِلَيْنَا وَأَنْزَلَ إِلَيْكُمُ وَإِهْنَأْ وَإِهْنَأْ وَإِهْنَأْ وَنَحْنُ لَهُ مُسْلِمُونَ﴾

*“Diskutoni me ithtarët e Librit vetëm me mënyrën më të mirë, por jo me keqbërësit e tjerë. Dhe thoni: “Ne besojmë në atë që na është zbritur neve dhe në atë që ju është zbritur juve. Zoti ynë dhe Zoti juaj është një - dhe ne Atij i nënshtrohemi si myslimanë”.*³²

﴿ادْعُ إِلَى سَبِيلِ رَبِّكَ بِالْحُكْمِ وَالْمَوْعِظَةِ الْحَسَنَةِ وَجَادِلْهُمْ بِالَّتِي هِيَ أَحْسَنُ إِنَّ رَبَّكَ هُوَ أَعْلَمُ بِمَنْ ضَلَّ عَنْ سَبِيلِهِ وَهُوَ أَعْلَمُ بِالْمُهْتَدِينَ﴾

*“Thirr në rrugën e Zotit tënd me mençuri dhe këshillë të bukur dhe diskuto me ata në mënyrën më të mirë! Me të vërtetë, Zoti yt i di më së miri ata që janë shmangur nga rruga e Tij, e di më së miri ata, që janë në rrugë të drejtë”.*³³

³¹ Shih: Dr. Xhemil Saliba, *El-Mu'xhemu'l felsefij*, Esh-Sheriketu'l alemijetu lil kitab, Bejrut, pa v. bot. v. I, f. 493- 495.

³² Kuran, El-Ankebut: 46.

³³ Kuran, En-Nahl: 125.

﴿فَلذَلِكَ فَادْعُ وَاسْتَقِمْ كَمَا أُمِرْتَ وَلَا تَتَّبِعْ أَهْوَاءَهُمْ وَقُلْ آمَنْتُ بِمَا أَنْزَلَ اللَّهُ مِنْ كِتَابٍ وَأُمِرْتُ لِأَعْدِلَ بَيْنَكُمْ اللَّهُ رَبُّنَا وَرَبُّكُمْ لَنَا أَعْمَالُنَا وَلَكُمْ أَعْمَالُكُمْ لَا حُجَّةَ بَيْنَنَا وَبَيْنَكُمْ اللَّهُ يَجْمَعُ بَيْنَنَا وَإِلَيْهِ الْمَصِيرُ﴾

*“Andaj, ti thirri dhe bëhu këmbëngulës, ashtu siç je urdhëruar, mos i ndiq epshet e tyre dhe thuaj: “Unë besoj çdo libër që e ka shpallur Allahu dhe jam urdhëruar që të gjykoj drejt midis jush; Allahu është Zoti ynë dhe Zoti i juaj. Veprat tona janë për ne, e veprat tuaja janë për ju. Midis nesh dhe jush nuk ka kurrfarë mosmarrëveshjeje. Allahu do të na tubojë të gjithëve dhe tek Ai do të kthehemi të gjithë”.*³⁴

Pra, kriteret e dialogut duhen ndjekur ashtu si porosit Allahu xh.sh. e jo që ato t’i nënshtrohen momentit imponues apo epsheve njerëzore të ndryshuara.

7. Nga drejtësia kuranore ndaj “tjetrit” është edhe dallimi sipas meritave e vlerave

Njeriu shpesh mundohet që të jetë i drejtë dhe të gjithë njerëzit t’i shikojë me syrin e barabartë, ata që janë të barabartë me ata që nuk janë të tillë. Në realitet, ai me këtë orvatje për të arritur drejtësinë i shmanget më shumë drejtësisë, sepse dihet sheshazi se të gjithë njerëzit nuk janë të njëjtë. Një përpjekje e tillë është në kundërshtim me drejtësinë, prandaj e hasim se Kurani famëlartë nuk i barazoi të gjithë, por secilit ia dha pozitën që meriton.

7.1. Qëndrim të veçantë ndaj ithtarëve të Librave në ushqim dhe martesë

- E lejoi ushqimin e tyre.
- E lejoi ushqimin e myslimanëve për ata.
- E lejoi martesën me gratë e tyre.

³⁴ Kuran, Esh-Shura: 15.

Allahu xh.sh. thotë:

﴿الْيَوْمَ أَحَلَّ لَكُمْ الطَّيِّبَاتُ وَطَعَامُ الَّذِينَ أُوتُوا الْكِتَابَ حِلًّا لَكُمْ وَطَعَامُكُمْ حِلًّا لَهُمْ وَالْمُحْصَنَاتُ مِنَ الْمُؤْمِنَاتِ وَالْمُحْصَنَاتُ مِنَ الَّذِينَ أُوتُوا الْكِتَابَ مِنْ قَبْلِكُمْ إِذَا آتَيْتُمُوهُنَّ أُجُورَهُنَّ مُحْصِنِينَ غَيْرَ مُسَافِحِينَ وَلَا مُتَّخِذِي أَخْدَانٍ وَمَنْ يَكْفُرْ بِالْإِيمَانِ فَقَدْ حَبِطَ عَمَلُهُ وَهُوَ فِي الْآخِرَةِ مِنَ الْخَاسِرِينَ﴾
*“Sot ju janë lejuar gjërat e mira e të pastra. Ju janë lejuar edhe ushqimet e ithtarëve të Librit; po ashtu, edhe ushqimet tuaja janë të lejuara për ata. Të lejuara për ju janë të ndershmet besimtare dhe të ndershmet e atyre që u është dhënë Libri para jush, nëse ju u jepni pajën e kurorëzimit, duke u martuar me ato, e jo duke bërë kurvëri, as duke i marrë për dashnore. Kushdo që mohon besimin, veprat e tij do të zhvlerësohen dhe në jetën tjetër ai do të jetë i dështuar”.*³⁵

7.2. Tregoi dallimet e tyre në përkushtim ndaj Zotit dhe qëndrimin dashamirës ndaj myslimanëve

Allahu xh.sh. thotë:

﴿...ذَلِكَ بِأَنَّ مِنْهُمْ قِسِيَسِينَ وَرُهَبَانًا وَأَنَّهُمْ لَا يَسْتَكْبِرُونَ﴾
*“...Kjo për shkak se ndër ta ka priftërinj (të dhënë mbas dijes) e murgj (të përkushtuar ndaj adhurimit) dhe se ata nuk janë kryelartë (ndaj së vërtetës)”.*³⁶

7.3. Iu drejtua me emra përkëdhelës

- Ithtarë të Librit أهل الكتاب
- ithtarë të Inxhilit أهل الإنجيل
- bartës të Tevratit
- popull i Musait
- ndjekës të Isait.

³⁵ Kuran, El-Maide: 5.

³⁶ Kuran, El-Maide: 82.

7.4. Urdhëroi sjellje të mirë ndaj të afërmit që nuk është mysliman

Përpos urdhëresave që përmendëm më lart, Allahu xh.sh. e urdhëron myslimanin që të sillet mirë me të afërmit e tij, ndonëse me besim të ndryshëm, e sidomos kur janë në pyetje prindërit, ndaj të cilëve sjellja e mirë ka përparësi ndaj besimit. Pra, këtu shohim qartë se theksi vihet mbi aspektin njerëzor të mirësjelljes sesa atij të besimit. Këtë porosi e kemi në dy ajete, madje në të dytin kërkohet sjellja e mirë ndaj tyre edhe atëherë kur ata orvaten të të largojnë nga feja islame duke i shoqëruar Allahut dikë tjetër në adhurim! Edhe pse çështja e shirkut, të bërit rival Zotit, është nga mëkatet më të mëdha, edhe në këtë rast Allahu xh.sh. porositi që sjelljet të jenë sa më të mira me ta. Allahu xh.sh. thotë:

﴿وَوَصَّيْنَا الْإِنْسَانَ بِوَالِدَيْهِ حُسْنًا وَإِنْ جَاهَدَاكَ لِتُشْرِكَ بِي مَا لَيْسَ لَكَ بِهِ عِلْمٌ فَلَا تُطِعْهُمَا إِلَيَّ مَرْجِعُكُمْ فَأُنَبِّئُكُمْ بِمَا كُنْتُمْ تَعْمَلُونَ﴾

*“Ne e kemi urdhëruar njeriun që të sillet mirë me prindërit e vet dhe: “Nëse ata të nxisin ty që të më shoqërosh Mua (në adhurim) atë, për të cilin ti nuk di asgjë, atëherë mos i dëgjo ata.” Tek Unë do të ktheheni të gjithë e do t’ju lajmëroj për gjithçka që keni bërë”.*³⁷

﴿وَوَصَّيْنَا الْإِنْسَانَ بِوَالِدَيْهِ حَمَلَتْهُ أُمُّهُ وَهْنًا عَلَىٰ وَهْنٍ وَفِصَالُهُ فِي عَامَيْنِ أَنْ اشْكُرْ لِي وَلِوَالِدَيْكَ إِلَيَّ الْمَصِيرُ (١٤) وَإِنْ جَاهَدَاكَ عَلَىٰ أَنْ تُشْرِكَ بِي مَا لَيْسَ لَكَ بِهِ عِلْمٌ فَلَا تُطِعْهُمَا وَصَاحِبُهُمَا فِي الدُّنْيَا مَعْرُوفًا وَاتَّبِعْ سَبِيلَ مَنْ أَنَابَ إِلَيَّ ثُمَّ إِلَيَّ مَرْجِعُكُمْ فَأُنَبِّئُكُمْ بِمَا كُنْتُمْ تَعْمَلُونَ﴾

“Ne e kemi urdhëruar njeriun që t’i nderojë prindërit e vet. Nëna e ka mbartur atë, duke duruar mundim pas mundimi, e ndarja e tij (nga gjiri) është brenda dy vitesh. Ne i thamë atij: “Bëhu

³⁷ Kuran, El-Ankebut: 8.

falënderues ndaj Meje dhe prindërve të tu! Tek Unë do të ktheheni të gjithë". Nëse ata orvaten, që të më shoqërosh Mua (në adhurim) diçka, për të cilën ti nuk ke dijeni, mos i dëgjo, por sillu mirë me ata në këtë jetë dhe ndiq rrugën e atij që drejtohet tek Unë me devotshmëri; pastaj, tek Unë do të ktheheni dhe Unë do t'ju lajmëroj për atë që keni bërë".³⁸

³⁸ Kuran, Lukman: 14-15.

Conclusions

The Qur'an is revealed to guide the Muslim in their lives and also regulate relations of Muslims to fellow Muslims and non-Muslims, by making mandatory to them to preserve: Freedom of belief, freedom of worship, to be fair to them, even when he is angry, to expand cooperation for good, benefits and peace, and refrain from sins, wrongs and enmity.

To fulfill the agreements which in addition to being obligatory they are essentially a "covenant with Allah" as well. To develop a dialogue, under the condition of the best possible etiquette and the implemented at highest levels at all times and across countries.

It regulates the relationships with non-Muslim relatives, especially parents who need the best possible treatment, even when they are trying to turn you away from the religion.

All these relationships and behaviors towards the others, in reality, are divine commands, by which the Muslims obtain devotion to God, and consequently approaches His reward both in this world and in the Hereafter.

Literatura:

- *KURANI I MADHËRISHËM*, përkth. Hasan ef. Nahi, bot. AIITC, Tiranë, 2006.
- Esh-Sha'ravi, Muhammed Mutevel-li, *Tefsiru'l havatir*, Ahbaru'l Jevm, Kajro, 1997.
- El-Bejdavi, Nasirud-din Abdullah, *Envaru't-tenzili ve esraru't-te'vil*, Daru ihjai et-turathi'l-arabi, Bejrut, 1997.
- Kurtubi, Muhamed ibën Ahmet, *Tefsiru'l El- Xhamiu li ahkami'l Kuran*, Daru'l kutubi'l misrije, Kajro, 1384h./1964.
- Saliba, Dr. Xhemil, *El-Mu'xhemu'l felsefij*, Esh-Sheriketu'l alemijetu lil kitab, Bejrut, pa v. bot.

Prof. ass. dr. Lulzim ESATI

ROLI DHE PËRGJEGJËSIA E NJERIUT NË TOKË SIPAS SURES “El-Bekare”

Abstrakt

Në këtë punim synojmë të ofrojmë disa mësimë të rëndësishëm të veçantë që ka surja “El-Bekare”, sikurse do të mësojmë për objektivin kryesor të kësaj sure, që është “*istihlafi*”, qeverisja në tokë.

Kjo sure e vë theksin veçanërisht te tre modele të qeverisjes:

1) modeli i Ademit a.s., 2) modeli i Beni Israilëve, 3) modeli i Ibrahimit a.s.. Dy modelet e para sipas tekstit kuranor të kësaj sureje janë modele të dështuara, ndërsa modeli i Ibrahimit a.s. është modeli më i suksesshëm. Allahu i Gjithëfuqishëm nuk e favorizon askënd, qoftë ai edhe prej umetit të Muhamedit a.s., prandaj kushdo që dështon në bartjen e përgjegjësisë, Zoti do ta zëvendësojë atë, siç i ka zëvendësuar popujt që ishin para umetit të Muhamedit!

Fjalët kyçe: qeverisje, objektiv, Beni Israilët, mosbindje, begati.

Karakteristikat e sures “El-Bekare”

Surja El-Bekare është kaptina e parë që ka zbritur në Medinë¹ pas emigrimit. Kjo kaptinë ka shoqëruar formimin e shoqërisë islame në Medinë nga fillimi e deri në mbarim. Është kaptina më e gjatë e Kuranit famëlartë, e cila përbëhet nga gjithsej 286 ajete. Meqenëse ishte kaptina më e gjatë, kjo bëri që të shpallej gati në tërë periudhën e Medinës.

Vlera e sures “El-Bekare” sipas haditheve të Muhamedit a.s.

Janë të shumta hadithet e evidentuara në përmbledhjet e korpusit të porosive dhe udhëzimeve të Pejgamberit a.s., të cilat flasin për vlerën e kaptinës El-Bekare, e cila veçohet nga mesi i kaptinave të përgjithshme kuranore. Këtu më poshtë do të përmendim disa prej tyre:

1. Transmeton Muslimi: “Ditën e Kiametit do të paraqitet Kurani me ithtarët e tij, të cilët kanë vepruar me të në dynja, atyre do t’u prijë surja El-Bekare dhe surja Ali-Imran, duke e mbrojtur personin që ka punuar me to²”.

Në një transmetim tjetër thuhet: “Ditën e Kiametit do të paraqitet Kurani me ithtarët e tij, të cilët kanë vepruar me të në dynja, atyre do t’u prijë para surja El-Bekare dhe surja Ali-Imran, sikur të ishin dy re!”³

Ditën e Kiametit nxehtësia do të jetë e ashpër! Dielli do të jetë afër mbi kokat e njerëzve, kurse kjo kaptinë vjen dhe i bën hije besimtarit që e ka mësuar përmendësh, ka punuar me të apo e ka lexuar shpesh.

¹ Kjo sure radhitet e dyta në Kuran pas sures El-Fatiha.

² Muslim ibn Haxhaxh ibn Muslim, *Sahih Muslim*, Sh.B. Daruassalam, Riad, 2000, Kapitulli: “Vlera e leximit të Kuranit dhe e sures El-Bekare”, Hadithi nr. 1876, f. 325.

³ Po aty.

2. Në një transmetim tjetër të përmbledhjes së Muslimit lexojmë hadithin në vijim: “Në shtëpinë ku lexohet surja El-Bekare nuk hyn shejtani!” Në një transmetim tjetër thuhet: “tri ditë nuk hyn shejtani në të⁴”.

Për rolin e kësaj sureje tregohet gjithashtu se Pejgamberi a.s. kur ishte në pozita të vështira gjatë betejës, i thërriste muslimanët: -Ku janë shokët e sures “El-Bekare”? Siç shihet, shokët e sures El-Bekare ishin njerëz të veçantë, që sapo e dëgjonin thirrjen, suleshin me nxitim për t’u përgjigjur thirrjes.

Përputhshmëria e ajetit të fundit të sures “El-Fatiha” me ajetet e para të sures El-Bekare

Surja El-Fatiha në përfundimin e saj tregon se kush janë ata që i ka bekuar Allahu xh.sh., ata që ishte i hidhëruar ndaj tyre si dhe ata që kanë humbur.

I Lartmadhërishmi në Kuran thotë:

صِرَاطَ الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ غَيْرِ الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ وَلَا الضَّالِّينَ.

“Në rrugën e atyre, të cilët i bekove, jo të atyre që kanë merituar hidhërimin, e as të atyre që kanë humbur!”⁵

Kurse surja El-Bekare fillon me përmendjen e gjithë këtyre të lartpërmendurve, por së pari fillon me përmendjen e të devotshmëve. I Lartmadhërishmi në Kuran thotë:

ذَلِكَ الْكِتَابُ لَا رَيْبَ فِيهِ هُدًى لِّلْمُتَّقِينَ

“Ky libër, në të cilin nuk ka dyshim aspak, është udhëzim për të devotshmit”⁶.

⁴ Muslimi (780), El-Hakim, “El-Mustedrek” (2062).

⁵ Kuran, El-Fatiha: 7.

⁶ Kuran, El-Bekare: 2.

Këta janë ata që i ka bekuar Zoti dhe pastaj ofron përshkrimin e atributëve të “el-muteki-nëve”, të devotshmëve, në ajetin 3-5, thotë: *“Të cilët e besojnë të fshehtën-gajbin, e kryejnë faljen, dhe prej asaj që Ne i kemi furnizuar japin. (3) Dhe ata të cilët e besojnë atë që t’u shpall Ty dhe atë që është shpallur para teje, dhe të cilët për ahiretin (botën tjetër) janë të bindur. (4) Të tillët janë të udhëzuarit nga Zoti i tyre dhe të tillët janë të shpëtuarit(5).”*⁷

Pastaj ajeti në vijim:

إِنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا سَوَاءٌ عَلَيْهِمْ أُنذَرْتَهُمْ أَمْ لَمْ تُنذِرْهُمْ لَا يُؤْمِنُونَ

*“E për ata që mohuan është njëlloj, ua tërhoqe vërejtjen apo nuk ua tërhoqe, ata nuk besojnë”*⁸.

Ky ajet përfshin jobesimtarët ndaj të cilëve është i hidhëruar, sikurse edhe të humburit. Më pas përmend mynafikët, hipokritët, kur thotë:

وَمِنَ النَّاسِ مَنْ يَقُولُ آمَنَّا بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ وَمَا هُمْ بِمُؤْمِنِينَ

*Ka prej njerëzve që thonë: “Ne i besojmë Allahut dhe jetës tjetër (ahiretit)”, por ata nuk janë besimtarë”*⁹.

Pra, ka një përputhshmëri të plotë mes fundit të sures El-Fatiha dhe ajeteve me të cilat fillon surja El-Bekare¹⁰.

Objektivi i sures: Përgjegjësia e rregullimit të jetës në tokë bie mbi njeriun.

Pa dyshim se çdo sure prej sureve të Kuranit famëlartë ka një objektiv që synon ta arrijë. Objektivi i kësaj sureje është qeverisja në tokë, që do të thotë: O ju njerëz, ju jeni përgjegjës për mbajtjen e rendit dhe rregullit në tokë. Qeverisja dhe menaxhimi në tokë është përgje-

⁷ Kuran, El-Bekare: 3-5.

⁸ Kuran, El-Bekare: 6.

⁹ Kuran, El-Bekare: 8.

¹⁰ www.quran-radio.com.

gjësi që jua ka ngarkuar Allahu xh.sh. dhe këtë përgjegjësi duhet ta kryeni sipas mësimëve dhe udhëzimeve të Tij.

Allahu xh.sh. përgjatë historisë ua dha qeverisjen në tokë popujve të ndryshëm. Disa prej tyre patën sukses e disa dështuan. Tani në fund radhën e ka ky umet. Mirëpo, Allahu i Gjithëfuqishëm nuk e favorizon askënd, qoftë ai edhe umeti i Muhamedit a.s.. Prandaj, nëse pjesëtari i umetit musliman dështon në bartjen e përgjegjësisë, atëherë Allahu do ta zëvendësojë atë, siç i ka zëvendësuar edhe popujt që ishin para umetit të Muhamedit.

Këtu mësojmë edhe arsyen se përse El-Bekare është surja e parë pas sures El-Fatiha, sepse pikërisht kjo sure përcakton udhëzimet për rregullimin organizativ shoqëror në tokë.

Gjithashtu, ne përmes kësaj sureje mësojmë edhe shkakun e zbritjes së saj në Medinë dhe përse ajo vazhdoi të shpallej për nëntë vite me radhë gjatë gjithë periudhës medinase. Pejgamberi a.s., siç edhe dihet, kur emigroi nga Meka në Medinë, filloi të ndërtonte edhe shoqërinë e parë muslimane, e cila kishte nevojë për t'u udhëzuar, se si të ishte përgjegjëse për rregullimin sa më të mirë të jetës në tokë, si dhe për të mësuar se si mund ta kryente misionin për të cilin kjo shoqëri është krijuar që ta kryejë¹¹.

Shejh Muhamed el-Gazali thotë: “Është e vërtetë që Muhamedi a.s. urdhëroi që një djalosh -edhe pse ishte shumë i ri- t'i besohej detyra e udhëheqësisë, ngase ai e dinte përmendësh suren El-Bekare! Ai nuk kishte nxënë në mend vetëm shkronjat, por e dinte tërë përmbajtjen e saj, inspirimet dhe dispozitat e saj, dritën e saj dhe tërë atë që ajo e ndante (të vërtetën nga e pavërteta). Kështu formohen dhe ngrihen popujt...”¹²

Njeriu duhet ta dijë se përgjegjësia e rregullimit dhe ndërtimit të tokës bie mbi të. E kjo nuk mund të bëhet ndryshe vetëm se me qeverisje

¹¹ Po aty.

¹² Muhamed el-Gazali, *Komenti tematik i Kuranit famëlartë*, përktheu nga arabishtja: Sadush Tahiri, sh.b: Logos, 2007, Shkup, f. 36.

të mirë. Njeriu nuk duhet të pranojë që të jetë i dështuar në jetë, por duhet bërë maksimumi për të qenë i suksesshëm. Kjo bëhet e qartë edhe gjatë analizave dhe leximit të sures El-Bekare.

Kaptina El-Bekare ndahet në katër pjesë;

1. parathënia
2. pjesa e parë
3. pjesa e dytë
4. përfundimi.

Në parathënie përshkruhen llojet e njerëzve dhe karakteri i tyre, duke filluar nga ajeti (1-29), si vijon:

Të devotshmit “el-mutekun”, ajeti 1-5.

Ata që mohuan “el-kafirun”, ajeti 6-7.

Hipokritët “el-munafikun”, ajeti 8-20.

Sa i përket llojit të fundit, hipokritëve, ata zënë një hapësirë më të madhe, për të tërhequr vërejtjen e kujdesit prej tyre, ngase përbëjnë rrezik dhe dëm të madh në shoqëri, duke e shfaqur publikisht besimin e duke e mbuluar mosbesimin e tyre, këta janë më të rrezikshëm se jobesimtarët¹³.

Pjesa e parë: Në këtë pjesë paraqiten tre modele nga grupet e njerëzve, që Allahu xh.sh. ua kishte ofruar qeverisjen e tokës. Këto modele janë:

- Ademi a.s. mëkëmbës i parë në tokë, ajeti 30-39.
- Beni Israilët, ajeti 40-123.
- Ibrahim a.s., ajeti 124-141.

Dy modelet e para janë modele të dështuara, ndërsa modeli i Ibrahim a.s. është paraqitur si model i suksesshëm.

¹³ El-Mubarekfuri, Safiurr-rahman, *el-Misbahul Munir fi tehdhibi tejsir Ibën Kethir*, Riad: Darusselam 2000, f. 35.

Ademi a.s.

Ademi a.s. u zgjodh nga Krijuesi Fuqiplotë, që të jetë mëkëmbës i parë në tokë, siç na njofton i Lartmadhërishtmi në Kuran:

وَإِذْ قَالَ رَبُّكَ لِلْمَلَائِكَةِ إِنِّي جَاعِلٌ فِي الْأَرْضِ خَلِيفَةً

“(Përkujto Muhamed) **Kur Zoti yt u tha engjëjve: “Unë po krijoj (po përcaktoj) në tokë një zëvendës!”**”¹⁴

Ademi ishte përvoja e parë e qeverisjes në tokë. Duke qenë që Ademi ishte zgjedhur nga i Lartmadhërishtmi direkt, kjo na mëson që përgjegjësia e qeverisjes dhe barra e menaxhimit në tokë nuk bie mbi ata që nuk e besojnë Allahun xh.sh., e as mbi ata që e kundërshtojnë programin e Tij, por kjo barrë bie mbi supet e besimtarëve sepse Ademi a.s. përveç që u zgjodh si *kalif* (udhëheqës), ishte edhe Pejgamber¹⁵.

Fjala e të Lartmadhërishtmit thotë:

وَعَلَّمَ آدَمَ الْأَسْمَاءَ كُلَّهَا

“**E Ai (Zoti) ia mësoi Ademit të gjithë emrat (e sendeve)**”.¹⁶

Çka nënkupton kjo?

Kjo do të thotë që i Lartmadhërishtmi ia mësoi Ademit natyrën e jetës, metodat e funksionimit të gjërave në këtë jetë, ia mësoi emrat e krijesave dhe funksionet e tyre, të diellit, hënës, detit, pemëve, frutat, etj..¹⁷ Kjo nënkupton paralajmërim për besimtarët që ata të mos mendojnë se do të jenë udhëheqës në tokë pa e ditur se si menaxhohen këto gjëra. Këtë e dëfton edhe ky ajet:

¹⁴ Kuran, El-Bekare: 30.

¹⁵ <https://mawdoo3.com>

¹⁶ Kuran, El-Bekare: 31.

¹⁷ Ibën Ashur, Muhamed Tahir. *Et-Tahrir ve-t- Tenvir*,sh,b.: Dar tunisije, Tunis 1984, vëll. 1, f. 123.

الَّذِي جَعَلَ لَكُمُ الْأَرْضَ فِرَاشًا وَالسَّمَاءَ بِنَاءً

*“Ai që për ju bëri tokën shtrat, (vendbanim) e qiellin kulm”.*¹⁸

Në këtë ajet Allahu xh.sh. na bën të qartë mjetet e kalifatit - mëkëmbësisë siç janë; nënshtrimi i tokës dhe qiellit dhe mbjellja. Ky ajet gjithashtu na tërheq vërejtjen që mos të kuptojmë se Islami është i përkufizuar vetëm në namaz dhe në agjërimin e muajit ramazan, duke mos kuptuar e duke e lënë anash rolin dhe rëndësinë e besimtarëve për menaxhimin e jetës në tokë. Allahu xh.sh. ia mësoi Ademit se si ta menaxhonte jetën e tij në tokë, e përmes tij për të na treguar edhe neve që gjërat në tokë nuk drejtohen e nuk ndryshohen vetëm me mësimin për besimin në Zot, por edhe me krijimtari të reja, dituri, studim dhe zbulim të vazhdueshëm¹⁹.

Mosbindja është shkak i zëvendësimit të të vjetrit me të riun

Ajeti 36 na tregon përvojën e Ademit me Iblisin²⁰:

فَأَزَلَّهُمَا الشَّيْطَانُ عَنْهَا فَأَخْرَجَهُمَا مِمَّا كَانَا فِيهِ

*“Po djalli i bëri që ata të dy të mashtrohen në atë (pemë ose xhennetin) dhe i nxori ata nga ajo (e mirë) që ishin në të”.*²¹

Këtu në këtë ajet fisnik gjejmë treguesin që na mëson se mosbindja është shkak i zëvendësimit. Duket sikur ky ajet na është drejtuar neve në këtë kohë duke na thënë: “O umeti i Muhamedit, ju vazhduat të jeni përgjegjës për tokën për 1300 vite, e ajo që ju ndodhi në 100 vitet e fundit është për shkak të mosbindjes suaj, ashtu siç i ndodhi babait tuaj,

¹⁸ Kuran, El-Bekare: 22.

¹⁹ www.quran-radio.com.

²⁰ Djalli.

²¹ Kuran, El-Bekare: 36.

Ademit a.s., me gjithë dallimin e madh mes gabimit të Ademit a.s. si Pejgamber dhe mosbindjeve e shkeljeve të turpshme që bën ky umet sot natë e ditë!

Pra, vini re e mësoni nga gabimet e mëparshme, largohuni prej tyre, që pastaj t’ju kthehet qeverisja”.

Kështu vazhdojnë ajetet për ngjarjen e Ademit deri në ajetin 38, në të cilin thuhet:

قُلْنَا أَهْبِطُوا مِنْهَا جَمِيعًا فَإِمَّا يَأْتِيَنَّكُمْ مِنِّي هُدًى فَمَنْ تَبَعَ هُدَايَ فَلَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ

*“Ne u thamë: “Dilni prej aty që të gjithë, e juve gjithqysh do t’u arrijë udhëzimi prej Meje, e kush pranon udhëzimin Tim, për ata nuk ka as frikë as që do të brengosen”.*²²

Këtu na thuhet se udhëzimi që do të vijë nga Allahu i Lartmadhë-rishëm është udhëzimi që është përmendur në fillim të kësaj sureje, që ka për qëllim Kuranin famëlartë:

ذَلِكَ الْكِتَابُ لَا رَيْبَ فِيهِ هُدًى لِّلْمُتَّقِينَ

*“Ky është libri në të cilin nuk ka dyshim, udhëzues për ata që frikësohen (nga Allahu).”*²³

Kurse ne çdo ditë e lusim Allahun gjatë leximit të sures Fatiha, që të ecim në këtë udhëzim:

أَهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ

“Udhëzoni në rrugën e drejtë!”

Këtu muslimani mund të shijojë ëmbëlsinë e Kuranit dhe lidhsh-mërinë e ajeteve të tij.

²² Kuran, El-Bekare: 38.

²³ Kuran, El-Bekare: 2.

Beni Israilët

Bëni Israilët²⁴ janë modeli dhe përvoja e dytë e qeverisjes në tokë. Modeli i Beni Israilëve fillon nga ajeti 40 deri tek ajeti 123 në suren El-Bekare. Këto ajetet të Kuranit famëlartë tregojnë dështimin e Beni Israilëve në bartjen e përgjegjësisë ndaj tokës dhe rënien e tyre në këtë provim.

Përkujtim i begative

Ajeti i parë në këtë kontekst është fjala e Allahut xh.sh.:

يٰۤاَيُّهَا اِسْرٰٓءِيْلُ اذْكُرُوْا نِعْمَتِيْ الَّتِيْ اَنْعَمْتُ عَلَيْكُمْ وَاَوْفُواْ بِعَهْدِيْ اُوْفٍ بِعَهْدِكُمْ
وَإِيَّيْ فَارْهَبُوْا

*“O bijtë e Israilit, kujtoni (jini mirënjohës për) të mirat e Mia, të cilat ua dhurova juve dhe zbatoni premtimin që më keni dhënë Mua. Unë zbatoj atë që u premtova dhe të më keni frikë vetëm Mua”.*²⁵

Pra, ajeti i parë që iu drejtua Beni Israilëve është:

اٰذْكُرُوْا نِعْمَتِيْ

“Kujtoni (jini mirënjohës për) të mirat e Mia”.

Kurse fjala e parë që na është drejtuar neve në programin tonë është:

اَلْحَمْدُ لِلّٰهِ رَبِّ الْعٰلَمِيْنَ.

*“Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve!”*²⁶

²⁴ Beni Israilët janë bijtë e Jakubit a.s., të dymbëdhjetë (12), dhe pasardhësit e tyre. Wikipedia, The free Encyclopedia.

²⁵ Kuran, El-Bekare: 40.

²⁶ Kuran, El-Fatiha: 1.

Sikur do të thotë që fillimi i çdo umeti për përgjegjësinë e menaxhimit të çështjeve në tokë fillon me përkujtimin e begative të Allahut xh.sh..²⁷

Llojet e begative dhe të mirave që Allahu xh.sh. u dha Beni Israilëve

Nga këto begati është:

وَإِذْ فَرَقْنَا بِكُمْ الْبَحْرَ فَأَنْجَيْنَاكُمْ وَأَغْرَقْنَا آلَ فِرْعَوْنَ وَأَنْتُمْ تَنْظُرُونَ

“Dhe kur për ju e ndamë detin e ju shpëtua, ndërsa ihtarët e faraonit i fundosëm, e ju i shihnit (me sytë tuaj).”²⁸

ثُمَّ عَفَوْنَا عَنْكُمْ مِّنْ بَعْدِ ذَلِكَ لَعَلَّكُمْ تَشْكُرُونَ

“Mandej edhe pas asaj ua falëm (gabimin), ashtu që të falënderoni.”²⁹

Fjala është për faljen e mëkatit të adhurimit të viçit³⁰. Nga Beni Israilët kërkohej që të jenë falënderues për mirësinë e faljes³¹.

وَوَهَبْنَا لَكُمْ الْعَمَامَ وَأَنْزَلْنَا عَلَيْكُمُ الْمَنَّاءَ وَالسَّلْوَىٰ كُلُوا مِن طَيِّبَاتِ مَا رَزَقْنَاكُمْ وَمَا ظَلَمُونَا وَلَكِن كَانُوا أَنفُسَهُمْ يَظْلِمُونَ.

“Dhe Ne bëmë që retë t’u bëjnë juve hije, ju furnizua me rrëshirë (të ëmbël -manna) dhe me shkurtëza (salëa). (Ju thamë) Hani nga të mirat që ju furnizua! (Ata nuk qenë mirënjohës). Po Neve ata nuk na bënë kurrfarë dëmi, por ata dëmtuan vetveten.”³²

²⁷ www.quran-radio.com.

²⁸ Kuran, El-Bekare: 50.

²⁹ Kuran, El-Bekare: 52.

³⁰ El-Begavi, El-Husejn Ibën Mes’ud ibën Muhamed, (v. 516h), *Mealimut -Tenzil*, vëll. I, f. 545.

³¹ En-Nesefi, Abdullah bin Ahmed, (v. 701 h), *Tefsir en-Nesefi*, botimi i I^{te}, sh.b: Darul Kutubil Ilmije, Bejrut, 1994, vëll. I, f. 123.

³² Kuran, El-Bekare: 57.

Përkujtoni, o Beni Israilë, që nga mirësitë e begatitë e Mia, ku Ne po ashtu i dërguam retë për t'u bërë hije juve gjatë qëndrimit në shkretëtirën e Sinasë si dhe ju furnizua me ushqime të mrekullueshme. Mirëpo ata prapë ishin jomirënjohës ndaj këtyre të mirave e këtyre dhuntive³³.

Ajete të njëpasnjëshme që flasin për të mirat e dhuntitë që iu dhanë Beni Israilëve, në vazhdim, një pjesë e tyre flasin edhe për gabimet që ata bënë në jetën e tyre dhe kjo që të shërbejë si mësim për ne që të kemi vëmendjen e t'u shmangemi gabimeve të atyre që ishin para nesh.

Gabimet e umetit para nesh

Kështu fillojnë ajetet e Kuranit famëlartë, që i përshkruajnë gabimet e Beni Israilëve:

وَإِذْ قُلْتُمْ يَا مُوسَىٰ لَنْ نُؤْمِنَ لَكَ حَتَّىٰ نَرَىٰ اللَّهَ جَهْرَةً

*“Dhe kur i thatë: “O Musa, ne nuk të besojmë ty derisa ta shohim Allahun haptazi”.*³⁴

Kjo për arsye se ishin popull materialist deri në ekstrem. Nga kjo mësojmë që çdo popull i cili bie në këtë gabim trashanik do të ishte edhe arsye e mjaftueshme për ta zëvendësuar atë. Mbizotërimi i materializmit deri në atë masë kur nuk besojnë në asgjë që nuk mund të preket e shihet me shqisat tona. Këtu e kujtojmë atributin e parë të të devotshmëve në fillim të sures, që ishte:

الَّذِينَ يُؤْمِنُونَ بِالْغَيْبِ.

*“Të cilët e besojnë të fshehtën”.*³⁵

³³ Et-Tantavi, Muhammad Sejjid, *et-Tefsir el-Vasit lil-Kuranil Kerim*, sh.b: Dar Nahdatu Miser, 1998, Kajro, vëll. II, f. 78.

³⁴ Kuran, El-Bekare: 55.

³⁵ Kuran, El-Bekare: 2.

Ajete të shumta në këtë sure flasin për krimet fatale që kanë ushtruar Beni Israilët, si p.sh. vrasja e Pejgamberëve, mosbindja ndaj tyre, mohimi i ajeteve e fakteve të zbritura nga Allahu Fuqiptotë, sulmi i “as’habus sebti”³⁶, dredhitë e tyre me dispozitat e Allahut xh.sh., të cilat vazhdojnë deri te tregimi i cili është edhe boshti i sures, “Tregimi i Lopës”.

Përse është quajtur kjo sure “Kaptina e Lopës”?

Disa mund të pyesin përse është emërtuar kjo sure me emrin “Kaptina e Lopës”? Disa mund të përgjigjen: Është quajtur kështu sepse në të ka ardhur ngjarja e lopës. Mirëpo, në këtë sure ka edhe shumë tregime të tjera interesante, atëherë përse është emërtuar pikërisht me këtë ngjarje, pos ngjarjeve dhe tregimeve të tjera?

Tregimi i lopës përmbledh gabimet e mëdha esenciale të Beni Israilëve, për këtë u emërtua kështu, që muslimanët që do të bëhen përgjegjës për tokën t’i kujtojnë këto gabime dhe t’u shmangen atyre. Në këtë tregim të lopës gjejmë si vijon:

Polemika e paargumentuar është çelësi i të këqijave

Këto gabime që bënë Beni Israilët dalin në pah me ajetin 67 të kësaj sureje:

وَإِذْ قَالَ مُوسَى لِقَوْمِهِ إِنَّ اللَّهَ يَأْمُرُكُمْ أَنْ تَذْبَحُوا بَقَرَةً قَالُوا أَتَتَّخِذُنَا هُزُؤًا قَالَ أَعُوذُ بِاللَّهِ أَنْ أَكُونَ مِنَ الْجَاهِلِينَ (٦٧) قَالُوا ادْعُ لَنَا رَبَّكَ يُبَيِّنْ لَنَا مَا هِيَ قَالَ إِنَّهُ يَقُولُ إِنَّهَا بَقَرَةٌ لَا فَارِضٌ وَلَا بِكْرٌ عَوَانٌ بَيْنَ ذَلِكَ فَافْعَلُوا مَا تُؤْمَرُونَ (٦٨) قَالُوا ادْعُ لَنَا رَبَّكَ يُبَيِّنْ لَنَا مَا لُونُهَا قَالَ إِنَّهُ يَقُولُ إِنَّهَا بَقَرَةٌ صَفْرَاءٌ فَاقِعٌ لُونُهَا تَسْرُ النَّاطِرِينَ (٦٩) قَالُوا ادْعُ لَنَا رَبَّكَ يُبَيِّنْ لَنَا مَا هِيَ إِنَّ الْبَقَرَ تَشَابَهُ عَلَيْنَا وَإِنَّا إِن شَاءَ اللَّهُ لَمُهْتَدُونَ (٧٠) قَالَ إِنَّهُ يَقُولُ إِنَّهَا

³⁶ Banorët e fshatit që jetonin buzë detit, të cilët nuk respektuan ndalimin e peshkimit në ditën e shtunë.

بَقْرَةَ لَا ذُلُولٌ تُثِيرُ الْأَرْضَ وَلَا تَسْقِي الْحُرثَ مُسَلِّمَةً لَا شَيْءَ فِيهَا قَالُوا الْآنَ
جِئْتُ بِالْحَقِّ فَذَبْحُوهَا وَمَا كَادُوا يَفْعَلُونَ (٧١)

“(Përkujtoni) Edhe kur Musai popullit të vet i tha: “Allahu ju urdhëron ta therni një lopë! Ata thanë: “A bën tallje me ne?” Ai tha: “Allahut i mbështetem të më ruajë e të mos bëhem nga injorantët!”(67) Ata thanë: “Lute Zotin tënd për ne të na sqarojë çfarë është ajo? Ai tha: “Ai thotë se ajo është një lopë as e vjetër (e moshuar) as e re (mëshqerrë), është e mesme, zbatoni pra atë që urdhëroheni!”(68) Ata thanë: “Lute Zotin tënd për ne që të na sqarojë çfarë është ngjyra e saj? A tha: “Ai thotë se ajo është një lopë e verdhë, ngjyra e saj është e fortë që kënaqë shikuesit”.(69) Ata thanë: “Lute Zotin tënd për ne që të na sqarojë çfarë është ajo, se lopët na janë përzier (janë bërë të ngjashme) e ne do të gjejmë të vërtetën në dashtë All-llahu!(70) Ai tha: “Ai thotë se ajo është lopë jo e lodhur duke lëruar tokën as duke ujitur bimët, ajo është pa të meta dhe në të nuk ka shenjë (ngjyrë tjetër)!” Ata thanë: “E tash na e sqarove saktë dhe e therën atë, e për pak e lanë pa e kryer punën.”(71)³⁷

Tregimi i lopës fillon kur një person nga Beni Israilët vritet dhe nuk dihet se kush është vrasësi, pastaj mes tyre lind edhe pyetja dhe dyshimet se kush mund ta ketë vrarë. Allahu xh.sh. përmes shpalljes e urdhëron Musain a.s. që t’i urdhërojë të therin një lopë dhe që nga ajo të marrin një pjesë të saj dhe ta prekin të vdekurin me të, kështu që ai (njeriu i vdekur) do të bëhet i gjallë dhe do të tregojë kush e ka vrarë!

Allahu Fuqiplotë kërkoi prej tyre një gjë të tillë ngase ishin skajsh-mërisht materialistë, në mënyrë që ta shohin me sytë e tyre që Allahu është i Gjithëfuqishëm dhe se gjërat nuk janë ashtu siç po mendojnë, por Ai e ngjall të vdekurin dhe ai foli. Meqenëse ata nuk e kuptuan ur-

³⁷ Kuran, El-Bekare: 67-71.

tësinë e kësaj duke pasur parasysh që ishin tepër të dhënë pas botës materiale, refuzuan me këmbëngulje zbatimin e urdhrit³⁸.

Ngjarja e lopës përmbledh gabimet e Beni Israilëve nga materializimi në polemikë e mosbindje ndaj Pejgamberëve të tyre e deri te mosbindja ndaj Allahut të Lartmadhërishëm përmes përdredhjeve ndaj programit të Tij³⁹. E kur e zbatuan atë që u urdhëruan ta bënë, ata e zbatuan atë me imponim e urrejtje, siç njofton edhe Kurani famëlartë:

فَدَبَّحُوْهَا وَمَا كَادُوْا يَفْعَلُوْنَ

“...Dhe e therën atë, e për pak e lanë pa e kryer punën”.

Në fund të përmbylljes së bisedës për modelin e qeverisjes së Beni Israilëve vjen ajeti i cili është zgjedhur me urtësi të plotë për këtë pozicion kuranor. Ky ajet na njofton në mënyrë të qartë për amanetin e fundit të Jakubit a.s. në prag të vdekjes, që ishte adhurimi i Allahut xh.sh., Zotit një dhe të vetëm.

أَمْ كُنْتُمْ شُهَدَاءَ إِذْ حَضَرَ يَعْقُوبَ الْمَوْتُ إِذْ قَالَ لِبَنِيهِ مَا تَعْبُدُونَ مِن بَعْدِي
قَالُوا نَعْبُدُ إِلَهَكَ وَاللَّهُ أَبَانِكَ إِبْرَاهِيمَ وَإِسْمَاعِيلَ وَإِسْحَاقَ إِلَهًا وَاحِدًا وَنَحْنُ لَهُ
مُسْلِمُونَ

“A ishit ju (ihtarë të librit) dëshmitarë kur Jakubit iu afrua vdekja, e ai bijve të vet u tha: “Çka do të adhuroni pas meje”? Ata thanë: “Do të adhurojmë Zotin (Allahun) tënd dhe Zotin e prindërve tuaj: Ibrahimit, Ismailit, Is’hakut, një të vetmin Zot dhe ne vetëm Atij i jemi dorëzuar!”⁴⁰

Fjalimi u drejtohet hebrenjve dhe të krishterëve, të cilët po ia bashkëngjisnin Ibrahimit a.s. atë çka nuk e kishin lënë testament bijtë e tij, kinse Ibrahimit ka qenë në fenë hebraike apo të krishterë. Allahu xh.sh.

³⁸ Urdhri nga Allahu i Lartmadhërishëm ishte therja e një lope.

³⁹ Ibën Ashur, *Et-Tahrir ve-t- Tenvir*, vëll. 1. F: 223. Esh-Shaaravi, Muhamed Muteveli, (v:1998), *Tefsir Havatir*, sh.b: Ahbarul Jaum, Kairo 1997, vëll. 1, f. 432.

⁴⁰ Kuran, El-Bekare: 133.

përmes përmendjes së testamentit të Jakubit a.s., biri të Ibrahimit a.s., ua hedh poshtë Beni Israilëve pretendimet e rreme⁴¹.

Megjithatë tregimi i lopës shpalos realitetin e përmëshjes së këtij amaneti nga Beni Israilët, të cilët amanetin e Jakubit a.s. e zëvendësuan me materializmin e jetës dhe shpikjen e intrigave dhe hileve të ndryshme, me të cilat nuk synonin gjë tjetër por vetëm e vetëm ikjen dhe zmbropsjen nga urdhrat e Allahut xh.sh.. Ky ishte fati i amanetit të Jakubit a.s..

Përfundimi

Mësimet e sures “El-Bekare” janë të shumta, si në fushën e çështjeve të besimit ashtu edhe në fushën e dispozitave, megjithatë këtu mund të konkludojmë që rëndësi të veçantë i kushtohet “*istihlafit*”, qeverisjes në tokë. Kjo që thamë rezulton nga fakti i arsyes së krijimit të Ademit a.s. dhe bisedës së Zotit me engjëjt për krijimin e një kalifimëkëmbësi të Tij në tokë. Vlen të përmendet se kjo sure e ka mbuluar tërë periudhën e Medinës, që na jep të kuptojmë se formimi i shoqërisë së parë muslimane u bë me monitorimin e kësaj sureje. Kjo sure ofron tre modele të qeverisjes: modelin e Ademit a.s., i cili në eksperimentin që iu bë në xhenet dështoi dhe u përjashtua nga xheneti. Nga ky model dhe kjo ngjarje mësojmë se mosbindja ose shkelja e urdhrat të Allahut xh.sh. si shpagim ka zëvendësimin. Nga modeli i Beni Israilëve mësojmë se heqja e së drejtës së tyre për të qeverisur në tokë kishte shumë shkaktarë, por më kryesorët se ishin mosmirënjohës ndaj dhuntive e begative të shumta që u dha i Lartmadhërishtmi, polemika dhe mosbindja ndaj urdhrave të Allahut xh.sh. siç shihet nga tregimi i lopës dhe materializmi i skajshëm i tyre.

Ndërsa sa i përket modelit të Ibrahimit a.s., për këtë do të mësojmë në pjesën e dytë.

⁴¹ El-Kurtubi, Muhamed bin Ahmed, (671, h), *Elxhamiu Liahkamil Kuran*, sh.b.: Darul kutub el-Ilmije, Bejrut, 1991, vëll. 2, f. 222.

Conclusion

There are many lessons taken out from sure "Al-Bakarah" in the issues of religion and other dispositions as well. We may conclude that a special access is given to "Al-istilafah" governing on the Earth. This results are based on the facts of Adem's creation and the dialogue with angels on creating a "Khalifah" - a vicegerent on Earth. This issue in this Surah has covered all Medina's period. Formation of Muslim society per se is in a way followed by this Surah.

According to this Surah there are three models of governing: the model of Adem a.s that by the test -experiment made in Paradise was expelled from it, by this we learn that disobedience of Allah's order as a retaliation has the substitution; by the model of Beni Israels a lesson can be taught that removing of their rights to lead on Earth is consequence on many reasons , mainly because they had been ungrateful towards what Almighty God provided for them, including here the disobedience towards Allah's order as illustrated in The Story of the Cow; and the Model of Abraham narrated in the second part of this Surah.

Literatura:

- *Kurani Kerimi* në gjuhën arabe.
- Prof. Hasan I. Nahi, *KURANI i madhërishëm*, përktheu kuptimet e tij nga gjuha arabe. AIITC, 2006, Tiranë.
- Sh. Ahmeti, *KUR'ANI* –përkthim me komentim në gjuhën shqipe. I shtypur në kompleksin e shërbyesit të dy haremeve, në Medinë, 1413 h.
- El-Begavi, El-Husejn Ibën Mes'ud ibën Muhamed (v. 516h), *Mealimut –Tenzil*.
- el-Hakim, “El-Mustdrek” (2062).
- El-Kurtubi, Muhamed bin Ahmed, (671, h), *Elxhamiu Liahkamil Kuran*, sh.b.: Darul kutub el- Ilmije, Bejrut, 1991.
- El-Mubar Kefuri, Safijurr-rahman, *el-Misbahul Munir fi tehdhibi tefsir Ibën Kethir*, Rijad: Darusselam, 2000.
- En-Nesefi, Abdullah bin Ahmed, (v. 701 h), *Tefsir en-Nesefi*, botimi i I^{re}, sh.b.: Darul Kutubil Ilmije, Bejrut, 1994.
- Esh-Shaaravi, Muhamed Muteveli, (v:1998), *Tefsir Havatir*, sh.b. Ahbarul Jaum, Kajro, 1997.
- Et-Tantavi, Muhammad Sejjid, *et-Tefsir el-Vasit lil-Kuranil Kerim*, sh.b. Dar Nahdatu Miser, 1998.
- Ibën Ashur, Muhamed Tahir. *Et-Tahrir ve-t- Tenvir*, sh.b. Dar tunisije, Tunis, 1984.
- Muhammed El-Gazali, *Komenti tematik i Kuranit famëlartë*, përktheu nga arabishtja: Sadush Tahiri, sh.b.: Logos, 2007, Shkup.
- Muslim, ibën Hxhaxh ibën Muslim, *Sahih Muslim*, sh.b. Daruasselam, Riad, 2000.

Faqet e internetit:

- <https://mawdoo3.com>
- www.quran-radio.com
- [Wikipedia The free Encyclopedia](http://Wikipedia)

Prof. asoc. dr. Sulejman OSMANI

SJELLJET SOCIALE NË KOHË PANDEMIE - NJË VËSHTRIM NGA PIKËPAMJA ISLAME

Abstrakt

Pandemia e virusit Corona, e koduar me emrin Covid-19, ka marrë vëmendjen e gjithë botës dhe është bërë një temë e zakonshme diskutimi rreth e rrotull nesh. Edhe aty ku nuk ka arritur, e ka imponuar gjithë brengën rreth saj ngase po përballemi me diçka që nuk shihet, kurse bota, me gjithë arritjet e mileniumit të ri, me aftësitë dhe përparimet shkencore, në fusha të ndryshme, veçanërisht në mjekësi, ende po tregohet e paaftë në luftimin dhe parandalimin e saj. Lutemi që sa më shpejt të gjendet bari shërues që do ta zhdukë këtë virus, i cili deri tash është shkaktar për vdekjen e shumë njerëzve, shumë të tjerë janë të sëmurë, ndërsa me miliona vazhdojnë të jetojnë në ankth për shëndetin e tyre. Gati në gjithë botën është imponuar një rend i ri jete, ku gjithçka ka marrë një kah të detyruar. Qeveritë kanë marrë masa shtrënguese deri në ato të shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme, ndërsa kanë ndryshuar edhe sjelljet në rrethin e ngushtë familjar, ku bëhet thirrje që edhe brenda ambienteve të tilla të respektohen rregullat dhe sjelljet që izolojnë mundësinë e përhapjes së virusit.

Përpjekjet për parandalimin e përhapjes së virusit kanë aktivizuar të gjitha masat që mund të kontribuojnë për realizimin e këtij qëlli-

mi. Nuk ka dyshim se në plan të parë janë masat praktike tradicionale, të cilat vlerësohen si esenciale dhe shumë efektive dhe se pa aplikimin e tyre nuk mund të ketë sukses në shërimin nga pandemia që ka goditur botën.

Pandemitë e ndryshme, që nga periudhat më të hershme të historisë njerëzore, kanë qenë shumë shkatërruese. Menjëherë pas vdekjes së Muhamedit a.s., muslimanët u ballafaquan me pandeminë e murtajës që kishte goditur rajonin e Shamit, ku si pasojë vdiqën një numër i madh njerëzish. Në këtë situatë ishin mësimet e të Dërguarit të Allahut ato që ofruan zgjidhje duke vendosur parimet bazë për mënyrën e sjelljes në kohë pandemie. Edhe sot, kur shkencat mjekësore kanë avancuar shumë, masat e tilla mbeten mënyra më e mirë, më e lirë, më e lehtë, më praktike dhe më efektive për mbrojtje nga përhapja e pandemisë.

***Fjalët kyçe:** Muhamedi a.s., pandemia e Shamit, Umeri r.a., Serg, konsultimet, shërimi nga pandemia*

Hyrje

Në vitin 18 h. / 640, rreth shtatë vite pas vdekjes së Muhamedit a.s., muslimanët dhe pushteti i udhëhequr nga Umer bin El Hatabi po përballëshin me tri kriza shumë të mëdha, të cilat lanë gjurmë të pashlyera dhe merituan të përmenden e të shkruhet rreth tyre. Ngjarjet dhe ndodhitë ishin të ndryshme, por e përbashkëta ishte fakti se ndodhën në të njëjtën periudhë kohore. Viti 18 sipas hixhretit u karakterizua nga tri ngjarje të mëdha, të cilat në pika të shkurtra do t'i cekim në këtë hyrje, ndërsa pandeminë- murtajën e Shamit do të mundohemi ta trajtojmë në mënyrë më të detajuar. Këto tri ngjarje të atij viti ishin:

E para kishte të bënte me urinë e skajshme në Medinë dhe vendet e rajonit të Hixhazit, ku për shkak të thatësisë së vazhdueshme toka

nuk kishte mbirë asgjë dhe nuk ishte zhvilluar asnjë kulturë bimore, si pasojë njerëzit po rrezikoheshin nga uria e skajshme. Skamja ishte aq e thellë, sa njerëzve u kishte ndryshuar edhe ngjyra e trupit, madje edhe Umerit si kalif, i cili ishte zotuar se do të jetonte jetën e të tjerëve. Ai ishte betuar se nuk do të hante asgjë të yndyrshme, mish apo qumësht, derisa këtë të kenë mundësi ta kishin edhe të tjerët. Kjo gjendje zgjati rreth nëntë muaj¹.

E dyta kishte të bënte me frontin e luftës së hapur me dy perandoritë më të mëdha të kohës; në rajonet e Irakut po përballeshin me Perandorinë Persiane dhe aleatët e tyre, ndërsa në vendet e Shamit po përballeshin me Perandorinë Romake².

E treta kishte të bënte me pandeminë e murtajës (Plague of Emmaus), e cila fillimisht ishte shfaqur në vendin e quajtur Amevas³, një vendbanim në Palestinë, e më pas ishte shpërndarë në viset e Shamit. Ishte shpërndarë shumë shpejt, si flaka e zjarrit në barishtet e thata⁴.

Pandemia e Shamit, e njohur si murtaja Amevas (Emmaus)

Pandemitë nuk janë sëmundje të përditshme e të rëndomta. Gjatë historisë njerëzore kanë shkaktuar dëme shumë të mëdha dhe mbi të gjitha kanë marrë edhe shumë jetë njerëzish. Me gjithë përparimet në

¹ Ibën Xherir Et Taberi, Terijh el umemi ve el muluk, Darul kutub el ilmije, Bejrut,- Liban, vëll. 2, fq. 508.

² <http://arab-ency.com.sy/detail/9705> data e qasjes 05.11.2020.

³ Fshat në Palestinë, 25 km në veriperëndim të Kudsit, apo 28 km. në verilindje të qytetit Jafa, me lartësi mbidetare rreth 200 m. Ka një pozitë shumë strategjike. Ky vend kaloi nën udhëheqjen e muslimanëve në kalifatën e Ebu Bekrit gjersa komandant i luftës ishte Amër ibn El As. Menjëherë pas çlirimit shërbeu si qendër e komandës ushtarake. Vend shumë pjellor dhe i beqetshëm, aty mbillen shumë kultura bimore. Përgjatë gjithë periudhave kohore ishte vend shumë i rëndësishëm. Sot si territor bie nën kontrollin izraelit, ndërsa në vitin 1967 është shndërruar në shëtitore duke shkatërruar të kaluarën e tij.

⁴ Ibën Kethijr, El Bidaje ve En Nihaje, el mektebe el Kudusije, Lahor, botimi i parë, 1404 h, vëll.7, fq. 78-91.

fushën e shkencës dhe mjekësisë, edhe në kohën bashkëkohore paraqiten të rrezikshme dhe shumë problematike, prandaj çfarë mund të themi për periudhën kohore për të cilën po flasim? Shteti islam ishte shumë i ri dhe përvoja me pandeminë shumë e panjohur. Megjithatë, një situatë e tillë nxori në pah veprimet se si duhet të sillemi në kohë pandemie dhe cilat janë veprimet që duhen ndërmarrë, që kryesisht mbështeten në masat e kujdesit të duhur maksimal që nënkuptojnë pastërtinë dhe distancimin social. Këto masa, si një manual, kishin për bazë mësimin e të Dërguarit të Allahut, Muhamedit a.s.. Ai, në kuadër të udhëzimeve të tij të gjithëmbarshme, kishte dhënë mësimet e duhura edhe për sjelljet në situata pandemie, të cilat krijonin parimet bazë që u morën parasysh në përballje me pandemitë në të gjitha periudhat kohore, kurdo që ndodhën ato e deri në situatën me pandeminë aktuale, e cila ka trazuar mbarë botën.

Shtjellimi i problematikës rreth pandemisë së ndodhur në vitin 18 h. në territoret e Shamit është përmbledhur në një ngjarje të cilën e ka prodhuar udhëtimi i Umerit si kalif drejt atyre vendeve. Pasi u njoftua për gjendjen, ai analizoi tërë situatën dhe në fund vendosi të kthehej në Medinë duke mos vazhduar rrugën drejt Shamit. Aty u bë publike edhe thënia e Muhamedit a.s., e cila kërkon masa të distancimit; ata që janë brenda territorit (të sëmuret) ku është shfaqur pandemia nuk bën të dalin jashtë e ata që janë jashtë (të shëndoshët) nuk bën të futen brenda.

Udhëtimi i Umerit drejt Shamit

Buhariu ka shënuar në sahihun e tij transmetimin e Ibën Abasit në lidhje me pandeminë që kishte goditur rajonet e Shamit dhe udhëtimin e Umerit drejt atyre vendeve me qëllim vizite, ndaj do ta paraqesim këtë ndodhi ashtu siç e ka përshkruar Ibën Abasi.

عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عَبَّاسٍ: أَنَّ عُمَرَ بْنَ الْخَطَّابِ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ ، خَرَجَ إِلَى الشَّامِ ، حَتَّى إِذَا كَانَ بِسَرْعَ لَقِيَهُ أُمَّرَأَةُ الْأَجْنَادِ ، أَبُو عُبَيْدَةَ بْنُ الْجَرَّاحِ وَأَصْحَابُهُ ، فَأَخْبَرُوهُ أَنَّ الْوَبَاءَ قَدْ وَقَعَ بِأَرْضِ الشَّامِ . قَالَ ابْنُ عَبَّاسٍ: فَقَالَ عُمَرُ: ادْعُ لِي الْمُهَاجِرِينَ الْأَوَّلِينَ ، فَدَعَاهُمْ فَاسْتَشَارَهُمْ ، وَأَخْبَرَهُمْ أَنَّ الْوَبَاءَ قَدْ وَقَعَ بِالشَّامِ ، فَاحْتَلَفُوا ، فَقَالَ بَعْضُهُمْ : قَدْ خَرَجْتَ لِأَمْرٍ ، وَلَا نَرَى أَنْ تَرْجِعَ عَنْهُ ، وَقَالَ بَعْضُهُمْ : مَعَكَ بَيِّنَةُ النَّاسِ وَأَصْحَابُ رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ ، وَلَا نَرَى أَنْ تُقَدِّمَهُمْ عَلَى هَذَا الْوَبَاءِ ، فَقَالَ: ارْتَفِعُوا عَنِّي ، ثُمَّ قَالَ : ادْعُوا لِي الْأَنْصَارَ ، فَدَعَوْهُمْ فَاسْتَشَارَهُمْ ، فَسَلَكُوا سَبِيلَ الْمُهَاجِرِينَ ، وَاحْتَلَفُوا كَاخْتِلَافِهِمْ ، فَقَالَ: ارْتَفِعُوا عَنِّي ، ثُمَّ قَالَ : ادْعُ لِي مَنْ كَانَ هَاهُنَا مِنْ مَشِيخَةٍ قُرَيْشٍ مِنْ مُهَاجِرَةِ الْفَتْحِ ، فَدَعَوْهُمْ ، فَلَمْ يَحْتَلِفْ مِنْهُمْ عَلَيْهِ رَجُلَانِ ، فَقَالُوا : نَرَى أَنْ تَرْجِعَ بِالنَّاسِ وَلَا تُقَدِّمَهُمْ عَلَى هَذَا الْوَبَاءِ ، فَنَادَى عُمَرُ فِي النَّاسِ: إِنِّي مُصَبِّحٌ عَلَى ظَهْرٍ فَأَصْبِحُوا عَلَيْهِ . قَالَ أَبُو عُبَيْدَةَ بْنُ الْجَرَّاحِ : أَفِرَارًا مِنْ قَدْرِ اللَّهِ ؟ فَقَالَ عُمَرُ : لَوْ غَيْرَكَ قَالَهَا يَا أَبَا عُبَيْدَةَ ؟ نَعَمْ نَفَرُ مِنْ قَدْرِ اللَّهِ إِلَى قَدْرِ اللَّهِ ، أَرَأَيْتَ لَوْ كَانَ لَكَ إِبِلٌ هَبَطَتْ وَادِيًا لَهُ عُذْوَتَانِ ، إِحْدَاهُمَا خَصْبَةٌ ، وَالْأُخْرَى جَدْبَةٌ ، أَلَيْسَ إِنْ رَعَيْتَ الْخَصْبَةَ رَعَيْتَهَا بِقَدْرِ اللَّهِ ، وَإِنْ رَعَيْتَ الْجَدْبَةَ رَعَيْتَهَا بِقَدْرِ اللَّهِ ؟ قَالَ : فَجَاءَ عَبْدُ الرَّحْمَنِ بْنُ عَوْفٍ - وَكَانَ مُتَعَيِّنًا فِي بَعْضِ حَاجَتِهِ - فَقَالَ : إِنَّ عِنْدِي فِي هَذَا عِلْمًا ، سَمِعْتُ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقُولُ : إِذَا سَمِعْتُمْ بِهِ بِأَرْضٍ فَلَا تَقْدُمُوا عَلَيْهِ ، وَإِذَا وَقَعَ بِأَرْضٍ وَأَنْتُمْ بِهَا فَلَا تَخْرُجُوا فِرَارًا مِنْهُ قَالَ : فَحَمِدَ اللَّهُ عُمَرُ ثُمَّ انْصَرَفَ .

Abdullah ibën Abasi tregon se Umer bin El-Hatabi u nis për në Sham dhe vazhdoi rrugën derisa arriti në (vendin e quajtur) Ser-rg. Aty u takua me komandantët e zonave ushtarake, Ebu Ubejde ibnu el Xherrahun dhe të tjerët. Ata e njoftuan se në Sham

ishte përhapur pandemia. Ibën Abasi tregon se (në këtë situatë) Umeri tha: “M’i thirrni muhaxhirët e (gjeneratës së) parë!” I ftoi ata dhe u konsultua me ta, duke i njoftuar se pandemia kishte goditur Shamin. Ata kishin mendime të ndryshme (se a duhet të vazhdonin rrugën më tutje apo të kthehen). Disa prej tyre thanë se ti je nisur për një qëllim të caktuar, ndaj nuk e shohim të udhës që të kthehesh pa e realizuar atë. Ndërsa të tjerët i thanë se ti me vete ke një masë njerëzish e po ashtu edhe shokë të dalluar të Pejgamberit a.s., ndaj nuk e shohim të udhës që të vazhdosh rrugën e t’u shkosh atyre në gjendje pandemie. (Në një situatë të tillë) Umeri tha: “Ngrihuni e largohuni nga unë!” Pastaj vazhdoi duke thënë: “M’i thirrni ensarët!” (Ibën Abasi thotë) Unë i thirra dhe ai u konsultua me ta. Edhe ata u përgjigjën ngjashëm me muhaxhirët, duke mbajtur qëndrime të ndryshme po si ata. Umeri u tha: “Ngrihuni e largohuni nga unë!” Pastaj tha: “M’i thirr ata që janë këtu nga paria e Kurejshëve-muhaxhirët e periudhës së çlirimit të Mekës!” Unë i thirra dhe ata ishin shumë unikë në qëndrimin e tyre, sa nuk kishte asnjëri që mendonte ndryshe. Të gjithë i thanë se ne mendojmë se ti me gjithë njerëzit duhet të kthehesh e të mos shkosh te të tjerët në pandemi. Umeri e bëri publik qëndrimin e vet duke u thënë njerëzve se unë nesër do t’i hipi devesë, edhe ju bëni të njëjtën gjë! (Me të parë qëndrimin e Umerit) Ebu Ubejde tha: -A je duke ikur nga caktimi i Allahut?! Umeri tha: -Po ta thoshte dikush tjetër këtë, o Ebu Ubejde! Po. Ne po ikim prej caktimit të Allahut e po shkojmë (drejt) caktimit të Allahut! Çka mendon po të kishë deve e të zbrisnin në një luginë ku ka dy kullota, njëra prej tyre është pjellore (barishte), ndërsa tjetra djerrinë; a nuk është e vërtetë se nëse i kullot në atë që është pjellore, e bën këtë me caktimin e Allahut e po ashtu nëse i kullot në djerrinë, e bën këtë me caktimin e Allahut? Ibën Abasi thotë se

ndërkohë erdhi Abdurrahman bin Aufi, i cili po mungonte (në ato momente) ngase ishte i zënë për nevojë personale dhe tha: “Unë kam njohuri rreth kësaj çështjeje! E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut duke thënë: “Kur dëgjoni se pandemia ka goditur një vend, mos shkoni atje. E nëse ka goditur një vend gjersa ju jeni brenda, mos dilni jashtë duke ikur nga aty⁵”. Ndërsa Umeri (dëgjoi këto fjalë) falënderoi Allahun dhe u largua⁶”.

Arsyet që bënë që Umeri të udhëtonte drejt Shamit

Nga veprimet e Umer bin Hatabit shohim se ai në tërë situatën e pandemisë u soll me shumë kujdes dhe ishte në nivelin e përgjegjësive në të gjitha aspektet. Mënyra se si u soll ai dhe analiza e veprimeve që ndërmori na bëjnë ta kuptojmë përgjegjësinë e duhur për të menaxhuar një krizë të re, të panjohur deri tani dhe se me një situatë të tillë po përballeshin për herë të parë. Shikuar nga kjo pikëpamje, e shohim të udhës që asaj që bëri Umeri si kalif ne t’i bëjmë një analizë për të nxjerrë mësimet se si duhet të menaxhohen situatat e jashtëzakonshme, si të ballafaqohemi me kriza të cilat paraqesin rrezik masiv dhe se mostrajtimi adekuat mund të rezultojë me dëme katastrofike.

Udhëtimi i Umerit drejt Shamit, ashtu siç e tregon Abdullah ibën Abasi dhe e transmeton Buhariu në sahihun e tij, ka nxjerrë në shesh veprimet praktike dhe mënyrën e sjelljes në situata kur jemi para marrjes së ndonjë vendimi të duhur, si në rastin e gjendjes së pandemisë me të cilën ishte ballafaquar Umeri r.a. gjatë rrugës së tij drejt Shamit. Por jo vetëm kaq, ngase ngjarja si e tillë duhet të analizohet nga aspekte të gjithanshme, të cilat paraqesin një rëndësi të veçantë studimi. Kjo

⁵ Ibën Haxher el Askalani, Fethul bari bi sherh Sahihi el Buhari, darul kutub el ilmije, Bejrut-Liban, vëll. 10, fq. 190, nr. 5396, Sahih Muslim, Daru ihjai et turath el arabi, Bejrut-Liban, hadithi, nr. 1217.

⁶ Ibën Haxher, Fet’hul Bari, vëll. 10, fq. 184, nr. 5397.

ngjarje është dëshmi edhe për mënyrën se si Umeri si udhëheqës suprem i muslimanëve udhëhiqte pushtetin, organizimin e sistemit ushtarak, përgjegjësinë e pushtetit në rastin e menaxhimit të situatave, nevoja për një bazë të gjerë konsultimi duke i vlerësuar të gjitha kategoritë e shoqërisë, sidomos shtresat e caktuara. Mënyra e veprimit të Umerit paraqet modelin se sa është e rëndësishme të konsultohesh me të tjerët, veçanërisht kur je para vendimeve të cilat mund të kenë pasoja në masën e gjerë, siç është rasti me pandeminë.

Shikuar nga kjo pikëpamje, ngjarja e ndodhur nxjerr në shesh edhe shumë tema të tjera, të cilat janë interesante po aq sa edhe çështja e murtajes, e cila doli si problem i ri me të cilin nuk ishin ballafaquar kurrë më parë. Shoqëria islame, si një organizëm i ri, po rritej, organizohet e zhvillohet në të gjitha aspektet e jetës. Para pak vitesh ishin vetëm një grumbull njerëzish, ndërsa pa kaluar dy dekada nga fillimi, ata ishin shndërruar një forcë e cila po zgjeronte pushtetin duke fituar në përballje me dy perandoritë më të njohura të kohës, atë persiane dhe romake.

Përpjekjet e para për të testuar forcat romake dhe ballafaqimi në front

Edhe sa ishte gjallë Muhamedi a.s., kishte organizuar përpjekje ushtarake të cilat synonin shfaqjen e guximit dhe gatishmërinë për përballje me forcat romake. Për këtë qëllim kishte përgatitur dhe urdhëruar Usame bin Zejdin që në krye të një ushtrie të niseshin drejt Shamit, ku do të parandalonin një sulm të mundshëm të ushtrisë romake⁷.

Pasi Pejgamberi a.s. kaloi në ahiret, në udhëheqjen e pushtetit e zëvendësoi Ebu Bekri, i cili menjëherë pasi vendosi rendin dhe ligjin duke u ballafaquar me trazirat e brendshme dhe ktheu në vend ligjsh-

⁷ Ibën Sead, Et Tabekat el Kubra, Daru el Kutub el Ilmije, Liban-Bejrut, vëll. 2, fq. 189.

mërinë e pushtetit duke zotëruar gjithë situatën, shfaqti mendimin e përballjes me forcat persiane dhe ato romake⁸.

Në drejtim të Irakut të sotëm ai kishte nisur formacionet ushtarake, një brigadë me në krye komandantin e përgjithshëm Halid bin Velidin, që do të përballëshin me forcat persiane. Gati në të njëjtën kohë kishte nisur konsultimet për dërgimin e forcave të tjera në drejtim të viseve të Shamit, ku do të përballëshin me romakët bizantinë. Pas bisedave të duhura dhe këshillimeve me njerëzit më të afërm të tij, kishte dalë me vendimin se duhet të ndërmerrnin të gjitha masat dhe të bënë përgatitjet e duhura për misionin e radhës, i cili ishte shumë i vështirë dhe shumë sfidues. Deri në atë kohë nuk kishte formacione të rregullta luftarake, ndaj ushtria formohej nga individë mbi bazën e përgjegjësisë morale, e cila klasifikohej si detyrim fetar për të gjithë ata që ishin në gjendje të merrnin pjesë në luftë. Medina, si kryeqytet dhe qendër e vendosjes, nuk kishte atë masë të duhur njerëzish që do të luftonin, veçanërisht kur kemi parasysh përballjen që po i priste, ndaj Ebu Bekri si kalif dhe komandant suprem bëri një thirrje publike me të cilën kërkoi që edhe rajonet e tjera islame të merrnin pjesë. Sipas burimeve tregohet se populli i Jemenit ishte përgjigjur në mënyrë masive, duke iu bashkangjitur radhëve të ushtrisë, e cila do të nisej drejt Shamit. Në anën tjetër, Ebu Bekri me kohë kishte nisur përgatitjet dhe kishte bërë strategjinë mbi bazën e së cilës ushtria do të lëvizte dhe do të organizonte aktivitetet e veta në fushën e mejdanit.

Në ditët e sotme kur themi Sham nënkuptojmë shtetin e Sirisë e jo diçka më tepër, ndërsa në kohën e mëhershme Shami nënkuptonte terriore shumë më të gjera ku hynin shtetet e sotme: Siria, Libani, Jordania, Palestina, disa pjesë të Arabisë Saudite në kufi me Jordaninë, disa

⁸ Muslimi në sahihun e tij transmeton hadithin i cili bën fjalë rreth qëndrimit të Ebu Bekrit përballë rebelimeve të grupeve të caktuara pas vdekjes së Muhamedit a.s. dhe vendosmërinë që kishte treguar për sundimin e rendit dhe ligjit. Për më tepër shih: Sahihu Muslim bi sherh En Nevevi, botoi: Darul kutub el ilmije, Bejrut, Liban, vëll.1, fq. 53, nr. 23.

territore të Turqisë në kufi me Irakun edhe Sirinë. Pra, duhet ta kemi të qartë se ushtria që po niste Ebu Bekri duhej të përballej me një territor shumë të gjerë, skajet e të cilit ishin vështirë të arritshëm.

Duke analizuar territorin dhe specifikat e tij Ebu Bekri kishte vendosur që Shamin ta ndante në katër njësi ushtarake, ku çdonjëra do të kishte përgjegjësi operative të ndara, por që në raste nevoje dhe sipas zhvillimeve në terren gjithsesi do të ndërvepronin dhe do t'i koordinonin veprimet ushtarake. Ebu Bekri kishte paraparë ndarjen e zonave të tilla dhe kishte emëruar komandantët ushtarakë sipas paraqitjes në vazhdim⁹:

- Ebu Ubejde ibnul Xharrahu, komandant për zonën Hims, nën komandën e tij kishte rreth 3000-4000 ushtarë.
- Jezid bin Ebi Sufjani, komandant për zonën Damask, nën komandën e tij kishte rreth 7000 ushtarë.
- Amër ibn El Asi, komandant për zonën e Palestinës, nën komandën e tij kishte më pak se 7000 ushtarë.
- Sherahbijl bin Haseneh, komandant për zonën Tebuk, nën komandën e tij kishte më pak se 4000 ushtarë.

Më vonë, gjatë zhvillimeve të luftës, duke u parë nevoja dhe me kërkesë të komandantëve në terren, u kishin shkuar si mbështetje edhe 2700 trupa.

Në anën tjetër, ushtria bizantine përbëhej prej 270.000 trupash, të përqendruara në dy zona; rreth 70.000 trupa ishin vendosur në Palestinë, ndërsa 200.000 trupa ishin vendosur në Antakia. Pra, shihet qartë dallimi në numra, ngase ushtria e muslimanëve kishte rreth 20.000 ushtarë, ndërsa ushtria romake numëronte rreth 270.000 ushtarë.

Nisja e ushtrisë së Ebu Bekrit drejt Shamit kishte ndodhur në vitin 12 sipas hixhretit apo 633, pastaj luftimet kishin zgjatur disa vite, prej 12 deri më 19 h. apo 633 deri më 639m, kur i tërë territori i Shamit ki-

⁹ Emijn el Kudat, El Hulefau err Rrashidun Eamalun ve ahdath, darul Furkan 2004, fq. 30.

shte kaluar nën autoritetin e pushtetit islam. Në llogaritje kohore duket se luftimet kanë zgjatur për rreth gjashtë vite, por e vërteta dëshmon se komandantët ushtarakë të muslimanëve për të shmangur luftën u jepnin kohë zgjidhjeve paqësore dhe bisedimeve. Kështu që shumë prej vendeve të Shamit ranë në dorë të ushtrisë islame në mënyrë paqësore. Veprimet e Ebu Bekrit ishin shumë të rëndësishme ngase hapën rrugën e shtrirjes së Islamit në toka të reja, të një rëndësie të veçantë, si në aspektin gjeografik po ashtu edhe në atë strategjik. Ebu Bekri ishte në krye të shtetit që prej dy vitesh, prej 11 h deri 13 apo prej 631 deri më 634¹⁰. Megjithatë ky ishte vetëm fillimi ngase ngjarjet më të rëndësishme, luftërat më të rrepta e fitoret më të mëdha deri në kapitullin e fundit u zhvilluan në kohën kur Umeri ishte në krye të udhëheqjes së muslimanëve.

Tri vizitat e Umerit r.a. në Sham

Gjersa luftimet po vazhdonin dhe ushtria e muslimanëve po merrte vendet e Shamit një nga një, kishin arritur të rrethonin qytetin e shenjtë të Kudsit, të cilin e vunë nën kontroll nga të gjitha anët dhe ky rrethim zgjati diku rreth gjashtë muaj, saktësisht, prej muajt nëntor 636 deri në prill të vitit 637 (sheval 15h. deri rabiul evel 16). Me gjithë kushtet e vështira, në stinë dimri, muslimanët kishin vazhduar rrethimin, duke mos u zbrapsur në asnjë moment. Me stinën e pranverës, nga prapavija erdhën edhe forca shtesë, pas të cilave Sophronius, patriarku i qytetit të Kudsit, ra në ujdë që të bënte marrëveshje për dorëzimin e qytetit, por kushtëzoi që këtë ta bënte vetëm me Umerin r.a. si udhëheqës i muslimanëve.

Komandantët menjëherë njoftuan Umerin, i cili u nis nga Medina për të bërë një rrugë të gjatë derisa arriti në Kuds, ku u takua me patri-

¹⁰ Ebu Bekri vdiq më 21 xhumade eth Thani të vitit 13 h. apo më 22 gusht 634.

arkun dhe bënë marrëveshjen për dorëzimin e qytetit në mënyrë paqësore, ku precizoheshin edhe pikat e saj, për të cilat Umeri u deklarua se do t'i merrte parasysht dhe do t'i respektonte në tërësi. Umeri r.a. mori çelësat e Kudsit më 13 ramazan të vitit 15 h. Natyrisht se është shumë me interes që atë marrëveshje ta bëjmë publike edhe në kohët e sotme për të dëshmuar besnikërinë, tolerancën dhe respektin që muslimanët kanë për të tjerët, sidomos në rrethana kur janë në epërsi, si në rastin e marrëveshjes në fjalë.

Hera e dytë kur Umeri vizitoi Shamin

Problemi i pandemisë ka sjellë në kujtesën tonë udhëtimin e Umerit drejt Shamit, në një tregim ngjarje e cila përfundon me hadithin e Muhamedit a.s. rreth sjelljes në raste pandemie e që për ne sot është temë shumë aktuale dhe na bën të ndihemi krenarë me atë që është transmetuar nga i Dërguari i Allahut rreth mënyrës së sjelljes në situata pandemie. Mësimet e tij edhe në këto kohë paraqesin kodin e sjelljeve të duhura përballë problemeve të tilla, të cilat muslimanët i kanë marrë për bazë dhe i kanë zbatuar qysh para katërmëdhjetë shekujsh.

Ajo që thamë më herët rreth luftërave të muslimanëve në territoret e Shamit paraqet arsyen e drejtpërdrejtë pse Umeri kishte marrë rrugën për atje. Aktivitetet ushtarake po shkonin drejt fundit, ndaj ishte koha që Umeri me shokët e tij të bënin vizitë për të shënuar triumfin dhe për të uruar të gjithë ata që luftuan e ranë shëhidë në ato vende, e sa të shumtë ishin ata! Umeri në Medinë nisi përgatitjet e duhura për udhëtim. Pasi e përzgjedhi shoqërinë e rrugës, bëri publike nisjen. Në mesin e atyre që udhëtuan kishte sahabë nga më të mëdhenjtë, të cilët ishin edhe këshillues edhe ndihmëtarë, e nëse e kërkonte puna edhe luftëtarë. Biseda e mëvonshme e bën të qartë klasin e atyre që udhëtuan me të. Ai në luftë kishte dërguar më të aftët, por edhe në Medinë kishte lënë ata që i duheshin t'i kishte afër vetes ngase kishte nevojë për ta.

Umeri me shokë ishin nisur drejt Shamit, përafërsisht në të njëjtën rrugë që kishte bërë Muhamedi a.s., kur kishte udhëtuar për në luftën e Tebukut.

Komandantët ushtarakë që po vepronin në Sham ishin në dijeni për udhëtimin e Umerit, ndaj i dolën para në rrugë që ta pritnin në distancë, para se ai me shoqëruesit e tij të hynin në zonat me pandemi, e cila sa kishte filluar. Dy palët u takuan në vendin e quajtur Serg¹¹. Aty e

¹¹ Është një vend në kufirin ndarës në mes Shamit dhe Hixhazit, kështu definohej në kohët e mëhershme kur kufijtë nuk ishin të përcaktuar si sot. Ndërsa në ditët e sotme ky vend gjendet në Jordani, afër kufirit me Arabinë Saudite. Ka një rëndësi historike qysh në kohët e mëhershme edhe para ardhjes së Islamit. Edhe në periudha më të lashta udhëtimet nga Meka (Hixhazi) drejt Damaskut (Sham) kalonin nëpër Serg. Në periudhën e Islamit haxhilerët, në udhën për në haxh, me karvanët e tyre, drejt Mekës, kalonin nëpër këtë vend. Në rrugën e gjatë ishte një pikë ndalese, e pesëmbëdhjeta sipas radhës duke filluar nga Damasku, ku pushonin e pastaj vazhdonin rrugën. Kështu vepronin edhe në shkuarje edhe në kthim. Si një luginë tatëpjetëse ishte e rrethuar me male (kodra) shkëmbore. Vendi dallohej nga një shkëmb kapelor, i cili është shumë i lashtë e ashtu vazhdon të jetë edhe sot si një mrekulli e Allahut. Të tillë e kanë përshkruar edhe autorët gjatë gjithë periudhave kohore. Edhe pse ishte stacion ndalese e pushimi, nuk ishte vend i banueshëm. Aty kishte një burim uji, i cili shuante etjen e udhëtarëve e bëhej shumë i rëndësishëm në kohën haxhit. Kishte shumë pak ujë e në anën tjetër shumë të nevojshëm për të. Thuhej se në atë vend një gotë ujë vlente sa një gotë gjak. Ky vend me emrin Serg ishte njohur deri në shekullin e shtatë sipas hixhrit. Në shekullin e dhjetë ky vend njihet me tre emra: Surer, Et Tubejlje dhe Xhugejman. Ky i fundit sipas një burri, i pari i fisit i cili sillej keq me haxhilerët dhe i sulmonte ata. Veprimet e tij kishin ndodhur prej vitit 910 deri 926 h.

Evlija Çelebi në udhëpërshkrimet e tij e ka cekur këtë vend duke thënë: “Aty ka një shkëmb që është mrekulli e Allahut, gjendet në jug të shkretëtirës, nuk është e banuar. Aty vajza e sulltan Sulejmanit, Esmā, kishte ndërtuar një rrjedhë uji, e cila përmes gypave sillte ujin në një pellg, i cili anonte kah njelmësia.

Më vonë për shkak të shkëmbit rrethor ky vend ndërroi emrin, tani quhej El Mudevere (Rrethorja) e me këtë emër quhet edhe në ditët e sotme.

Në periudhën e kalifatit osman, Abdulla Pasha, si udhëheqës i haxhit, në këtë vend kishte ngritur një ndërtesë (kala), për ndërtimin e së cilës kishte punuar edhe personalisht. Në dy anët e saj kishte rrjedha uji, ku nga pellgu i madh uji kalonte në pusin e vogël. Përbrenda ndërtesës kishte shpuar një burim nga i cili nxirrej uji i ëmbël për pirje. Këto veprime kishin ndodhur në vitin 1731/1143h, në kohën kur Abdulla Pasha si vali i Shamit ishte edhe në detyrën e udhëheqësit të haxhit si një përgjegjësi shumë e rëndësishme dhe me nder.

Në vitin 1905/ 1332h. sulltan Abdulhamidi kishte vendosur të ndërtonte hekurudhën, e cila do të lidhte Shamin me Hixhazin. Duke mënjeluar terrenet e vështira e kodrinore ishte paraparë që projekti i hekurudhës të mos kalonte nëpër Serg (Mudevere) duke e anashkaluar për 3.5 km në lindje të saj. Ky ishte momenti kur një vend me një histori e ngjarje të shënuara përgjatej shekujve, edhe vetë kaloi në histori. Në ditët e sotme kalaja ka mbetur e shkretë dhe pa kurrfarë kujdesi nga organet përgjegjëse. Nga fotot e shkrepura në vitin 2018 shihet se dora e

njoftuan se vendi ishte goditur nga murtaja dhe se ishte përhapur me të madhe, ndaj kërkuan vëmendjen e Umerit dhe vlerësimin e situatës.

Sipas asaj që dëshmojnë transmetimet, Umeri kishte ndier rrezikun e murtajës që në momentet e para të arritjes dhe njoftimit. Menjëherë kishte tërhequr vëmendjen te pozita që po mbante dhe përgjegjësinë që kishte. Në një situatë të tillë ai do të mund të infektohej dhe të vdiste, ndaj la vasijet gojor, ku caktoi zëvendësin e tij duke thënë: “Nëse unë vdes, ndërsa Ebu Ubejde ibnul Xherrah është gjallë, unë po ua lë zëvendës timin atë. E nëse Allahu do të më pyeste (pas vdekjes), se pse e caktove për zëvendës, unë do t’i them se i Dërguari Yt ka thënë:

إن لكل أمة أميناً وإن أميننا أيتها الأمة أبو عبيدة بن الجراح

“Çdo ymet ka (ndonjë njeri) të besuar, e i besuari ynë o ymet është Ebu Ubejde ibnul Xherrah¹²”. E nëse unë vdes dhe Ebu Ubejde nuk është gjallë, atëherë zëvendësi im është Muadh bin Xhebeli. Nëse Allahu do të më pyeste se pse e caktove Muadhin, unë do t’i them se e kam dëgjuar të Dërguarin tënd duke thënë: “*Ai (Muadhi) Ditën e Gjykimit do të ringjallet në mesin e dijetarëve në pozitë të dalluar (avancuar)*¹³”.

Nga mënyra e shprehjes së Umerit është e qartë se ai këto deklarime i ka bërë para se të takohej me udhëheqësit e luftës në territoret e Shamit. Ai ishte vënë në dijeni për gjendjen para se ata të arrinin, ndërsa më pas, kur ata kishin arritur, ishte zhvilluar e gjithë biseda e treguar në hadithin e temës. Kjo kohë përkonte me fillimin e shfaqjes së pandemisë.

njeriut e ka dëmtuar shumë dhe ajo është para rënies. Shih fotot dhe të dhënat e tjera në: <http://alsahra.org/?p=21065> gjithashtu:

<http://wiki.dorar-aliraq.net/lisan-alarab/%D8%B3%D8%B1%D8%BA>

¹² Ibën Haxher, *Fethul Bari*, vëll. 7, fq. 116.

¹³ Musnedi i imam Ahmedit, *Darul hadith*, Kajro, vëll. 1, fq. 23.

Takimi me komandantët e luftës

Sipas tekstit të hadithit, Umerin kishin dalë ta pritnin komandantët e luftës, të cilët administronin zonat e Shamit dhe udhëhiqnin aksionet ushtarake. Përafërsisht ata që i kishte emëruar Ebu Bekri: Ebu Ubejde ibën El Xharrahu, Amër ibën El Asi, Jezid bin ebi Sufjanu, Sherahbijl bin Hasene dhe Halid bin Velidi, i cili u ishte bashkuar komandantëve të Shamit, më herët me urdhrin e Ebu Bekrit, ngase komandantët në terren kishin kërkuar forca shtesë. Natyrisht, në mesin e atyre që erdhën për ta takuar kishte edhe shumë nga paria dhe personalitetet më me ndikim, ngase momenti ishte shumë serioz dhe gjendeshin para vendimeve të rëndësishme, ndaj duheshin konsultime të mirëfillta për të nxjerrë vendime të duhura¹⁴.

Umeri ishte shumë mendjehollë dhe kishte një intuitë të cilën ia kishte lavdëruar edhe Pejgamberi a.s. në shumë raste deri në atë shkallë sa kishte thënë se “po të kishte Pejgamber pas meje, ai do të ishte Umeri¹⁵”. Edhe me këtë rast ai dëshmoi aftësitë e tij. Nuk kishte si të bënte më mirë sesa të vendoste për një bazë të gjerë konsultimi, të thërriste të gjitha shtresat prezente dhe të merrte mendimin e tyre. Nuk ka dyshim se problemi ishte shumë i madh, ndaj të gjithë kishin vëmendjen e duhur se çka do të ndërmerrete Umeri r.a. dhe si do të vepronte përballë një situatë me të cilën nuk ishin ballafaquar më parë. Të gjithë e dinin dhe e kishin provuar se Umeri r.a. ishte njeri i vendimeve¹⁶.

Dilema e konsultimit ishte e qartë ngase duhej të merrej një vendim se a do të vazhdonte rrugën Umeri dhe të hynte në Sham në gjendje pandemie apo duhet të kthehej në Medinë¹⁷.

¹⁴ El Kurtubi, *El Muftim lima eshkele min telhijis kitab Muslim*, Dar ibën Kethir, Damask-Bejrut, vëll. 5, fq. 615.

¹⁵ Hadithin e transmeton Tirmidhiu, nr. 3686, dhe Ahmedi, vëll. 4, fq. 154, nr. 17405.

¹⁶ El Kurtubi, *El Xhami li ahkami el Kuran*, vëll. 3, fq. 232.

¹⁷ Po aty, vëll.1, fq. 210.

Ajo që bie në sy që në fillim është profili i personazheve të kësaj ngjarje. Ibën Abasi, si mufesiri dhe dijetari i këtij ymeti, e transmeton krejt këtë ndodhi e për më tepër ai ishte personi përmes të cilit Omeri r.a. komunikonte me të tjerët.

Konsultimi me bazë të gjerë

Ata që e njohin udhëheqjen e Omerit si prijës në krye të shtetit islam e dinë mirë se konsultimin e kishte mekanizmin kryesor në të gjitha çështjet e jetës, veçanërisht në raste vendimmarrje kur situata ishin serioze. Omeri ishte shumë i fortë, por jo i vrazhdë. Edhe në raste lufte kur emëronte komandantët, i urdhëronte që para vendimeve gjithsesi të konsultoheshin me më të mençurit që kishin me vete. Parimin e konsultës së gjerë e zbatoi edhe në këtë rast. Fillimisht urdhëroi Ibën Abasin të thërriste për konsultime gjeneratën e parë të muhaxhirëve nga sahabët, ata që kishin falur namazin duke u drejtuar drejt dy kibleve, në fillimet e Islamit në Medinë, drejt Kudsit e kur Allahu ndryshoi kiblen, ata u kthyen drejt Qabesë. Ata kishin vlera të cilat Allahu ua njohu në Kuran dhe rreth tyre zbritën ajete, ndërsa Muhamedi a.s. tha shumë hadithe duke u thurur shumë lavde e merita. Ata kishin shumë merita për arritjet e Islamit, për këto arsye donte t'i vlerësonte duke i konsultuar. Ata që kanë pranuar Islamin pas ndërrimit të kibles, nga Kudsi drejt Qabesë, nuk llogariten nga muhaxhirët e parë. Nga konsultimi i tyre rezultoi se nuk ishin të një mendimi. Disa i thanë se ti je nisur për një qëllim të caktuar, që të arrish në Sham, ndaj duhet të vazhdosh rrugën derisa të arrish qëllimin, pa u ndikuar nga shpërthimi i pandemisë. Të tjerët thoshin se duhet të kthehesh ngase me ty ka shumë njerëz e në mesin e tyre edhe shokë të Muhamedit a.s. si një kategori e veçantë në shoqëri, për të cilët duhet të kesh kujdes duke mos ua rrezikuar shëndetin. Sipas tyre duhet treguar kujdesi i duhur në këtë situatë duke vepruar me shumë maturi. Duke parë mendimet e tyre të ndryshme dhe se

ata nuk po bëheshi të një fjale, kërkoi prej tyre që të largohen nga kuvendi i tij.

Pasi përfundoi konsultimin me grupin e parë, urdhëroi Ibën Abasin të thërriste në konsultime përfaqësuesit e ensarëve (vendastit e Medinës), të cilët shoqëronin Omerin r.a. në udhëtimin drejt Shamit. Edhe ata nuk dalluan shumë nga ajo që thanë grupi para tyre dhe kishin gati të njëjtat arsye. Disa i sugjeruan që të vazhdonte rrugën, ndërsa të tjerët ishin të mendimit se duhet të kthehej. Me të përfunduar konsultimet dhe duke parë se nuk ishin në ujdi rreth një qëndrimi, Omeri i urdhëroi që të ngrihen e të shkojnë.

Në këtë situatë urdhëroi Ibën Abasin që të thërriste për konsultime burrat që kishin bërë hixhretin pak kohë para çlirimit të Mekës, apo edhe në vitin e çlirimit të Mekës. Në mesin e tyre kishte edhe të atillë që kishin kaluar në Medinë pas çlirimit të Mekës, edhe pse hixhreti kishte pushuar si veprimtari e ligjshme në emër të Islamit, këta quheshin muhaxhirë në aspektin formal e simbolik. Ata ishin njerëz shumë të çmuar e me vlerë. Për shkak të pozitës në shoqëri, Omeri e kishte parë të udhës që edhe me ata të konsultohej duke marrë parasysh mendimin e tyre, si një kategori specifike. Disa prej tyre ishin të rinj në Islam, por në anën tjetër kishin shumë përvoja jetësore. Gjatë konsultimit u bë i qartë qëndrimi i tyre unik se Omeri duhet të kthehet dhe se kthimi do të ishte qëndrimi më i drejtë në këtë situatë. Ata vlerësonin se është shumë e rëndësishme që njerëzit të mbahen larg territoreve të pandemisë.

Pasi konsumoi konsultimet me të gjitha palët, Omeri bëri publik qëndrimin e tij duke thënë se do të ktheheshin për Medinë dhe njoftoi se do të lëviznin nesër herët në mëngjes.

Autorët e ndryshëm në komentimin e hadithit, duke vlerësuar vendimin e Omerit, kanë thënë se ai kishte një qëndrim të vetin që në fillim kur e njoftuan për problemin, por megjithatë vendosi që vendimin ta merrte pasi të konsultohej me të gjitha palët prezente, duke vlerësuar

kështu rëndësinë që ai u jepte shtresave të ndryshme të shoqërisë. Tani ishte momenti që të gjithë të ishin pjesëmarrës në një vendim të duhur e në një moment shumë të rëndësishëm. Shikuar realisht Omeri veprroi sipas konkluzës që prodhoi konsulta, ngase dy grupet e para ishin të ndara në mendime; disa thoshin se duhej vazhduar rruga drejt Shamit e të tjerët thoshin se duhet të ktheheshin, ndërsa grupi i tretë ishin unik duke thënë se duhet të ktheheshin. Kjo i bie se Omeri ka vepruar sipas mendimit të shumicës.

Polemika ndërmjet Omerit r.a. dhe Ebu Ubejdes

Omeri kishte bërë publik vendimin e tij dhe ai duhej të zbatohej. Megjithatë, Ebu Ubejde në pozitën e komandantit kryesor të të gjitha forcave që gjendeshin në tokat e Shamit, i bëri vërejtje vendimit të Omerit duke i thënë: -A po kthehesh duke ikur nga caktimi i Allahut?

Ai po implikonte kështu një element besimi, i cili i referohej caktimit të Allahut. Të gjitha çështjet janë në dorën e Tij dhe se nuk mund të ndodhë asgjë pa dijen dhe caktimin e Tij, ndaj mbi këtë bindje dogmatike Omeri duhej të vazhdonte drejt Shamit duke hyrë në vatrat e pandemisë. Me të dëgjuar thënien e Ebu Ubejdes, Omeri ia ktheu: -Po ta kishte thënë këtë dikush tjetër!

Omeri ishte shumë i shpejtë dhe shumë i saktë në shprehjen e mendimit të tij. Në këtë cilësi nuk e shoqëronte askush. Ai e shprehte mendimin e vet edhe në prezencën e Pejgamberit a.s. dhe zakonisht ia qëllonte dhe merrte vëmendjen e tjerëve. Edhe kësaj here reagoi konform situatës dhe duke pasur parasysh personalitetin dhe pozitën e Ebu Ubejdes. Në një pikëpamje tjetër kjo polemikë dëshmon transparencën dhe nivelin e lirisë së shprehjes e të mendimit në nivele aq të larta të udhëheqjes. Përballë ishin dy personalitetet kryesore të shtetit; Omeri si udhëheqës i përgjithshëm i muslimanëve dhe Ebu Ubejde si njeriu i dytë i shtetit, në pozitën e komandantit ushtarak për gjithë zonën e

Shamit. Edhe pse ishte mendim i kundërt, megjithatë Ebu Ubejde e tha atë që mendonte. Shumë lehtë do të mund të kishte një qëndrim vasal e të përshtatej me të pa e vrarë mendjen se a e ka mirë apo jo; së paku kjo është logjika e udhëheqjes së pushtetit dhe qëndrimit në pushtet në shumicën e rasteve.

Çfarë deshi të thoshte Omeri me reagimin e tij ndaj Ebu Ubejdes

1. Po ta kishte thënë këtë dikush tjetër, do të kisha reaguar duke marrë masa ndëshkuese ndaj tij.
2. Po ta kishte thënë këtë dikush tjetër, ngase një thënie e tillë nuk të përket ty, nuk të ka hije që ta thuash ti këtë. Ti je një burrë i madh e i mençur, ndaj nuk e prisja prej teje një vlerësim të tillë. Sipas këtij mendimi Omeri kishte një reagim këshillues duke marrë parasysh vlerësimin që kishte për Ebu Ubejden.
3. Omeri gjithmonë e vlerësonte qëndrimin e Ebu Ubejdes, ndaj lakmonte që të ishte identik me të dhe të qëndronte përkrah tij. Kishte bindjen se mendimi i përbashkët me Ebu Ubejden i jepte një ndjenjë sigurie dhe që të dy e forconin njëri-tjetrin dhe mbaheshin më të fortë. Këtu përballëshin me një situatë shumë serioze, ndaj Omerit i vinte keq që nuk ishin të një mendimi.

Nuk ka dyshim se në reagimin e Omerit ndikoi implikimi i çështjes së kaderit në një qëndrim i cili mund të trajtohej në mënyrë të dyanshme, ngase nuk kishte të bënte me argumente të prera e të drejtpërdrejta¹⁸. Vendimi për të vazhduar apo për t'u kthyer ishte çështje analize e studimi ngase gjendeshin para një situatë ku duhej vlerësuar rreziku real, i cili ishte shumë objektiv. Ruajtja e njerëzve ishte interes vital,

¹⁸ Ibën Haxher, *Fet'hul Bari*, vëll. 10, fq. 189-190.

ndërsa hyrja në territoret ku ishte përhapur pandemia po paraqiste një rrezik real që shihej hapur. Pastaj, Omeri e arsyetoi shumë logjikshëm qëndrimin për t'u kthyer. Kur Ebu Ubejde i tha se a po ikni nga kaderi (caktimi) i Allahut, Omeri tha se po ikim prej kaderit të Allahut e po shkojmë drejt kaderit të Allahut¹⁹. Kjo nënkupton se njeriu kudo që shkon, nuk mund të ikë nga kaderi i Allahut dhe se caktimi i Tij është i pashmangshëm e njeriu shkon drejt tij detyrimisht. Ata vetëm sa bënë atë që në situatën e caktuar e shihnin si një zgjidhje më të mirë dhe më me interes²⁰.

Krejt kjo polemikë ndodhi pasi Omeri e kishte marrë vendimin dhe e kishte bërë publik atë. Megjithatë situata u bë e qartë plotësisht kur erdhi sahabi i mirënjohur Abdurrahman bin Aufi dhe tha se ai kishte njohuri rreth kësaj çështjeje duke thënë se e kishte dëgjuar të Dërguarin e Allahut duke thënë: “Kur dëgjoni se pandemia ka goditur një vend, mos shkoni atje. E nëse ka goditur një vend gjersa ju jeni brenda, mos dilni jashtë duke ikur nga aty”. Ndërsa Omeri (dëgjoji këto fjalë) falënderoi Allahun dhe u largua.

Natyrisht se ky transmetim i Abdurrahman bin Aufit e sqaroi tërë situatën, ndërsa Omeri kishte arsye që tani të ishte plotësisht i qetë për vendimin që kishte marrë.

Respekti i Omerit ndaj Ebu Ubejdes

Në lidhje me polemikën ndërmjet Omerit dhe Ebu Ubejdes duhet të sqarojmë diçka që është shumë e rëndësishme. Mënyra e zhvillimit të bisedës dhe paraqitja e mendimeve të kundërta në asnjë mënyrë nuk mund të kuptohet si shfaqje e raporteve jomiqësore mes atyre të dyve. Është e vërtetë e argumentuar në mënyra të ndryshme se Omeri e donte

¹⁹ Ibën Kajim El Xhevziye, *Zedul mead li hedji hajril ibad*, Muesesetu Er Risaleti, vëll. 4, fq. 44-45.

²⁰ El Kurtubi, *El Xhami li ahkamil Kuran*, vëll. 3, fq. 233.

shumë Ebu Ubejden, e çmonte dhe e vlerësonte nga të gjithë sahabët dhe kjo është e dëshmuar publikisht.

Ai e kishte emëruar për komandant të përgjithshëm, i cili udhëhiqte forcat e armatosura në Sham. Kishte thënë se nëse unë vdes në këtë kohë pandemie dhe Ebu Ubejde është gjallë, unë që tash po ua caktoj atë si zëvendës në pozitën e kalifit pas meje. Në një rast, duke zgjedhur nga dëshirat e kësaj bote, kishte thënë se “do të dëshiroja të kisha shumë burra si Ebu Ubejde e t’i angazhoja në kryerjen e detyrave (fi sebililah)”.

Omerit i dhimbsej shumë Ebu Ubejde, ndaj me t’u kthyer në Medinë mori iniciativën për ta nxjerrë jashtë Shamit²¹. Ai i dërgoi një shkresë me urgjencë, në të cilën e urdhëronte që posa ta hapte letrën, menjëherë të nisej për Medinë ngase donte të konsultohet për një çështje shumë të rëndësishme dhe se kthimi i tij ishte i domosdoshëm. Me të hapur letrën, Ebu Ubejde e kishte kuptuar qëllimin e Omerit dhe se ai donte ta largonte nga zona e pandemisë, ndaj menjëherë i shkroi se duke marrë parasysh gjendjen në të cilën ishin dhe pozitën e tij si udhëheqës i përgjithshëm, nuk mund t’i lejonte vetes të largohej e të tjerët të mbeteshin aty, ndaj me gjithë kujdesin që t’i bindej autoritetit të Omerit si udhëheqës i besimtarëve, i kërkoi hallallin duke thënë se do të vazhdonte me detyrat e besuara²². Me të arritur përgjigjja e Ebu Ubejdes tek Omeri r.a., posa e hapi dhe e lexoi, filloi të qante, ndërsa të pranishmit e pyetën me shqetësim se a kishte vdekur Ebu Ubejde. Omeri ua ktheu duke thënë: -Jo, por gati qenka para vdekjes.

²¹ Ibën Kethir, *El Bidaje ve en Nihaje*, botoi, Dar alemil kutub, 2003, vëll. 10, fq. 42.

²² Ibën El Ethir, *El Kamil fi et Teërih*, botoi, Dar el kitab el arabi, 1997, vëll. 2, fq. 377.

Omeri nxjerr udhëzimet dhe masat ndaj pandemisë

Pasi u bë e qartë se nuk do të kthehej në Medinë dhe kishte kërkuar mirëkuptimin e kalifit për këtë qëndrim, Omeri i përcolli udhëzimet që duhen ndërmarrë në përballje me gjendjen e pandemisë. Ai i shkroi Ebu Ubejdes duke i thënë se njerëzit ishin vendosur në Amvas, i cili ishte një vendbanim moçalik, një ambient me ujëra dhe me shumë lagështi, ndaj duhet të largoheshin nga aty dhe të vendoseshin në vende më të hapura, me rryma të ndryshme ajri, të shpërndareshin nëpër male dhe të qëndronin larg njëri-tjetrit derisa Allahu ta largonte këtë provë nga ata. Ebu Ubejde menjëherë kishte ftuar sahabin e mirënjohur, Ebu Musa el Eshariun, duke e njoftuar për shkresën e Omerit dhe këshillat e tij rreth pandemisë dhe njëkohësisht kërkoj prej tij që të dilte për të hulumtuar një vend të përshtatshëm sipas përshkrimit të Omerit r.a.. Ebu Musa menjëherë ishte kthyer në shtëpi që të bëhej gati, por kishte gjetur se gruaja e tij kishte simptoma të pandemisë, ndaj u kthye tek Ebu Ubejde duke i thënë se për shkak të gjendjes së gruas së tij nuk mund ta bënte punën e kërkuar. Me të dëgjuar për gjendjen në familjen e tij, Ebu Ubejde përgatiti devenë e vet dhe u bë gati që të dilte në terren. Gjersa po hipte mbi të, në gishtin e vogël të dorës së tij pa një simptomë murtaje²³ dhe ky ishte fillimi i sëmundjes, e cila shumë shpejt u shpërnda në trupin e tij. Megjithatë, ai lëvizi me masën për t'u larguar nga aty, por vetëm pas pak ditësh, i sëmurë nga murtaja, Ebu Ubejde kaloi në botën tjetër²⁴.

²³ Edh Dhehebi, Sijer ealami en Nubela, botoi Muesesetu err rrisaleti, Bejrut, Liban, vëll. 1, fq. 22.

Dhehebiu ka shkruar më gjerësisht rreth shfaqjes së sëmundjes së Ebu Ubejdes për herë të parë, reagimin në ato momente dhe duatë që kishte bërë duke e mirëpritur caktimin e Allahut. Për më tepër Dhehebiu mendon se Ebu Ubejde dhe familja e tij nuk ishin goditur nga sëmundja e murtajës, por sëmundja e tyre erdhi si rezultat i duasë që ai bëri duke lutur Allahun që edhe atij t'i ndante hise nga sëmundja.

²⁴ Muhamed Hasen Sherab, Ebu Ubejde ibën El Xherrah, botoi, darul ilm, Bejrut – Liban, fq. 225-226.

Pas vdekjes së Ebu Ubejdes në vend të tij u emërua sahabi i mirënjohur Muadh bin Xhebeli, por edhe ky nuk qëndroi gjatë në udhëheqje, ngase shpejt u sëmur nga murtaja dhe vdiq. Pas tij në krye të udhëheqjes u emërua Amër bin El Asi. Ky menjëherë ndërmoi masa aktive sociale për parandalimin e pandemisë. Amri mbajti një fjalim para njerëzve dhe tha²⁵: “O ju njerëz, vërtet pandemia është si zjarri i ndezur, ndërsa ju jeni lënda djegëse e tij, ndaj largohuni nga njëri-tjetri dhe shpërndahuni në mal, kështu që zjarri nuk gjen çka të djegë dhe fiket vetvetiu.”²⁶

Njerëzit iu bindën urdhrave të tij duke vepruar ashtu si kërkoi. Disa u izoluan në shtëpitë e tyre, të tjerët dolën të jetonin në male e kodrina duke respektuar distancën sociale. Këtu pandemisë së murtajës në Sham i kishte ardhur fundi.

Hera e tretë kur Omeri vizitoi Shamin

Lufta me romakët dhe në fund pandemia e murtajës kishin shkakuar vdekje masive. Gjatë luftës vdiqën një numër i madh njerëzish, prej tyre disa nga sahabët më të dalluar, ndërsa pandemia ishte shkatërruese. Burimet e ndryshme thonë se si rezultat i murtajës në Sham dhe vendet përreth tij vdiqën diku rreth 25,000 deri në 30,000 njerëz. Duke e krahasuar me numrin e përgjithshëm të banorëve, i bie se kishin vdekur rreth 50% e popullatës²⁷.

Pasi lufta kishte përfunduar e më pas edhe pandemia e murtajës ishte tërhequr, kishte shumë arsye që Omeri të vizitonte Shamin.

Kishin vdekur komandantët kryesorë, njerëzit më të njohur e më të dashur të Omerit. Ata ishin zyrtarët më të lartë të tij. Njerëzve u kishin vdekur të afërmit, shumëkujt i kishte humbur lidhja e trashëgimisë.

²⁵ Ahmed bin Hanbel, El Musned, hadithi nr. 1697.

²⁶ Ibën Xherir Et Taberi, Terih Et Taberi, vëll. 3, fq. 163.

²⁷ En Nevevi, Sherh Sahih Muslim, vëll. 1, fq. 106.

Gjithë vendit i duhej një rregullim dhe ndarje e re si në aspektin administrativ edhe në komandën ushtarake. Për shumë arsye Shami me etje të madhe po priste ardhjen e Omerit r.a..

Në këtë situatë ai u konsultua me kuvendin e tij dhe më pas mori vendimin për të udhëtuar drejt Shamit, ndërsa në Medinë emëroi si zëvendës Aliun r.a.. Para nisjes kishte deklaruar se atje do të qëndronte aq sa ishte e nevojshme. Gjatë qëndrimit punoi për të zgjidhur të gjitha problemet e paraqitura duke vendosur bazat e rregullimit administrativ, ku përkufizoi ndarjet rajonale dhe emëroi përgjegjësitë e tyre. Gjithashtu mori vendimet e duhura që kishin të bënin me trashëgiminë dhe trajtoi çështjet më vendimtare për të cilat masat popullore paraprakisht ishin deklaruar se do të donin t'i gjykonte Omeri r.a.. Ardhja e tij nga Medina banorëve të Shamit ua lehtësoi dhembjet e shpirtit dhe të trupit në një kohë kur kishin humbur më të dashurit e tyre²⁸.

Njëri nga momentet më të ndjeshme gjatë qëndrimit në Sham ishte ezani i Bilalit. Pasi ishte afruar koha e namazit dhe po bëheshin gati për faljen e tij, njerëzit i thanë: -Sikur të kishe urdhëruar Bilalin të thërriste ezanin! Omeri e urdhëroi. Ndërsa Bilali po thërriste ezanin, të gjithë u prekën, në atë masë sa lotët u pikonin edhe nga mjekrat e tyre. Omeri ishte ai që qante më së shumti. Ata që e kishin jetuar kohën e Muhamedit a.s. dhe ezanin e Bilalit së bashku me të u përmalluan pa masë, ngase dashuria për të dashurin e Allahut shkundi ndjenjën e tyre, ndërsa të tjerët qanin së bashku me ta.

Pasi mbaroi punët, Omeri u kthye në Medinë.

²⁸ Ali Muhamed Es Salabi, Siretu emjiril muëminijne Umer bin El Hatab siretuhu ve asruhu, botoi: Muessesetu Ikre, Kajro, 2005, fq. 230-235.

Përfundim

Karantina konsiderohet si njëra nga masat më të rëndësishme për të kufizuar përhapjen e sëmundjeve epidemike edhe në epokën e tanishme dhe sipas saj çdokush parandalohet të hyjë në zonat ku është përhapur një lloj epidemie dhe të përzihet me njerëzit e tyre, si dhe të parandalojë largimin e njerëzve të atyre zonave, pavarësisht nëse personi është i infektuar me këtë epidemi apo jo.

Në një numër hadithesh Muhamedi a.s. shpjegoi parimet e karantinës, duke e deklaruar këtë shumë qartë. Ai i ndaloi njerëzit të hynin në qytetin e prekur nga murtaja dhe gjithashtu parandaloi që njerëzit e atij qyteti të largoheshin prej tij. Përkundrazi, ai e bëri atë si ikjen nga fronti i luftës, që është një nga mëkatet më të mëdha. Ai që qëndron në vendin e goditur nga pandemia dhe duron këtë gjendje sipas haditheve të Muhamedit a.s., ka shpërblimin e shehidit.

Mrekullia profetike është e dukshme në këto hadithe në parandalimin e një personi që banon në vendin e një epidemie për të mos e lënë atë edhe nëse nuk është i infektuar. Parandalimi i hyrjes së njerëzve në tokën e epidemisë mund të jetë një çështje e qartë dhe e kuptueshme, por ai i ndaloi edhe ata që ishin në qytetin e prekur të largoheshin nga aty, edhe nëse ishin të shëndetshëm, diçka që mund të duket se nuk është e qartë. Përkundrazi, logjika dhe arsyeja kërkojnë që një person i shëndetshëm që jeton në qytetin e epidemisë, nuk duhet të ikë prej tij në një qytet tjetër të shëndetshëm, në mënyrë që ai të mos jetë bartës i virusit dhe të infektojë të tjerët. Arsyeja për këtë nuk dihej deri në epokat e mëvonshme në të cilat shkenca dhe mjekësia përparuan duke konfirmuar atë që kanë thënë hadithet e Muhamedit a.s.. Kjo ka të bëjë me një mrekulli të qartë, e cila i është dhënë atij nga ana e Allahut xh.sh..

Conclusions

The Coronavirus disease (Covid-19) has received worldwide attention and has become a common topic of discussion. Even in the places where it has not reached, it has imposed all the possible concerns about it because the world is facing something difficult to overcome, and with all the achievements of the new millennium, with the skills and scientific advances, in various fields, especially in medicine, has still shown to be incompetent in combating and preventing it. We pray that a cure will be found as soon as possible to cure this virus which until now has been the cause of death for many people, many others have been hospitalized while millions continue to live in anxiety about their health.

Almost all over the world a new order of life has been imposed where everything has taken a new and imposed direction. Governments have taken coercive measures to the point of declaring a state of emergency, while changing the behavior in the family circle where it is called that even within such facilities to respect the rules and behaviors that limit the possibility of spreading the virus.

Efforts to prevent the spread of the virus have activated all measures that can contribute to achieving this goal. There is no doubt that the preventive measures of risk factors which are considered essential and very effective and they play a preventive role during the pandemic. Various pandemics, since the earliest period of human history have been known to be very destructive. Shortly after the death of Muhammad s.a., the Muslims faced the plague pandemic which had hit the Al-Sham region, killing a large number of people. According to sources who wrote about this pandemic, its developments and consequences, it is said that about twenty-five to thirty thousand people died. In this situation, it was in the teachings of the Messenger of Allah that the solution was provided by establishing the basic principles of how to behave in times of pandemic. Even today, when medical science has advanced greatly, such measures remain the best, cheapest, easiest, most practical, and most effective way to protect against the spread of the pandemic.

Literatura:

1. Ali Muhamed Es Salabi, Siretu emjril muëminijne Umer bin El Hatab siretuhu ve asruhu, botoi: Muesesetu Ikre, Kajro, 2005.
2. Edh Dhehebi, Sijer ealami en Nubela, botoi Muesesetu err rrisaleti, Bejrut-Liban.
3. Emijn el Kudat, El Hulefau err Rrashidun Eamalun ve ahdath, darul Furkan, 2004.
4. El Kurtubi, El Mufhim lima eshkele min telhijis kitab Muslim, Dar ibën Kethir, Damask-Bejrut.
5. Ibën El Ethir, El Kamil fi et Teërih, botoi, Dar el kitab el arabi, 1997.
6. Ibën Haxher el Askalani, Fethul bari bi sherh Sahihi el Buhari, Darul kutub el ilmije, Bejrut-Liban.
7. Ibën Kajim El Xhevzije, Zedul mead li hedji hajril ibad, Muesesetu Er Risaleti.
8. Ibën Kethijr, El Bidaje ve En Nihaje, El mektebe el Kudusije, Lahor, botimi i parë.
9. Ibën Kethir, El Bidaje ve en Nihaje, botoi, Dar alemil kutub, 2003.
10. Ibën Sead, Et Tabekat el Kubra, Daru el Kutub el Ilmije, Liban-Bejrut.
11. Ibën Xherir Et Taberi, Terijh el umemi ve el muluk, Darul kutub el ilmije, Bejrut- Liban.
12. Muhamed Hasen Sherab, Ebu Ubejde ibën El Xherrah, botoi Darul ilm, Bejrut - Liban.
13. Musnedi i imam Ahmedit, Darul hadith, Kajro.
14. Sahih Muslim, Daru ihjai et turath el arabi, Bejrut-Liban.
15. Sahihu Muslim bi sherh En Nevevi, botoi Darul kutub el ilmije, Bejrut, Liban.
16. <http://alsahra.org/?p=21065>
17. <http://arab-ency.com.sy/detail/9705>
18. <http://wiki.dorar-aliraq.net/lisan-alarab/%D8%B3%D8%B1%D8%BA>

Ali Suleiman ALI

LINDJA E TEFSIRIT DHE VEÇORITË E TIJ DERI NË KOHËN E TABIINËVE - GJENERATËS SË DYTË MYSLIMANE PAS KALIMIT NË AMSHIM TË MUHAMEDIT a.s.

Shkenca e tefsirit synon të shpjegojë kuptimet e fjalës së Allahut në Librin e Tij të shenjtë, në Kuran. Tefsiri është njëra ndër shkencat kryesore islame.

Rrënja arabe f-s-r *فسر* ka disa kuptime, por ajo më e theksuara është “zbulimi i diçkafit”.

Studiuesit tradicionalë dhe klasikë myslimanë deklarojnë se emri foljor tefsir rrjedh nga folja fessere, që do të thotë të zbulosh, të shpjegosh dhe të interpretosh¹.

Ndryshe, tefsir, fjalë për fjalë do të thotë ‘shpjegim’, kurse te’vil ‘interpretim’. Këto janë këto dy terma që zakonisht përdoren nga studiuesit si sinonime ose të këmbyeshme për të treguar interpretimin ose shpjegimin kuranor.

* Dr. ALI SULEIMAN ALI, u diplomua në 1979 për gjuhën arabe dhe studime islame në Universitetin Islamik në Madinë. Ai pastaj vazhdoi studimet e mëtejshme në Universitetin e Miçigenit (Ann Arbor) ku mori një MA dhe PhD në Studimet Islame. Disertacioni i Dr. Aliutmbi “Tafsir bil Ma’thur” (Tefsiri tradicional, që merret me çështjen e provave detyruese (huxhexh), ishte një studim thelbësor i tij. Ai ka dhënë mësim për studimet islame, arabe dhe kuranore në Universitetin e Detroit.

¹ Es-Sujuti, Xhelalu-Din 'Abd er-Rahman ibn Ebu Bekr, el-Itkan fi Ulumiel- Kur'an, (Bejrut: Dar el-Kutub e-'Imijeh, 1987/1407).

Sipas Muhamed ibn Muhamed el-Maturidiut (v. 333 AH), tefsiri është shpjegimi i kuptimit përfundimtar të tekstit kuranor, i cili zbulon atë që synohet ekskluzivisht nga teksti kuranor, ndërsa te'vili تَأْوِيلٌ vlen për të mbështetur interpretimin më të mundshëm, kur teksti ka më shumë se një kuptim të mundshëm².

Te'vil shpesh përdoret për të sqaruar kuptime dhe fjali dhe përdoret më së shumti në tekste teologjike-fetare, ndërsa tefsiri përdoret në tekste teologjike si dhe në fusha të tjera (të tilla si shkencat e Kuranit dhe jurisprudenca islame³).

Termi tefsir, i cili përdoret për të nënkuptuar shpjegimin e Kuranit, u zhvillua në gjysmën e dytë ose në fund të shekullit të parë islam.

Në të vërtetë, ne nuk gjejmë asnjë përmendje të këtij termi në Kuran dhe Hadith që të nënkuptojë shpjegimin e kuptimit të Kuranit. Kuran, nga ana tjetër përdori fjalën tefsir në ajetin (25:33) në kuptimin e 'shpjegimit.'

Si Pejgamberi a.s., ashtu edhe sahabët, interpretuan një pjesë të ajeteve kuranore, por jo të gjithë Kuranin në plotni. Megjithatë, interpretimet e tyre quheshin *tefsir* dhe jo *te'vil*.

Shumë studiues të tefsirit, nëse jo shumica, nuk kanë parë ndonjë ndryshim midis dy kuptimeve të këtyre dy termave.

I Dërguari Muhamed a.s. dhe tefsiri

I Dërguari Muhamed a.s. ishte ekzekutuesi ose interpretuesi i parë i Kuranit (mufessir). Mirëpo ai, megjithatë, nuk e shpjegoi tërë Kuranin fjalë për fjalë sepse shumë prej ajeteve ishin të qarta për njerëzit e kohës së tij, në sajë të arabëve të kohës, të cilët e kuptonin gjuhën arabe.

² Ahmed ibn Hanbel, el-Fether-Rabbani li Tertib Musned el-Imam Ahmed ibn Hanbel esh-Shejbani, & Abd er-Rahmanel-Benna, (Kairo: Dar esh-Shihab).

³ Ebu Xha'fer Muhammed ibn Xherir et-Taberi, Xhamiuel-Bejanan Te'vil Aj el-Kuran.

Në përgjithësi, shpjegimet e tij të ajeteve të Kuranit ndodhën në një nga tre rastet:

- Kur një fragment i veçantë nuk mund të kuptohej përmes një kuptimi tipik të arabishtes.
- Kur kuptimi i drejtpërdrejtë i një ajeti, sipas studiuësve myslimanë, nuk ishte i shpjeguar nga vetë Kurani.
- Si dhe kur një shok i tij, i njohur në literaturën islame si sahabi-u, kërkonte sqarime për pjesë të caktuara kuranore.

Një shembull për këtë është urdhri kuranor për kohën e ndërprerjes së ushqimit gjatë muajit të Ramazanit. Për këtë, Muhamedi a.s. shpjegoi se fija e bardhë dhe e zezë e përmendur në ajetin kuranor i referohej dritës së mëngjesit, agimit të hershëm – e cila është në kontrast me errësirën e qiellit⁴.

Tefsiri pas kalimit në amshim të Muhamedit a.s.

Myslmanët pas vdekjes së Profetit njohën aftësitë e sahabëve të caktuar, që ata i kishin në lidhje me njohuritë kuranore.

Para se të vdiste, Muhamedi a.s. e shpalli statusin e tyre superior në lidhje me Kuranin në tri mënyra:

- Së pari, ai dërgonte shokët e tij në qytete të tjera për t'u mësuar njerëzve Kuranin dhe Islamin.
- Së dyti, i Dërguari do të lavdëronte ndonjë sahab të caktuar për dijen që kishte.
- Së treti, ai do t'u kërkonte sahabëve të caktuar që të jepnin fetva (mendime juridike) në praninë e tij⁵.

Pas vdekjes së Muhamedit a.s., pesë shkolla të ndryshme të interpretimit dhe recitimit kuranor (kira'ete) u shfaqën në rajone si: Mekë,

⁴ Ebu Xha'far Muhammed ibn Xherir et-Taberi, *Xhami el-Bejan an Te'vil Ajel-Kur'an*, Mahmud Muhammed Shakir & Ahmed Muhammed Shakir, (Kajro: Dar el-Me'arif), vol. 1, f. 204.

⁵ Ibn Sa'd, Muhammed ibn Sa'd ibn Mani el-Zuhri, *et-Tabakat el-Kubra* (Beirut: Dar Sadir, 1957), vol. 2, f. 98-99.

Medinë, Kufë, Basra (në zonën e Irakut të sotëm) dhe në esh-Sham (Palestina e sotme, Siria dhe Libani).

Tefsiri pas erës së tabiinëve

Nga fundi i shekullit të dytë hixhri, studentët e sahabëve të Muhamedit a.s., që njihen si tabiinët, në përgjithësi kishin vdekur. Asnjë përkthyes i asaj periudhe nuk kishte prodhuar vepra kushtuar ekskluzivisht interpretimit kuranor.

Është pohuar se Muxhahidi ka shkruar një tefsir të plotë të Kuranit, por që edhe sot a kësaj dite ende nuk është zbuluar dhe nuk është publikuar.

Gjatë gjysmës së fundit të shekullit të dytë hixhri, studiues të ndryshëm filluan përpilimin e punimeve për Kuranin sipas tematikave të ndryshme.

Qasjet dhe metodologjitë e përdorura nga gramatikanët dhe gjuhëtarët si dhe nga tradicionalistët nuk u panë deri në fund të shekullit të tretë dhe në fillim të shekullit të katërt hixhri.

Prandaj vetëm në shekullin e IV-të H, letërsia e tefsirit u nda nga trupi kryesor i letërsisë së hadithit. Të dyja u krijuan si shkenca të pavarura.

Pas ndarjes së tefsirit nga trupi kryesor i hadithit, secili u shndërrua në një shkencë të pavarur me shqetësimet e veta.

Literatura e hadithit, për shembull, ka të bëjë vetëm me raporte të transmetuara mbi veprimet dhe thëniet e Muhamedit a.s.

Literatura e tefsirit merret me transmetimin e raporteve në lidhje me shpjegimin e të Dërguarit për Kuranin, si dhe ato të sahabëve dhe tabiinëve së bashku me vlerësimet gjuhësore, retorike, juridike dhe teologjike.

Këto raporte dhe konsiderata ishin subjekt i studimit intensiv, pasi ishte bërë ndarja midis hadithit dhe tefsirit.

Literatura e tefsirit u nda përfundimisht në dy lloje kryesore, të njohura teknikisht si التفسير بالمأثور و التفسير بالرأي - *et-tefsirbiel-me'thur dhe et-tefsirbier-re'j*.

Tefsiri në shekujt e tretë dhe të katërt hixhri

Në shekujt e tretë dhe të katërt sipas kalendarit hixhri shkrimi i tefsirit evoluoi. Transmetimi i tefsirit me një zinxhir të plotë (isnad) u bë i njohur dhe filloi të tërheqë vëmendjen e teologëve dhe leksikografëve si një specializim në një aspekt të shpjegimit kuranor.

Kështu, ata filluan të shkruanin komente- tefsire, të dominuara nga një tipar dallues i dukshëm. Tefsiri i et-Taberi-ut “Xhami-u el-Bejan fi Te'vil el-Kur'an”, جامع البيان عن تأويل أي القرآن, përgjithësisht nga dije-tarët myslimanë pranohet të jetë puna më gjithë përfshirëse e tefsirit tradicional.

Zhvillime të rëndësishme pas tefsirit të Taberit

Pas shekullit të katërt hixhri, tre zhvillime kryesore ndodhën në fuqinë e komentim kuranor.

Në termat e el-Sujuti-ut, këto ishin a) *ih-tisarel-esanid* (إختصار الأسانيد), që do të thotë shkurtimi i zinxhirëve të transmetimit (të cilat shoqërohe-shin edhe me thënie të paverifikuara).

Në vend që të përsërisnin emrin e secilit mësues ose raportuesi në një zinxhir të caktuar transmetimi (isnad), studiuesit myslimanë filluan të heqin dorë nga *isnadi* i plotë⁶.

Të tilla veprime ishin kundër metodologjisë së studiuesve myslimanë të deriatëhershëm, sepse kjo tendencë nuk parashikonte verifikimin e burimeve të informacionit.

⁶ Es-Sujuti, *el-Itkan*, vol. 2, f. 419. Shih gjithashtu Muhammed Abd el-Adhim ez-Zer-kani, *Me-nahil el-Irfan fi Ulumiel-Kur'an*, vol. 2, f. 32-3.

Si pasojë, shumë tekste u shkruan për një studim dhe standard aq të dobët, sa që autorët e tyre nuk bënin dallim midis të dhënave të sakta dhe të pasakta.

Sidoqoftë, es-Sujuti dhe të tjerët e konsiderojnë periudhën nga shekulli i pestë e lart si periudhë të epokës së specializimit në tefsir sepse vetëm në këtë kohë ekspertët prodhuan interpretim kuranor nga këndvështrimi i fushës së tyre të specializimit, me theks më të madh në ato fusha si gramatikore, juridike dhe analiza teologjike.

Pas vrasjes së Othman ibn Affanit, kalifit të tretë si dhe konfliktit fetaro-politik me të cilin përballen muslimanët, u shfaqën tre grupe kryesore:

- a. **Alevitët** (mbështetësit e Ali ibn Ebi Talibit),
- b. **Umejadët- Emevitët** (mbështetësit e Muavije ibn Ebi Sufjanit) dhe **Havarixhët**.
- c. Ndarja **sunite dhe shiite** e përgjithshme, e cila ndikoi shumë në rrjedhat e mëvonshme. Të tria palët akuzuan reciprokisht njëra-tjetrën si muslimanë të rremë.

Kjo çështje e vazhdueshme pasqyrohet në tekstet e protagonistëve në përgjithësi dhe në punët e tefsirit në veçanti.

Tefsiri “El-Bejan” i **Et-Taberiut** është një nga tefsirët që përfaqësojnë pikëpamjet sunite. Tefsiri **shia** u zhvillua paralelisht me atë të sunitëve.

Sidoqoftë, ekzistojnë dy dallime kryesore midis tyre.

- Së pari, disa shiitë besojnë se Kurani në radhë të parë i flet imamet të tyre Ali ibn Ebi Talibit dhe njëmbëdhjetë pasardhësve të tij.
- Së dyti, shiitët besojnë ose i konsiderojnë dymbëdhjetë imamët e tyre si autoritetet e vetme legjitime për shpjegimin e Kuranit pas Muhamedit a.s..

Tradicionalistët e quajtën tefsirin e mu`tezilitëve **si bid`a** (devijim nga vija tradicionale) sepse ata besonin se **mu`tezilitët** përdrohdën disa nga fjalët e Kuranit për të mbështetur ose përshtatur synimet e tyre.

Mu`tezilitët thonë se tradicionalistët i keqkuptuan ata ose i keqinterpretuan pikëpamjet e tyre.

Tefsiri sufist ka natyrë mistike dhe është shumë i ndikuar nga mendimi filozofik.

Ata besojnë se Kurani ka dy kuptime kryesore dhe qenësore:

- një kuptim të dukshëm (dhahiri - ظاهر) dhe
- një kuptim të brendshëm, të fshehur (batini - باطن).

Më në fund, një metodë interpretimi e quajtur *el-tafsirel-ishari* التفسير الإشاري (interpretimi me indikacion ose alegori) duket përtej kuptimeve të dukshme të Kuranit.

Sipas tyre, kjo formë e interpretimit nxjerr kuptime që nuk janë të dukshme për askënd, pohojnë eksponentët e saj.

Sipas tyre këtë lloj tefsiri e kuptojnë vetëm ata që zemrën ua ka hapur Zoti. Ithtarët e tij e mbështesin interpretimin e tyre në tefsirin e caktuar të sahabëve të të Dërguarit⁷.

Reagimet e konservatorëve ndaj variacioneve të interpretimit racional

Shfaqja e variacioneve të reja të tefsirit pas shekullit IV dhe V hi-xhri u kritikua ashpër nga tradicionalistët si Ibni Tejmije, Ibn Kethiri, Es-Sujutiu dhe të tjerët. Ata besuan se interpretimet e tilla nga të ashtuquajturit *mubtediune* مبتدعون (praktikues të inovacionit jo islamik jo ortodoks) janë vetëm shtrembërime të interpretimit të të Dërguarit Muhamed a.s, të sahabëve të tij si dhe të pasardhësve.

⁷ Muhammed Husejn edh-Dhehebi, Et-Tefsir ve el-Mufessirun (Kajro: Dar el-Kutub, 1961/1381).

Kështu, ata filluan sulme pa kompromis ndaj variacioneve jotradicionale të tefsirit. Për më tepër, tradicionalistët avokuan që myslimanët duhet të shkruajnë dhe lexojnë vetëm vepra të tefsirit tradicional. Ata ishin kundër tefsirit *bi-r-re'j* بالرأي التفسير dhe përdorën katër burime të ndryshme për të vërtetuar pikëpamjet e tyre: Kuranin, Hadithin, raportet e sahabëve dhe ato të pasardhësve të sahabëve- tabiinëve⁸.

Disa ithtarë të qasjes tradicionale ndaj tefsirit kanë pohuar se Kurani nuk mund të kuptohet pa hadithin e të Dërguarit.

Thirrja për interpretim ekskluzivisht tradicional si dhe ajo kundër çdo përdorimi të përpjekjes racionale nuk është intelektualisht e arsyeshme nga pikëpamja e tyre.

Juristë, gramatikanë dhe teologë të caktuar, përfshirë Ebu Hamid el-Gazaliun, Ibn Atije-en, el-Kurtubi-un dhe EbuHajjanin, ishin ata të cilët e sfiduan këtë pikëpamje, duke përdorur të njëjtat burime të përdorura nga kundërshtarët e tyre, në përgjigje të referimit të tradicionalistëve në ajetin kuranor 16:44 (Ty ta zbritëm Kuranin, që t`u shpjegosh njerëzve atë që u është shpalluar atyre, me shpresë se do ta studiojnë (Kuranin).

Ibni Atijeh argumentoi se megjithëse të Dërguarit iu dha përgjegjësia për të shpjeguar Kuranin, interpretimi i tij ishte në përputhje me nevojat e kohës së tij dhe për njerëzit e asaj periudhe kohore dhe për çështje të tjera të caktuara.

Faktori hapësirë-kohë mund të kërkojë një sforcim të mëtejshëm intelektual për të sqaruar gjeneralitetet në interpretimin e të Dërguarit. Ky argument i proceduar do të kërkonte përdorimin e arsytimit skolasik (re'jin), prandaj është i lejueshëm me kusht që të zbatohen rregullat themelore të tefsirit.

⁸ Muhammed ibn Yusuf ibn el-Endelusi Ebu Hajan, El-Bahrel-Muhit, (Riad: Mektebe ve Metba'ahel-Hashrel-Hadlth, 1969).

Mbrojtësit e përdorimit të **re'ji-it** në tefsir gjithashtu përdorën Kur-anin për të vërtetuar pozicionin e tyre.

Ithtarët e **re'ji-it** citojnë edhe hadithin e famshëm ku i Dërguari qartë i inkurajoi ithtarët e tij të merreshin me ixhtihad: “Kush bën ixhtihad dhe ai ka të drejtë në ixhtihadin e tij, do të fitojë dy shpërblime. Nëse, megjithatë ai është gabim, ai do të fitojë vetëm një shpërblim”⁹.

Si rezultat i këtyre argumenteve midis tradicionalistëve dhe teologëve - juristëve, tefsiri klasik u nda në dy kategori kryesore: **el-tefsir-biel-me'thur dhe el-tefsirbier-re'j** **التفسير بالمأثور و التفسير بالرأي** .

Fjala **me'thur** rrjedh nga folja rrënjësore **ethere**, që do të thotë “të gjurmsh” ose “të shënosh”. **Ethere** gjithashtu do të thotë të transmetosh, të raportosh, të kalosh, etj., kurse “**me'thur**” do të thotë ajo që transmetohet, dorëzohet nga njëri te tjetri. Në përgjithësi, et-tefsir bi el-me'thur janë interpretimet kuranore të marra nga i Dërguari Muhamed, nga shoqëruesit si dhe nga pasardhësit e tyre.

Fjala **re'j** është një emër foljor që do të thotë mendim, pikëpamje, besim, e cila zakonisht përfshin analogji dhe sforcim intelektual.

Teknikisht, ajo i referohet mendimit të pavarur që përdoret për të nxjerrë interpretimin kuranor duke ushtruar mendjen.

Ky lloj komentimi zakonisht bazohet në njohuritë e shëndosha të gjuhës arabe dhe zbatimin e parimeve të dakorduara të tefsirit, i cili ndahet në **er-re'jel-mahmud** ose **el-memduh** (i lavdërueshëm) dhe **el-re'jel-medhmum** (i hedhur poshtë ose i papranueshëm)

(الرأي المحمود و الرأي المذموم).

⁹ Ibn Tejmijeh, Tekijed-Din Ahmedibn 'Abd el-Halim, “*MukaddimehfiUsul et-Tafsir*”, Adnan Zorzo, (Beirut: Dar el-Qur'an el-Karim, 1979/1399), f. 52.

Tafsiri në shekujt e tretë dhe të katërt hixhri, konceptet dhe përkufizimet

Fjala *me'thur* është një pjesore pasive që rrjedh nga emri foljor *ethere*. Sipas leksikut arab, *ethere* ka një larmi kuptimesh, duke filluar nga gjurmimi, shënimi, raportimi dhe “transmetimi”. Më tej, në arabisht, termi “hadith” fjalë për fjalë do të thotë “**i ri**” në krahasim me “**të vjetër-in**” dhe i referohet raportit, historisë, komunikimit, bisedës, etj., domethënë lajmit. Kurani e përdor këtë fjalë normalisht për të treguar kuptimin gjuhësor të historisë, komunikimit dhe bisedës. I Dërguari përdori termin hadith, ashtu siç është përdorur në kuptimin gjuhësor edhe në Kuran.

Në përmbledhjen *Fet-h el-Bari* në një hadith lexojmë: “*Hadithi më i mirë është libri i Allahut*”.

Muhaddithunët (studiuesit e hadithit) përdorën termin hadith për të treguar atë që ishte transmetuar nga i Dërguari ose rreth tij në lidhje me veprimet, thëniet, miratimin e heshtur ose përkrahjet e *sifatit* të tij (pamja fizike). Suneti është një mënyrë ose rregull e mirë për t'u vepëruar apo porosi për t'u larguar nga e keqja.

Një pjesë e dijetarëve muslimanë besojnë se i Dërguari u urdhërua hyjnisht t'i shpjegonte Kuranin njerëzimit dhe jo me arsyetimin e tij, por përmes fjalëve që engjëlli Xhebrail i kishte sjellë atij nga Zoti¹⁰.

Disa ajete tregojnë se i Dërguari duhet të jetë interpretuesi i parë i Kuranit, por kjo nuk nënkupton domosdoshmërisht se i Dërguari e shpjegoi tërë Kuranin. Më shumë gjasa kjo nënkupton për shpjegimet e ajeteve problematike si dhe atyre që nuk mund të kuptohen vetëm përmes arabishtes, siç janë ajetet mbi agjërimin, haxhin-pelegrinazhin, etj., të cilat mund të kuptohen vetëm përmes Sunetit.

¹⁰ Ibn Haxherel-'Askalani, “*El-Isabah fi Temjizes-Sahabeh*” (Kajro: Maktabel- Kullijeh, 1969), vol. 2, f. 83.

Myslimanët nxiten më shumë se një herë në Kuran dhe në hadithe që të reflektojnë mbi Kuranin, si mënyrë për ta kuptuar atë. Për shembull, ajeti 38:29: “*Ky është libër i bagatshëm, Ne ta shpallëm ty këtë, që t’i studiojnë argumentet e tij dhe që të marrin mësim prej tij ata që kanë mend.*”

Tefsiri dhe fetvatë e sahabëve, pesha e tyre në komentimin e Kuranit

Sahabët u bënë interpretuesit më të rëndësishëm të Kuranit pas vdekjes së Muhamedit a.s.. Ata përdorën një numër burimesh në tefsirin e tyre duke përfshirë deklaratat e të Dërguarit dhe arsyetimin ose kuptimin e tyre (ixhtihadin) si dhe gramatikën arabe.

Sahabët ishin gjithashtu të vetëdijshëm për rrethanat në të cilat u shpall Kurani si dhe arsyet e shpalljes dhe vendin e shpalljes.

Disa nga më të spikaturit në këtë fushë janë katër kalifët, (Ebu Bekri, Omeri, Othmani dhe Aliu r.a.). Fjala arabe *sahib* (mbiemër) rrjedh nga emri foljor (masdar) *suhbeh* صحبة, i cili ka shumë kuptime të cilat tregojnë nocionin e shoqërimit.

Sahib në historiografinë islame i referohet një bashkëkohësi të Dërguarit a.s., dikujt që besoi tek ai si i Dërguar i Zotit, e shoqëroi atë dhe vdiq si i tillë. Tradicionalistët dhe juristët kanë përkufizimin e tyre për këtë term. Tradicionalistët thonë se *sahab* mund të quhet kushdo që takoi Muhamedin a.s. pasi ai u bë i Dërguari i Zotit¹¹.

Juristët myslimanë (*usulijunët*) e shikonin një sahab jo thjesht si dikush i cili vetëm e takoi të Dërguarin, por në një kontekst më të gjërë. Përveç shoqërimit të gjatë kohor gjatë asaj periudhe, sahabi duhet edhe të ketë mësuar para tij.

¹¹ Ibid.

Sahabët, qoftë gjatë jetës së Dërguarit a.s. apo më pas, disa herë kishin përdorur mendimin e tyre në interpretimin e Kuranit dhe Hadithit.

Kjo përpjekje nga ana e tyre u bë e njohur si “**re‘ju es-sahabij**” رأي الصحابي (mendimi i një sahabi), dhe kështu autoriteti i tij pastaj u bë objekt polemikash midis dijetarëve myslimanë¹².

Ka shumë ajete në Kuran dhe Hadith të cilat urdhërojnë myslimanët të kërkojnë dituri dhe ta nxënë atë. Të frymëzuar nga ky urdhër, sahabët u përfshinë në tefsir. Megjithatë, ata nuk e interpretuan tërë Kuranin dhe as nuk lanë një përmbledhje të kontributit të tyre.

Dallimet mes dijetarëve për peshën e sahabit në tefsir

Studiuesit janë të ndarë në dy grupe në lidhje me autoritetin detyruar të interpretimit të sahabëve:

Ata që e konsiderojnë shpjegimin e sahabit si të detyrueshëm, siç janë: Imam Maliku, Imam Ahmedi, Ibn Hanbeli, Ibni Tejmijje dhe studenti i tij Ibni Kajjimi.

Të lartpërmendurit e bazuan argumentin e tyre kryesisht në faktin e virtyteve dhe meritave të sahabëve sepse ata u vlerësuan si në Kuran ashtu edhe në hadith dhe se ata ishin edhe dëshmitarë të shpalljes. Përveç kësaj, sipas tyre ata kishin zotëruar mirë gjuhën e Kuranit.

Kurse mes atyre që besuan ndryshe, pra se tefsiri i sahabëve nuk është i detyrueshëm, ishin: El-Gazaliu, Ibni Hazmi dhe Ebu Hajjani. Fokusi i argumentit të tyre qëndronte në praktikën e interpretimit të sahabëve që përmban kontradikta të papajtueshme në vende të ndryshme. Me këtë, nënkuptohet se duke folur praktikisht, të pranosh si detyruar tefsirin e sahabëve, me ndryshimet e tyre të papajtueshme, do t'i vendoste myslimanët në një gjendje hutimi dhe konfuzioni, pasi kontradikta

¹² Sejfed-Din el-Amidi, *El-Ihkam fi Usuliel-Ahkam*, ed., Abd er-Rezzak Afifi, vol. 2 (Beirut: El-Mektebel-Islami, 1402 H), vol. 4, f. 140-145.

të tilla do të kishin domosdoshmërisht zbatim praktik të detyrueshëm në fusha të ndryshme të jetës së myslimanëve.

Interpretimi i sahabëve është pa dyshim i rëndësishëm në kuptimin e Kuranit dhe ka vlera e padiskutueshme si dhe merita të brendshme, duke pasur parasysh afërsinë e tyre me të Dërguarin dhe njohjen e Kuranit, **por pasi të jetë vërtetuar aftësia profesionale e tyre.**

Tefsiri dhe fetvatë e pasardhësve (tabiinët)

Ekzistojnë mosmarrëveshje nëse interpretimet nga radhët e tabiinëve (pasardhësve të sahabëve) konsiderohen apo jo ligjërisht të detyrueshme.

Fatkeqësisht, materialet historike kushtuar diskutimit të kësaj çështje nuk janë të gjera si në rastin e sahabëve. Gazaliu, Ibni Hazmi dhe të tjerët nuk treguan interes për të diskutuar autoritetin e interpretimit të tabiinëve. Sidoqoftë, shumica e dijetarëve sunitë kanë rënë dakord se xhemati i pasardhësve të sahabëve, gjegjësisht tabiinëve, është një provë detyruese (*huxhxhe* حجة), në rast se tabiini ka qenë studiues shquar në fushën e interpretimeve kuranore si dhe në rast se zinxhiri transmetues është vërtetuar si i saktë.

Tabiiu nënkupton një person, ose një brez që vjen pas një tjetri që ka kaluar; ose një brez që ndjek ose pason një të mëparshëm - një pases, një pasardhës.

Teknikisht, **tabi-ii** i referohet një myslimani i cili nuk kishte kontakte të drejtpërdrejta me të Dërguarin Muhamed a.s. (pra nuk e pa atë), por kishte kontakte të drejtpërdrejta me një nga shokët e tij, i cili e kishte takuar atë në të gjallë dhe pastaj vdiq si mysliman¹³.

Tabiinët konsiderohen brezi i dytë i Islamit dhe më i miri pas sahabëve.

¹³ Ibn Kethir, *El-Baitheel-Hathith fi Ihtisar Ulumil-Hadith* (Beirut, Dar el- Fikr, 1967), f. 78.

Midis studiuesve sunitë Ebu Hanifja besonte se interpretimi i pasardhësve- tabiinëve si dhe dekretet e tyre fetare nuk janë detyruese.

Kjo thjesht duke qenë se ata nuk kishin mundësinë të shihnin të Dërguarin ose të dëshmonin për shpalljen e Kuranit. Ibn Tejmijje e mbështet këtë mendim, ndërsa sipas Ebu Hajjanit të pranohet interpretimi i tabiut është vetëvrasje intelektuale ose shkencore¹⁴.

Grupi i dytë përfshin Ahmed ibn Hanbelin dhe disa juristë të malikive, të cilët besonin se interpretimi nga pasuesit-tabiinët e menjëherëshëm ishte i detyrueshëm.

Sidoqoftë, sipas një juristi modern të hanbelive, Abdullah ibn Muh-sinel-Turki, shumica e juristëve hanbeli duket se besonin se raporti më autentik që ka ardhur nga Ahmed ibn Hanbeli tregon se mendimet e tabiinëve megjithatë nuk janë detyruese për gjeneratat e mëvonshme¹⁵.

Dallimet në interpretimet kuranore të tabiinëve

Tabiinët ndryshojnë në pesë fusha kryesore: fikh, teologji, personazhe historike kuranore, gjuhësi, fraza kuranore.

Lidhur me fushën e **fikhut**, ndryshimet midis çështjeve në pasojat juridike të ajeteve mund të jenë shkaktuar nga kuptimi i ndryshëm i atyre ajeteve, mungesa e njohurisë për thëniet e Muhamedit a.s. në lidhje me çështje fetare, ose varësia nga hadithet e dobëta.

Një shembull që ilustron mungesën e njohurive për thëniet e Profetit për një çështje specifike mund të shihet në lidhje me ajetin 2: 196: *“Dhe plotësoni haxhin dhe umren në shërbim të Allahut. Por nëse ju pengojnë (që ta plotësoni atë), dërgoni një ofertë për flijim, siç mund ta gjeni dhe mos rruani kokën derisa oferta të arrijë në vendin e flijimit”*¹⁶

¹⁴ IbnTejmijjeh, *Mukaddimeh fi Usulet-Tafsir*, f. 105.

¹⁵ Muhammed Ebu Zehrah, *El-M`xhizhahel-Kubra: El-Kur`an* (Beirut: Dar al- Fikrel-'Arabi), f. 513.

¹⁶ Ibn Kethir, *Tafsir Ibn Kathir*, vol. 1, pp. 412-413.

I Dërguari ka specifikuar në hadith (i regjistruar më vonë nga el-Buhariu dhe Muslimi) se sa ditë duhet të agjërohet dhe sa njerëz të varfër duhet të ushqehen kur dikush nuk lejohet të kryejë haxhin ose umren.

Sidoqoftë, ne zbulojmë se tabiinët ndryshojnë në mendime në lidhje me numrin e ditëve që duhet agjëruar si dhe numrin e njerëzve të varfër që duhet të ushqehen.

Më tej, ka edhe referenca kuranore për personalitete individuale, emrat e të cilëve nuk janë dhënë në detaje në Kuran.

Sidoqoftë, disa nga studiuesit tabiinë u përpoqën t'i identifikonin ata në një mënyrë ose në një tjetër (ndoshta duke iu referuar Tevratit dhe Dhjatës së Re) dhe jo çuditërisht ndryshuan në lidhje me atë se kush ishin ata, për shembull ajeti 2: 246 *“A nuk e keni marrë vesh për parinë e bijve të Izraelit pas Musait, kur i patën thënë një të Dërguari të tyre...”* Kurani nuk përmend emrin e këtij Profeti të Izraelit, por disa nga tabiinët megjithatë u përpoqën të gjenin identitetin e tij me emër të cilin e quajtën **Shemun**.

Teologjia i referohet të kuptuarit të vetë tabiinëve për një ajet kuranor dhe interpretimit të tij pa u varur nga një hadith ose thënie nga sahabi.

Një shembull i këtij interpretimi mund të shihet në ajetin 4: 159: *“Dhe nuk ka asnjë nga njerëzit e Librit (hebrenj dhe të krishterë) për duhet të besojnë në të [Isain] para vdekjes së tij (kablemevtihi قبل موته) ...”* përemri *-damiri* “hi” që do të thotë i tij, në frazën, قبل موته (para vdekjes së tij) mund t'i referohet një individi të njerëzve të Librit ose Isait. Nëse përemri “ai” i referohet një individi të popullit të Librit, kuptimi i ajetit do të ishte që të gjithë njerëzit e Librit duhet të besojnë me siguri në Isain si Lajmëtar i Zotit, para se ai (individi) të vdesë. Nëse, megjithatë, përemri i referohet Isait, atëherë kuptimi do të ishte se nuk ka “asnjë nga njerëzit e Librit, të cilët nuk duhet të besojnë në të para se të vdesë”.

Gjuhësiaka të bëjë me fjalë ose terma të veçantë që tabiiu i kuptonte ndryshe, në përputhje me prejardhjet e tyre të ndryshme gjuhësore.

Më interesant është se ata gjithashtu ndryshuan për sa i përket origjinës së disa fjalëve kuranore, që pretendohet se rrjedhin nga gjuhë të huaja. Për shembull, fjala “*es-Samed*” në ajetin 112: 2, është interpretuar në mënyra të ndryshme: Zejd ibn Eslem e sheh atë si *es-Sejîd* (mjeshtër), Katadah e kupton atë si *el-Baki* (ai që e tejkalon krijimin e Tij), *Ikrimeh* e shpjegon atë si ai që nuk nxjerr mbeturina ose ka nevojë të ushqehet¹⁷.

Ibn Enes thotë se kuptimi është (Ai që nuk ka lindur dhe as nuk është i lindur)¹⁸ dhe më në fund akorduar me Muxhahidin, Sa`d ibn Xhubejrin, el-Suddi-in dhe el-Dehekiun besojnë se fjala *es-Samed* الصمد (është një dritë që shkëlqen¹⁹).

Frazat kuranore kanë të bëjnë me termat në Kuran, të cilat tabi-iu i ka interpretuar ndryshe, për shkak të mungesës së njohurive të hadithit që përmend kuptimin e këtyre frazave ose sepse nuk kishte hadith në lidhje me frazat e vështira, duke çuar secilin individ duke përdorur mendimin e tij. Kështu fraza në ajetin 15:87: “***Dhe, me të vërtetë, Ne të kemi dhuruar ty shtatë nga [vargjet] e përsëritura shpesh...***”

Për studentët e Ibni Abasit, kryesisht Muxhahidin, Se`ad ibn Xhubejrin dhe ed-Dehekiun, kjo nënkuptonte shtatë kapitujt më të gjatë të Kuranit. Nga ana tjetër, për El-Hasen el-Basriun, Kataden dhe Muxhahidin (pasi dikur mbante mendimin e mëparshëm), سبع المثاني si frazë kuranore nënkuptonte vetëm kaptinën *el-Fatihah* (surja e parë e Kuranit)²⁰. Ata citojnë një hadith që më vonë është gjetur edhe në përmbledhjen el-Buhari-ut për të mbështetur këtë interpretim, ndërsa ata që

¹⁷ Ibid.

¹⁸ Ibid.

¹⁹ Ibid.

²⁰ Ibid, fq. 476.

mbajnë mendimin e mëparshëm nuk iu referuan ndonjë hadithi të caktuar.

Karakteristikat kryesore të tabiinëve në tefsir, burimet dhe metodologjia

Përkundër pretendimeve se disa tabiinë si Muxhahidi, Sa'd ibn Xhubejri dhe të tjerë shkruanin komente islame, megjithatë tekstet e tyre nuk i mbulonin të gjitha ajetet e Kuranit. Në përgjithësi, tefsiri i tabiit ishte i thjeshtë dhe jo shumë i qartë. Ai përfshinte shumë pak citate nga poezia e klasike arabe, e cila përdorej për të mbështetur kuptimin gjuhësor të frazave kuranore.

Përkufizimi i tekstit kuranor dhe analizat gramatikore mungojnë, disa prej tyre të tilla si Katade, ofruan vëzhgime retorike dhe gjuhësore të disa ajeteve nga vetë Kurani²¹.

Tabiiu kryesisht përdori tre burime:

- Kuranin;
- sahabiun;
- mendimin e pavarur.

Edhe një burim tjetër që ata përdorën për interpretimin e tyre të Kuranit ishin *isra'ilijetet*, veçanërisht nxënësit e Ibn Abasit.

Studiuesit myslimanë janë të ndarë në dy grupe për sa i përket autoritetit detyrues të shpjegimit të tabiit. Shumica besojnë se shpjegimi i tyre nuk është huxhxhe - حجة, argument, pasi ata nuk e takuan të Dërguarin personalisht dhe se nuk ishin dëshmitarë të rrethanave që lidhen me shpalljen.

Të tjerët pohojnë se meqenëse veprat e tefsireve të tabiit bazohen në njohuritë që fituan nga sahabët, ata kanë qëndrim të barabartë me

²¹ *Sahih al-Bukhari*, vol. 4, pp. 123-170.

punën e sahabit si provë detyruese sepse çfarëdo njohurie që tabiiu të merrte, ajo do të ishte e njëjtë me atë të mësuesve të tyre.

Sidoqoftë, në fund të fundit duket se arsyetimet dhe arsyet e ofruara nga të dy palët për sa i përket autoritetit detyrues të tefsirit të tabiiut vështirë se mund të mbështeten në kredencialet skolasitike.

Marrë nga:
**“A BRIEF INTRODUCTION
TO QUR’ANIC EXEGESIS”,**
botuar nga
The International Institute of Islamic Thought,
në Herndon-SHBA, viti 2018.

Nga anglishtja:
Xhabir Hamiti

Dr. Fidan XHELILI

AGJËRIMI I DITËS SË ASHURËS DHE PROBLEMATIKAT RRETH SAJ

Abstrakt

Nuk ka dyshim se agjërimi në Islam është një ndër adhurimet më të rëndësishme dhe më të vlerësuara nga Zoti i Madhërishëm. Si adhurim me dëshmi të Kuranit është shumë i lashtë, edhe pse në forma të ndryshme duke iu përshtatur secilit ymet, specifikave të tij. Agjërimi është dy llojesh, agjërimi obligativ dhe ai vullnetar. Agjërimi vullnetar ka specifikat e veta që e bëjnë të dallojë nga ai obligativ. Një ndër këto dallime është se agjërimi obligativ është në ditë të caktuara të një muaji të caktuar për dallim nga agjërimi vullnetar, i cili mund të kryhet edhe në ditë të caktuara edhe jashtë tyre. Njëra ndër ditët që agjërohen vullnetarisht është edhe dita e Ashurës, për të cilën është përfolur e shkruar shumë dhe për këtë shkak synojmë që në këtë punim të hedhim dritë sadopak mbi realitetin e agjëritit të kësaj dite. Nuk ka dyshim se agjërimi i ditës së Ashurës është një ndër ditët më të vlefshme, të cilën Pejgamberi a.s. e ka agjëruar, por edhe ka nxitur të tjerët që ta agjërojnë.

Fjalët kyçe: Agjërim, Ashura, Musai a.s., hebrenj, përngjasim, periudhë, problematikë.

Hyrje

Agjërimi i ditës së Ashurës është i rëndësishëm për faktin se kjo ditë është agjëruar qysh nga koha e lashtë, nga Musai dhe Beni Israilët, e pastaj është trashëguar edhe te popuj të ndryshëm, ku në mesin e tyre janë edhe Kurejshët mekas. Gjithashtu ajo që e bën të rëndësishëm agjërimitin e kësaj dite është se në zanafillën e Islamit kjo ditë ishte obligim të agjërohej, deri atëherë kur u zëvendësua me agjërimitin e rama-zanit.

Në këtë punim do të përqendrohemi në disa çështje rreth agjërimitit të ditës së Ashurës. Çështja e parë do të jetë rreth mënyrave të shqiptimitit të emrit të kësaj dite, çështja e dytë rreth haditheve që flasin për vlerën e agjërimitit të kësaj dite, në çështjen e tretë do të shqyrtojmë periudhat nëpër të cilat ka kaluar agjërimi i ditës së Ashurës dhe në pikën e katërt dhe të fundit kemi sjellë problematikat e cekura nga opinionistët të ndryshëm rreth haditheve që flasin për agjërimitin e Ashurës, duke iu përgjigjur një nga një këtyre problematikave me një metodologji shkencore që të mënjanojmë çdo lloj kontradikte mes haditheve të ditës së Ashurës.

1. Mënyra e drejtshkrimit dhe drejtshqiptimit të Ashurës dhe shkaku i emërtimit të kësaj dite

Në drejtshkrimin dhe drejtshqiptimin e Ashurës kemi disa mënyra: - "عشور", "عشورا", "عشوراء", "عشوراء", "عشوراء" që në gjuhën shqipe të gjitha shqiptohen "Ashura", pos të fundit "Ashur",¹ dhe që të gjitha do të thonë e dhjeta.

Ndërsa për shkakun e emërtimit të kësaj dite me këtë emër janë dhënë disa mendime të cilat nuk kanë mbështetje në fakte. Më e sakta dhe më së afërmi së vërtetës -Allahu e di më së miri- është mendimi që

¹ Ahmed ibën Muhamed El-Fejjumij, "El-Misbah el-Munir fi garibish-sherhil-kebir", Bejrut, El-Mektebetul-ilmije, pa vit botimi, fq 75.

mbrojnë disa linguistë, si Ibën Mendhuri², Fejruz Abadij³, Zebidij⁴, se Ashura e ka marrë këtë emër ngase është dita e dhjetë e muajit Muharrem. Dijetarët kanë divergjenca se kjo fjalë a është arabe apo jo dhe kanë dy mendime:

1. El-Bejruij⁵ dhe Ahmed Atijetullah⁶ mendojnë se kjo fjalë është hebraike dhe jo arabe.
2. Ibën Durejdi⁷ dhe Ibnul-Ethiri⁸ mendojnë se kjo fjalë është fjalë arabe. Ashura është ditë që është emërtuar në Islam dhe nuk është njohur në kohën paraislamike. Sipas tyre është e mundur që emri Ashura i ditës së dhjetë të muajit Muharrem të jetë përdorur për herë të parë në kohën e Pejgamberit a.s., ashtu siç kanë dalë shumë shprehje të tjera fetare. Ndërsa dr. Ali Abdulvahid Vafij mendon se emri i ditës së nëntë dhe të dhjetë të muajit Muharrem, “Tasua dhe Ashura”, janë dy emërtime arabe të vjetra, nuk janë trashëguar nga gjuha hebraike e as nga ndonjë gjuhë tjetër⁹. Kjo duket të jetë më e saktë.

Këtë ditë e kanë agjëruar Nuhu dhe Musai a.s., siç ka ardhur në hadithin që transmeton imam Ahmedi¹⁰ nga Ebu Hurejra r.a., i cili ka thënë: “I Dërguari a.s. kaloi pranë disa hebrenjve të cilët agjëronin

² Ibn Mendhur Muhamed bin Mukrim Ebul Fadl, Lisanul Arab, Bejrut: Dar Sadir, 1414 h., 4/569.

³ Fejruz Abadij, “El-Kamus El-Muhit”, Bejrut: Muesseset err-Rrisale, 2005, fq. 565.

⁴ Ez-Zebidij Muhamed bin Muhamed, Taxhul- Arus min xhevami-il-kamus, grup rec. Darul Hidaje, pa vit botimi, 13/43.

⁵ Bejruij, “El-Athar el-Bakije anil-Kurun el-Halije”, fq. 330, pa rec.

⁶ Ahmed Atijetullah, “El-Kamus el-islamij”, Mektebet en-Nehdatul-Misrij, pa vit botimi, 5/19.

⁷ Ibën Durejd, “Xhemheretul-lugati”, rec. Remzi Munir Balebekij, Bejrut: Darul ilm lil melajin, 1987. 2/343.

⁸ Ibnul-Ethiri, “En-Nihajetu fi garibil-hadithi”, rec. Tahir Ahmed ez-Zavij dhe Mahmud Muhamed et-Tanahij, Bejrut: El Mektebetul-ilmije, 1979, 3/240.

⁹ Ali Abdulvahid Vafij, “Buhuthun fil-Islami vel Ixhtima”, Egjipt, Dar Nehdat Misr lit-tiba veneshr, 2016, 1/200.

¹⁰ Ahmed bin Hanbeli, El- Musned, rec. Shuajb Arnaut, Bejrut: Mueseset err-Rrisale, 2001, dhe botimi tjetër, rec. Ahmed Shakir, Kajro: Darul-Hadith, 1995, nr i hadithit 8717.

Ashurën dhe i pyeti ata: - Çka është kjo ditë që po agjëroni? Ata thanë: - Kjo është dita në të cilën Allahu e shpëtoi Musain dhe Beni Israilët prej përmbytjes, ndërsa faraoni u përmbyt, gjithashtu kjo është dita në të cilën është stabilizuar anija e Nuhut në Xhudij. E kanë agjëruar Nuhu dhe Musai në shenjë falënderimi për Allahun. Pejgamberi a.s. tha: - Unë kam më shumë merita për Musain dhe që ta agjëroj këtë ditë,- më pas i urdhëroi shokët e tij ta agjëronin këtë ditë”.

Këtë hadith e ka përmendur Hafidh ibën Haxheri në sqarimin e tij ndaj sahihut të Buhariut dhe nuk ka thënë asgjë për të, ndërsa dihet se heshtja e Ibën Haxherit ndaj hadithit në “Fet'hul Barij” aludon se hadithi ose është i saktë ose të paktën hasen, i mirë. Kjo rregull është në shumicën e rasteve. Këtë rregull e ka cekur vetë Ibën Haxheri në parathënien e tij ndaj sahihut të Buhariut¹¹.

Ndërsa dijetari Es-Sa'atij në verifikimin e tij ndaj haditheve të musnedit të imam Ahmedit ka cituar se zinxhiri i këtij hadithi është i mirë¹². Ndërsa dijetari Albani¹³ dhe dijetari Shuajbi¹⁴, Allahu i mëshiroftë, hadithin e konsiderojnë të dobët.

Këtu kemi për qëllim rreth këtij hadithi vetëm shtojcën ku përmendet “Nuhu a.s.”, ngase hadithi ku përmendet vetëm Musai a.s. është hadith i saktë dhe e transmetojnë Buhariu¹⁵ dhe Muslimi¹⁶.

Hafidh ibën Rexhebi thotë: “Dita e Ashurës ka vlerë të madhe dhe shenjtëri të kahmotshme. Agjërimi i kësaj dite ka qenë i njohur mes Pejgamberëve a.s., e kanë agjëruar Nuhu dhe Musai a.s.. Ehlu kitabi e

¹¹ Ibën Haxher el-Askalanij, “Fet'hul Barij sherh Sahih el-Buharij” apo siç njihet parathënia e tij si “Hed'jus-Sarij”, rec. Muhibudin el-Hatib, Bejrut: Darul Ma'rife, 1379h. 1/4.

¹² Es-Sa'atij, Ahmed ibën Abdurrahman, “Bulugul Emanij min Esrar el-Fet'h err-Rrabanij”, rec. Hasan Abdulmenan, Bejtul eftar ed-devlije, 10/177-178.

¹³ Muhamed Nasirudin Albani, “Silsilet el-Ehadith ed-Daife..” Riad: Mektebet el Mearif, 1992. 3/691.

¹⁴ Musnedi i Imam Ahmedit, nr. i hadithit 8717 me verifikim të shejh Shuajbit.

¹⁵ Transmeton Buhariu, rec. Muhamed Zuhejr, Dar Turuk en-Nexhat, nr. i hadithit 2004.

¹⁶ Transmeton Muslimi, rec. Muhamed Fuad AbdulBakij, Bejrut: Dar Ihjaut-turath el-Arabij 1436 h., nr i hadithit 1130.

kanë agjëruar, gjithashtu edhe Kurejshët në kohën e injorancës e agjër-onin. Delhem ibën Salih i ka thënë Ikrimes: “Ç’është puna e Ashurës?” Tha: “Kurejshët kanë bërë një mëkat të madh në kohën e injorancës dhe kjo gjë i mundoi shumë dhe për këtë pyetën se si mund të pendo-heshin. Atyre iu tha: “Agjëroni Ashurën, ditën e dhjetë të muajit Mu-harrem¹⁷”.

2. Hadithet e cekura për vlerën e agjërimit të ditës së Ashurës

Hadithi i parë

Ubejdullah bin Ebi Jezidi transmeton nga Abdullah bin Abbasi r.a. të ketë thënë: “Nuk e kam parë Pejgamberin a.s. të përkujdeset për agjërimin e ndonjë dite me vlerë më shumë sesa kjo ditë, ditën e Ashu-rës, dhe këtë muaj, d.m.th. muajin ramazan”.

Transmetimi i hadithit

Hadithin e transmeton Buhariu¹⁸ (shprehja është e tij), Muslimi¹⁹, Nesaiu²⁰, Ahmedi²¹, Ibën Huzejme²² me shprehje të përafërta, që të gjithë nga rrugë të shumta transmetimesh nga Ubejdullah bin Ebi Jezi-di me të njëjtin zinxhir.

Hadithi i dytë

Gajlan bin Xheriri transmeton nga Abdullah bin Ma'bed Ez-Zem-mannij, e ai nga Ebu Katade r.a., në hadithin e agjërimit të Pejgamberit a.s., hadithi është i gjatë, ku ndër të tjera thotë: “U pyet (i Dërguari a.s.) për agjërimin e Ashurës. Ai tha: “(Agjërimi i kësaj dite) i fal më-

¹⁷ Ibën Rexheb, “Letaiful-Mearif”, Bejrut: Dar ibn Hazm, 2004, fq. 48.

¹⁸ Transmeton Buhariu, nr. i hadithit, 2006.

¹⁹ Transmeton Muslimi, nr. i hadithit, 1132.

²⁰ Transmeton Nesaiu, rec. Hasen Abdul Munim Shelebij, me mbikëqyrje të shejh Shuajb Arna-utit, Bejrut: Mueseset err-Rrisale 2001, nr. i hadithit 2370.

²¹ Transmeton Ahmedi, nr. i hadithit 1938.

²² Transmeton Ibën Huzejme, rec. Muhamed Mustafa el-Adhamij, bot 3, 2003, nr. i hadithit 2086.

katet e vitit të kaluar”, në një shprehje tjetër: “Agjërimi i ditës së Ashurës shpresoj tek Allahu t'i falë mëkatet e vitit para tij”.

Transmetimi i hadithit

Hadithin e transmeton Muslimi²³ (shprehja është e tij), Tirmidhiu²⁴ dhe të tjerë me shprehje të ndryshme, që të gjithë nga rrugë të ndryshme nga Gajlan bin Xheriri me zinxhir të njëjtë.

3. Periudhat nëpër të cilat ka kaluar agjërimi i Ashurës

Dijetarët kanë përmendur katër periudha nëpër të cilat ka kaluar agjërimi i ditës së Ashurës.

Periudha e parë: *Kur Pejgamberi a.s. e agjëronte në Mekë, por nuk urdhëronte askënd ta agjëronte atë.* Siç qëndron në dy koleksionet më të sakta të haditheve, Buhariu dhe Muslimi transmetojnë nga Aish-ja r.a. të ketë thënë: “Ashura ishte një ditë që e agjëronin Kurejshët në kohën e injorancës, por edhe Pejgamberi a.s. e agjëronte. Mirëpo, kur erdhi në Medinë, e agjëroi dhe i urdhëroi të tjerët ta agjëronin. Ndërsa kur u obligua agjërimi i muajit ramazan, e agjëroi ramazanin dhe e la (obligueshmërinë) agjërimin e Ashurës; kush dëshironte ta agjëronte, e agjëronte e kush dëshironte, nuk e agjëronte”. Ndërsa në transmetimin e Buhariut qëndron kështu: “Dhe i Dërguari a.s. tha: “*Kush dëshiron, le ta agjërojë e kush dëshiron, mos ta agjërojë*”²⁵”.

Periudha e dytë: *Kur i Dërguari a.s. e agjëronte dhe i urdhëronte të tjerët ta agjëronin atë.* Kur erdhi në Medinë, Pejgamberi a.s. i pa hebrejtë duke e agjëruar dhe pasi kishte dëshirë të përputhej me ta në gjërat që nuk kundërshtojnë, e agjëroi Ashurën dhe i urdhëroi të tjerët ta agjëronin, derisa e ngriti lart vlerën e agjërimin të Ashurës, sa që i urdhëronin edhe fëmijët ta agjëronin. Në dy sahihët transmetohet nga Abdullah bin Abasi të ketë thënë: "Erdhi i Dërguari a.s. në Medinë, i

²³ Transmeton Muslimi, nr. i hadithit 1162.

²⁴ Transmeton Tirmidhiu, nr. i hadithit 749.

²⁵ Transmeton Buhariu, nr. i hadithit 2002 dhe Muslimi, nr. i hadithit 1125.

gjeti hebrenjtë agjërueshëm ditën e Ashurës dhe i pyeti: “Ç’është kjo ditë që agjëroni?” Ata i thanë: “Kjo është ditë e madhe, Allahu në këtë ditë e shpëtoi Musain dhe popullin e tij, ndërsa e fundosi faraonin dhe ushtrinë e tij. E agjëroi Musai a.s. në shenjë falënderimi për Allahun dhe për këtë ne e agjërojmë. Atëherë i Dërguari a.s. tha: “Ne kemi më shumë të drejtë dhe kemi më merita për Musain sesa ju”²⁶. E agjëroi dhe urdhëroi të agjërohet.

Periudha e tretë: Mosurdhërimi nga ana e Pejgamberit a.s. që të tjerët ta agjërojnë, pasi ishte bërë obligim agjërimi i ramazanit. Kush dëshironte, e agjëronte e kush dëshironte, nuk e agjëronte. Në këtë periudhë disa prej sahabëve nuk e kanë agjëruar Ashurën²⁷, pasi u bë agjërimi i ramazanit obligativ. Këtë e vërteton transmetimi te Buhariu nga Abdullah bin Omeri r.a., ku thotë: “Pejgamberi a.s. e ka agjëruar Ashurën dhe i ka urdhëruar të tjerët ta agjërojnë. Por, kur u obligua ramazani, atëherë u la Ashura, për këtë arsye Abdullah bin Mes'udi nuk e agjëronte Ashurën, pos nëse përputhej me ditët që ai i agjëronte”²⁸. Ndërsa te Muslimi qëndron se Abdullah bin Mes'udi r.a. thoshte: “(Ashura) Ishte një ditë të cilën e agjëronte i Dërguari i Allahut para se të obligohej agjërimi i ramazanit. Pasi është bërë obligim muaji i ramazanit, është braktisur agjërimi i Ashurës”²⁹.

Periudha e katërt: Kur Pejgamberi a.s. kishte vendosur të mos e agjëronte si ditë të vetme, por t’ia bashkëngjiste një ditë tjetër, në shenjë kundërshtimi ndaj ithtarëve të librit. Në sahihun e Muslimit transmetohet nga Ibën Abasi r.a. të ketë thënë: “Kur i Dërguari i Allahut e agjëroi dhe urdhëroi të agjërohet Ashura, i thanë: - O i Dërguari i Allahut, kjo është një ditë që e madhërojnë hebrenjtë dhe të krishterët. Atëherë Pejgamberi a.s. tha: “Kur të vijë viti tjetër, dashtë Zoti, do ta

²⁶ Transmeton Buhariu, nr. i hadithit 2004 dhe Muslimi, nr. i hadithit 1130.

²⁷ Shiko; Ibën Rexheb, “Letaiful Mearif”, fq 47.

²⁸ Transmeton Buhariu, nr. i hadithit 1892.

²⁹ Transmeton Muslimi, nr. i hadithit 1127.

agjërojmë edhe ditën e nëntë”. Transmetuesi thotë se vitin tjetër Pejgamberi kishte ndërruar jetë³⁰.

4. Problematikat e shfaqura rreth haditheve të Ashurës³¹

Problematika e parë

Në hadithin që transmeton Aishja r.a., ajo thotë: “Ashurja ishte një ditë që e agjëronin në injorancë Kurejshët, e bashkë me ta e agjëronte edhe Pejgamberi a.s., ndërsa kur erdhi në Medinë, e agjëroi dhe urdhëroi të agjërohet. Kur zbriti obligueshmëria e agjëritit të muajit ramazan, ai e agjëronte ramazanin dhe e la agjërimin e Ashurës, pos kush dëshironte, siç u përmend më lart. Ndërsa në hadithin e lartcekur nga Ibën Abasi r.a. qëndron: “Kur erdhi i Dërguari i Allahut në Medinë, i gjeti hebrenjtë duke agjëruar Ashurën dhe i pyeti se pse e agjëronin këtë ditë. Ata i thanë: “Kjo është një ditë e madhe, Allahu e shpëtoi në të Musain dhe popullin e tij, ndërsa e fundosi faraonin dhe popullin e tij, ndaj Musai e agjëroi në shenjë falënderimi, për këtë arsye edhe ne e agjërojmë. Atëherë Pejgamberi a.s. tha: “Ne kemi më shumë merita për Musain sesa ju”, pastaj i Dërguari i Allahut e agjëroi dhe urdhëroi të agjërohet.

Problematika është këtu: Nëse Pejgamberi a.s. e agjëronte Ashurën para hixhretit, siç u pa në hadithin e Aishes, përse i pyeti për të hebrenjtë kur i pa tek e agjëronin? E kur ata iu përgjigjën, ai e agjëroi dhe urdhëroi të agjërohej, siç u pa në hadithin e Ibën Abasit. Sikur nuk kishte dëgjuar dhe nuk e kishte agjëruar Ashurën, pos pasi i pyeti hebrenjtë. Kjo shihet si kundërthënie mes transmetimeve.

³⁰ Transmeton Muslimi, nr. i hadithit 1134.

³¹ Këto problematika zakonisht i përmendin disa prej opinionistëve bashkëkohorë dhe i përsërisin çdo herë duke pas synim t'i shpallin hadithet e agjëritit të Ashurës si hadithe të kota dhe të shpikura.

Përgjigja: Nuk ka mes transmetimeve mospërputhje sepse i Dërguari i Allahut e agjëronte Ashurën para hixhretit, ndërsa hebrenjtë i pyeti vetëm për shkakun pse e agjëronin këtë ditë, jo se i Dërguari e mori agjërimin e kësaj dite prej tyre. Kurtubiu thotë: “Pyetja e Pejgamberit a.s. drejtuar hebrenjve ishte me qëllim që të mësonte prej tyre shkakun pse e agjëronin këtë ditë”³².

Problematika e dytë

Në hadithin e Ibën Abasit u përmend se Pejgamberi a.s. i pyeti hebrenjtë për Ashurën dhe e mori prej tyre agjërimin e saj. Si është e mundur që të marrë fenë prej hebrenjve, kur dihet se feja e tyre është e shtrembëruar? A na lejohet neve që të mbështetemi në atë që transmetojnë ithtarët e librit nga Pejgamberët e tyre, siç u mbështet Pejgamberi a.s. në transmetimin e tyre nga Musai se ai kishte agjëruar Ashurën?

Përgjigja: I Dërguari a.s. e agjëronte Ashurën para hixhretit, siç u pa në hadithin e Aishes, ndërsa vërtetimi i lajmit të tyre nga ana e Pejgamberit a.s., nuk është se është mbështetur tek ata, por është bërë ose me shpallje nga Allahu i Madhërishëm, ose kjo vepër është përcjellë gjeneratë pas gjenerate, ose e ka lajmëruar ndokush nga hebrenjtë e bërë myslimanë. Kadij Ijadi, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: “U përmend se Kurejshët e agjëronin e bashkë me ta edhe Pejgamberi a.s. kur erdhi në Medinë e ka agjëruar, ndërsa agjërimi i hebrenjve nuk ka sjellë ndonjë dispozitë të re, që duhet të flitet për të, por ajo ishte cilësim i një gjendjeje dhe përgjigje ndaj një pyetje, e kjo tregon se fjala në hadith “atëherë e agjëroi” nuk është se ai nga aty e filloi agjërimin e saj³³”. Maziriu, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: “Lajmi i hebrenjve është i papranueshëm, ndaj mund të themi se Pejgamberit a.s. iu shpall vërtetësia

³² Kurtubiu, Ahmed bin Shejh, “El-Mufhim lima eshkele min telhisi kitab Muslim”, pa vit botimi, 9/139.

³³ Kadij Ijad bin Musa, “Ikmalul Mulim bi fevaid Muslim”, rec. Jahja Ismail, Egjipt: Darul Vefa, 1998. 4/83.

e lajmit të tyre kur treguan për tregimin e kësaj ngjarjeje apo ndoshta ky lajm ishte në pozitën e mutevatirrit, që ishte përcjellë gjeneratë pas gjenerate, pra ishte çështje e padiskutueshme³⁴.

Problematika e tretë

Në hadithin paraprak të Ibën Abasit shënohet se i Dërguari a.s., kur erdhi në Medinë, i gjeti hebreujtë që agjëronin Ashurën. Si mund të kuptohet kjo, kur ai hyri në Medinë në muajin rebiul-evel?

Përgjigja: Në hadith nuk thuhet se Pejgamberi a.s. i gjeti hebreujtë agjërueshëm ditën kur hyri në Medinë. Ibën Kajimi thotë: “Në hadith nuk thuhet se ditën kur erdhi i gjeti duke agjëruar, ngase ai ka hyrë në Medinë ditën e hënë më dymbëdhjetë rebiul-evel, por për herë të parë kur u ballafaqua me këtë ishte në vitin e ardhshëm, pasi kishte ardhur në Medinë³⁵”. Të njëjtën përgjigje e thotë edhe Hafidh ibën Haxheri³⁶.

Problematika e katërt

Si të përputhet mes pajtueshmërisë së Pejgamberit a.s. me hebreujtë në agjërimin e Ashurës dhe mes urdhrin të tij që ithtarët e librit të kundërshtohen dhe ndalesës së tij që t’i përngjajmë ata?

Përgjigja është në dy aspekte:

- a) Pejgamberi a.s. e agjëronte Ashurën para hixhretit, rrjedhimisht agjërimin e Ashurës nuk e ka marrë nga hebreujtë dhe nuk i ka pasuar ata. Ibën Tejmije thotë: “Nëse esenca e agjërimin të tij nuk është pajtueshmëria me ithtarët e librit, atëherë fjala e tij: “Ne kemi më merita për Musain sesa ju” është përforcim i agjërimin të

³⁴ Maziriu, Muhamed bin Ali, “El-Mulim bi fevaid Muslim”, rec. Muhamed Esh-Shadhilij, Algjeri, Ed-Dar et-Tunisije dhe Muesesetul Vatanije lil Kitab, 1998, 2/38.

³⁵ Ibën Kajim el-Xhevzije, “Zadul-Mead”, rec Shuajb dhe Abdulkadir Arnaut, Bejrut, Mueseset err-Rrisale, 1994, 2/71.

³⁶ Ibën Haxher el-Askalanij, “Fet’hul Barij”, 6/537.

tij dhe sqarim për hebrenjtë se ajo çfarë po veproni në pajtueshmëri me Musain, edhe ne e veprojmë, ndaj ne kemi më merita se ju për Musain³⁷”.

b) Kjo që ka ndodhur në fillim të hixhretit, ku Pejgamberi a.s. agjëron Ashurën duke e ditur se me këtë po pajtohet me atë që bënë hebrenjtë, krejt kjo ka qenë në periudhën kur Pejgamberi a.s. dëshironte të përputhej me ithtarët e librit në gjërat që nuk kishte ndonjë ndalesë specifike, e më pas urdhëroi që të kundërshtoheshin dhe ndalonte që të përgjasehemi me ta.

Ibën Haxheri ka thënë: “Pejgamberi a.s. dëshironte të përputhej me ithtarët e librit në gjëra që nuk kishte ndalesë, e sidomos në gjërat në të cilat kundërshtonte idhujtarët. E kur e çliroi Mekën dhe Islami mori dhenë, e dëshironte kundërshtimin e ithtarëve të librit. Pra, në fillim u pajtua me ta, ndaj tha: “Ne kemi më merita për Musain sesa ju”, ndërsa më pastaj e dëshironte mospajtimin e tyre dhe urdhëroi që t’i shtohet një ditë para dhe një ditë pas, si kundërshtim ndaj tyre³⁸”.

Problematika e pestë

Hadithi i Ibën Abasit tregon se Pejgamberi a.s. nuk u lajmërua se hebrenjtë e madhëronin Ashurën me agjërim pos në fund të jetës së tij dhe menjëherë vendosi që në vitin e ardhshëm t’i kundërshtonte, ndaj si të kuptohet se Pejgamberi a.s. qëndroi në Medinë dhjetë vite dhe çdo vit e agjëronte Ashurën dhe i shihte hebrenjtë tek agjëronin?!

Përgjigja: Për këtë problematikë jemi përgjigjur edhe më herët, kur sqaruar se esenca e agjërimit të Pejgamberit a.s. nuk ka qenë si shenjë pajtueshmërie me ithtarët e librit, që më vonë të ketë nevojë t’i kundërshtojë, dhe se shkak i agjërimit të kësaj dite nëse është shkak i ligjshëm në aspektin fetar, atëherë nuk ka ndonjë pengesë që të shoqë-

³⁷ Ibën Tejmije, “Iktidaus-Siratil-Mustekim”, rec. Nasir Abdulkerim el Akl, Beirut, Daru Aleml Kutubi, 1999, fq. 174.

³⁸ Ibën Haxher, “Fet’hul Barij”, 6/532.

rohen hebrenjtë apo injorantët. Ndërsa shkaku shariatik në këtë rast është shpëtimi i Musait dhe popullit të tij dhe shkatërrimi i faraonit dhe i popullit të tij. Në këtë rast jemi përputhur, por kjo nuk konsiderohet përngjasim me ta, por është marrje në konsideratë e shkakut, të cilin edhe ata e kishin marrë, për të cilin edhe kishin agjëruar. Pra, ajo që kishte ndodhur në fillim të hixhretit, ku Pejgamberi a.s. vazhdonte ta agjëronte ditën e Ashurës, edhe pse e dinte se kjo përputhej me agjërimin e hebrenjve, ishte në periudhën kur Pejgamberi a.s. dëshironte të përputhej me ithtarët e librit në gjërat që nuk ishte i ndaluar. Pejgamberi a.s. kishte vendosur ta agjëronte edhe ditën e nëntë, që të ishte si kundërshtim i hapët për ata të cilët do të hamendeshin se agjërimi i Ashurës ishte për t'u përputhur me hebrenjtë dhe përngjasim me ta, por realiteti e tregon se kjo gjë nuk ishte kështu.

Problematika e gjashtë

Si mund të konsiderohet agjërimi i ditës së nëntë bashkë me të dhjetën kundërshtim i hebrenjve, kur në realitet kjo është e njëjtë si ajo që veprojnë hebrenjtë? Pra, agjërimi i ditës së dhjetë, vetëm me një shtesë, pra agjërimi i së nëntës, e cili është kundërshtimi në këtë formë?

Përgjigja: Kundërshtimi këtu është i qartë, ngase hebrenjtë agjërojnë një ditë, ndërsa myslimanët agjërojnë dy ditë, ndaj kundërshtimi në numër është i qartë. Imam Neveviu ka thënë: “Disa dijetarë kanë thënë se ndoshta shkaku i agjërimin të ditës së nëntë bashkë me të dhjetën është që të mos përngjante me hebrenjtë në agjërimin e vetëm një dite³⁹”. Munaviu thotë: “Qëllimi në këtë adhurim është kundërshtimi i

³⁹ En-Neveviu, “El Minhaxh Sherh Sahih Muslim”, pa rec, Bejrut, Daru Ihjaut-turath el-arabij, pa vit botimi, 8/13.

ihhtarëve të librit, duke e ruajtur adhurimin, që ndodh duke e transferuar të dhjetën në të nëntën apo edhe duke i agjëruar të dyja së bashku⁴⁰”.

Problematika e shtatë

Mosagjërimi nga Ibën Mesudi dhe Ibën Omeri r.a. i ditës së Ashurës i kundërshton hadithet që tregojnë se ky agjërim është sunet. Gjithashtu hadithi të cilin e transmeton Muaviu r.a., ku ai thotë: “O medinas, ku janë dijetarët tuaj? E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut a.s. të thotë: “Kjo është dita e Ashurës, Allahu nuk ua ka bërë obligim agjërimin e saj, ndërsa unë jam agjërueshëm. Kush dëshiron të agjërojë le të agjërojë e kush do, mos ta agjërojë”⁴¹, na shtyn të pyesim si ka mundësi që dijetarët e Medinës nuk e dinin këtë sunet, kur prej qytetit të tyre kishte dalë?!

Përgjigja: Është vërtetuar me hadithe të sakta e të shumta nga Pejgamberi a.s. ligjshmëria e agjërimin të ditës së Ashurës, gjithashtu vazhdueshmëria në këtë agjërim derisa vdiq, ndaj kjo nuk mund të kundërshtohet me lënien e Ibën Mesudit dhe Ibën Omerit r.a., ngase ata e kanë lënë për ta qartësuar se agjërimi i saj nuk është obligativ dhe kjo është e qartë për atë që i shikon hollësisht hadithet e tyre.

Kadi Ijadi, kur komenton fjalën e Ibën Mesudit r.a., thotë: “Nuk ka në të argument se është mekruh -i urryer- agjërimi i kësaj dite, ai është vetëm lajmërim për lënien e obligueshmërisë së tij dhe ato fjalë Ibën Mesudi ua ka thënë atyre që ia panë për të madhe ngrënien në këtë ditë⁴²”. Kastalani thotë: “Transmetuesi i hadithit, Abdullah bin Mesudi, nuk e agjëronte ditën e Ashurës nga frika se mos mendohej se është

⁴⁰ El-Munaviu, Abdurreuf, “Et-tejsir bi sherh el-Xhami es-Sagir”, Riad, Mektebet el Imam esh-Shafij, 1998, 2/245.

⁴¹ Mutefekun alejhi, Buhariu, 2003, dhe Muslimi, 126-1129.

⁴² Kadij Ijadi, “Ikmaul -Mu’lim”, 4/81.

obligim apo që të madhërohej siç ishte madhëruar në kohën e injorancës, në të kundërtën agjërimi i kësaj dite është sunet⁴³”.

Mendimi i shumicës së hadithologëve dhe usulistëve është se veprimi i transmetuesit apo fetvaja e tij në kundërshtim me atë që transmeton nuk e pengon të vepruarit me atë hadith, ngase fjala e Pejgamberit a.s. është argument më vete, ndaj nuk anashkalohet hadithi e të kalohet te mendimi i transmetuesit apo te veprimi i tij sepse ai nuk është argument⁴⁴.

Ndërsa fjala e Muaviut r.a. për banorët e Medinës: “Ku janë dijetarët tuaj?”, nuk aludon për atë se dijetarët e Medinës nuk kanë qenë në dijeni për këtë sunet, mbase me këtë fjalë mund të aludohet për disa kuptime të tjera. Kadij Ijadi thotë: “Fjala e tij ‘dijetarët’ nënkupton tërheqjen e vëmendjes së tyre për këtë gjykim apo edhe kërkim të ndihmës prej tyre që ta këshillonin nëse kishin diçka për t’i thënë apo edhe ndoshta mund të kuptohet si shprehje e revoltës ndaj asaj që kishte parë prej tyre në raport me këtë ditë⁴⁵”.

Ndërsa Kurtubiu thotë: “Muaviu r.a. i veçoi dijetarët me thirrjen e tij që ta kumtonin nga ai apo që ta vërtetonin atë që thoshte, ngase këtë e dinin shumë prej tyre, sepse ata ishin më të diturit për hadithet e Pejgamberit a.s..⁴⁶” Ibën Haxheri thotë: “Konteksti i kësaj ngjarjeje të jep të kuptosh se Muvaiu nuk pa nga banorët e Medinës interesim për agjërimin e ditës së Ashurës, për këtë arsye edhe ka pyetur për dijetarët e Medinës apo se Muvaiu kishte dëgjuar për disa që e urrenin agjërimin e Ashurës apo për disa të cilët mendonin se është obligim agjërimi i saj⁴⁷”.

⁴³ Kastalani, Ahmed bin Muhamed, “Irshadus-Sarij Li sherh Sahihil-Buharij”, Egjipt: El Matba el-Kubra el Umejrije, 1323 h 3/345.

⁴⁴ Shiko: “Irshadul- Fuhul ila tahkikil-haki min ilmil- usul” të Shevkanit, rec. Ahmed Azv Inaje, Damask, Darul kitab el-Arabij, 1999, fq. 153.

⁴⁵ Kadij Ijad, “Ikmalul- Mu’lim”, 4/81.

⁴⁶ El Kurtubiu, “El-Mufhim”, 3/192.

⁴⁷ Ibn Haxher, “Fet’hul Barij”, 6/535.

Problematika e tetë

Si është e mundur që ngjarjen e Ashurës, e cila ka ndodhur në fillim të hixhretit, ta transmetonte Ibën Abasi r.a., i cili në atë kohë ishte në moshën trevjeçare?

Përgjigja: Këtë metodë transmetimi dijetarët e njohin si ‘mursel es-sahabij’, kur sahabi transmeton nga Pejgamberi a.s. atë që nuk e ka dëgjuar nga ai apo nuk e ka parë, qoftë për shkak të moshës së tij të vogël, qoftë për shkak të mungesës së tij. Ky lloj hadithi merr gjykimin si hadith i lidhur ngase transmetohet nga sahabi, ndërsa mosnjohja e sahabit nuk e dëmton zinxhirin e transmetimit ngase të gjithë sahabët pa dallim janë të besueshëm⁴⁸. Ibën Haxheri thotë: “Hadithologët janë unanimë se mursel es-sahabij merr gjykimin e hadithit mevsul- të lidhur e të pashkëputur⁴⁹”.

⁴⁸ Ibn Salah, Uthman bin Abdurrahman, “Mukadimet ibn Salah”, rec Nurudin Itri, Siri Darul Fikr, dhe botimi tjetër, Bejrut: Darul fikr el Muasir, 1986, fq. 56.

⁴⁹ Ibn Haxher, “Hedjus-Sarij”, 2/285.

Conclusions

After briefly presenting the hadiths of Ashura, it became clear that the hadiths of fasting on the day of Ashura are accurate and proven hadiths, the whole ummah is unanimous that they are accepted and that we act upon. It has become clear to me, that all the problems mentioned, towards the hadiths of Ashura, while in they are not real but only perceived as such, and the issues are not based on arguments. It became clear, that there is authenticity of these hadiths and their compatibility with each other with a precise scientific methodology, built on scientific arguments and grounds.

Of course, the treatment of the topic of Ashura can be even broader, there may be other things that need to be known about the day of Ashura both in the practical-fikh aspect of fasting this day, or in the historical one, because of some very important events that have occurred on this day, or even in terms of some practices and customs practiced on this day. But, due to the limitation of this paper, I hope that even more elaborated arguments related to the Day of Ashura will be put forward in future papers.

Literatura:

1. Abdurreuf el Munavij, Et-Tejsir bi sherh el-Xhamis-Sagir, Rijad, Mektebet el Imam Esh-Shafij, 1998.
2. Ahmed Atijetullah, El Kamus Islamij, Mektebet en-Nehdatul-Misrij, pa vit botimi.
3. Ahmed bin Abdurrahman, Bulugul Emanij min esrar el-fet'h err-Rrabanij, rec. Hasan Abdulmenan, Bejtul efkar ed-devlije.
4. Ahmed bin Alij, "Ibn Haxher" el-Askalanij, Fet'hul Barij sherh Sahih el-Buharij, rec. Muhibudin el-Hatib, Bejrut, Darul Ma'rife, 1379h.
5. Ahmed bin Hanbel, Musned Ahmed bin Hanbel, rec. Shuajb Arnaut, Bejrut, Mueseset err-Rrisale, 2001, dhe botimi tjetër, rec. Ahmed Shakir, Kajro, Darul-Hadith, 1995.
6. Ahmed bin Muhamed el-Fejumi, El Misbahul Munir fi Garibish-sherhilkibir, Bejrut, El-Mektebetul-ilmije, pa vit botimi.
7. Ahmed bin Muhamed el-Kastalanij, Irshadus-Sarij li sherhi Sahihil Buhari, Egjipt, El Matba el-Kubra el Umejrije, 1323 h.
8. Ahmed bin shejh El-Kurtubij, El- Mufhim lima eshkele min telhil kitab Muslim, pa vit botimi.
9. Ahmed bin Shuajb en-Nesaij, es-Sunen el-Kubra, rec. Hasen Abdul Munim Shelebij, me mbikëqyrje të shejh Shuajb Arnautit, Bejrut, Mueseset err-Rrisale 2001.
10. Ali Abdulvahid Vafij, Buhuthun fil- Islami vel Ixhlima, Egjipt, Dar Nehdat Misr lit-tiba ven-neshr, 2016.
11. El Bjerunij Muhamed bin Ahmed, El-Athar el Bakije anil Kurunil Halije, pa rec.
12. Esh-Shevkanij Muhamed bin Ali, Irshadul fuhul ila tahkikil haki min ilmil usul, rec. Ahmed Azv Inaje, Damask, Darul kitab el-Arabij, 1999.
13. Ez-Zebidij Muhamed bin Muhamed, Taxhul- Arus min xhevami-il-kamus, grup rec., Darul Hidaje, pa vit botimi.
14. Fejruz Abadij Mexhdudin, El-Kamus el-Muhit, Bejrut: Muesseset err-Rrisale, 2005.

15. Ibn Ethiri, Mexhdudin Ebus-Seadat, En-Nihajetu fi garibil-Hadith, rec. Tahir Ahmed ez-Zavij dhe Mahmud Muhamed et-Tanahij, Bejrut, El Mektebetul-ilmije, 1979.
16. Ibn Huzejme Muhamed bin Is'hak, Sahih ibn Huzejme, rec. Muhamed Mustafa el-Adhamij, bot 3, 2003.
17. Ibn Mendhur Muhamed bin Mukrim Ebul Fadl, Lisanul Arab, Bejrut, Dar Sadir, 1414 h.
18. Ibn Rexheb Zejnudin Abdurrahman, Letaiful- Mearif, Bejrut, Dar ibn Hazm, 2004.
19. Kadij Ijad bin Musa, Ikmalul Mu'lim bi fevaid Muslim, rec. Jahja Ismail, Egjipt, Darul Vefa, 1998.
20. Muhamed bin Ali el-Mazirij, El-Mu'lim bi fevaid Muslim, rec. Muhamed Esh-Shadhilij, Algjeri, Ed-Dar et-Tunisije dhe Muesesetul Vatanije lil Kitab, 1998.
21. Muhamed bin Ebubekër "Ibn Kajim", Zadul Mead Fi Hedji Hajril-Ibad, rec Shuajb dhe Abdulkadir Arnaut, Bejrut, Mueseset err-Risale, 1994.
22. Muhamed bin Hasen Ibn Durejd, Xhemheretul-lugati, rec. Remzi Munir Balebekij, Bejrut, Darul ilm lil melajin, 1987.
23. Muhamed bin Ismail "Buhariu", El-Xhamiul Musned es-Sahih el Muhtesar, rec. Muhamed Zuhejr, Dar Turuk en-Nexhat.
24. Muhamed Nasirudin Albani, Silsilet el-Ehadith ed-Daife, Riad, Mektebet el Mearif, 1992.
25. Muhjidin Jahja bin Sheref, En-Nevevij, El Minhaxh sherh Sahih Muslim bin Haxhaxh, pa rec, Bejrut, Daru Ihjaut-turath el-arabij, pa vit botimi.
26. Muslim bin Haxhaxh en-Nejsaburij, El-Musned es-Sahih el Muhtesar, "Sahih Muslimi", rec. Muhamed Fuad AbdulBakij, Bejrut, Dar Ihjaut-turath el-Arabij 1436 h.
27. Tekijudin Ahmed Abdulhalim "Ibn Tejmije", Iktidaus-siratil Mustekim, rec. Nasir Abdulkerim el-Akl, Bejrut, Daru alemil kutubi, 1999.
28. Uthman bin Abdirrahman "Ibn-Salah", Mukadimet ibn Salah, rec Nurudin Itri, Siri Darul Fikr, dhe botimi tjetër, Bejrut, Darul fikr el Muasir 1986.

Dr. Ajni SINANI

INSTITUCIONI I FETVASË DHE I MYFTIUT

Abstrakt

Çdo sjellje në kundërshtim me kërkesën e përmbajtur në normën shariatike paraqet shkelje të rendit të caktuar nga Zoti, që në raport me shkelësin manifestohet si mëkat. Me qëllim që të rregullonin sjelljet e tyre brenda mësimave islame, besimtarët e pyesnin Pejgamberin a.s. për çështje të ndryshme dhe ai u jepte shpjegimet e nevojshme.

Fetvaja është interpretim i ligjit ose fesë. *El-iftau* (fetvaja) interpretohet si dhënie e mendimit shariatiko-juridik nga myftiu ndaj pyetjes së shtruar, ose qartësim i një norme të caktuar pa ndonjë pyetje parapake, apo sqarim i normës së shariatit në lidhje me rastin e veçantë në bazë të konsultimit me literaturën klasike, ose përgjigje ndaj rastit të ri. Në shkencën juridike fetvaja është njoftim (*el-ihbar*) për vullnetin e Allahut, përkatësisht normën (*el-hukm*), e dhënë në bazë të provave/dëshmimeve të shariatit, e shqiptuar pas pyetjes së parashtruar.

Myftiu i parë është i Dërguari i Zotit, Muhamedi a.s., prandaj shërbimi i myftiut është një nga shërbimet më të vjetra në Islam dhe si i tillë është aktual dhe i rëndësishëm edhe në ditët tona. Ligjvënësi ua ka lënë atyre që janë të specializuar për t'u marrë me lëshimin e vendimeve ligjore-fetvave. Me ardhjen e Islamit në hapësirat tona, vendosen njerëz të ditur në rang të myftinjve me qëllim të lëshimit

të fetvave. Myftiu është ekspert në njohjen e normave të të Lartësuarit dhe ekspert për argumentet/provat e sheriatit. Esh-Shatibi thotë: "Myftiu përfaqëson të Dërguarin e Zotit brenda bashkësisë së tij".

Fjalët kyçe: *Allah, Pejgamber, mysliman, shariat, fetva, myfti, sahabë, tabiinë, ulema, El Karafi, Ibn Ashur, kadi, muxhtehid, medhheb.*

Hyrje

Sheriati përfshin normat e natyrës fetare, etike dhe juridike dhe paraqet bazën për formimin e një sistemi juridik. Funkcioni i interpretimit të rregullave të sheriatit (*ifta*) ka qenë dhe është i një rëndësie të madhe në historinë e myslimanëve. Ky funksion i interpretimit, ndonëse në kushte dhe rrethana të ndryshme gjatë historikut të tij, është aktual dhe ruan atë rëndësi edhe sot. Përmbajtja e këtij funksioni është dhënia e interpretimeve mbi çështjet e besimit islam, të drejtën dhe moralin me kërkesë të individëve ose organeve të interesuara. Fetvaja është interpretim i ligjit ose fesë. Në varësi të statusit që gëzon Islami në një shtet, kjo rrethanë ndikoi nëse një fetva do të kishte pasoja vetëm në jetën private dhe sjelljen e një individi apo edhe në rrjedhën e jetës shoqërore. Statusi i Islamit, përveç kësaj, ndikon në statusin shoqëror të interpretuesve të tij. Në dritën e këtyre rrethanave do të ofrojmë një pasqyrë të përgjithshme të përmbajtjes së fetvasë si dhe rolit shoqëror dhe ndryshimeve të shërbimit të myftinisë të ne.

1. Institucioni i fetvasë

Ligji islam është universal për shkak se është i zbatueshëm në të gjitha kohët, në të gjitha shoqëritë e për të gjithë njerëzit, siç thuhet në shumë ajete kuranore dhe hadithe¹. Ligjet e shpallura hyjnore janë vendosur të tëra për të ruajtur interesat e njerëzve në këtë jetë dhe jetën që vjen². Ky është qëllimi i sheriatit. Çdo sjellje në kundërshtim me kërkesën e përmbajtur në normën sheriatike paraqet shkelje të rendit të caktuar nga Zoti, që në raport me shkelësin manifestohet si mëkat. Që të arrihej të bëhej mënyra e jetesës që duhej pasuar, besimtarët e pyesnin Pejgamberin a.s. për çështje të ndryshme dhe ai u jepte shpjegimet e nevojshme. Në burime islame theksohet se besimtarët e pyetnin Pejgamberin a.s., kurse ai u jepte përgjigje deri në kohën para namazit të drekës. Në disa pyetje përgjigje jepte vetë Zoti³:

“Ata kërkojnë prej teje dispozita (fetva) për gratë. Thuaj: “Allahu do t’i shpjegojë rregullat për to...” (En Nisa: 127), dhe në ajetin:

“Kërkojnë përgjigjen tënde. Thuaju: “Allahu ju përgjigjet në çështjen e “kelale-s” (ai që nuk ka prindër, as fëmijë që ta trashëgojnë)...” (En Nisa, 176). Në këto ajete foljet *istefta* (pyeti) dhe *efta* (u përgjigj), në format *jesteftuneke* dhe *juftikum*) janë përdorur në kontekstin juridik.

Shejh Mahmud Sheltuti në parathënien e tij të përmbledhjeve të fetvave ka paraqitur dy mënyra për shpalljen e ajeteve kuranore. E para është se ajetet shpjegojnë dispozitat, pa u paraprirë nga pyetjet që as’-habët i kanë parashtruar Pejgamberit a.s.. Kurse e dyta është se ajetet janë shpallur pasi as’habët e kanë pyetur të Dërguarin e Allahut. Ai vazhdon e thotë: “Myslimanët e kishin bërë traditë që nga koha e zbritjes

¹ Ibn Ashur, Et Tahir, Mekasid esh Sheriah el islamijeh, f. 234, sipas: Auda, Jasser, Objektivat e ligjit islam, një udhëzues për fillestarët, AIITC, Tiranë, 2020, f. 73.

² Er Rejsuni, Ahmed, Objektivat e ligjit islam, Logos A, Shkup Prishtinë Tiranë, 2015, f. 19.

³ Karcic, Fikret, Studime për të drejtën e sheriatit dhe institucionet, Logos A 2015, Shkup, Prishtinë, Tiranë, f. 52.

së shpalljes e deri në ditët e sotme që ulemaja t'u jepnin shpjegime mbi dispozitat e fesë, duke i shpjeguar me metodën e Kuranit, kur nuk kishte paraprirë pyetja e pyetësit ose me metodën e shpjegimit pas pyetjes, e ato janë fetvatë⁴”.

Fetvaja (vendimi sheriatik) kryesisht ka kuptimin e nxjerrjes së konkluzionit fetar juridik në lidhje me një problem fetar⁵.

Termi *fetva* - shumësi *fetava* (*el-fetava*) dhe *fetavin* (*el-fetavin*) gjuhësisht domethënë mendim (sheriatik), juridik, fetva, vendim, kazuis-tikë. Po këtë domethënie ka edhe forma *futja*. Në këtë rast është me rëndësi të përmenden edhe dy forma foljore: *el-istifta* forma e dhjetë e foljeve me parafjalën *fi*, që do të thotë: të pyesësh për mendim (sheriatik) juridik, të pyesësh për mendim, të lutesh për këshillë (shpjegim, njoftim për diçka), dhe *efta* forma e katërt, e cila me parafjalën *fi* domethënë të shtrosh mendimin (sheriatik) juridik, të japësh shpjegim (këshillë), ndërsa me parafjalën *bi* domethënë të shtrosh mendimin (juridik), të deklaroresh për (diçka)...⁶

El-iftau domethënë dhënie e mendimit juridik (zgjidhje) për ndonjë pyetje, ndërsa gjuhësisht do të thotë shpjegim ose interpretim. *El-iftau*, sipas Ibn Mandhurit, rrjedh nga rrënja *f-t-j* në kuptimin e një të riu që është i fortë, me fuqinë e tij ngrihet dhe e tejkalon problemin. Sipas kësaj, myftiu është ai që e mbizotëron ose e tejkalon problemin me shpjegimin e tij dhe ai problem bëhet i zgjidhur dhe i tejkaluar⁷.

Kuptimi themelor: Në fjalorin “Lisan el-Arab”, *el-iftau* interpretohet si: dhënie e shpjegimit për diçka, dhënie e mendimit sheriatiko-juridik për ndonjë çështje. *Istifta* do të thotë të kërkosh dhe të hetosh

⁴ Shih: Hasani, Mustafa, *Opći pogled na instituciju fetve i muftije u šerijatskom pravu*, Usul-i-fikh, Hrestomatia, përgatiti: Ljavaković, Enes, Sarajevo, 2005., f. 354.

⁵ Karaman, Hayreddin, Historia e së drejtës islame nga fillimi deri në kohën tonë, Logos A, Shkup Prishtinë Tiranë, 2004, f. 102.

⁶ Muftic, Teufik, Arapsko-srpskohrvatski rjecnik, II, Sarajevo, 1973, f. 2555- 2556.

⁷ Hasani, Mustafa, *Opći pogled na instituciju fetve i muftije u šerijatskom pravu*, Usul-i-fikh, hrestomatia, op. cit., f. 353.

mendim sheriatik juridik, kurse *efta-l-myfti* do të thotë u përgjigj myftiu për ndonjë pyetje. Kjo është gjithashtu edhe terminologji kuranore, që shihet nga ajeti: **“Kërkojnë prej teje (Muhamed) përgjigje - fetva për (çështjen) ...”** *jesteftuneke ... (En Nisa: 127)*. Fetva, pra, është mendimi i juristit të sheriatit për ndonjë pyetje⁸.

Fetvaja fjalë për fjalë do të thotë vendim apo verdikt fetar apo siç thotë Esh-Shatibi: “Përgjigje juridike ndaj një pyetjeje që e jep një ekspert (myfti), qoftë me fjalë, vepra ose miratim.” Prandaj, fetvaja duhet së pari të bazohet në burime dhe së dyti mbi konkluzionet juridike që kanë nxjerrë muxhtehidët duke bërë ixhtihad, kur burimet nuk japin tekstin përfundimtar dhe të qartë, *katti*, por është *dhanni* ose kur nuk ka tekst të zbatueshëm⁹.

Fetvaja është përgjigje e myftiut ndaj pyetjes së shtruar ose qartësim i një norme të caktuar pa ndonjë pyetje apo sqarim i normës së sheriatit në lidhje me rastin e veçantë në bazë të konsultimit me literaturën klasike ose përgjigje ndaj rastit të ri¹⁰.

Fetvaja është mendim juridik që e shqipton myftiu ose autoriteti i respektueshëm fetar juridik dhe paraqet përgjigjen ndaj pyetjes që ka parashtruar gjyqtari ose personi privat. Në bazë të "mendimit" të tillë, gjykatësi mund të vendosë për ndonjë mosmarrëveshje, kurse personi privat të drejtojë jetën e tij personale. Ky mendim duhet të përkojë saktësisht me ndonjë zgjidhje të mëparshme të vërtetuar, sepse myftiu nuk mund të marrë vendime në bazë të mendimit personal.

Në një shtet ku do të sundonte e drejta islame, këto vendime do të kishin mbështetjen e pushtetit shtetëror dhe do bëheshin pjesë e ligjit të

⁸ Džadulhak, Džadulhak Ali, *Izdavanje šerijatsko-pravnih mišljenja - fetvi*, Islamka misao, godina VII, n. 73, januar, Starjesinstvo Islamske zajednice Bosne i Hercegovine, Hrvatske i Slovenije, Sarajevo, 1985, rabiul-ahir - džumadel-ula, 1405, f. 9.

⁹ Ramadan, Tariq, *Të jesh mysliman evropian*, Logos A, Shup, Prishtinë, Tiranë 2011, f. 143.

¹⁰ Ez Zuhajli, Vehbe Mustafa, *Kompetencije za izdavanje fetvi*, shih: *Ustanova fetve u globaliziranom svijetu (Al iftau fil alem meftuh)*, Međunarodni centar za srednji islamski put u Kuvajtu, Sarajevo, El-Kalem, 1453/2013, f. 12.

atij vendi. Por sot pothuajse të gjitha vendet e kanë ngushtuar fushën e së drejtës islame, kështu që fetvatë zbatohen vetëm kur bëhet fjalë për martesën, trashëgiminë ose divorcin¹¹.

Në të drejtën e sheriatit fetvaja përdoret në kuptimin e përgjigjes nga fusha e së drejtës së sheriatit. Në shkencën juridike fetvaja është njoftim (*el-ihbar*) për vullnetin e Allahut, përkatësisht normën (*el-hukm*), e dhënë në bazë të provave/dëshmimeve të sheriatit, e shqiptuar pas pyetjes së parashtruar. El-Karafi thotë se fetvaja është njoftim për normën e Allahut të shprehur në formën e obligimit dhe të lejimit¹².

Fetvaja sipas natyrës së saj ligjore ishte njoftim për përmbajtjen e dispozitës islame dhe jo gjithmonë është aplikuar nga personi që ka kërkuar këshilla. Fetvaja nuk ka karakter të detyrueshëm në kuptimin praktik sepse ai që ka kërkuar një mendim juridik mund të pyesë një ekspert tjetër për çështjet juridike dhe të veprojë sipas mendimit të tij.

Ndërkaq, nëse fetvaja është e qartë, në kuptimin që nuk ka mendime të tjera, atëherë ajo në kuptimin fetaro-moral është e obligueshme sepse Allahu xh. sh. thotë: “... *pyetni ata që dinë nëse ju nuk e dini.*” (*En Nahl: 43*)

Fetvaja gjithashtu është e obligueshme nëse personi që parashtron pyetje është pasues i medhhebit të cilin e pason edhe vetë personi që ka dhënë fetvanë¹³.

Fetvaja, të cilën e përbëjnë përgjigjet për ndonjë çështje fetare dhe çështje juridike, ka një vend të veçantë në funksionimin e së drejtës islame. Fetvaja është në të vërtetë zbatim në lëmin e drejtësisë sipas parimit të këshillimit, që në përgjithësi rekomandohet në Islam, dhe që është i pranishëm nga kohët më të hershme.

¹¹ Smailagić, Nerkez, *Leksikon islama*, Svjetlost, Sarajevo, 1990, f. 186.

¹² Hasani, Mustafa, *Opći pogled na instituciju fetve i muftije u šerijatskom pravu*, Usuli-fikh, Hrestomatia, op. cit., f. 354.

¹³ Ez Zuhajli, Vehbe Mustafa, *Kompetencije za izdavanje fetvi*, op. cit., f. 12.

Omeri r.a. formoi në Medinë këshillin e përbërë nga shtatë juristë. Ai këshill ishte një instancë së cilës mund t'i drejtohej çdo individ, duke përfshirë edhe kadiun e Medinës, gjatë zgjidhjes së problemeve juridike. Kalifi Omer r.a. i ndaloi anëtarët e këshillit që të largoheshin nga Medina në mënyrë që të mund të konsultohesh për çështje juridike sa herë ishte nevoja¹⁴.

2. Institucioni i myftiut

Shërbimi i myftiut është një nga shërbimet më të vjetra në Islam dhe si i tillë është aktual dhe i rëndësishëm edhe në ditët tona. Ligjvënësi ua ka lënë atyre që janë të specializuar për t'u marrë me lëshimin e vendimeve ligjore-fetva. Personi që pyet për fetvanë është *mustefti* (*el-mustefti*), ndërsa personi nga i cili kërkohet përgjigje është myfti (*el-mufti*)¹⁵.

Me ardhjen e Islamit në hapësirat tona vendosen njerëz të ditur në rangun e myftinjve me qëllimin e lëshimit të fetvave. Ishte i paimagjinueshëm shërbimi i kadillëkut pa myfti apo një komunitet mysliman i organizuar pa një person (myfti), që do t'ia interpretonte disa çështje fetare myslimanëve në frymën e rrethanave të reja të asaj gjenerate¹⁶.

Në kohën e Pejgamberit a.s. personat e tillë janë emëruar si: dijetarë (*alim*), juristë (*fakih*), mendimtarë (*dhu rej'*). Më vonë atyre që kanë dhënë fetva u është thënë myfti. Në mesin e obligimeve dhe funksioneve të Pejgamberit a.s. ka qenë dhënia e fetvasë. Pejgamberi a.s. ka qenë burim që ka informuar për vendimet fetare, kurse as'habët ose i kanë përcjellë fetvatë e tij a.s. ose kanë vendosur në bazë të përpjekjeve të

¹⁴ Hamidullah, *Hukuk Ilmi*, str. 121. Vidi: *Fetva i veza između fetve i kadiluka, Historija Osmanske države i civilizacije*, pergatiti: Ihsanoglu, Ekmeleddin, Orijentalni institut u Sarajevu, Sarajevo, 2004, f. 559.

¹⁵ Hasani, Mustafa, *Opći pogled na instituciju fetve i muftije u šerijatskom pravu*, Usul-i-fikh, hrestomatia, op. cit., f. 353.

¹⁶ Muharem Omerdic, Pir Muhamded El Uskubi i njegov zbornik fetvi, shih: <http://isamveri.org/pdfdkm/16/DKM160193.pdf>

tyre personale intelektuale, por më vonë ia kanë prezantuar Pejgamberit a.s. dhe ai ka dhënë vlerësimin e tij për atë fetva se është e saktë apo jo¹⁷.

Prej sahabëve që kanë dhënë fetva në kohën e Pejgamberit a.s. janë: Ebu Bekri, Omeri, Othmani, Aliu, Ubej bin Kabi, Muadh b. Xhebeli, Zejd b. Thabiti, Abdurrahman b. Avfi, Ammar b. Jasiri, Hudhejfe b. Jemani, Ebu Derda, Ebu Musa el Eshariu, Ibn Mesudi, Ubade b. Es Samiti (radijAllahu anhum). Fetvatë që kanë dhënë as'habët në këtë periudhë janë bërë në vendet ku nuk ka qenë Pejgamberi a.s. ose si pasojë e procesit të tyre edukativo-arsimor. Më vonë fetva kanë dhënë dijetarë (fakihë) të ndryshëm¹⁸.

Juristi, myftiu duhet të njohë gjendjen e pyetësve dhe të sillet me ta siç sillet psikiatri me pacientët. Ata gjithsesi duhet t'i besojnë atij e të çlodhen tek ai, qenien e tyre duhet tërësisht t'ia dorëzojnë dhe t'i shpallin mendimet e fshehta që bartin në gjokset e tyre¹⁹.

Në mënyrë që një jurist të mund të nxjerrë fetvatë, nuk duhet që atë kompetencë t'ia japë ndonjë autoritet qendror, siç ishte rasti me emërtimin e kadilerëve. Mjaftonte që të kishte arsimim në fushën e së drejtës (fikhut). Fetvatë që kanë dhënë myftinj të nuk i kanë obliguar kadilerët, por gjithnjë kishin një vend të rëndësishëm në proceset juridike.

Kadilerët²⁰, në situata kur nuk ishin në gjendje të jepnin interpretime, kanë ndier nevojën që të këshilloheshin me myftiun, i cili i ndihmonte që të caktonin parimet juridike për kontestin që duhet të zgjidhnin. Në kohën kur në sistemin e drejtësisë nuk ka ekzistuar apelimi si pjesë përbërëse dhe obliguese e saj, vetë prania e myftiut, të cilit palët në kontest gjithmonë mund t'i drejtoheshin, madje edhe në

¹⁷ Hayreddin Karaman, op. cit., f. 102.

¹⁸ Ibid, f. 102.

¹⁹ El Kardavi, Jusuf, Fetva bashkëkohore, ShB Furkan ISM, Shkup 1424 h. 2003, f. 34.

²⁰ Pejgamberi a.s. ka thënë: "Asnjë gjykatës nuk duhet të japë vendime kur është i zemëruar." (Muttefekun alejh), shih: Er Rejsuni, Ahmed, Objektivat e ligjit islam, Logos A, Shkup Prishtinë Tiranë, 2015, f. 36.

zonat që ishin larg qendrës, kadiun e detyronte të respektonte parimet juridike. Në kuptim të caktuar, të gjitha vendimet e marra nga kadiu gjithmonë mund t'i nënshtrohen kontrollit të myftiut²¹.

Ndryshe nga dhënia e fetvasë nga myftiu, aktgjykimi i gjykatës i obligon të gjithë, pavarësisht nga përkatësia e medhhebit. Vendimi i gjykatës shqiptohet nga gjyqtarët në mënyrë që të gjykojnë palët në mosmarrëveshje dhe është i zbatueshëm dhe i detyrueshëm²².

Vendimi i kadiut sipas karakterit të tij përfaqësonte dhënien e së drejtës dhe zbatimin e saj nën kërcënimin e sanksionit. Individidi që refuzonte të vepronte në përputhje me fetvanë, e cila ishte në përputhje me sheriatin, do të ishte nën goditjen e sanksioneve juridiko-penale (*ta'zir*) dhe në disa raste mund të konsiderohej si i dalë nga feja (*murted*).

Fetvaja, e cila do t'i referohej rastit që ishte në shqyrtim te kadiu, nuk e ka obliguar në çdo rast atë kadi për shkak se myftiu e sjell fetvanë në bazë të fakteve që paraqesin palët, kështu që zbatueshmëria e fetvasë në rastin konkret varet nga koincidenca e fakteve të paraqitura me gjendjen e vërtetë. Kadiu që refuzonte aplikimin e fetvasë, e cila ishte në përputhje me sheriatin dhe që i përgjigjej gjendjes së vërtetë të rastit që zgjidhej, mund të ndërrohej²³.

²¹ Er Rejsuni, Ahmed, op. cit., f. 559.

²² Ez Zuhajli, Vehbe Mustafà, *Kompetencije za izdavanje fetvi*, op. cit., f. 12.

²³ Karčić, Fikret, *Opšti pogled na istorijat muftijske službe kod nas*, shih: Takvim, Presedništvo udruzenja islamskih vjerskih sluzbenika u SRBiH, Sarajevo, 1987, f. 113-126.

3. Historiku i institucionit të myftiut

Myftiu i parë është i Dërguari i Zotit, Muhamedi a.s..²⁴ Dhënia e fetvasë është një nga funksionet e të Dërguarit të Zotit a.s. në kuadër të detyrës së tij të komunikimit të shpalljes dhe sqarimit të asaj me çka Allahu xh.sh. e ka obliguar: “*Ne ty të shpallëm Kuranin për t’u shpjeguar njerëzve atë që i është shpallur atyre ...*” (En Nisa, 105). Nga funksionet që ka kryer i Dërguari i Zotit a.s. juristët theksojnë si vijon:

- a) komunikimi i shpalljes së Zotit (*et-teblig*) i dedikuar për të gjithë myslimanët (*el-ummeh*);
- b) udhëheqja e shoqërisë (*el-imameh*), që i përket bashkisë myslimane të asaj kohe;
- c) gjykimi (*el-kada*), ku i Dërguari i Zotit paraqitet në funksionin e gjyqtarit dhe me të e zgjidh rastin konkret;
- d) dhënia e fetvasë (*el-ifta*), për të cilën ka dhënë shpjegime, gjithashtu, për një rast konkret²⁵.

Këtu është e nevojshme të bëhet dallimi midis funksionit të tij të komunikimit të shpalljes (*et-tablig*) dhe dhënies së fetvasë (*el-ifta*), ndryshe nga dy funksionet e tjera (*el-imameh* dhe *el-kada*), të cilat në metodologjinë e së drejtës islame nuk llogariten në Sunetin normativ (*es-sunnah gajr et-teshri jje*).

Si gjykatës, i Dërguari i Zotit bën gjykimin, i cili mund të jetë vetëm një e drejtë ligjore, por jo domosdoshmërisht edhe e drejtë reale, krejt kjo në varësi të fuqisë së provave të paraqitura dhe aftësive të palëve para gjyqit në mënyrën e prezantimit, gjegjësisht mbrojtjes²⁶. Si

²⁴ Handžić, Hadži Mehmed, *Pitanje muftija*, Glasnik, br. 23, Islamske verske zajednice Kraljevine Jugoslavije, Sarajevo, 1936, f. 47.

²⁵ Hasani, Mustafa, *Opći pogled na instituciju fetve i muftije u šerijatskom pravu*, vidi: *Usulifikh*, Hrestomatia, op. cit., f. 363.

²⁶ Pejgamberi a.s. gjatë vendosjes për çështje të caktuara ka theksuar se ai bazohet në provat objektive. Kjo shihet nga fjalët që ka thënë Pejgamberi a.s.: “Unë jam njeri si ju. Ju i sillni rastet tek unë, ndoshta njëra palë i parashtron provat në trajtën më të besueshme se tjetra dhe si pasojë unë vendos në favor të tyre. Nëse unë vendos për njërën palë dhe ajo nuk e ka të drejtë

imam i Dërguari i Zotit a.s. ishte kreu i shtetit, udhëhiqte punët e shoqërisë, që paraqet fushën e gjykimit të tij personal²⁷.

Myftiu është person që u jep përgjigje personave të interesuar dhe se gjatë asaj nuk kushtëzohet që ai të jetë në shkallën e ixtihadit. Myftiu mund të jetë muxhtehid, por edhe pasues (*el-mukalid*) i njërit nga paraardhësit²⁸.

Dijetari që konsiderohet i kualifikuar për të nxjerrë të drejta nga burime të njohura quhet muxhtehid, kurse rezultati i përpjekjes së tij intelektuale mendim ligjor ose fetva. Myftiu është ekspert në njohjen e normave të të Lartësuarit dhe ekspert për argumentet e sheriatit.

Allahu i Plotfuqishëm ka urdhëruar këdo që nuk e njeh normën e sheriatit që të kërkojë mendimin juridik (fetvanë) nga dijetarët kompetentë dhe të besueshëm, të cilët u përmbahen kufijve të Allahut, nga ata që kanë frikë-respekt ndaj urdhrave dhe dispozitave të Tij²⁹.

Esh-Shatibi thotë: “Myftiu përfaqëson të Dërguarin e Zotit brenda bashkësisë së tij. Ka shumë argumente që e mbështesin këtë qëndrim:

- Së pari, ekziston hadithi: “Në të vërtetë, alimat janë trashëgimtarë të Pejgamberit, e ajo që trashëgohet nga i Dërguari nuk është dinar e as dërhëm, por dija (*ilmi*).” Transmetojnë Ebu Davudi dhe Et Tirmidhiu³⁰.
- Së dyti, myftiu është medium me anë të të cilit përcillen rregullat (*ahkam*) sipas fjalëve të të Dërguarit të Zotit: “Të pranishmit t’ua

atë, le të mos e marrë, se i kam dhënë një copë zjarri në dorë.” Shih: Karaman, Hayreddin, op. cit., f. 101.

²⁷ Hasani, Mustafa, *Opći pogled na instituciju fetve i muftije u šerijatskom pravu*, shih: *Usulifikh*, Hrestomatia, op. cit., f. 364.

²⁸ Ibid, f. 364.

²⁹ Ez Zuhajli, Vehbe Mustafa, *Kompetencije za izdavanje fetvi*, op. cit., f. 12.

³⁰ Shih: El ulemau verethetul enbijai, Daru Iftai el Misrije, https://www.aliftaa.jo/Article.aspx?ArticleId=117&fbclid=IwAR00noRyrPJRqrsX8jURB_YPSdGzbtbIbqtcBrrOGZxLZb7RbIa-5GZQyT9E#.YBe4njFKj3h

përcjellin atyre që mungojnë...”³¹ dhe “Transmetoni prej meje, edhe sikur të ishte vetëm një ajet.” Transmeton Buhariu³². Meqë është kështu, atëherë do të thotë se myftiu përfaqëson të Dërguarin e Zotit.

- Së treti, myftiu është një lloj ligjvënësi pasi ajo që thotë për shëriatin është dhënë nga Ligjvënësi (përmes shpalljes ose Sunetit) ose është nxjerrë nga burimi³³”.

Myftiu është trashëgimtar i të Dërguarit a.s. në kryerjen e detyrave të interpretimit të qartë të dispozitave. Këtë obligim me përgjegjësi pas vdekjes së të Dërguarit a.s. e kanë marrë as’habët fisnikë r.a. dhe pas tyre ulemaja. A ka nder dhe njohje më të madhe për myftiun sesa në emër të Allahut t’i lajmërojë njerëzit për dispozitat dhe se me mënyrën e komunikimit të tyre ai pason të Dërguarin më të përzgjedhur a.s.!³⁴

Imam Neveviu duke folur për fetvanë nënvizon: “Dije se në shqipërimin e fetvasë është nder i madh, por edhe sfidë e madhe. Myftiu është trashëgimtar i të Dërguarit a.s. dhe në këtë mënyrë e kryen *fardi-kifaje* (obligimin kolektiv), prandaj thuhet që myftiu “nënshkruan në emër të Allahut xh.sh., duke u ekspozuar ndaj mundësisë së gabimit³⁵”.

Është e domosdoshme që personi i cili dëshiron të shkelë në këto ujëra të jetë i aftë për gjykim dhe ixhtihad për shkak të rëndësisë së studimit të dispozitave të shëriatit dhe jetës së myslimanëve. Interesat e njerëzve bazohen në këtë dhe mbi këtë bazë ata gjejnë udhëzime në çështjet që lidhen me këtë dhe botën e ardhshme³⁶.

³¹ Hutab en nebij salaAllahu alejhi ve selem fi haxhetil vedai, shih: <https://ar.islamway.net/article/>

³² Sherhu Hadith “Beligu ani ve lev ajeh...”, shih: <https://islamic-content.com/hadeeth/501>

³³ Ramadan, Tariq, Të jesh mysliman evropian, op. cit., str. 18.

³⁴ Džum’a, Ali, *Promjene fetve zbog promjene jedne od četiri okolnosti*, shih: *Ustanova fetve u globaliziranom svijetu (Al-iftau fil-alem meftuh)*, op. cit., f. 116.

³⁵ Ibid, str. 116.

³⁶ Ali, El Kahtani, Musfir b., *Princip olakšavanja u izdavanju fetvi, obilježja i pravila*, shih: *Ustanova fetve u globaliziranom svijetu (Al-iftau fil-alem meftuh)*, op. cit., f. 71.

Myftiu, përveç arsimimit në të drejtën e sheriatit dhe në disiplina të tjera "fetare dhe botërore" dhe njohuri të tjera, duhet që gjatë dhënies së fetvasë të tregojë tërë aftësinë e tij, talentin, perceptimin, mprehtësinë dhe zgjuarsinë e mendjes, mundësinë e shtjellimit dhe t'i qaset në mënyrë kritike dhe analitike problemit. Gjegjesisht, jo çdo jurist (al-fakih) është myfti, ndërkaq çdo myfti është jurist³⁷.

Kompetenca e përgjithshme e myftiut është shpjegimi i dispozitave të sheriatit. Në përputhje me kuptimin e sheriatit si rrugë e jetës së duhur që duhet të ndjekë një ndjekës i Islamit, funksioni i myftiut nuk i përket vetëm interpretimit të çështjeve ligjore, por edhe i atyre që kanë të bëjnë me besimin, moralin, higjienën personale, zakonet shoqërore etj.. Meqenëse Islami në shtetin osman kishte statusin e një feje shtetërore, kurse e drejta e sheriatit forcën detyruese, fetvatë kanë përfaqësuar mbikëqyrjen legjitime ndaj akteve të autoriteteve publike dhe sjelljeve të individëve³⁸.

Myftinj të ne në kohën gjatë sundimit osman i përkisnin kategorisë të myftinjve krahinorë (kenar muftileri). Ata ishin myftinj në vendet më të mëdha ku Shejhu-I-slami kishte lëshuar autorizimin (*menshurën*) për të kryer funksionin e shpjegimit të sheriatit.

Pasi për shërbimet e tyre nuk kanë marrë paga, zakonisht kanë kryer funksionin e myderrizit në medresenë lokale. Në praktikë ishte e përhapur që për fetvanë e lëshuar me shkrim të jepej kompensim, shpeshherë minimal. Në parim, shërbimi i myftiut kryhej për tërë jetën, por ishte i mundur ndërrimi nga funksioni³⁹.

E drejta e sheriatit ndjek lëvizjet shoqërore dhe u përgjigjet sfidave dhe nevojave të individit dhe shoqërisë. Në këtë kuptim, detyra e mu-

³⁷ Hasani, Mustafa, *Opći pogled na instituciju fetve i muftije u šerijatskom pravu*, shih: Usulifikh, Hrestomatia, op. cit., f. 368.

³⁸ Karčić, Fikret, *Opšti pogled na istorijat muftijske službe kod nas*, Takvim, op. cit., f. 114.

³⁹ Ibid, f. 114.

xhte hidit dhe e myftiut është të gjejë zgjidhje të përshtatshme në çdo kohë.

Në përputhje me këtë duhet të kuptohen debatet që janë zhvilluar, se a lejohet që për një kohë të caktuar të mos ketë muxhte hid, dome thënë person që është në gjendje që në bazë të burimeve ligjore të sjellë zgjidhje që u përgjigjen nevojave të jetesës së një kohe të caktuar, hapësirës dhe ambientit shoqëror.

Myftiu nuk mund ta kryejë detyrën e tij nëse nuk e njeh veprën në fjalë, nëse ajo trajtohet jashtë momentit të përgjithshëm shoqëror, ngjarjeve politike, ekonomike dhe ndodhive jetësore. Kështu, është e mundur që në një moment të caktuar një sjellje është në kundërshtim me interesin publik dhe në një tjetër moment një sjellje e tillë do të ishte shprehje e interesit publik⁴⁰.

Kur lëshon një fetva, është e nevojshme që myftiu të ketë parasysh pozicionin, kohën, vendin, kushtet si dhe personin në mënyrë që të mos shprehë mendimin e tij pa një pozicion të qartë për të⁴¹.

Koha dhe vendi janë përcaktuesit e çdo ngjarjeje. Kur themi se ka ndryshim të fetvasë me ndryshimin e kohës, vendit, rrethanave dhe zakoneve, atëherë kemi parasysh ndryshimin e mënyrës së jetës, ndryshimin e rrethanave shoqërore dhe ndryshimin e civilizimeve⁴².

Ndryshimi i fetvasë me ndryshimin e kohës dhe vendit është diçka që shumë dijetarë e kanë përmendur në veprat e tyre, si Ibn Kajimi dhe Karafi⁴³.

⁴⁰ Hasani, Mustafë, *Institucija fetve i služba muftije u šerijatskom pravu* (II dio), http://www.znaci.com/serijatsko_pravo/serijat/Institucija-fetve-i-sluzba-muftije-u-Serijatskom-pravu-II-dio.html

⁴¹ El Arebi, El Bešeri, *Polazišta fikha myslimanskih manjina u zemljama Zapada*, shih: *Srednji islamski put, društvene implikacije*, Sarajevo, El-Kalem, 1435. po H/ 2013. godine, f. 234.

⁴² Abdulgafar, Eš-Šerif Muhammed, *Obnovom fikskih propisa ka ostvarenju interesa myslimanskih manjina*, shih: *Srednji islamski put, društvene implikacije*, op. cit., f. 349.

⁴³ Bejja, dr. Abdullah b., *Standardi srednjeg puta u fetvama*, shih: *Zajednica srednjeg puta, teorija i praksa islamske umjerenosti*, knjiga 1, Sarajevo, El-Kalem, 1453. po h/ 2013. godine, f. 124.

Ulematë paralajmëruan për pasojat e këqija të dhënies së përgjigjeve pa dije. Historia e sahabëve dhe tabiinëve është plot me shpjegime dhe paralajmërime për përgjigje të gabuara, për shmangien e dhënies së zgjidhjeve ligjore si dhe udhëzime në dhënien e mendimeve⁴⁴.

Përkundër asaj se e drejta e sheriatit, në një masë më të madhe ose më të vogël, do të përbënte pjesë të sistemit të drejtësisë pozitive në rajonin tonë nga themelimi i administratës osmane e deri në fund të Luftës së Dytë Botërore, e madje edhe pas kësaj, pavarësisht nga mungesa e elementit normativ, përbërjet e saj paraqesin udhëzime për sjelljen e besimtarëve myslimanë, kanë munguar përpjekjet që të mundësohet një pasqyrë e zhvillimit historik të këtij institucioni dhe sistemit të drejtësisë, strukturës së saj dhe institucioneve më të rëndësishme. Njëra nga institucionet e pasqaruara në mënyrë jo të mjaftueshme është edhe institucioni i fetvasë dhe funksioni i saj gjegjësi i myftiut⁴⁵.

4. Myftinia si njësi organizative e Bashkësisë Islame

Fjala *myfti* është përkthyer nga gjuha arabe, që do të thotë: “autoriteti kryesor fetar që përfaqëson bashkësinë islame në çështjet e fesë në zonën e myftinisë”.

Myftinia është njësi organizative e Bashkësisë Islame me myftiun në krye. Detyrat e myftiut janë: dhënia e fetvasë, mbikëqyrja e zyrtarëve fetarë dhe të vakëfeve, mbikëqyrja e xhamive dhe objekteve të tjera fetare⁴⁶.

Në të njëjtën kohë myftinjët kanë intensifikuar funksionin e tyre të mbikëqyrjes të mësimbesimit fetar islam në shkolla dhe punën e med-

⁴⁴ Ebu Zejd, Vasfi Ašur Ali, *Riječ-dvije o obučavanju da'ije fekiha*, shih: *Zajednica srednjeg puta, teorija i praksa islamske umjerenosti*, knjiga 2, Sarajevo, El-Kalem, 1453. po h/ 2013. godine, f. 440.

⁴⁵ Karčić, Fikret, *Studije o šerijatskom pravu i institucijama*, op. cit., f. 38.

⁴⁶ Prekić, Adnan, *Islamska zajednica u Pljevljima*, shih: <http://www.bosanskehistorije.com/historija/36-etimologija/758-adnan-prekicislamska-zajednica-u-pljevljima>.

resesë, ruajtjen e moralit në mesin e popullatës myslimane (luftën kundër "martesave të egra", alkoolizmit, prostitucionit, etj.)⁴⁷.

Pozicioni i myftiut është shumë i përgjegjshëm dhe i ndershëm sepse këtë Zoti i të gjitha botëve ia ka atribuuar Vetes, siç shihet në ajetin: **“Ata kërkojnë prej teje dispozita (fetva) për gratë. Thuaj: “Allahu do t’i shpjegojë rregullat për to ...”** (En Nisa: 127)⁴⁸

Përveç myftinjve, të cilët ishin të caktuar me dekretin e Shejhu-l-islamit, në vende më të vogla mund të ishin individë të dekretuar si myfti ose kadiu i autorizuar lokal ka dhënë autorizim për dhënien e fetvasë. Një person i tillë në dokumente figuron si *medhun bil-ifta* (i autorizuar për të dhënë interpretime ligjore).

Edhe myftiu i parë dhe i dytë ishin të detyruar që t’i jepnin fetvatë sipas mësimëve të shkollës juridike hanefite sipas mendimit të shumicës (*mufta bihi el-kavl*). Gjithashtu, ata ishin të detyruar që në fetvatë e veta të tregonin burimet në të cilat ata e bazonin përgjigjen e tyre për pyetjen e ngritur (*nakl*).

Sipas praktikës osmane, fetvaja duhej të përmbante një përgjigje të qartë dhe jo dykuptimshme, kështu që në asnjë rast nuk e ka lënë në dilemë atë që ka kërkuar shpjegime. Pasi pyetja do të formulohej pa përmendur personat specifikë të përfshirë në situatë, myftiu do përgjigjej me “lejohej” (*olur*), ose “nuk lejohej” (*olmaz*)⁴⁹. Në atë kohë, fetvaja e myftiut kishte karakterin e interpretimit të së drejtës.

Myftiu, pas luftërave ballkanike, ka avancuar si myfti kryesor dhe imamët janë autorizuar që të zbatojnë ligjin e sheriatit për të drejtën personale dhe administrimin e pasurisë së vakëfit⁵⁰.

⁴⁷ Shih: http://cns.ba/wp-content/uploads/2014/03/fikret_karcic_studije_o_serijatskom_pravu.pdf, f. 327.

⁴⁸ Sedić, Fuad, *Poslanikove fetve*, El Kalem, Sarajevo, 1426/2005, f. 7.

⁴⁹ Karčić, Fikret, *Opšti pogled na historijat muftijske službe Bošnjaka*, op. cit., f. 113-126.

⁵⁰ Bamja, Menduh, *Pozita kushetuese-juridike dhe faktike e bashkësive fetare në ish Jugosllavi me veshtrim të vecantë të bashkësisë islame*, Prizren, 2009, f. 43.

Sipas Kushtetutës së Bashkësisë fetare Islame të Mbretërisë së Jugosllavisë nga 9 korrik 1930, neni 48, detyra e myfiut kryesisht është që:

- I. të nxjerrë fetvatë e zakonshme;
- II. t'u kushtojë vëmendje të plotë institucioneve kulturore dhe arsimore islame në territorin e myftinisë;
- III. të mbikëqyrë zyrtarët fetarë në shërbimin autonom dhe shërbimin shtetëror në territorin e vet dhe inspekton xhamitë dhe objektet e tjera fetare në kuptim të udhëzimeve dhe urdhrave të ulema-mexhllisit dhe sipas nevojës së treguar;
- IV. të mbikëqyrë zbatimin e kurrikulave për trajnimin fetar islam në shkollat shtetërore dhe të tjera dhe kujdeset që të mbrohen dhe të respektohen rregullat e Islamit në të gjitha institucionet publike;
- V. të përpiqet të përhapë njohuritë e shkencës islame në mesin e myslimanëve përmes predikimit dhe praktikave që morali të përmbushet sa më mirë;
- VI. t'i paraqesë ulema-mexhllisit raporte për raste të rëndësishme dhe rezultatet e shqyrtimit, sipas nevojës, kurse raportin kryesor për të gjithë punën çdo gjashtë muaj.

Ndërsa neni 49 thotë: Për të mbuluar shpenzimet e udhëtimit gjatë udhëtimeve zyrtare myftinjtë marrin një paushall vjetor nga fondet e Bashkësisë Fetare Islame, sipas vendimit të Këshillit Vakuf-Mearifit, me propozimin e ulema-mexhllisit. Për paushallin vjetor parashihet kredi e nevojshme për çdo vit në buxhetin e Komunitetit të Bashkësisë Islame⁵¹. Gjithashtu, udhëheqja e punëve arsimore fetare dhe vakëfeve të myslimanëve iu besua myftinjve.

⁵¹ Ustav Islamske vjerske zajednice Kraljevine Jugoslavije od 9. jula 1930. godine, shih: http://www.rijaset.ba/images/stories/Ustavi/Ustav_IZ-e_iz_1930.pdf

Dhënia e fetvasë, përkatësisht, kryerja e këtij shërbimi është një obligim kolektiv (*fard el-kifajeh*) i cili përmbushet nëse në një bashkësi, fjala është për një tërësi territoriale të myftnisë, një person kryen funksionin e myftiut. Por në rast se në një mjedis të tillë askush nga qytetarët nuk jep fetva, me këtë e gjithë bashkësia është mëkatore. Meqenëse është fjala për një detyrim kolektiv, është detyrë e autoritetit kompetent të kujdeset për caktimin dhe emërimin e personit që do t'u japë popullsisë fetva dhe t'ua mësojë atyre rregullat e fesë.

Nga ana tjetër, është detyrim i personit të interesuar, që nëse është e nevojshme, të udhëtojë deri te myftiu për të marrë fetvanë. Duke e marrë parasysh këtë problem nga raporti i myftiut ndaj personit të interesuar, në literaturë ceket se myftiu nuk e ka gjithmonë obligim t'i përgjigjet pyetjes së musteftijëve.

Megjithëse detyra e tij primare është që t'u japë fetva personave të interesuar në rastet konkrete, ndonjëherë myftiu nuk është i obliguar t'i përgjigjet pyetjes së parashtruar, edhe pse e di atë. Si arsyeja më e shpeshtë për këtë qëndrim është parandalimi i abuzimit me fetvanë, por edhe ruajtja e autoritetit të vetë myftiut⁵².

Sipas Kushtetutës së Bashkësisë Islame në RSFJ të vitit 1990, neni 27, myftinia është organ kryesor fetar në territorin e më shumë këshillave të Bashkësisë Islame. Selinë dhe territorin e punës së myftiut e përcakton kuvendi gjegjës. Myftininë e përbëjnë: myftiu dhe këshilli i myftinisë. Punën e myftinisë e udhëheq myftiu...

Neni 28

Myftinia në autorizimet e veta:

- kujdeset për përparimin e jetës fetare dhe ngritjes kulturoro-fetare të myslimanëve,
- jep fetvatë,

⁵² Hasani, Mustafa, *Opći pogled na instituciju fetve i muftije u šerijatskom pravu*, vidi: Usulifikh, Hrestomatia, op. cit., f. 359.

- i propozon Këshillit Islam të japë shpjegime autoritative për parimet themelore të shariatit,
- kujdeset për aplikimin e drejtë të rregullave të shariatit dhe rregulloreve të bashkësisë islame,
- përfaqëson Bashkësinë Islame në territorin e vet,
- mbikëqyr punën e nëpunësve të Bashkësisë Islame në territorin e vet⁵³.

Më datë 11 dhjetor 1993, Kuvendi i Bashkësisë Islame merr vendim për pavarësinë e Bashkësisë Islame të Kosovës.

⁵³ Kushtetuta e Bashkësisë Islame në RSFJ (e shpallur më 12 prill 1990), shih: Glasnik, br. 2, mart-april, viti LIII. Islamske zajednice u SFRJ, Sarajevo 1990, f. 39-40.

Conclusions

The issue of interpretation of Islamic religious rules has not lost its importance up today. Current circumstances ask for a strengthening of the mechanism of muftiate. Members of Muslim Community in Kosovo and beyond are facing a number of issues on which it is necessary for the Islamic Community to engage strongly and take a unified stance and position binding to all structures of the religious community. This is something that is currently happening. Modern life brings new dilemmas that must be considered and resolved in the light of Islamic rules. On the other hand, Islamic Community in our country cannot uncritically accept interpretations and solutions that have appeared in different social, political, legal and cultural conditions. Fiqh offers alternative solutions to individual situations, so according to the circumstances in which Muslims live in a certain country, should be resolved according to the principles of usuli-fiqh, the one that best suits the spirit of Islamic teaching and the interests of our believers. But this must not be done by individuals but rather by the Institution of the Islamic Community itself, which is solely responsible for explaining and interpreting Islamic teachings. BIK (Islamic Community of Kosova) as the only official institution for Muslims in the region of Prishtina, Gjiilan, Mitrovica, Prizren, Peja and Gjakova, including members of the Islamic Community who work and reside abroad, and the others who recognize the Islamic Community as their own⁵⁴.

⁵⁴ Bashkësia Islame e Kosovës, Kushtetuta e Bashkësisë islame, Prishtinë, 2013.

Literatura:

- Ahmed Er Rejsuni, Objektivat e ligjit islam, Logos A, Shkup Prishtinë Tiranë, 2015.
- Auda, Jasser, Objektivat e ligjit islam, një udhëzues për fillestarët, AIITC, Tiranë, 2020.
- Fikret Karcic, Studime për të drejtën e sheriatit dhe institucionet, Logos A 2015, Shkup, Prishtinë, Tiranë.
- Fikret Karčić, *Opšti pogled na historijat muftijske službe Bošnjaka*, Takvim, Presedništvo udruženja islamskih vjerskih službenika u SRBiH, Sarajevo, 1987.
- Fuad Sedić, *Poslanikove fetve*, El Kalem, Sarajevo, 1426/2005.
- Hayreddin Karaman, Historia e së drejtës islame nga fillimi deri në kohën tonë, Logos A, Shkup Prishtinë Tiranë, 2004.
- Jusuf El Kardavi, Fetva bashkëkohore, ShB Furkan ISM, Shkup 1424 h. 2003, f. 34.
- Menduh Bamja, *Pozita kushtetuese-juridike dhe faktike e bashkësive fetare në ish Jugosllavi me veshtrim të vecantë të bashkësisë islame*, Prizren, 2009.
- Nerkez Smailagić, *Leksikon islama*, Svjetlost, Sarajevo, 1990.
- Ramadan, Tariq, Të jesh mysliman evropian, Logos A, Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2011.
- *Historija Osmanske države i civilizacije*, përgatiti: Ekmeleddin Ihsanoglu, Orijentalni institut u Sarajevu, Sarajevo, 2004.
- Usul-i-fikh, Hrestomatia, përgatiti: Ljavaković, Enes, Sarajevo, 2005.
- *Përmbledhje punimesh, Srednji islamski put, društvene implikacije*, Sarajevo, El-Kalem, 1435. po h/ 2013. godine, f. 234.
- *Përmbledhje punimesh, Ustanova fetve u globaliziranom svijetu (Al iftau fil alem meftuh)*, Međunarodni centar za srednji islamski put u Kuvajtu, Sarajevo, El-Kalem, 1453/2013.
- *Përmbledhje punimesh, Zajednica srednjeg puta, teorija i praksa islamske umjerenosti*, knjiga 1, Sarajevo, El-Kalem, 1453. po h/ 2013. godine.

- *Përmbledhje punimesh, Zajednica srednjeg puta, teorija i praksa islamske umjerenosti*, knjiga 2, Sarajevo, El-Kalem, 1453. po h/ 2013. Godine.
- Muftic, Teufik Arapsko-srpskohrvatski rjecnik, II, Sarajevo, 1973.

Revistat:

- Glasnik, nr. 2, mart-april, g. LIII. Islamske zajednice u SFRJ, Presednistvo udruzenja islamskih vjerskih sluzbenika u SRBiH, Sarajevo 1990.
- Glasnik, br. 23, Islamske verske zajednice Kralovine Jugoslavije, Sarajevo, 1936.
- Islamka misao, godina VII, n. 73, januar, Starjesinstvo Islamske zajednice Bosne i Hercegovine, Hrvatske i Slovenije, Sarajevo, 1985, rabiul-ahir - džumadel-ula, 1405.

Webfaqet:

- El ulemau verethetul enbijai, Daru Iftai el Misrije,
https://www.aliftaa.jo/Article.aspx?ArticleId=117&fbclid=IwAR00noRyrPJRqrsX8jURB_YPSdGztbiBqtcBrrOGZxLZb7RbIa-5GZQyT9E#.YBe4njFKj3h
- Hutab en nebij salaAllhu alejhi ve selem fi haxhetil vedai,
<https://ar.islamway.net/article/>
- Sherhu Hadith “Beligu ani ve lev ajeh...”,
<https://islamic-content.com/hadeeth/501>
- http://www.znaci.com/serijatsko_pravo/serijat/Institucija-fetve-i-sluzbamuftije-u-Serijatskom-pravu-II-dio.html
- <http://www.bosanskehistorije.com/historija/36-etimologija/758-adnan-prekicislamska-zajednica-u-pljevljima>.
- <http://isamveri.org/pdfdkm/16/DKM160193.pdf>
- http://cns.ba/wp-content/uploads/2014/03/fikret_karcic_studije_o_serijatskom_pravu.pdf.
- http://www.rijaset.ba/images/stories/Ustavi/Ustav_IZ-e_iz_1930.pdf

Dr. Valon MYRTA

HYRJE KONCEPTUALE NË SHKENCËN “QËLLIMET E SHERIATIT” - (2)

Abstrakt

Në këtë studim hyrës shqyrtohet koncepti i disiplinës “*Qëllimet e Sheriatit*” dhe sigurohen disa përkufizime themelore për këtë fushë të jurisprudencës islame. Kjo është bërë duke hulumtuar kuptimet e çdo nocioni me ndikim në ndërtimin e perceptimit për këtë lëmi, duke reflektuar fillimisht për kuptimet etimologjike të nocioneve, për t’u thelluar më pas në zanafillën dhe objektin e kësaj lëmie, për të arritur deri te përkufizimi terminologjik dhe në fund radhitja e gjetjeve përfundimtare të këtij punimi.

Fjalët kyçe: Qëllim, interes, ligj, shariat, jurisprudencë islame, filozofi e së drejtës shariatike, jurisprudencë e intereseve.

Nëse shikojmë kuptimin e nocionit nga aspekti leksikor, mund të thuhet se “*Mekasidush-Sheria*” quajmë “*Qëllimet e Sheriatit*”, mirëpo është më se e qartë se një përkufizim i këtillë nuk është i mjaftueshëm nga aspekti përmbajtësor sepse në këtë mënyrë nuk bëjmë asgjë tjetër veçse përkthejmë domethënien fillestare të emrit nga gjuha arabe në

gjuhën shqipe, pa thënë asgjë për zanafillën e nocionit ose për kuptimin terminologjik që mban ai sot. Prandaj, është e nevojshme të sqarojmë në vijim zanafillën e përdorimit të këtij termi dhe subjektin e lëndës, para se të kalojmë te përkufizimet terminologjike që janë dhënë për të.

4. Zanafilla e lëndës

Shkenca juridike islame paraqet një sistem kompleks që grumbullon një varg disiplinash të veçanta, por të ndërvarura, që përbëjnë një tërësi shkencore. E, për të kuptuar sa më mirë zanafillën e lëmisë ‘*El-Mekasid*’, do ta shqyrtojmë atë në dy kontekste: a) përmbajtësor dhe b) historik.

Në kontekstin përmbajtësor rrjedha e kësaj teorie ka burimin të “*ligji i arsyes së mjaftueshme*”, logjika e të cilit që në fillim na ndihmon të konstatojmë se duhet të ekzistojnë arsye për ligjin sikurse ka arsye për veprimet njerëzore, të cilat janë subjekt i dispozitave ligjore. Pra, zanafilla e kësaj discipline gjendet te shqyrtimi i hershëm mbi konceptin e qëllimësisë së dispozitave (*hikmetul-ahkam*) në të drejtën islame dhe mbi mënyrat e gjetjes së arsyeve ligjore (*ilelul-ahkam*) prapa tyre. Kështu që vërtetimi i teorisë së qëllimësisë (*el-mekasid*) varet drejtpërdrejt nga vërtetimi paraprak i a) të qenurit e sheriatit një ligj që ka dispozita të justifikuara me kuptime të arsyeshme dhe se b) arsyetimet me të cilat justifikohen dispozitat e sheriatit janë në ndërlidhje me interesat e njeriut, jetësore dhe fetare.

I vetëdijshëm për këtë realitet, imam Shatibiu ndjeu nevojën ta fillonte kapitullin *el-mekasid* me një premisë teologjike, të pakundërshtueshme sipas tij, se *ligjet (e shpallura) janë vënë me qëllim për t’u shërbyer interesave të njeriut, në këtë jetë dhe tjetrën në të njëjtën*

¹ Ekrem Murtezai, Logjika, Prishtinë: Sh.B. Libri shkollor, 2013, fq. 3.

*kohë*². Sepse çdo detyrë ligjore e shariatit është vënë për të parandaluar ndonjë lloj dëmi ose për të arritur dobi, ose për të dyja së bashku³.

Ky konstatim i tij u mbështetet në një lexim induktiv të Islamit, duke filluar nga më të përgjithshmet e deri te detajet ligjore, të cilat në Kuranin fisnik gjejmë se janë tekstualisht të arsyetuara me përfitime të caktuara.

a) Nga arsyetimet e përgjithshme të fesë mund të përmendim disa:

- i. Arsyeja e krijimit të njerëzve është adhurimi i Zotit me vepërmirësi. Zoti thotë në Kuran: “Xhinët dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të më adhurojnë”⁴. “Është Ai që ka krijuar qiejt dhe tokën për gjashtë ditë, teksa Arshi i Tij ndodhej mbi ujë, për t’ju vënë në provë kush është më i mirë në vepra.”⁵ “Ai i ka krijuar jetën dhe vdekjen, për t’ju provuar se kush prej jush do të veprojë më mirë”⁶.
- ii. Arsyeja pse njerëzit e kanë të natyrshëm besimin te Zoti i referohet metafizikisht rastit: ***“Kur Zoti yt nxori nga kurrizi i bijve të Ademit pasardhësit e tyre dhe i bëri të dëshmojnë kundër vetes së tyre, u tha: “A nuk jam Unë Zoti juaj?” Ata u përgjigjën: “Po, dëshmojmë se Ti je.” Kështu bëri Ai, në mënyrë që ju (o njerëz) të mos thoni në Ditën e Kiametit: “Këtë nuk e kishim ditur. Ose që të mos thoni: “Me të vërtetë, etërit tanë ishin idhujtarë para nesh, kështu që edhe ne jemi pasardhësit e tyre. A mos vallë do të na shkatërrosh për veprat e atyre që ndoqën mashtrimin?”***⁷
- iii. Në qoftë se natyra e njeriut e pranon vetvetiu besimin te Zoti, në pyetjen: Arsyeja pse u dashka të dërgohen Profetë që të flasin prapë për të, me dy fjalë është: harresa (nisjan) dhe shpër-

² Shatibi, *El-Muvafekatë*, rec. Elhusejn Ejt Seid, 3/5. Rejsuni, *Objektivat e ligjit islam*, fq. 280.

³ Shatibi, *El-Muvafekatë*, rec. Elhusejn Seid, 2/467. Rejsuni, *Objektivat e ligjit islam*, fq. 282.

⁴ Kuran, Edh-Dharijatë: 56.

⁵ Kuran, Hudë: 7.

⁶ Kuran, El-Mulk: 2.

⁷ Kuran, El-A’rafë: 172-173.

fillja (gafleti). Zoti thotë: *“Dhe Ne bëmë më përpara një marrëveshje me Ademin, po ai harroi dhe Ne nuk gjetëm qëndrueshmëri te ai”*. Si rrjedhojë kemi çuar *“të Dërguar që kanë sjellë lajme të mira e kanë paralajmëruar, në mënyrë që njerëzit të mos kenë ndonjë justifikim ndaj Allahut, pas ardhjes së të Dërguarve”*⁸, se nuk u është kujtuar. Për të përfillur njerëzoren brenda njeriut, Profeti alejhi selam është dërguar me udhëzime mëshire që duhet të ndiqen: *“Dhe Ne nuk të kemi dërguar ty (o Muhamed), veçse mëshirë për botët”*⁹.

- b) Arsyetimet për detaje të ndryshme ligjore janë shumë më tepër se të përmenden këtu, por mund të veçojmë prej tyre vetëm disa, si ilustrim për të tërhequr vëmendjen kah kjo e vërtetë, për shembull:
- i. Arsyeya e abdestit është se *“Allahu nuk dëshiron t’ju krijojë ndonjë vështirësi, por dëshiron t’ju pastrojë dhe t’i plotësojë dhuntitë e Tij ndaj jush, që të jeni falënderues.”*¹⁰
 - ii. Arsyeya e namazit është se *“të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar.”*¹¹
 - iii. Arsyeya e agjërimit është *“që të mund të jeni të devotshëm (të përkushtuar për të bërë mirë dhe të ruheni nga të këqijat).”*¹²
 - iv. Arsyeya e xhihadit është se *“atyre që janë sulmuar, u lejohet (që të mbrohen), sepse u është bërë padrejtësi.”*¹³

⁸ Kuran, En-Nisa: 165.

⁹ Kuran, El-Enbija: 107. Ndërkaq, arsyeya pse shpalljet e Zotit drejtuar popujve (nëpërmjet Profetëve) janë në gjuhët e përdorura nga njerëzit, e jo në ndonjë formë tjetër, është që të jenë qartësisht të kuptueshme për ata, ashtu që të bjerë mbi ta përgjegjësia e vetëdijesimit. Në shpalljen e fundit Zoti thotë: “Ne e zbritëm këtë Kuran në gjuhën arabe, për ta kuptuar ju”. Kuran, Jusuf: 2.

¹⁰ Kuran, El-Maide: 6.

¹¹ Kuran, El-Ankebut: 45.

¹² Kuran, El-Bekare: 183.

¹³ Kuran, El-Haxhxh: 39.

- v. Arsyeja e kisasit -parimi i barazisë në ndëshkim në raste të mosfaljes - është se ***“në ligjin e barazisë në ndëshkim ka siguri për jetën tuaj, o mendarë, në mënyrë që ju të përmbaheni!”***¹⁴

Si një aksiomë e padiskutueshme që është kjo pikënisje, sipas Shatibiut ajo nuk mundet dhe as që ka nevojë të argumentohet, por mjafton të zgjojmë vëmendjen për këtë fakt me disa citate të lartpërmendura kuranore. Dhe, kjo premisë, me që është e vërtetë, vlen për tërë ligjin¹⁵.

Në kontekstin historik, ‘qëllimet e shariatit’ nisin të vërehen e të identifikohen që nga koha e zbulesës së Kuranit fisnik, kur edhe jetësohej nga vetë i Dërguari i Zotit alejhi salatu ve selam, që më pas u përpoqën të ndjekin traditën e tij edhe kalifët e drejtë.

Termi *mekasid* përdoret në të menduarit ligjor islam për t’iu referuar qëllimeve ose objektivave madhore të ligjërimit juridik në shpalljen e Zotit. Studiuesit, pas një hulumtimi, nuk kanë gjetur dëshmi që pohojnë se ky term është përdorur me këtë kuptim të sotshëm nga juristët e shekujve të parë. Megjithëse, vërehet nga trashëgimia që kanë lënë prapa se koncepti ishte i qartë në mendjen e tyre, saqë punonin sipas tij pa e menduar gjatë. Vlera e dijetarëve të mëvonshëm qëndron në atë se e shkoqitën si temë në libra të veçantë dhe e studiuuan si lëmi të posaçme të shariatit.

Si një ide juridike¹⁶, nocioni *el-mekasid* u zhvillua midis shekujve të njëmbëdhjetë dhe katërmëdhjetë të erës sonë, në një periudhë kur mendimi ligjor islam vazhdoi të mbetet më krijuesi i kohës. Gjatë kësaj kohe ideja u përdor nga një numër juristësh për të identifikuar një nu-

¹⁴ Kuran, El-Bekare: 179.

¹⁵ Shatibi, *El-Muvafekatë*, rec. Elhusejn Seid, 3/5. Rejsuni, *Objektivat e ligjit islam*, fq. 280.

¹⁶ Në aspektin e dimensionit të brenshëm të Islamit, të thellimit në urtësi, gjejmë se Hakim Tirmidhiu (vdiq rreth vitit 320 hixhri) është i pari që ia la termin *Mekasid* veprës së tij me titull “Es-salatu ue mekasiduha” (Namazi dhe qëllimet e tij). Ndërkaq, më afër përdorimit juridik të këtij termi ishte filozofi Muhammed El-Amiri (v. 381 h), në librin me titull: “El-I’lamë bi me-nakibil-islam” (Njoftimi me virtytet e Islamit).

mër qëllimesh themelore ose thënë ndryshe, një listë të të drejtave themelore të njeriut.

Edhe pse shumë struktura mendimesh dhe qëndrimesh nga fusha e studimit të saj ishin zhvilluar gjatë shekujsh të tërë pune të dijetarëve, tematika e arsyeve dhe e urtësive të shariatit filloi të jepte fryte në shekullin e pestë pas hixhretit, që korrespondon me shekullin e njëmbëdhjetë pas Isait alejhi selam. Në këtë kohë u shfaq i formuluar mirë koncepti i pesë themeloreve, ‘pesë domosdoshmërive’, për mbrojtjen e të cilave janë shpallur revelatat dhe janë vënë ligjet, e që janë: e drejta e jetës, e fesë, e intelektit, e pasardhësit dhe e pronës. *Gazaliu* përfitoi nga *Xhurvejni* dhe i sistemoi këto të drejta si pesë objektivat më të larta të ligjit. Pas tij ka patur përpjekje të shtohen edhe të tjera, për shembull *Karafî* shtoi si qëllim të gjashtë të *drejtën e nderit (irzit) ose dinjitetin (kerametit)* dhe ka disa dijetarë bashkëkohorë që shtuan edhe qëllime të reja, si *liria, drejtësia e të tjera*. Mirëpo, ka mbetur e fuqishme thirrja se gjithçka që shtohet është veçse nëndegë e njëres nga ‘pesë të domosdoshmet’.

Këto domosdoshmëri dijetari i njohur Izzuddin bin Abdusselam i quajti “interesa” (el-mesalih) në librin e tij: “Maksimat e dispozitave në interes të njerëzve” (Kavaidul-ahkam fi mesailil-enam). Ky jurist me famë me të drejtë mund të konsiderohet si themeluesi i asaj që sot quhet ‘*jurisprudencë e interesave*’, sepse deri në këtë kohë ‘interesat’ (mesâlih) shiheshin nga disa shkolla juridike si argument juridik i kontestuar ose periferik.

I pari që e veçoi *el-mekasid* si koncept në një studim gjithëpërfshirës si teori juridike të plotësuar dhe e mbrojti si tezë në mënyrë argumentative në shekullin e tetë hixhri ishte juristi i mirënjohur nga Andaluzia, imami i ndritur Shatibiu¹⁷. Kapitullin e dytë të librit “Përpu-

¹⁷ Quhet Ibrahim bin Musa Esh-Shatibi, dijetar i madh nga qyteti Shatibe, në Andaluzinë e hershme, prej nga edhe e merr emrin, që sot është qytet i Spanjës i njohur si Xâtiva (Gjativa).
Shih: <https://en.wikivoyage.org/wiki/X%C3%A0tiva#Q738013>.

thjet në Bazat e Sheriatit” (El-Muvafekat fi Usulish-Sheria)¹⁸ ai e titulloi *El-Mekasid*, ku formuloi teorinë e “qëllimeve”, e shtjelloi gjerësisht dhe të lidhur ngushtë me interesat jetësore e fetare, në një vëllim të tërë dhe si asnjëherë më parë. Në këtë libër ai i dha subjektit karakterin e ekstrapolimit e të gjithëpërfshirjes dhe e ndërlidhi me disiplinat e tjera të së drejtës islame.

Kjo disiplinë e themeluar nga Shatibiu fillimisht nuk arriti të përhapet e as t’i afirmonte dot pikëpamjet e saj si disiplinë e veçantë juridike. Pionierët që e përkrahën dhe e zhvilluan atë filluan të dilnin në fillim të shekullit XX, në kohën kur shoqëritë myslimane ndienin nevojën të gjenin përgjigje për ndryshimet rrënjësore që pësonin në rrafshin politik dhe për idetë e reja me prejardhje nga jashtë, që po ndërrojnë mënyrën e jetesës së njerëzve edhe në aspektin kulturor. “Gjatë mëkëmbjes prej një periudhe rëniesje, bota islame po e shihte të vështirë t’i harmonizonte dispozitat e fesë me realitetet e jetës moderne dhe libri “*El-Muvafekat*” i Shatibiut u provua të jetë një strehë dhe burim këshille autoritare (për të përballuar këtë sfidë)”¹⁹. Nga më të shquarit dhe ndër të parët prej bashkëkohorëve që inspiruan të tjerët të interesoheshin për këtë lëmi është dijetari egjiptian Muhamed Abduhu me nxënësit e tij, sidomos Abdullah Dirazi, i cili përpiloi një *Hashije* (sqarim i shkurtër)²⁰ për librin e Shatibiut. Ndërkohë që dy dijetarë të tjerë, marokeni Al-lal el-Fasi dhe tuniziani Ibën Ashuri, shkruan secili prej tyre nga një libër mbi këtë lëmi.

¹⁸ Ky libër ka pasur shumë botime. Për herë të parë është botuar në Tunizi, në vitin 1884 (1302 hixhri), nga “Shtëpia shtetërore e Tunisit” (Matbeatud-devletit-Tunisije). Pastaj, kanë pasuar botimet e tjera, e së fundmi është botuar në Fas të Marokut, në pesë vëllime (i pari është studim rreth librit) nga “Publikimet e Beshir Binatijje” (*Menshuratul-Beshir Binatijje*), në vitin 2017 (1438 hixhri), me recensim të dr. Elhusejn Ajt Seid, profesor në “Universiteti Kadi Ijad”.

¹⁹ Thënie e Muhammed el-Fadil bin Ashurit. Shih, Rejsuni, *Objektivat e ligjit islam*, fq. 489.

²⁰ Është botuar në Bejrut, nga shtëpia botuese “Darul-Ma’rife”, pa datë publikimi.

Në dekadat e fundit disa mendimtarë islamë kanë përdorur *el-mekasid* si një teori e cila mund të angazhohet drejtpërsëdrejti me idenë e të drejtave të njeriut. Dijetarët myslimanë, si Reshid Rida dhe Ibni Ashuri, kanë propozuar që “*Qëllimet e Sheriatit*” të zgjerohen për të mbuluar çështje të tjera themelore, të tilla si barazia, liria dhe dinjiteti. Sot, në Mbretërinë e Bashkuar ky proces vazhdon nëpërmjet punës së mendimtarëve të tillë si Xhasir Aude²¹, i cili në tezën e doktoratës e vendosi këtë koncept në qendër të përpjekjeve të tij për të ngritur pozitën e të menduarit ligjor islam në shoqërinë moderne.

Me pak fjalë, zhvillimi i kësaj lëmie juridike kaloi nëpër katër faza:

- a) *Themelimi teorik fillestar*; me pionierët e hershëm si Hakim Tirmidhiu (vdiq 320 hixhri), Ahmed Belhiu (vdiq 322h), Kaffal Shashi -i madhi- (vdiq 365h), El-Amiri (vdiq 381h), Bakil-lani (vdiq 403h), Xhuvėjni (vdiq 478h), Gazali (vdiq 505h), Muhammed Buhari (vdiq 546h), Rrazi (vdiq 606h), Amidi (vdiq 631h) e të tjerë.
- b) *Kombinimi mes teorikes dhe praktikes*; me juristët Izzuddin bin Abdusselami (vdiq 660 h), Karafī (vdiq 684h), Tufī (vdiq 716h), Ibën Tejmije (vdiq 728h), Ibnul Kajimi (vdiq 751h) e të tjerë.
- c) *Kompletimi teorik e metodik*; me imam Shatibiun (vdiq 790 hixhri).
- d) *Zhvillimi modern*; rifilloi me zell nga dijetarë si Muhamedtahir bin Ashuri, Al-lal El-Fasi dhe Abdullah Dirazi në gjysmën e shekullit të katërmbëdhjetë hixhri. Në mesin e kontribuesve me vlerë për këtë lëmi janë Ahmed Rejsuni, Abdullah bin Bejje dhe Abdulmexhid Nexhxhari. Përpjekje krijuese për ta rinovuar lëminë kanë dhënë: a) filozofi Taha Abdurrahman, në ndërlidhjen e qëllimeve me moralin; b) mendimtari Taha Alvani, në formuli-

²¹ Shih Xhasir Aude, *Maqasid al-Shariah as Philosophy of Islamic Law: A Systems Approach (Qëllimet e sheriatit si filozofi e ligjit islam: një qasje sistemesh)*, London-Washington: Instituti Ndërkombëtar i Mendimit Islam, 2007.

min e qëllimeve më të larta: tevhidi (monoteizmi), tezkijje (edukimi) dhe imrani (zhvillimi); c) juristi Xhemaluddin Atijje, në funksionalizimin e qëllimeve duke shndërruar fokusimin nga 'pesë domosdoshmëritë' në 'katër sferat': individi, familja, yme-ti dhe njerëzimi.

Me kohë kjo disiplinë është emancipuar nga metodologjia e sistemit juridik islam e njohur si shkenca e *Usuli Fikhut* dhe pothuajse është mëvetësuar si disiplinë e veçantë në kohën moderne nën emrin *Mekasidush-Sheria* (Qëllimet e Sheriatit). Dijetari tunizian *Ibën Ashuri* qe i pari i cili arsyetoi idenë e mëvetësimit të *el-mekasid* si disiplinë e veçantë dhe i pari profesor që e ligjëroi si lëndë në një universitet, në *Universitetin e Zejtunit*. Ndërkohë që ka të atillë si Xhemaluddin Atijje, të cilët shprehin rezervat e tyre në lidhje me dobishmërinë e ndarjes së kësaj discipline nga Usuli Fikhu në këtë kohë, nga frika se mos dëmtohen nga ndarja e hershme të dyja. Madje, Abdullah bin Bejje i konsideron këto dy disiplina si një dhe të padobishme ndarjen nga njëra tjetra, sepse sipas tij përfitohet nga *mekasidi* në mbi njëzet çështje të *usulit*²².

5. Objekti i studimit

Janë dy pyetje jetike për të cilat kërkohen përgjigje për të zhvilluar një filozofi të ligjit: a) Cili është qëllimi i ligjit? b) Çfarë është zbatimi i ligjit?

Një përgjigje i kushtohet pyetjes së parë dhe ajo sqaron se e drejta islame mbron dhe realizon interesat jetësore e fetare në mënyrë të

²² Muhamed Tahir bin Ashurë, *Mekasidush-sheriatil islamijje*, Tunizi: Esh-sheriketut-tunisijje lit-tevzi', 1988, fq. 111; Xhemaluddin Atijje, *Nahve tef'ilil-mekasid*, Damask: Darul Fikr – Amman: El-Ma'hedul-alemi lil fikril islami, ed. 2, 2008, fq. 267; Abdullah bin Bejje, *Alakatu mekasidish-sheriatil bi Usulil-fikh*, Londër: Muesesetul-furkan lit-turathil-islami, Merkez dirasati mekasidish-sheria, ed.1, 2006, fq. 131 dhe 99.

ndërhorthë, në të njëjtën kohë²³. Është një qasje me të cilën juristët (fukahatë) e konsiderojnë ligjin si të përcaktuar kryesisht të mbajë balancin midis interesave politike, ekonomike, morale, sociale dhe shpirtërore në shoqëri. Prandaj, në njëfarë mënyre, ata i shohin rregullat dhe vendimet ligjore si rrugë të fitimit të interesave dhe si kategorizim i disa prej tyre mbi të tjerat. Ndërkaq, zbatimi i ligjit mbase është një nga problemet politike më të rëndësishme që shoqëria bashkëkohore duhet të adresojë. Zbatimi i ligjit ekziston vetëm atëherë kur çdo akt kufizohet me ligj, përfshirë aktet e sovranit dhe agjentëve të tij. Kjo gjendje funksionon vetëm atëherë kur viktima ka të drejtën e padisë kundër pushtetit, kur ky abuzon me shtetin, dhe të jetë e mundur që të imponohet verdikti përfundimtar²⁴. Por kush do ta bëjë imponimin? Qartësisht vetë sovrani. E sovrani është ai që mbetet të *përcaktohet* për të drejtën islame si sistem drejtësie, kur arrin të arsyetojë interesin publik që sjell përfillja e udhëzimeve të Zotit nga ana e ligjvënësve dhe *monotoron* zbatimin e verdikteve përfundimtare qofshin edhe kundër pushtetit. Për sigurimin e ligjshmërisë në një shtet si mekanizëm zbatohet

²³ Ka përgjigje të kundërta në *kelam* lidhur me pyetjen: A ka Zoti qëllime në veprimet që ndërmerr dhe në urdhrat që shpall, apo thjesht vepron dhe urdhëron çfarë të dojë konform vullnetit (irade)? Si rrjedhojë, kjo divergjencë ndikoi në jurisprudencë në lidhje me përcaktimin e llojit të marrëdhënies midis urdhrave dhe qëllimeve, përndryshe të gjithë janë unikë në atë se normat fetare, qofshin urdhra apo ndalesa, janë në marrëdhënie të rregullt me interesin e krijesave, mirëpo u diskutua: a) a kanë marrëdhënie shkakësie me karakter ndikues (il-le) ose motivues (baith), apo thjesht janë shenja të rregullta dhe b) a mund të përdoren kuptimet e arsyeshme (el-ilel), urtësitë (hikem) dhe qëllimet në interes të njeriut (mekasid) si argument prej të cilit mund të nxjerrim përfundime ligjore, apo duhet të mbështetemi vetëm në literalen e citateve. Konsulto, Ahmed Et-Tajjib, *Hadithun fil ileli uel mekâsid*, ed. 2, Kajro: Darul-kudsil-arabi, 2016; Abdunnur Bezza, *Nadharijjetit-ta 'lili fil fikrejnil-kelami uel usuli*, ed.1, Virxhinia: El-ma'hedul-âlemi lil-fikril-islami, 2011; Muhammed Shelebi, *Ta 'lilul-ahkam*, Beirut: Darun-nahdatil-arabijje, 1981; Abdulkhakim Sa'di, *Mebahithul Il-leti fil kijas indel usulijjine*, ed.2, Beirut: Darul-beshairil-islamijje, 2000; Raid Ebu Mu'nis, *Menhexhut-ta 'lili bil hikmeti ue etheruhu fi kavaidil fikhi ue usulih*, ed. 2, Virxhinia: El-ma'hedul-âlemi lil-fikril-islami, 2011.

²⁴ Roger Scruton, *Filozofia moderne nga Aristoteli te filozofia analitike*, Spartak Ngjela (përkth.), Tiranë: Uetpress, prill 2017, fq. 588.

het ndarja e pushteteve, e nëse gjykata është njëmend e pavarur, ajo imponon ligjin nëpërmjet zbatuesve të tij.

Prandaj, kjo disiplinë hulumton çdo shpjegim të vlefshëm për pyetjen 'pse' vihet ligji, për çfarë qëllime? E, meqë ka shumë mënyra të të shpjeguarit të gjërave, duhet pranuar se ka kuptime të ndryshme për pyetjen 'pse?'

- 'Pse' që kërkon qëllimin përfundimtar tërheqës.
- 'Pse' që kërkon arsyen dhe urtësinë justifikuese.
- 'Pse' që kërkon shkakësinë, marrëdhënien shkak dhe pasojë.
- 'Pse' që kërkon motivin shtytës.

Çështje këto me të cilat do të merret më vonë gjerësisht lëmia *mekasid* i kanë vënë re dhe shtruar qysh herët dijetarët e *usuli fikhut*, ndërkohë që ata shqyrtonin nocione me ngjashmëri me termin 'maksid', siç janë: 1) hikmeti - urtësia; 2) maslahati - interesi; 3) ileti - arsyeja, dhe; 4) sebebi - shkak. Pra, që në kohët e hershme janë ngritur pyetje dhe problematika në mesin e kelamistëve dhe juristëve nën titullin e arsyeve ligjore (ilel) dhe urtësive të legjislacionit (hikem). Mirëpo, ato u zhvilluan kryesisht si një detajim brenda kapitullit të analogjisë (kijasit) ose përshtatshmërisë së dispozitave me interesin (munasebeti), derisa u provua se vetëm arsyet ligjore të analogjisë nuk janë të mjaftueshme, pasi kemi urdhëresa që justifikohen me urtësi, si për shembull thënia kuranore: "*Fale namazin! Vërtet që namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar.*"²⁵ Si pasojë, hulumtimi i jurisprudencës ka shkuar në dy drejtime: arsyetimi me *ilel* dhe justifikimi me qëllime përfundimtare *Mekasid*. Ky i fundit studion filozofinë dhe teorinë e përgjithshme ligjore, ndërkaq drejtimi i parë merret me detajet dhe hollësitë e rasteve praktike.

Kështu që kjo dituri studion dhe *nëpërmjet saj kërkohet të dimë, tri gjëra të rëndësishme:*

²⁵ Kuran, El-Ankebut: 45.

E para: *Natyra e sheriatit që përfaqësohet në karakteristikat e tij.* Studimi i tyre merr një rëndësi të veçantë në mes të rrethanave të tanishme, kur feja përjeton një rritje të nevojës së njerëzve për të, për të plotësuar personalitetin njerëzor. Dijetarët myslimanë vërejtën rëndësinë e kësaj teme qysh herët, prandaj edhe lanë vepra të shkruara nën tituj të tillë si: Bukuritë e Islamit (Mehasinul-islam); Tiparet e Islamit (Menakibul-islam); Virtytet e fesë (Fedailud-din). Ka pasur një përqendrim në këto përpilime në pesë karakteristika kryesore të fesë: njëshmëria (tevhidi), njerëzia (fitret), toleranca (semâha), barazia (musava’), lehtësimi (tejsîr), ndërnjohja mes njerëzve (teâruf) dhe kombinimi i interesave të kësaj bote me të botës tjetër (maslaha).

E dyta: *Logjika e qëllimësisë përbrenda sheriatit, që t’i qasemi kuptimit të sheriatit me vetë logjikën e tij, që e veçon nga sistemet e tjera të drejtësisë.* Kjo logjikë *ndërlidh interesat jetësore me ato fetare, prandaj edhe krijon marrëdhënie mes moralit e ligjit dhe i lë të ndërvarura në një lloj marrëdhënieje shkakësie dispozitat ligjore me interesat njerëzore.* Si pasojë, kjo lëmi mund të kuptohet edhe si “*jurisprudencë e interesit*”. Dhe si e tillë përfshin në studim “*të gjitha gjërat që njeriu i mban të dashura dhe të gjitha idealet që udhëzojnë jetën e njeriut*”²⁶.

E treta: *Implikimet e qëllimeve në ixhtihad (intelektin ligjor).* Për të hapur perspektivat për rinovimin e së drejtës islame, duke parë çështjet

²⁶ Në kuptimin më të përgjithshëm, jurisprudenca e interesave është një qasje e gjerë dhe e larmishme e ligjit që u shfaq në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe fillim të njëzetës. Një reagim kundër jurisprudencës pozitiviste dhe formaliste që dominoi mendimin ligjor. Jurisprudenca e interesave është një qasje me të cilën juristët e konsiderojnë ligjin si të përcaktuar kryesisht nga lufta midis interesave politike, ekonomike, morale dhe sociale në shoqëri. Prandaj, ata i shohin rregullat dhe vendimet ligjore si pasqyrim të fitores së disa interesave të tilla mbi të tjerët. Megjithatë, kuptimi i jurisprudencës së interesave nuk ka qenë as monolit as uniform. Për të shmangur keqkuptimet, duhet të dallojmë, së paku, kuptimin e gjerë të termit nga koncepti më i veçantë gjerman që i dha qasjes emrin e saj në radhë të parë. Shih, Enrico Pattaro dhe Corrado Rovarsi (Edit.), *A Treatise of Legal Philosophy and General Jurisprudence*, Springer, 2017, Chapter 22, 12/619; Rudolf von Jhering, *Law as a Means to an End (Der Zweck im Recht)*, Isaac Husik (përkth.), 2nd reprint ed., New Jersey: The Lawbook Exchange (Original published 1913 by Boston Book Co.), 2001) fq. xxxv.

dhe problemet në dritën e interesave të myslimanëve, si për nga ndikimi i qëllimeve në nxjerrjen e dispozitave ligjore ashtu edhe për nga gjetja e mekanizmave që realizojnë interesat në jetën e njerëzve. Edhe pse teorikisht ka unanimitet të dijetarëve se ‘qëllimet’ kanë rëndësi të madhe në ‘ixhtihad’, praktikisht ato nuk janë trajtuar si të tilla sepse usuli, ‘bazat dhe metodologjitë e fikhut’, më tepër është shqetësuar me çështjet mbi konformitetin e fjalëpërfjalshëm të tekstit hyjnor sesa për ‘qëllimet e sheriatit’ dhe si e tillë nuk arriti të kufizojë divergjencat e panevojshme. Prandaj, lindi nevoja për ‘qëllimet’ si shkencë e cila mund të konsiderohet ‘bazë e vetë usulit’, ngase shqetësohet për filozofinë e ligjit, perspektivat dhe objektivat, e jo vetëm për formulimin e tekstit të tij specifik, dhe shqyrton argumentet e shkallës së prerë, që duhet të kufizojnë mosmarrëveshjet në masa minimale. Në këtë këndvështrim, sheriatit nuk bën të shihet vetëm si një kompleks rregullash, urdhërimesh e ndalimesh, që i adresohen një *mukelefi* (individit të përgjegjshëm), por edhe si një sistem vlerash, ku rregulla specifike janë manifestime të prekshme të këtyre vlerave.

Pra, shkencën “*Mekasidush-sheria*” ka objekt studimi adresimin e qëllimeve të së drejtës islame, që vjen si rrjedhojë e natyrës së tij të përgjithshme të identifikuar në karakteristika të caktuara dhe hulumtimin e mekanizmave që mundësojnë realizimin e tyre në jetën e njerëzve. Mirëpo, për të arritur deri tek adresimi i qëllimeve në revelatë, disiplina zbaton teknika literale/gjuhësore të teorisë “*Ed-Delalatë*” dhe teknika të tjera racionale në subjektin ligj. Ndërkaq, për të bashkërenduar qëllimet e ligjit me ato të individit dhe shoqërisë disiplina përfiton nga teoria e motivimit njerëzor “*El-Kusud*”, për të çuar deri të përputhshmëria mes këtyre dy llojeve të qëllimeve, sepse zbatimi literal i normës ligjore të sheriatit, pa marrë në konsideratë qëllimin dhe as pasojat sociale që sjell, shpesh shoqërohet me padrejtësi dhe shkon kundër asaj që do të kishte dashur Ligjvënësi. Prandaj, dijetarët që përkufizuan qasjet të cilat çojnë në zbulimin e “Qëllimeve” nuk e lejuan

veten të zihen rob të sipërfaqësore literale (dhahir) të çfarëdo teksti, sado madhështor të jetë, e as të subjektivizmit ideor (batin), përderisa konteksti ku ose kur është thënë dhe logjika e përgjithshme e atij shkrimi i ndihmonte të thelloheshin deri tek urtësitë prapa fjalëve, pa e shpërfillur kuptimin tekstual që japin ato.

Me pak fjalë, kjo lëndë sot përfaqëson lidhjen midis shariatit dhe të drejtave të njeriut, zhvillimit të qëndrueshëm dhe qytetarisë si koncept i shtetësisë moderne. Ndër shumë çështje të tjera, *teoria mekasid* adreson edhe:

- i. Metodologjinë më të mirë për të rilexuar shkrimin e shpallur në dritën e realiteteve dhe gjendjes së diturisë së sotme.
- ii. Sistemin shqyrtues të vlerave islame si liria, drejtësia, mëshira, etj..
- iii. Lidhjen e të drejtave të njeriut me objektivat e ligjit islam.
- iv. Mekanizmat për të bërë qëllimet islame kontribuese në zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërive, moralin dhe qytetërimin njerëzor²⁷.

²⁷ Krahaso me ç'shkroi: Xhasir Aude, *Maqasid; a beginner's guide*, London - Washington: The international institute of islamic thought, 2008, fq. 3.

Literatura:

1. Abdulhakim es-Sa'di, *Mebahithul Il-leti fil kijas indel usulijjine*, ed. 2, Beirut: Darul-beshairil-islamijje, 2000.
2. Abdulkahir el Xhurxhani, *Delailul-i'xhâz*, rec. Muhamed Reshid Rida, Mekë: El-Mektebetut-Tixharijje, pa vit botimi.
3. Abdulmelik bin Abdullah el-Xhuvejni (478 h), *El-Burhan fi Usul'il-Fikh*, ed. 1, Beirut: Darul-kutubil-ilmijje, 1997.
4. Abdulmelik El-Xhevuñi, *El-Burhan fi Usulil-Fikh*, ed. 3, rec. Abduladhim ed-Dibë, El-Mensure: Darul-vefa.
5. Abdulmelik el-Xhuvejni, *El-burhan fi usulil-fikh*, ed.2, rec. Abduladhim ed-Dibë, Kairo: Darul-Ensarë, 1400 h.
6. Abdullah bin Bejje, *Alakatu mekasidish-sheriatu bi Usulil-fikh*, Londër: Muesesetul-furkan lit-turathil-islami, Merkez dirasati mekasidish-sheria, ed.1, 2006.
7. Abdunnur Bezza, *Nadharijjetit-ta'lili fil fikrejnil-kelami uel usuli*, ed. 1, Virxhinia: El-ma'hedul-âlemi lil-fikril-islami, 2011.
8. Abdurrahman el-Adravi, *Med'hal te'sisi fil-fikril-mekasidi*, ed. 1, Beirut: Merkez Nema lil buhuth ued-dirasat, 2015.
9. Abdurrahman es-Salimi, *A'malu Nedveti tetavvuril-ulumul-fikhijje; El-Mekasidush-sherijje*, ed. 2, Oman: Ministria e vakëfeve dhe çështjeve fetare, 1433h/2012.
10. Ahmed bin Abduhalim 'Ibnu Tejmijje', *Mexhmuul-fetava*, Mekë: Mektebetun-nahdatil-haditheti, pa vit botimi. Dhe, botimin tjetër: *Mexhmu'ul-Fetavi*, Medine: Mexhma'ul-melik Fehd lit-tibaatil-Mus'hafish-sherif, 1995.
11. Ahmed bin Faris, *Muxhmelul-lugati*, rec. Zuhejr Sulltan, ed. 2, Beirut: Mueseturr-rrisale, 1986.
12. Ahmed Et-Tajjib, *Hadithun fil ileli uel mekâsid*, ed.2, Kairo: Darul-kudsil-arabi, 2016.
13. Ahmed Muhammed el-Fejumi (vdiç rreth 770 h), *El-misbahul-munir fi garibish-sherhil-kebir*, ed. 2 Beirut: El-mektebetul-ilmijje, 1994.
14. Ahmed Muhtar Abdulhamid e të tjerë, *Mu'xhemul-lugatil-arabijetil-muasire*, ed.1, Beirut: Alemul-kutub, 2008.
15. Ahmed Rejsuni, *Objektivat e Ligjit Islam*, të Ahmed Rejsunit, Shkup: Logosa, 2015.

16. Alauddin el-Buhari, *Keshful Esrar an Usuli Fakhiril-Islam el-Bezdevi*, ed. 1, Beirut: Darul-kutubil-ilmijje, 1997.
17. Al-lal el Fasi, *Mekasidush-Sheriatil islamijjeti ue mekarimuha*, ed. 5, Beirut: Darul-garbil-islami, 1993.
18. Aly Abdel Moneim, Towards Islamic Maqasidi Education Philosophy for Sustainable Development Quranic Perspective With Special Attention to Indonesia, *Millah: Jurnal studi Agama*, vol. 17, no. 2, februari 2018.
19. Ekrem Murtezai, *Logjika*, Prishtinë: Sh.B. Libri shkollor, 2013.
20. Ali El-Amidi, *El-Ihkam fi Usulil-ahkam*, rec. Abdurrezak Afifi, Beirut: Elmektebul-islami.
21. Enrico Pattaro dhe Corrado Roversi (Edit.), *A Treatise of Legal Philosophy and General Jurisprudence*, Springer, 2017.
22. Rudolf von Jhering, *Law as a Means to an End (Der Zweck im Recht)*, Isaac Husik (përkth.), 2nd reprint ed., New Jersey: The Lawbook Exchange (Original published 1913 by Boston Book Co.), 2001.
23. Fazlur Rrahman, *Islami*, Eqrem Kryeziu (përk), Shkup: Logos-A, 2010.
24. Fet'hi ed-Durejni, *El-Menahixhul-usulijje fil-ixhtihadi bir-re'ji fit-teshri'il-islami*, Esheriketul-mutthehide, 1985.
25. Galijetu Buhedde, El-eb'adul-mekasidijje fi menahixhit-teâmuli meas-Sunneti indel-Muxhtehidine ue tatbikatuhel-muâsire, *Islamijjetul-ma'rife*, Aman, v. 16, nr. 61, 2010.
26. Halil bin Ahmed el-Ferahidi (vdiç 170 h), *Kitabul-Ajn*, red. Mehdi el Mahzumi dhe Ibrahim Es-samerrai, Daru ue mektebetul-hilal.
27. Ibrahim Musa Shatibiu, *El-Muvafekatë fi Usulish-Sheria*, rec. Abdullah Diraz, Beirut: Darul-ma'rife, pa vit botimi. Dhe, dy botime tjera: *El-Muvafekatë*, ed.1, Demmam: Daru Ibni Affan, 1997; *El-Muvafekatë*, rec. Elhusejn Ejt Seid, ed. 1, Fas - Marok: Menshuratul-Beshir, 2017.
28. Izzuddin bin Zegibe, *El-mekasidul-âme lish-sheriatil-islamijje*, ed. 1, Kairo: Darus-safve, 1996.
29. Luljeta Ikonomi, *Filozofia e së drejtës*, ed. 2, Tiranë: Onufri, 2010.
30. Muhamed Ahmed el-Kurtubi (671 h), *El-Xhami' li ahkamil-Kuran*, ed. 2, Kairo: Darul kutubil-misrijje, 1964.
31. Muhamed bin Ebubekër "Ibnul-Kajjim" (751 h), *I'lamul-muvekkiinë an Rab-bil-aleminë*, ed.1, Beirut: Darul-kutubil-ilmijje, 1991. Dhe, botimi tjetër: *I'lamul-Muvekkiinë*, rec. Taha Seid, Beirut: Darul-Xhilë.

32. Muhamed Hindo, *El-Kul-lijatut-teshriije ue etheruha fil ixhtihad uel fetva*, ed. 1, Amman: El-ma'hedul-alemi lil-fikril-islami, 2016.
33. Muhamedtahir bin Ashurë, *Mekasidush-sheriatil islamijje*, Tunizi: Esh-sheriketut-tunisijje lit-tevzi', 1988.
34. Muhammed bin Ali Hakim Tirmidhiu, *Ithbatul-ilel*, rec. Halid Zuhri, Ribat: Menshurat Kul-lijetil Adabë uelumil-insanijje, Kasablankë: Matbeatun-nexhah, pa vit botimi.
35. Muhammed el-Gazali, *El-mustasfa fi ilmil-usul*, botuar me librin e Muhib-bullah Abdushshekur: *Musel-lemuth-thubut*, ed.1, Egjipt: El-Matbeatul-emirijje, 1392 h.
36. Muhammed el-Gazali, *Shifaul Galil fi bejanish-shebehi uel-mukhajjeli ue mesalikut-ta'lil*, rec. Hamed el Kubejsi, Bagdad: Matbeatul-irshad, 1971.
37. Muhamed Shelebi, *Ta'lilul-ahkam*, Beirut: Darun-nahdatil-arabijje, 1981.
38. Raid Ebu Mu'nis, *Menhexhut-ta'lili bil hikmeti ue etheruhu fi kavaidul fikhi ue usulih*, ed. 2, Virxhinia: El-ma'hedul âlemi lil-fikril-islami, 2011.
39. Roger Scruton, *Filozofia moderne nga Aristoteli te filozofia analitike*, Spartak Ngjela (përkth.), Tiranë: Uetpress, prill 2017.
40. Taha Abdurrahman, *Texhdidul-menhexh fi takvimit-turath*, ed. 2, Beirut: El-Merkezuth-thekafil-arabi, 1994.
41. Taha el-Alvani, *Mekasidush-sheriatil*, ed.1, Beirut: Darul Hadi, 2001.
42. Valon Myrta, *Mekasidut-teshri'il-islami fis-sijaseti uel-hukm*, doktoraturë e mbrojtur në Universitetin e Jordanit, 2016, e pabotuar.
43. Xhasir Aude, *Maqasid al-Shariah as Philosophy of Islamic Law: A Systems Approach* (Qëllimet e Sheriatit si filozofi i ligjit islam: një qasje sistemesh), London-Washington: El-ma'hedul âlemi lil-fikril-islami, 2007.
44. Xhasir Aude, *Maqasid; a beginner's guide*, London - Washington: The international institute of islamic thought, 2008.
45. Xhemaluddin Atijje, *En-nadharijjetul-âme lish-sheriatil-islamijje*, ed. 1, Matbeatul-Medine, 1988.
46. Xhemaluddin Atijje, *Nahve tef'ilil-mekasid*, Damask: Darul Fikr -Amman: El-Ma'hedul-alemi lil fikril islami, ed. 2, 2008.

Prof. ass. dr. Musa VILA

KOMUNIKIMI MASIV NË THIRRJEN ISLAME

Abstrakt

Tema në fjalë është e lidhur ngushtë me metodën e thirrësit në aspektin gjeneral apo masiv. Kjo metodë e ndihmon thirrësin shumë në të kuptuarit e pozicionit të tij para opinionit publik .Këtë temë e kemi filluar me mënyrën se si duhet të jetë komunikimi i thirrësit me të ftuarit dhe kemi folur për domosdoshmërinë e përdorimit të metodave të ndryshme dhe alternative nga ana e thirrësit. Po ashtu ai duhet të ketë parasysh metodën e gradualitetit apo siç themi hap pas hapi për të arritur synimin. Kjo metodë e ndihmon atë që të jetë më i besueshëm para opinionit. Po ashtu kjo temë përfshin edhe atë se thirrësi për të arritur suksesin e tij duhet të ketë edhe përkrahësit, të cilët ia lehtësojnë dhe e ndihmojnë në arritjen e objektivitetit.

Tema në fjalë përfshin edhe domosdoshmërinë e përsëritjes së çështjeve esenciale, bazike, për t'i ngulitur në zemrat e njerëzve. Këtu kemi trajtuar edhe metodën e inkurajimit dhe të frikësimit, që ka një peshë jashtëzakonisht të madhe, ku jo pak njerëz do të përfitojnë dhe përqafojnë mësimet e thirrësit.

Fjalët kyçe: komunikim masiv, thirrës, metoda, inkurajim, frikësim.

HYRJE

S'ka dyshim se komunikimi masiv apo i përgjithshëm është prej metodave më të suksesshme të komunikimit. Po ashtu ka qenë metodë edhe në kohën kur Pejgamberi a.s. i ftonte njerëzit kur ishte në Mekë. Në këtë epokë ajo paraqitej në horizont të hapur. Kjo metodë i mundësoi që të përfitonte zemrat e disa personaliteteve. Në komunikimin gjeneral thirrësi duhet të karakterizohet nga një modesti e veçantë duke përdorur edhe fjalë të buta edhe të ëmbla. Thirrësi duhet të jetë në gjendje të nuhatë se çfarë kategorie janë ata që ka para vetes, a janë njerëz të thjeshtë, bujq, fermerë, administratorë apo intelektualë.

Komunikimi i thirrësit me të ftuarit

Thirrësi i shërben misionit të tij me të gjitha mundësitë, aftësitë dhe lidhjet e ndryshme që ka me njerëzit, si në shtëpi, në shkollë, në rrugë, në mjete të transportit etj., ngase thirrësi është një person me ambicie në mendimet e tij, kështu që ai mendimet e tij mundohet t'ua paraqesë njerëzve në të gjitha rastet dhe momentet që i jepen. Nganjëherë ka momente që nuk kursen asgjë nga vetja, duke dhënë shpjegimet e tij dhe duke i bërë të tjerët të kënaqen.

Komunikimi gjeneral apo i përgjithshëm ka një pozicion të lartë si metodë në misionin e daveit, që për nga dobia ndoshta ia kalon metodës së ligjëratës dhe të hytbes e të ngjashme me to. Komunikimi gjeneral në epokën mekase është paraqitur me një horizont të hapur. Ajo ka qenë e veçuar në hapësirë në shumicën e rasteve. Nuk ka dyshim se në mesin e njerëzve ka të ngritur dhe të thjeshtë, kështu që thirrësi duke shfrytëzuar dobësitë e të tjerëve dhe mungesën e përvojës për polemikë e ka më të lehtë të triumfojë. Në këtë kontekst Kurani e porositi të Dërguarin a.s. me këto fjalë:

وَاصْبِرْ عَلَىٰ مَا يَقُولُونَ وَاهْجُرْهُمْ هَجْرًا جَمِيلًا

“Dhe ki durim ndaj asaj që të thonë dhe largohu atyre i matur (me ndarje të mirë dhe me dinjitet).”¹

Në komunikimin gjeneral thirrësi duhet të jetë modest, i qetë dhe të përdorë fjalë të buta dhe të ëmbla. Ai duhet të ndiejë dhe nuhatë orientimin e palës duke qenë në gjendje të dallojë drejtimet se a janë të pozitës apo të opozitës. Thirrësi duhet të ketë në konsideratë këto pika:

1. Pasi të gjendet në vendin e bisedës, ai me edukatë dhe urtësi të lartë duhet të dijë se si ta ndërpresë bisedën e tyre. E, nëse i jepet rasti që ta fillojë ai bisedën, patjetër duhet ta nisë me butësi dhe dhembshuri, përndryshe nuk duhet ta marrë fjalën, ngase në shumicën e rasteve polemikat të çojnë në hidhërim, urrejtje, ndasi dhe ofendime. Kurani na e ka ndaluar që të ofendojmë zotat e jobesimtarëve, ngase një gjë e tillë ndikon që edhe jobesimtarët ta ofendojnë Allahun xh.sh.. Ai xh.sh. thotë:

وَلَا تَسُبُّوا الَّذِينَ يَدْعُونَ مِن دُونِ اللَّهِ فَيَسُبُّوا اللَّهَ عَدْوًا بِغَيْرِ عِلْمٍ

“Dhe mos i fyej ata (idhujt) që mosbesimtarët i adhurojnë përveç Allahut, që të mos e fyejnë Allahun pa të drejtë e pa asnjë dije.”²

Po ashtu edhe:

نَهَى رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ عَنِ الْمِرَاءِ

“Profeti ynë a.s. na i ka ndaluar polemikat e kota.”³

2. Thirrësi duhet t’i lërë anash pengesat me të gjitha format e tyre, ngase ai është si shembulli i gjuetarit, i cili para tij ka gjahun, kështu që nuk duhet të ketë pengesë për ta gjuajtur atë. Prej sfidave të tij do të jetë se sa është i armatosur dhe me çfarë mjeshtërie do ta përdorë ar-

¹ Kuran, El-Muzemmil: 10.

² Kuran, El-En’am: 108.

³ “Sunen Ebi Davud”, botoi Dar Err-Risaleh el-Alemijeh, viti 2009m -1430h, vëll. II, fq. 553.

mën e tij. Sa u përket Profetëve, ata si armë kishin edhe mu'xhizet, që ishin të veçanta për ta, ndërsa ne patjetër duhet të mbështetemi në fjalën e butë, në eliminimin e pengesave, braktisjen e çdo shkakut që bën që të ndikojmë në mënyrë negative tek ai që ftojme. Thirrësi duhet të shprehë modesti para palës tjetër, kur e heton se po i rri larg thirrësit. Në këtë mënyrë i jep rast palës për afrim dhe interesim, në mënyrë që më pas të kërkojë vetë takim apo ta ndjekë bisedën e tij. Personin që vë në shënjestër thirrësi duhet ta konsiderojë si të ishte një i sëmure që ka nevojë për kurim dhe shërim. Kjo do të jetë e lehtë kur thirrësi t'i shfaqet me afërsi, butësi dhe vlerësim, të cilat i shpreh përmes dëftimit apo sinjaleve trupore dhe lëvizjeve modeste dhe të qeta. Kështu që personi le ta shohë thirrësin si njeri të afërt, joshës dhe tërheqës, se këtu qëndron edhe shërimi i tij.

3. Thirrësi duhet të braktisë lavdërimin, mendjemadhësinë dhe veçimin nga të tjerët sepse njerëzit e urrejnë vetëlavdërimin dhe të veçuarit nga të tjerët. Thirrësi u flet atyre me oratori të thjeshtë dhe pa bërë dallime. Ai u drejtohet atyre sikur të jetë i njëjtë me ta (i një rangu), e mirësia dhe epërsia i takon Allahut. Për këtë Allahu xh.sh. urdhëron dhe thotë:

فِيمَا رَحْمَةٍ مِنَ اللَّهِ لَنْتَ لَهُمْ وَلَوْ كُنْتَ فَظًّا غَلِيظَ الْقَلْبِ لَانْفَضُّوا مِنْ حَوْلِكَ...

“Dhe nga mëshira e Allahut (ti o Muhamed) u solle but me ta. Po të kishë qenë i rreptë e me zemër të ashpër, ata do të kishin hequr dorë prej teje.”⁴

⁴ Kuran, Ali Imran: 159.

Domosdoshmëria e përdorimit të metodave të ndryshme nga ana e thirrësit

Urtësia që kërkohet nga thirrësi është shumëllojshmëria në metodat e thirrjes ashtu siç e kërkon situata, koha dhe momenti, por gjithmonë duke pasur parasysh zgjedhjen e metodës më të lehtë para metodave që janë më të vështira dhe delikate.

Metodat e llojllojshme duhen përdorur patjetër në bisedat e thirrjes. Thirrësi vigilent nuk ngurtësohet vetëm me një gjendje (metodë) dhe nuk përdor vetëm një rrugë të ngurtë, por përdor metoda të ndryshme në thirrje për në rrugën e Allahut, në mënyrë që të jetë tërheqës dhe t'i shtojë emocionet e të ftuarve. Në këtë drejtim kemi mësimet që na vij-në nga Nuhu a.s., i cili filloi ta ftonte popullin e tij natën dhe ditën, fshehurazi dhe haptazi, herë ua tërhoqi vërejtjen e herë i inkurajoi ata me shpresë se ndoshta populli do të vetëdijesohej. Kurani e përshkruan metodën e tij me këto fjalë:

قَالَ رَبِّ إِنِّي دَعَوْتُ قَوْمِي لَيْلًا وَنَهَارًا . فَلَمْ يَزِدْهُمْ دُعَائِي إِلَّا فِرَارًا .
... ثُمَّ إِنِّي دَعَوْتُهُمْ جِهَارًا . ثُمَّ إِنِّي أَعْلَنْتُ لَهُمْ وَأَسْرَرْتُ لَهُمْ إِسْرَارًا .

“Ai tha: o Zoti im, vërtet unë e ftova popullin tim natën dhe di-tën (fshehurazi dhe haptazi). Por thirrja ime nuk u shtoi atyre gjë veçse largimin (e tyre nga e vërteta)... Pastaj vërtet unë i thirra hapur (me zë të lartë). Pastaj vërtet unë i njoftova edhe shumë herë fshehurazi.”⁵

Nuhu a.s. i përshkruan ata si populli i tij, duke e konsideruar veten prej mesit të tyre. “Hapjen e thirrjes së tij për popullin e vet Nuhu a.s. e bëri me thirrje për të kërkuar pranimin e mendjeve të tyre, duke thënë që ata janë populli i vet, si paraftesë për të pranuar thirrjen e tij, sepse njeriu dëshiron për popullin e vet atë që dëshiron edhe për veten”... Thirrja haptas e përgjithshme në nivel kolektiv bëhet në vendet ku ek-

⁵ Kuran, Nuh: 5-9.

zistojnë turma të mëdha, si në konferencat mbarëpopullore dhe takimet publike. Më pas Nuhu a.s. i thirri haptas në nivel më të ngushtë dhe më në fund i thirri fshehurazi, në mënyrë të veçantë, në takime individuale⁶.

Edhe pse Nuhu a.s. kishte përdorur metoda të ndryshme në thirrje, prapë nuk bënë dobi nga armiqësia dhe mendjemadhësia që ata kishin.

Është shumë me rëndësi në këtë tematikë domosdoshmëria e metodave të ndryshme në thirrje, ngase ka prej të ftuarve që më lehtë i përgjigjen ftesës së hapur, ka të tjerë që u përshtatet ftesa e fshehtë, ka të tjerë që u përshtatet ftesa e veçantë dhe ka të tjerë që u përshtatet ftesa publike apo në grupe. Një metodologji të hapur dhe sheshazi e kishte përdorur edhe Pejgamberi a.s.. Qëllimi ishte që Pejgamberi a.s. të thërriste në rrugën e Zotit me gjithë energjinë, forcën dhe potencialin që kishte. Allahu xh.sh. e kishte urdhëruar Pejgamberin e Tij, Muhamedin a.s., që të ftonte haptazi:

فَاَصْدَعْ بِمَا تُؤْمَرُ وَأَعْرِضْ عَنِ الْمُشْرِكِينَ

“Ti prediko haptazi atë që të është urdhëruar dhe distancohu nga idhujtarët.”⁷

Metodat e gradualitetit në thirrje

Është mirë që thirrësi ta përdorë metodën më të lehtë para metodave të tjerave që janë të vështira. Shumë dijetarë e kanë përfituar këtë dobi nga thirrja e Nuhut a.s. drejtuar popullit të vet.

Prej hapave të parë që bëri Nuhu a.s. për thirrjen në rrugën e Zotit ishte thirrja e familjes dhe e rrethit të tij të ngushtë. Prej urtësive të Allahut xh.sh. është se çdo Pejgamber është dërguar te populli i vet me gjuhën që flasin, siç thotë Allahu xh.sh.:

⁶ Muhamed Ibn Ashurë, “Et-Tahrir vet-tenvir”, botoi Ed-Dar Et-Tunisije Lilneshr, Tunis, viti 2008 m, vëll. XIV, fq. 196.

⁷ Kuran, El-Hixhr: 94.

... وَمَا أَرْسَلْنَا مِنْ رَسُولٍ إِلَّا بِلِسَانٍ قَوْمِهِ لِيُبَيِّنَ لَهُمْ

“Ne nuk kemi çuar asnjë të Dërguar, përveçse në gjuhën e popullit të tij, për t’u shpjeguar atyre (shpalljet e Zotit)”.⁸

Kjo bëri që të pranohej sa më shpejt thirrja e të Dërguarit dhe t’i besohej asaj sepse po të vinte ndonjë i Dërguar i panjohur për ta, ndoshta do ta akuzonin për ato që nuk i posedonte, mirëpo kur Pejgamberi ishte nga mesi i tyre, atëherë ata e dinin besueshmërinë, moralin dhe biografinë e tij, gjëra të cilat i shtyjnë të besojnë ata që kërkojnë të vërtetën.

Një gjë tjetër gjithashtu është se njeriu interesohet më shumë për popullin e tij, për interesat dhe udhëzimin e tyre, më shumë se dikush tjetër. Për këtë arsye Allahu xh.sh. urdhëron Nuhun a.s. që ta thërrasë popullin e tij dhe t’ua tërheqë vërejtjen duke thënë: **أَنْ أَنْذِرُ قَوْمَكَ** - *“Tërhiqja vërejtjen popullit tënd.”*⁹

Përveç thirrjes së familjes dhe rrethit të tij të ngushtë, Nuhu a.s. më pas ndërmoi hapin tjetër të thirrjes së tij, duke iu drejtuar masës dhe popullit në përgjithësi, të gjitha gjeneratave, pa dallim moshe, pasi qëllimi i thirrësit është udhëzimi i njerëzve në rrugën e Zotit xh.sh. dhe që e gjithë njerëzia të shkojë sipas programit të Allahut xh.sh. dhe të ballafaqohen me armiqtë e thirrjes që qëndrojnë përballë tyre.

Ibn Abasi r.a. tregon: “Kur u shpall vargu kuranor: **“dhe këshilloje farefisin tënd të afërm (o Muhamed)”**, i Dërguari i Allahut a.s. doli jashtë dhe u ngjiti në kodrën Saffa dhe thirri: **“Ja sabahah!** (shprehje për alarm dhe rrezik). Njerëzit thanë: **“Kush është ai?”** Pastaj ata u mblodhën rreth tij, e pastaj ai (i Dërguari a.s.) tha: **“Dëgjoni! Nëse ju njoftoj se kalorësia (e ushtrisë armike) po marshon dhe po i ngjitet anës tjetër të kësaj kodre, a do të më besoni?”** Ata i thanë: **“Nuk të kemi dëgjuar kurrë të flasësh gënjeshtër”**. Pastaj ai tha: **“Unë jam kë-**

⁸ Kuran, Ibrahim: 4.

⁹ Kuran, Nuh: 1.

shillues i qartë për ju për një ndëshkim të ashpër përpara jush.” Ebu Lehebi tha: “U shfarofsh! A vetëm për këtë shkak na mblodhe?” Pastaj Ebu Lehebi u largua. Kështu u shpall kaptina “El Mesed” (Iu thafshin duart Ebu Lehebit)¹⁰”.

Shihet qartë se Nuhu a.s. kishte përdorur metoda të ndryshme në thirrje, për një kohë mjaft të gjatë, që kishte zgjatur një mijë vite pa pesëdhjetë. E tërë kjo kohë kishte kaluar duke përdorur metoda të ndryshme të thirrjes. Kur u bëhej monotone një metodë, ai përdorte metodën tjetër duke i thirrur me të gjitha artet e retorikës. Ai kishte derdhur mund të madh në këtë kohë të gjatë, kurse rezultati ishte fare i paktë. Ky rezultat të bën të futesh në pesimizëm dhe ta mbyllësh zemrën dhe të dyshosh te vetvetja, por kjo nuk duhet të jetë çështje e thirrësit. Ai ka për obligim ta kryejë detyrimin e tij, të japë angazhim në metodologjinë e tij në mënyrë që të arrijë t’i udhëzojë njerëzit përmes mësimit dhe udhëzimit. Sa i përket rezultatit dhe udhëzimit, ajo është çështje e Atij në dorën e të Cilit janë zemrat e njerëzve.

Udhëzimi është dy llojesh

a) *Udhëzimi me mësime* (el irshad - ta’lim), që është metodë e Profetëve dhe atyre që i pasojnë ata. Ky udhëzim ndodh nëpërmjet ftesës dhe veprimtarisë së të Dërguarve të Allahut dhe ftuesve të tjerë të zgjedhur e të përkushtuar, të cilët përhapin të vërtetën dhe ftojnë drejt saj, drejt udhës së drejtë. Allahu xh.sh. thotë:

وَأَنَّكَ لَتَهْدِي إِلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ

“Dhe vërtetë ti je ai që mund t’i udhëzosh në rrugën e drejtë”.¹¹

¹⁰ “Sahihul Buhari”, botoi Dar Ibn Kethiir, Bejrut-Damask, viti 2002m-1423h, nr. 4971.

¹¹ Kuran, Shura: 52.

b) *Udhëzim i plotë nga Allahu (tevfik)*. Ai ia hap zemrën dikujt për të kuptuar të vërtetën, besimin e pastër islam. Allahu xh.sh. thotë:

إِنَّكَ لَا تَهْدِي مَنْ أَحْبَبْتَ وَلَكِنَّ اللَّهَ يَهْدِي مَنْ يَشَاءُ وَهُوَ أَعْلَمُ بِالْمُهْتَدِينَ
“*Vërtetë ti (o Muhamed) nuk mund ta udhëzosh atë që do ti, por Allahu e udhëzon kë të dojë*”.¹²

Përkrahja e thirrësit dhe sukcesi i tij

Thirrësit në rrugën e Allahut nuk duhet të bien në pesimizëm e as në monotoni, por duke përdorur metoda të shumta dhe të ndryshme ta kryejnë obligimin e tyre me besnikëri dhe saktësi, ndërsa rezultati mbetet gjithmonë pronësi e Allahut xh.sh.. Kemi rastin kur në Ditën e Kiametit do të vijë një i Dërguar i Allahut e me atë një grup njerëzish (të cilët e kanë besuar dhe pasuar); do të vijë një i Dërguar i Allahut e me të një apo dy persona; gjithashtu do të vijë në Ditën e Kiametit një i Dërguar i Allahut e me të asnjë person. Ai Profet që nuk ka asnjë me vete nuk do të thotë se e ka kryer obligimin e tij me mangësi, përkundrazi ai e ka kryer në mënyrë të plotë si të gjithë Pejgamberët e tjerët, por sukcesi dhe rezultati janë të Allahut, se atij të Dërguari do t'i përgjigjet një apo asnjë. Kur Pejgamberit a.s. iu shfaq mërzia dhe pesimizmi për shkak se populli i tij nuk i besonte, atëherë Kurani iu drejtua me këto fjalë:

فَذَكِّرْ إِنَّمَا أَنْتَ مُذَكِّرٌ . لَسْتَ عَلَيْهِمْ بِمُصَيِّرٍ .

“*Kështu pra, kujtoji ata (këshilloji ata o Muhamed), ti je vetëm një përkujtues. Ti nuk je dhunues mbi ta*”.¹³

Pra, thirrësit në kohën e sotme duhet të përfitojnë nga metodat dhe mënyrat e thirrjes së Profetëve, në veçanti duke përdorur metodat e ndryshme dhe të llojllojshme, të cilat u përgjigjen kushteve dhe rretha-

¹² Kuran, El-Kasas: 56.

¹³ Kuran, El-Gashije: 20-21.

nave që jetojmë, pavarësisht situatave dhe rrethanave që ndodhemi dhe vështirësive që hasim. Thuhet *“Të mençurin nuk e paralizojnë intrigat”*.

Thirrësi duhet të largohet nga lakmitë dhe gjërat që janë në duart e njerëzve, ashtu që të ngrihet në pozitën që e meriton në fushën e thirrjes. Thirrësi nuk duhet të presë prej askujt pasuri për punën që bën, që të mos mendojë dikush se thirrësit e shfrytëzojnë davetin për të arritur në interesat e tij personale. Ai duhet që shpërblimin ta presë nga Allahu Fuqiptotë. Në këtë kontekst Nuhu a.s. ia drejton thirrjen popullit të tij me fjalët:

وَيَا قَوْمِ لَا أَسْأَلُكُمْ عَلَيْهِ مَالًا إِنْ أَجْرِيَ إِلَّا عَلَى اللَّهِ

“O populli im! Unë për këtë nuk kërkoj nga ju kurrfarë pasurie.

*Mua më shpërblen vetëm Allahu”.*¹⁴

Domosdoshmëria e përforcimit dhe e përsëritjes në fushën e davetit

Përsëritja e vazhdueshme e çështjeve ndryshon plotësisht nga metodat e ndryshme, ngase përsëritja ndodh në çështjet esenciale, ndërsa ndryshueshmëria ndodh vetëm në metodë dhe ekspozim.

Tematika e tevhidit është përsëritur dhe kërkuar shumë herë nga të gjithë Pejgamberët dhe thirrësit deri në Ditën e Kiametit, përveçse metoda e ekspozimit ndryshon nga personi në personin tjetër e në to nuk ka monotoni. Myslimani e dëgjon pesë herë në ditë ezanin dhe assesi nuk i bëhet monoton ngase shpreh në një farë mënyre tevhidin në Allahun xh.sh. dhe ibadetet e Tij.

Këtu do të paraqesim disa tematika esenciale në të cilat kanë ftuar të gjithë Pejgamberët, duke i përforcuar dhe përsëritur pa u bërë monotone. Ndër këto tematika mund të cekim:

¹⁴ Kuran, Hudë: 29.

1. Ftesa në besim se Allahu është një e nuk bëhet dy.
2. Ftesa në besim për ringjalljen dhe llogaridhënien.
3. Ftesa në edukimin e shpirtave dhe ngritjen morale të tyre.
4. Ftesa në ibadetet bazike apo shtyllat e Islamit.
5. Ftesa për të sqaruar shpërblimet dhe ndëshkimet, ngase njeriu nuk do të llogaritet përveçse për veprat e tij.
6. Ftesa për drejtësi dhe barazi në mes njerëzve.
7. Ftesa për devotshmëri dhe sinqeritet dhe sqarimi se tokën do ta trashëgojnë robërit e drejtë të Allahut.

Këto tematika apo baza të thirrjes janë përsëritur te të gjithë Pejgamberët. Secili prej tyre ka ftuar në këto çështje. Thirrësit duhet të ndjekin rrugën e tyre të ndritshme e jo të bëhen monotone në përsëritjen e shtyllave, bazave dhe rregullave të fesë.

Metoda e inkurajimit dhe e frikësimit

Inkurajimi në ato gjëra që u bëjnë dobi njerëzve dhe që përfitojnë prej tyre është një metodë mjaft ndikuese në pranimin e thirrjes, sepse i ftuari do t'i mendojë pasojat e pranimit të tij e më pas mundohet që t'i realizojë ato gjëra që i bëjnë dobi në këtë botë dhe në tjetrën. Nuhu a.s. e inkurajonte popullin e vet për të mirat e kësaj dhe të botës tjetër, me shpresë se do t'i përgjigjen. Në fillim ai e inkurajoi popullin e vet për të mirat e kësaj bote duke u thënë:

فَقُلْتُ اسْتَغْفِرُوا رَبَّكُمْ إِنَّهُ كَانَ غَفَّارًا. يُرْسِلِ السَّمَاءَ عَلَيْكُمْ مِدْرَارًا.
وَيُمِدُّكُمْ بِأَمْوَالٍ وَبَنِينَ وَيَجْعَلُ لَكُمْ جَنَّاتٍ وَيَجْعَلُ لَكُمْ أَنْهَارًا.

“E u thashë: Kërkoni falje nga Zoti juaj, i Cili është Falës i madh, që Ai t’ju dërgojë shi të bollshëm, t’ju shtojë pasurinë dhe fëmijët tuaj dhe të bëjë për ju kopshte e lumenj!”¹⁵

¹⁵ Kuran, Nuh: 10-12.

Natyrë e njeriut nxiton kah të mirat dhe dobisë e kësaj bote. Fahrudin Err-Rrazi në tefsirin e tij thotë: “Gjërat e premtuara nga Nuhu a.s. në këto ajete, nga të mirat e kësaj bote, janë pesë: 1. Zbritja e shiut me bollëk; 2. Shumimi i pasurisë; 3. Shumimi i fëmijëve; 4. Bërja e kopshteve dhe 5. Bërja e lumenjve.”¹⁶

Në ajetet e lartpërmendura, Allahu xh.sh. sqaron se besimi i sinqertë, pendimi dhe kërkimi i faljes nga Zoti nuk janë shkaqe vetëm për shlyerjen e mëkateve, por janë edhe shkaqe të shtimit të të mirave, shkaqe të furnizimit me pasuri dhe fëmijë. Këto ajete na udhëzojnë për përdorimin e metodës së inkurajimit në thirrjen që ua bëjmë njerëzve në këtë fe. Kjo metodë gjithashtu ishte edhe metodë e Musait a.s. dhe Harunit a.s., në thirrjen që ia bënë Faraonit. Kjo gjithashtu ishte edhe metodë e Muhamedit a.s..

Thirrësi duhet të përfitojë nga kjo metodë në inkurajimin që i bën popullit të vet, duke u sqaruar atyre se këto dhunti janë të lidhura me besimin në Allahun xh.sh.. Ekzistojnë disa njerëz që i bëjnë mëkate Allahut xh.sh. edhe pse kanë nevojë për pasuri e fëmijë, ndërsa ata e harrojnë lidhshmërinë ndërmjet adhurimit të Allahut dhe realizimit të kërkesës së tyre për të mirat e dynjasë dhe ahiretit.

Ekziston edhe premtimi i gjashtë i bërë nga Nuhu a.s. për të mirat e kësaj bote, siç tregon Allahu xh.sh. nga gjuha e Nuhut a.s.:

... وَيُؤَخِّرْكُمْ إِلَىٰ أَجَلٍ مُّسَمًّى إِنَّ أَجَلَ اللَّهِ إِذَا جَاءَ لَا يُؤَخَّرُ لَوْ كُنْتُمْ تَعْلَمُونَ.

“Dhe t’ju lërë (të jetoni) deri në një afat të caktuar. Dhe, kur t’ju vijë çasti i caktuar i Allahut, askush nuk do të mund ta shtyjë atë, veç sikur ta dinit!”¹⁷

¹⁶ Fahrudin Err-Rrazi “Tefsirul Kebir” (Miftahul gajbi). Darul Kutub el-ilmijeh, 1990m - 1411h, vëll. 30, fq. 123.

¹⁷ Kuran, Nuh: 4.

Ai është premtimi i shtyrjes së ndëshkimit, pasi konsiderohet e mirë e kësaj bote dhe njerëzit dëshirojnë të jetojnë më gjatë pa ndëshkime nga Zoti xh.sh.. Këtë premtim e ndërrojnë njerëzit sepse të gjitha të mirat e kësaj bote janë të lidhura me mbetjen e njeriut gjallë pa u ndëshkuar, sepse nuk ka kurrfarë dobie nga kjo botë në rast se njeriu ndëshkohet e shkatërrohet, ndërsa mohimi i Allahut nga një popull është shkak për ndëshkimin dhe shkatërrimin e tij sa më shpejt.

Duke e komentuar këtë ajet, Ibn Kethiri në tefsirin e tij thotë: “Pra, shpejtoni në bindje dhe adhurim para se t’ju vijë ndëshkimi, sepse nëse Allahu urdhëron për ndodhinë e një gjëje të tillë, s’ka kush që mund ta kthejë apo ta ndalojë, sepse Ai është i madhërishëm¹⁸”.

Inkurajimi për të mirat e botës tjetër (ahiretit) dhe shpërblimet e saj, që është qëllimi më kryesor i njeriut, përmendet nga gjuha e Nuhut a.s. drejtuar popullit të tij duke thënë:

... يَغْفِرْ لَكُمْ مِنْ ذُنُوبِكُمْ... - “*Ai ju fal ju disa nga mëkatet tuaja*”.¹⁹

Pa dyshim që prej dobive më të rëndësishme për ata që i përgjigjen thirrjes së të Dërguarit të tyre është ajo që ka premtuar Allahu xh.sh. për besimtarët në ahiret, për falje të mëkateve dhe hyrje në xhenet.

Më pas Nuhu a.s. përdor metodën e frikësimit, duke ia tërhequr vërejtjen popullit të tij nga ndëshkimi i Allahut xh.sh.. Kjo metodikë e Nuhut a.s. përmendet në disa ajete në Kuran, si:

... يَا قَوْمِ اعْبُدُوا اللَّهَ مَا لَكُمْ مِنْ إِلَهٍ غَيْرُهُ إِنِّي أَخَافُ عَلَيْكُمْ عَذَابَ يَوْمٍ عَظِيمٍ.

“Ne patëm dërguar Nuhun te populli i vet, e ai u tha: “O populli im, adhurojeni Allahun, ju nuk keni zot tjetër përveç Tij. Unë kam frikë se do të bjerë mbi ju dënimi i një dite të madhe!”²⁰

¹⁸ Ibn Kethir, “Tefsirul Kur’anil adhim”, botoi Darul Kutub el-ilmijeh, viti 2004, vëll. IV, fq. 425.

¹⁹ Kuran, Nuh: 4.

²⁰ Kuran, A’rafë: 59.

إِنَّا أَرْسَلْنَا نُوحًا إِلَىٰ قَوْمِهِ أَنْ أَنْذِرْ قَوْمَكَ مِنْ قَبْلِ أَنْ يَأْتِيَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ

“Ne dërguam Nuhun te populli i tij dhe i thamë: Paralajmëro popullin tënd para se t’i vijë një dënim i dhembshëm!”²¹

Nëse inkurajimi për të mira është prej faktorëve të pranimit të thirrjes për në rrugën e Zotit, edhe frikësimi është një faktor tjetër, madje mund të themi se ai është faktori më i fortë, sepse nuk ka kush që mund ta shpëtojë njeriun nga ndëshkimi i Allahut në dynja, por edhe në ahiret, gjersa ndëshkimi i ahiretit është më i fortë dhe më i rëndë.

Kërcënimi është metodë e Kuranit, e cila përmendet në ajete të shumta, pasi çdo Pejgamber ua tërhiqte vërejtjen popullit të tij nga ndëshkimi i Allahut xh.sh., nëse ata nuk i përgjigjeshin ftesës për besim.

Preferohet për thirrësit që të mos mjaftohen vetëm me frikësimet e kërcënimeve dhe duke ua tërhequr vërejtjen popullit, por këto duhen të shoqërohen edhe me këshilla, duke ua kujtuar atë që u ka ndodhur popujve të mëparshëm.

²¹ Kuran, Nuh: 1.

Conclusions

Mass or general communication has a high position as a method in the mission of da'wah, which in terms of usefulness surpasses the method of discourse and sermon, and the others like them.

The caller must, with high education and wisdom, know how to engage in da'wah or conversation, he must also know how to interrupt the conversation or conclude the topic of the call. The caller resembles the hunter, who has the prey in front of him, so there should be no obstacle to hunt him.

The person targeted by the caller should be considered as a sick patient in need of treatment and healing. The caller should abandon praise, arrogance, and isolation from the others, because people hate these things.

Literatura:

- Kurani Fisnik.
- Sahih El-Buharij, Kairo Mustafa El Halebij, 1378.
- Sunen Ebi Davud, El Mektebe Tixharije, korrigoji: Muhamed Muhidijn, 1369, H. Egjipt.
- Muhamed Ibn Ashur, "E Tahrir dhe Tenvir", Darul Mearif, Kajro.
- Fahrudin E Rrazij, "Tefsirul Kebir", Darul Kutub El Islamiye, Bejrut, 1411 H.
- Ibn Kethir, "Tefsirul Kurani El Adhim", botimi i tretë, 1956, Egjipt.

Prof. ass. dr. Rexhep SUMA

REALITETI I NDJENJËS SË FRIKËS NDAJ ZOTIT DHE INKURAJIMIT PËR SHPËRBLIMIN E TIJ NË MISIONIN E DAVETIT

Abstrakt

Me rëndësi qenësore në misionin e thirrjes islame është që të krijojmë një balancë mes dy nocioneve (tergib ve terhib), edhe pse disa anojnë më shumë nga përdorimi i gjuhës në davet, me anë të së cilës në ligjëratat e tyre mbizotëron përdorimi i argumenteve që kanë të bëjnë me ndëshkimit mbi atë të mëshirës dhe tolerancës. Këtu kemi parasysh të qartësojmë se disa i kanë kufizuar ligjëratat vetëm në dënimin në varr, asketizmin, largim nga çdo kënaqësi e kësaj bote, kurse nga ana tjetër ekzistojnë disa ligjërata të cilat objektivin e kanë drejt zbavitjes dhe kënaqësive të kësaj bote etj..

Në fakt mësimet islame na prezantojnë se argumentet që flasin mbi ekzistimin e dënimit në varr janë të sakta, xhehenemi është i vërtetë dhe këtë askush nuk mundet ta mohojë, por ajo që duhet të theksohet dhe t'i kushtohet vëmendje forcës ekuilibruese gjatë ligjëratave fetare në përdorimin dhe shtjellimin e këtyre dy nocioneve në mënyrë që të paraqiten sa më drejt këto çështje. Gjendja sociale dhe kulturore në një vend të caktuar detyron që ligjërata islame të ndikohet nga ambienti social dhe të jetë prodhim i asaj situatë ku predikohet.

Pra, frika e njerëzve nga ndëshkimi i Zotit dhe inkurajimi për shpërblimin e Tij përfshin çdo gjë që e pasionon të thirrurin drejt shpërblimit të Tij dhe xhenetit si dhe e frikëson me dënimin me zjarr.

Apriori është mirë që të njihemi me nocionet e inkurajimit dhe frikës ndaj Zotit në rrafshin teorik dhe praktik të komunikimit të thirrjes islame dhe ky studim trajton pikërisht këtë çështje.

Fjalë kyçe: *Inkurajim, frikësim, davet, komunikim, shpërblim.*

Hyrje

Fillimisht duke sqaruar nocionet e tergit dhe terhibit shohim se “*erragbe*” në aspektin etimologjik ka kuptimin e dëshirës ndaj një gjëje, preferim, drejtim, synim. Në Kuran thuhet:

فَإِذَا فَرَغْتَ فَانصَبْ وَإِلَىٰ رَبِّكَ فَارْغَبْ

“*E kur ta kryesh (obligimin), atëbotë mundohu me adhurim (Allahut). Dhe, vetëm te Zoti yt përqendro synimin!*” (Esherh, 7-8)

Kurse “*regibe an*” derivon në kuptimin: nuk e do, ushqen neveri.

وَمَنْ يَرْغَبْ عَنْ مِلَّةِ إِبْرَاهِيمَ إِلَّا مِنْ سَفَاهَةٍ نَفْسُهُ

“*E kush largohet prej fesë së Ibrahimit përveç atij që poshtëron vetveten.*” (El Bekare, 130).

Ndërsa në aspektin terminologjik fjala “*tergib*” d.m.th. çdo gjë që e pasionon të thirrurin që t’i përgjigjet thirrjes islame, të pranojë të vërtetën dhe të shfaqë stabilitet në të¹.

Sa i përket nocionit “*terhib*”, rrjedh prej foljes “*rehibe, jerhebu, rehbetun* që ka kuptimin, kërcënim, ka frikë, trembet etj.”²

¹ Abdulkërim Zejdani, *Usuleda`ve*, Muesesetu errisale, bot. 9, Bejrut, 1999, f. 437.

² Muhamed bin Mukrim bin Ebu el Fadl Xhemaludin Ibn Mendhur el Ensari erruvejfei el efrikij, *Lisan el arab*, Bejrut, botimi 2, 1997, v. 3, f. 131.

Nga aspekti terminologjik “terhib” përfshin çdo gjë që e frikëson dhe ia tërheq vërejtjen të thirrurit që të mos bëhet prej atyre që nuk janë stabilë pasi e pranojnë atë³.

Allahu xh.sh. në lidhje me çështjen e muslimanëve ka thënë:

إِنَّهُمْ كَانُوا يُسَارِعُونَ فِي الْخَيْرَاتِ وَيَدْعُونَنَا رَغَبًا وَرَهَبًا ۗ وَكَانُوا لَنَا خَاشِعِينَ

“Ata përpiqeshin për punë të mira, na luteshin duke shpresuar dhe duke u frikësuar, ishin respektues ndaj nesh.” (El Enbija, 90)

Metoda në thirrjen islame është pjesë e thirrjes, ndaj ndjekja gabim e metodës sigurisht që reflektohet edhe në rezultat. Metoda vjen para esenciales. Në të gjitha sistemet juridike ky është rregull me vlefshmëri konstante. Këtë mund ta përshtatim edhe në thirrje. Ngjashëm me këtë, nëse duam që porosia jonë, përpos plotësimit të ndjenjave tona, të bartë me vete vlera edhe përtej kësaj, të arrijë synimin e vet, si dhe nëse duam që të lë impresionjé mendjen e bashkëbiseduesit tonë, duhet që detyrimisht t’i përshtatemi metodës në thirrje dhe përshtatjes së stilit të duhur⁴.

Vështruar në natyrën e krijimit të qenies njerëzore dëshirën dhe frikën e ka të brumosur, ndaj edhe shikuar edhe nga plani dhe metodat që janë të përcaktuara nga Krijuesi ynë për t’i ftuar dhe për t’ua komunikuar fenë islame mbetet edhe ngacmimi që predikuesi duhet të prekë dhe të influencojë te masa nëpërmjet këtyre elementeve shpirtërorë. Po ashtu gjatë predikimit dhe komunikimit të fesë thelbësore mbetet që asnjëra të mos anojë më shumë në njërën anë duke anashkaluar tjetrën sepse kjo do të shpinte drejt e në rrezik. Thirrësi islam duhet që në ligjërimin e tij të balancojë frikën e njerëzve nga ndëshkimi i Zotit, në këtë botë dhe në tjetrën, për shkak të gjynaheve të tyre, dhe shpresës për të ftuar shpërblimin e madh që gjendet te Zoti, mirësive, begative

³ Tefvik el Vai, *Edda `vetu ilallah*, Daru -I- jekin, botimi dytë, Measure, 1995, f. 199.

⁴ Ramazan Kayan, *Thirrja islame akt profetik*, Fleta, Prizren, 2017, f. 115.

të pafundme të Tij, triumfit në këtë botë etj.. Kjo i shtyn ata t'i kthehen Zotit, bindjes ndaj Tij, pendimit dhe dashurisë së Tij⁵.

Metodat janë qenësore për një mision të suksesshëm në davet

Ndjekja e këtyre metodave në rrugën e komunikimit të fesë islame është qenësore për një mision të suksesshëm si dhe nxit ndjenjat te masa për përqaftimin e së vërtetës që ndërtohet mbi përdorimin e metodës së frikësimit nga dënimi si dhe metodën e inkurajimit të tyre për shpërblimin e madh që i pret. Eventualisht mosbalancimi i këtyre dy nocioneve mund të prodhojë efekte të kundërta. Ligjërimi i Kuranit e përmban edhe frikën ndaj Zotit, e kjo është garanci që të nxisë ndjenjat tek i ftuari për të përvetësuar mësimet me të cilat ka zbritur Islami dhe praktikimi i tyre⁶.

Duke iu referuar gurrës së pashtershme hyjnore, Kuranit, gjatë leximit dhe meditimit të ajeteve kuranore vërejmë se sa herë që përmendet xheneti, pas tij përmendet zjarri apo sa herë që përmendet ndëshkimi, Allahu xh.sh. pas tij përmend mëshirën dhe mirësinë. Thirrësi duhet të veprojë me këtë mënyrë në fushën e thirrjes dhe nuk i mjafton të përmendë vetëm frikën, por krahas saj të përmendë dhe kujtojë edhe shpresën, por mund të veprojë edhe të kundërtën.

إِنَّ اللَّهَ يُدْخِلُ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ جَنَّاتٍ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا
الْأَنْهَارُ وَالَّذِينَ كَفَرُوا يَتَمَتَّعُونَ وَيَأْكُلُونَ كَمَا تَأْكُلُ الْأَنْعَامُ وَالنَّارُ مَثْوًى لَهُمْ
*“Ata që besuan dhe bënë vepra të mira Allahu do t'i fusë në xhe-
nete, nëpër të cilat rrjedhin lumenj, e ata që nuk besuan, përje-*

⁵ Adnan AlAraur, *Menhexh ed-da'vefidev'iel vaki elmuasir*, Xhaizetu-l- Naif bin AbdulazizAl Saud el alemije lissuneti ennebevijje, vedirasat el islamije elmuasire, Riad, 2005, f. 68.

⁶ Muhamed Nexhati, *El Kuran ve ilmun-n-nefsi*, Darushuruk, botim i shtatë, Kajro, 2001, f. 156.

tojnë kënaqësi (në këtë jetë) dhe hanë ashtu si hanë kafshët, e vendi i tyre është zjarri". (Muhamed, 12)

Po ashtu Allahu xh.sh. përmend atë që ka thënë Hudi a.s.:

فَاتَّقُوا اللَّهَ وَأَطِيعُوا وَاتَّقُوا الَّذِي أَمَدَّكُمْ بِمَا تَعْلَمُونَ أَمَدَّكُمْ بِأَنْعَامٍ وَبَيْنَ
وَجَنَاتٍ وَعُيُونٍ إِنِّي أَخَافُ عَلَيْكُمْ عَذَابَ يَوْمٍ عَظِيمٍ

“Pra, kini frikë Allahun dhe në dëgjoni mua! Kini frikë Atë që u pajisi me çka e dinin vetë. U pajisi me mjete gjallërimi e me djem. Me kopshte e me burime uji. Vërtet, unë i frikësohem dënimit tuaj në një ditë të madhe.” (Eshuara, 131-135)

Kurse në suren Muhamed, Allahu xh.sh. në pjesën e parë të ajetit flet për përshkrimin e mirësive të xhenetit, që u është premtuar të devotshmëve, kurse pjesa e fundit e ajetit të fut frikën në palcë.

مَثَلُ الْجَنَّةِ الَّتِي وَعَدَ الْمُتَّقُونَ فِيهَا أَنْهَارٌ مِنْ مَاءٍ غَيْرِ آسِنٍ وَأَنْهَارٌ مِنْ لَبَنٍ لَمْ
يَتَغَيَّرَ طَعْمُهُ وَأَنْهَارٌ مِنْ حَمْرٍ لَذَّةٍ لِلشَّارِبِينَ وَأَنْهَارٌ مِنْ عَسَلٍ مُصَفًّى وَهُمْ
فِيهَا مِنْ كُلِّ الثَّمَرَاتِ وَمَغْفِرَةٌ مِّن رَّبِّهِمْ كَمَنْ هُوَ خَالِدٌ فِي النَّارِ وَسُقُوا مَاءً
حَمِيمًا فَقَطَّعَ أَمْعَاءَهُمْ

“Shembulli i xhenetit, i cili u është premtuar atyre që janë ruajtur (të devotshëm), në të cilin ka lumenj me ujë për pije, lumenj nga qumështi me shije të paprishur, lumenj nga vera e shijshme për njerëz, lumenj nga mjalti i kulluar, ata kanë aty edhe gjithfarë lloj pemësh, kanë edhe falje nga Zoti i tyre (a është i njëjtë) a si ai që është përgjithmonë në zjarr dhe u shuhet etja me ujë të valë që ua copëton zorrët e tyre?” (Muhamed, 15)

Kurse duke kaluar në praktikën e Muhamedit a.s., kjo metodë gjen aplikim shumë të gjerë sikurse është rasti kur i Dërguari a.s. ua kishte premtuar xhenetin atyre që ia kishin dhënë besën, siç ishte rasti me besatimin e parë në Akabe: “Në qoftë se ju i përmbaheni kësaj, do të

keni xhenetin, por nëse tradhtoni për ndonjë prej këtyre, çështja juaj i takon Allahut të Madhërishëm. Nëse do, ju dënon, e nëse do, ju fal”.⁷

Në jetën e përditshme janë disa individë të cilët tërë kohën e tyre janë në ngarendje pas dëshirave dhe pasioneve të ndryshme e pas materializmit dhe pasioneve pas veprave të ulëta. Këtë kategori njerëzish metodat e ndjenjës së frikës ndaj Allahut xh.sh. e ndalojnë dhe lëvizin ndërgjegjen e tij të brendshme nga pasojat e veprimeve të tij. Nisur nga ky fakt ajeti në vazhdim na sinjalizon se:

اللَّهُ نَزَّلَ أَحْسَنَ الْحَدِيثِ كِتَابًا مُتَشَابِهًا مَثَابًا تَفْشَعُرُ مِنْهُ جُلُودُ الَّذِينَ يَخْشَوْنَ رَبَّهُمْ ثُمَّ تَلِينُ جُلُودُهُمْ وَقُلُوبُهُمْ إِلَىٰ ذِكْرِ اللَّهِ ۗ

“Allahu e shpalli të folmen më të mirë, librin, të ngjashëm në mrekulli, të përsëritur herë pas herë (me këshilla e dispozita), që prej (dëgjimit të) tij rrëqethen lëkurat dhe zemrat e tyre.” (Ez-Zumer, 23)

Komentatori i Kuranit, Imam Ibn Kethiri, duke komentuar këtë ajet kuranor qartëson se kontekstet e Kuranit nganjëherë janë në njëkuptimësi të ngjashme, ndërsa herëve të tjera vjen duke përmendur diçka dhe të kundërtën e saj, si për shembull përmend myslimanët e pastaj jobesimtarët, xhenetin dhe xhehenemin e të ngjashme. Ndërsa te vargjet e përsëritura të Kuranit herë paraqiten si në ajetin: *“E s’ka dyshim se të mirët janë në kënaqësinë e përjetimeve (në xhenet). Dhe se mëkatarët janë në xhehenem”.* (El Infitar, 13-14), po ashtu kemi edhe ajetin tjetër: *“Jo, të mos rrinë gafil! Se shënimet e veprave të mëkatarëve janë në Sixhin (në një libër shënimesh të të këqijave më të dëmshme)”* (El Mutaffifin, 7), e deri tek: *“Jo, nuk janë të njëjtë! Se libri i të mirave gjendet në Il-lijjinë!”* (El Mutaffifin, 18), edhe: *“Ky është një përkujtim. E është e sigurt se ata që janë të ruajtur, kanë një ardhmëri të mirë”.* (Sad, 49) si dhe: *“Kjo është kështu, E, sa u përket atyre që nuk besuan, ata*

⁷ Ibn Hisham, *Essiretu ennebevijje*, Daru-l- Ihja etturath el islami, botim i parë, Bejrut, 1995, vol. 2, f. 47.

kanë një ardhmëri shumë të keqe”, (Sad, 55), e shumë kontekste të tjera që janë vargje të përsëritura të Kuranit⁸.

Hadithet profetike inkurajojnë dhe japin shpresë

Duke u mbështetur edhe në hadithet e Muhamedit a.s., hasim mjaft argumente të cilat i ka porositur dhe kanë gjetur aplikim në jetën e tij të përditshme. Ai na e tërheq vërejtjen të mos i japim përparësi jetës së kësaj bote ndaj botës tjetër.

Enes bin Maliku tregon: *“Muhamedi a.s. ka thënë: Pak më parë m’u shfaq xheneti dhe zjarri në hapësirën e këtij muri...”* Ndër të tjera Muhamedi a.s. tha: *“Nuk ka gjë për të cilën u është premtuar, vetëm se e kam parë në këtë falje që bëra. Pashë tek sollën zjarrin dhe ky ishte momenti kur më patë të zbrapsesha, nga frika se mos më prekte flaka e tij, derisa e pashë në të edhe hajdutin me kërrabë tek tërhiqte në zjarr shkopin e tij. Ai u vidhte haxhilerëve me kërrabën e tij dhe nëse ata e dallonin, u thoshte më ngeci (pa dashje) në kërrabë dhe nëse nuk e kishin mendjen, e merrte me vete. Aty pashë edhe gruan që e lidhi macen dhe nuk e ushqeu dhe as nuk e la të lirë të ushqej me kandrrat e tokës, derisa ngordhi nga uria. Më pas m’u shfaq xheneti dhe ky ishte momenti kur më patë tek eca përpara, derisa mbërrita në vendin tim dhe zgjata dorën për të kapur nga frutat e xhenetit që t’i shihnit, pastaj mendova të mos e bëj. Asgjë që ju është premtuar nuk ka ngelur pa e parë në këtë namaz që bëra.”*⁹

⁸ Imam Hafidh e bil Fida Ismaili bin Kethir el Kureshi Ed-dimeshki, *Tefsirul Kur’anil adhim*, Darul marifë, Bejrut, 1993, v. 4, f. 50.

⁹ Sahihu-l- Muslim, 904.

Cila është fshehtësia e urtësisë së ekuilibrit mes inkurajimit dhe frikësimit?

Kjo patjetër që duhet shikuar nga prizmi i natyrës së shpirtit njerëzor, e cila në konstrukt është e tillë që influencohet po në të njëjtën kohë nga ndjenja e frikës dhe joshja, i përgjigjet frikës sikurse edhe egos së dëshirës së vet. Aplikimi i këtij rregulli sigurisht që prek thellë në ndjenjat e shpirtit njerëzor duke lënë ndikim të vazhdueshëm në të. Kur njeriu vepron një gjynah, ai ndien fajin dhe përgjegjësinë dhe frika e shoqëron nga ndëshkimi i Allahut xh.sh. dhe e bën të reflektojë dhe të gjejë një shtegdalje nga kjo situatë. Dyert e pendimit janë të hapura, madje Islami këtë në çdo moment e thekson. Individu kur dëgjon për shpërblimin e Zotit, e shton devotshmërinë, mirësinë, ndërsa është edhe e kundërta kur dëgjon për ndëshkimin e Zotit, ai shmanget nga mëkati si p.sh. në këtë drejtim kemi ajetin kuranor:

وَمَنْ يَعِصِ اللَّهَ وَرَسُولَهُ وَيَتَعَدَّ حُدُودَهُ يُدْخِلْهُ نَارًا خَالِدًا فِيهَا وَلَهُ عَذَابٌ مُهِينٌ

“Kush e kundërshton Allahu dhe të Dërguarin e Tij, dhe i shkel dispozitat e Tij, atë e shtie në zjarr të përjetshëm. E për të është një dënim i rëndë”. (En-Nisaë, 14)

Sikurse edhe ajetin tjetër kuranor:

إِنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا بِآيَاتِنَا سَوْفَ نُصَلِّيهِمْ نَارًا كَلَّمًا نَضِجَتْ جُلُودُهُمْ بَدَلْنَاهُمْ جُلُودًا غَيْرَهَا لِيَذُوقُوا الْعَذَابَ إِنَّ اللَّهَ كَانَ عَزِيزًا حَكِيمًا

“Është e vërtetë se ata që mohuan argumentet Tona, do t'i hedhim në zjarr. Sa herë që u digjen lëkurat e tyre, Ne ndërrojmë lëkura të tjera që të shijojnë dënimin. Allahu është i plotfuqishëm, i drejtë”. (En-Nisaë, 56)

Edhe ajeti tjetër është në këtë vazhdë:

يَوْمَ يُسْحَبُونَ فِي النَّارِ عَلَىٰ وُجُوهِهِمْ ذُوقُوا مَسَّ سَقَرَ

“Ditën kur me fytyrat e tyre do të tërhiqen zvarrë në zjarr. “Vuani dënimin Sekar” (emër i një xhehenemi).” (El Kamer, 48)

Sigurisht që predikuesi (da’iu) gjatë komunikimit të fesë islame sikur të vinte theksin në përdorimin vetëm të këtyre ajeteve kuranore në kontakt me masën, ky komunikim do të prodhonte frikë dhe llahtari dhe si rrjedhojë do të mbillte pesimizëm. Po ashtu ky lloj komunikimi vetëm sa do t’i shtynte njerëzit të vazhdonin të zhyteshin në mëkate dhe përfundimisht do të shuanin shpresat e fundit për mëshirën e të madhit Zot, pra me këtë do të paraqiste fenë me fotografi shumë të zymtë.

Ka shumë ajete që kërkojnë nga ne të paraqesim apo të jemi shprehëdhënës sikurse do të përmendim ajetet në vazhdim.

قُلْ يَا عِبَادِيَ الَّذِينَ أَسْرَفُوا عَلَىٰ أَنفُسِهِمْ لَا تَقْنَطُوا مِن رَّحْمَةِ اللَّهِ ۚ إِنَّ اللَّهَ يَغْفِرُ الذُّنُوبَ جَمِيعًا ۚ إِنَّهُ هُوَ الْغَفُورُ الرَّحِيمُ

“Thuaj: “O robërit e Mi, të cilët e keni ngarkuar me shumë gabime veten tuaj, mos e humbni shpresën ndaj mëshirës së Allahut, pse Allahu i falë të gjitha mëkatet, Ai është që shumë falë dhe është mëshirues!” (Ez-Zumer, 53)

Në një ajet tjetër po ashtu thotë:

إِلَّا مَن تَابَ وَآمَنَ وَعَمِلَ عَمَلًا صَالِحًا فَأُولَٰئِكَ يُبَدِّلُ اللَّهُ سَيِّئَاتِهِمْ حَسَنَاتٍ ۗ وَكَانَ اللَّهُ غَفُورًا رَّحِيمًا

“Përveç atij që është penduar dhe ka bërë vepër të mirë, të tillëve Allahu të këqijat ua shndërron në të mira. Allahu është mëshirues, ndaj Ai fal shumë”. (El Furkan, 70)

Mandej shpresën nga Zoti nuk bën ta humbë askush që e ndien veten besimtarë.

يَا بَنِي آذْهَبُوا فَتَحَسَّسُوا مِنْ يُوسُفَ وَأَخِيهِ وَلَا تَيَاسُوا مِنْ رَوْحِ اللَّهِ ۗ إِنَّهُ لَا
يِيَّاسُ مِنْ رَوْحِ اللَّهِ إِلَّا الْقَوْمُ الْكَافِرُونَ

“Vetëm populli jobesimtarë e humb shpresën në Allahun”. (Jusuf, 70)

Pra, thirrësi në Islam duhet të tregojë aftësi dhe përgjegjësi duke përdorur metodën e shpresëdhënës dhe metodën e frikës njëkohësisht dhe asnjëra të mos peshojë karshi tjetrës, por të tregohet një ekuilibër mes tyre.

Kur jemi te përvojat dhe metodat e përdorimit të tyre nga aspekti i mëhershëm historik, hasim p.sh. ngjarjen e Lukmanit me të birin dhe këshillat që ia jep atij, të cilat mbështeten mbi këto dy metoda siç është rasti në ajetin kuranor:

وَإِذْ قَالَ لُقْمَانُ لِابْنِهِ وَهُوَ يَعِظُهُ يَا بُنَيَّ لَا تُشْرِكْ بِاللَّهِ ۗ إِنَّ الشِّرْكَ لَظُلْمٌ
عَظِيمٌ

“(përkujtoju popullit tënd) Kur Lukmani duke e këshilluar, birit të vet i tha: “O djali im, mos i përshkruaj Allahut shok, sepse idhujtaria është padrejtësi më e madhe!” (Lukman, 13)

Pra, në këta ajet kuranor është përdorur metoda e frikësimit duke ia kujtuar atij se shirku është padrejtësi më e madhe. Kurse në ajetin tjetër Zoti thotë:

وَصَبَّيْنَا الْإِنْسَانَ بِوَالِدَيْهِ حَمَلَتُهُ أُمُّهُ وَهَنَّا عَلَىٰ وَهْنٍ وَفَصَّالَةٌ فِي عَامَيْنِ أَنْ
اشْكُرْ لِي وَلِوَالِدَيْكَ إِلَيَّ الْمَصِيرُ

“Ne njeriun e kemi urdhëruar për (sjellje të mira ndaj) prindërit të vet, sepse nëna e vet atë e barti me mund pas mudi dhe pas dy viteve ia ndau gjirin. (e porositëm) Të jesh mirënjohës ndaj Meje dhe ndaj dy prindërve tu, pse vetëm tek Unë kthimi juaj”. (Lukman, 14)

Respekti ndaj prindërve dhe bamirësia ndaj tyre është ndërlidhur me çështjen hyjnore dhe me shpërblimin apo eventualisht ndëshkimin dhe vetë fjala e fundit (mesijr) përmban dy çështje: frikësimin dhe inkurajimin, ku secili do të shpërblehet sipas veprës¹⁰.

Shikuar në perspektivë vërejmë se frikësimi dhe inkurajimi ishin metoda të të Dërguarve përgjatë historisë së tyre. Pejgamberët erdhën me shpallje dhe mesazh, të vërtetën dhe udhëzimin, ata që e pranuan, u udhëzuan nga Allahu xh.sh., nuk do të devijohen dhe nuk do të dëshpërohen. Ndërsa ata që nuk patën vullnetin të përqafojnë këtë dritë, iu tërhoq vërejtja për mjerim e fatkeqësi në të dy botët, kërcënim dhe frikë për ta, ndëshkim dhe zemërim i Zotit për shkak se nuk pranuan urdhrat e Tij.

وَمَا تُرْسِلُ الْمُرْسَلِينَ إِلَّا مُبَشِّرِينَ وَمُنذِرِينَ ۗ فَمَنْ آمَنَ وَأَصْلَحَ فَلَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ

“Ne të Dërguarit nuk i dërgojmë ndryshe vetëm si përgëzues dhe qortues. E kush besoi dhe u përmirësua, ata nuk kanë as frikë as brengë.” (El Enamë, 48)

رُسُلًا مُبَشِّرِينَ وَمُنذِرِينَ لِئَلَّا يَكُونَ لِلنَّاسِ عَلَى اللَّهِ حُجَّةٌ بَعْدَ الرُّسُلِ ۗ وَكَانَ اللَّهُ عَزِيزًا حَكِيمًا

“Të Dërguar që ishin lajmëzues e kërcënues, ashtu që pas dërgimit të Dërguarve njerëzit të kenë fakt (arsyetim) para Allahut. Allahu është i pavarur në sundimin e vet dhe di si të veprojë”.
(En-Nisaë, 165)

Ndërsa për Muhamedin a.s. në Kuran thotë:

¹⁰ Xhevhëre Turejfi, *Fik'h da'veti el enbija*, Riad, pa vit botimi, f. 43.

يَا أَيُّهَا النَّبِيُّ إِنَّا أَرْسَلْنَاكَ شَاهِدًا وَمُبَشِّرًا وَنَذِيرًا وَدَاعِيًا إِلَى اللَّهِ بِإِذْنِهِ وَسِرَاجًا
مُنِيرًا وَبَشِيرِ الْمُؤْمِنِينَ بَأَنَّ هُمْ مِنَ اللَّهِ فَضْلًا كَبِيرًا

“O ti Pejgamber, Ne të dërguam ty dëshmues, lajmëtar përgëzues e qortues. Dhe me urdhrin e Allahut, thirrës për në rrugën e Tij dhe pishtarë ndriçues. E besimtarëve jepu shtetë se prej Allahut ata kanë dhuntit të madhe”. (El Ahzabë, 45-47)

Në çka është terghi dhe terhibi?

Synimi me përdorimin e metodës së inkurajimit është të arrihet kënaqësia e Zotit në të dy botët, që të shpërblehemi dhe të gjejmë shpëtimin e fitoren në botën tjetër. Këtë në esencë përmban edhe terhibi, i cili synon përdorimin e metodave të ndenjës së frikësimit te masa, që ta këtë gjithnjë në vëmendje frikën ndaj Zotit dhe nga ndëshkimi i Tij, ashtu siç e kemi edhe te historia e dërgimit të Pejgamberëve që do t'i paraqesim në vijim.

Fillimisht prezantojmë rastin e Nuhut a.s., i cili duke i komunikuar konceptet e fesë popullit të vet u tha:

فَقُلْتُ اسْتَغْفِرُوا رَبَّكُمْ إِنَّهُ كَانَ غَفَّارًا يُرْسِلِ السَّمَاءَ عَلَيْكُمْ مِدْرَارًا وَيُمْدِدْكُمْ
بِأَمْوَالٍ وَبَنِينَ وَيَجْعَلْ لَكُمْ جَنَّاتٍ وَيَجْعَلْ لَكُمْ أَنْهَارًا

“Unë u thashë: “Kërkoni falje Zotit tuaj, se Ai vërtet falë shumë; Ai ju lëshon nga qielli shi me bollëk, Ju shumon pasurinë dhe fëmijët, ju bën të keni kopshte dhe ju jep lumenj.” (Nuh, 10-12).

Kurse sa i përket Musait a.s., Kurani na komunikon bisedën e tij drejtuar masës:

يَا قَوْمِ لَكُمْ الْمُلْكُ الْيَوْمَ ظَاهِرِينَ فِي الْأَرْضِ فَمَنْ يَبْصُرْنَا مِنْ بِأَسِ اللَّهِ إِنْ
جَاءَنَا ۚ قَالَ فِرْعَوْنُ مَا أُرِيكُمْ إِلَّا مَا أَرَىٰ وَمَا أَهْدِيكُمْ إِلَّا سَبِيلَ الرَّشَادِ وَقَالَ
الَّذِي آمَنَ يَا قَوْمِ إِنِّي أَخَافُ عَلَيْكُمْ مِثْلَ يَوْمِ الْأَحْزَابِ مِثْلَ دَابِ قَوْمِ نُوحٍ
وَعَادٍ وَثَمُودَ وَالَّذِينَ مِنْ بَعْدِهِمْ ۚ وَمَا اللَّهُ يُرِيدُ ظُلْمًا لِلْعِبَادِ وَإِنِّي قَوْمِ إِنِّي

أَخَافُ عَلَيْكُمْ يَوْمَ التَّنَادِ يَوْمَ تُثَلَوْنَ مُدْبِرِينَ مَا لَكُمْ مِنَ اللَّهِ مِنْ عَاصِمٍ ۗ
وَمَنْ يُضِلِلِ اللَّهُ فَمَا لَهُ مِنْ هَادٍ

“O populli im, sot pushteti është juaji në vend, po kush do të na mbrojë prej dënimit të Allahut nëse na përfshin? “Faraoni tha: “Unë nuk kam mendim tjetër t’ju jap pos atij që ju thashë dhe nuk jam duke ju udhëzuar tjetër pos në rrugën e drejtë!” Ndërkaq, ai që kishte besuar tha: “O populli im, unë kam frikë për ju se po u gjen si i gjeti popujt e mëparshëm (grupet e mëparshme)!” Si rasti i popullit të Nuhut, të Adit, të Themudit dhe të atyre që ishin pas. Allahu nuk bën padrejtësi ndaj robërve. O populli im, unë kam frikë për ju ditën e britmës (të mjerimit), Ditën, kur nga frika ktheheni të ikni, e nuk ka kush që të prapësojë prej jush dënimin e Allahut, Atë që Allahu e lë të humbur, për të nuk ka ndonjë që e drejton”. (Gafir, 29-33)

Inkurajimi (tergibi) sipas mësimëve kuranore

1. Në atë që njeriu e arrin nga triumfi në jetën e kësaj bote, në krenari e dinjitet, siç thuhet në Kuran:

وَعَدَ اللَّهُ الَّذِينَ آمَنُوا مِنْكُمْ وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ لَيَسْتَخْلِفَنَّهُمْ فِي الْأَرْضِ كَمَا اسْتَخْلَفَ الَّذِينَ مِنْ قَبْلِهِمْ وَلَيُمَكِّنَنَّ لَهُمْ دِينَهُمُ الَّذِي ارْتَضَىٰ لَهُمْ وَلَيُبَدِّلَنَّهُمْ مِنْ بَعْدِ خَوْفِهِمْ أَمْنًا ۗ

“Atyre nga mesi juaj të cilët besuan dhe bënë vepra të mira Allahu u premtoi se do t’i bëjë zotërues në atë tokë ashtu si pat bërë zotërues ata që ishin para tyre dhe fenë të cilën Ai e pëlqeu për ta, do ta forcojë, e në vend të frikës Ai do t’u dhurojë siguri”. (En-Nurë, 55)

وَلِلَّهِ الْعِزَّةُ وَلِرَسُولِهِ وَلِلْمُؤْمِنِينَ

“Ndërsa e tërë krenaria i takon Allahut, të Dërguarit të Tij dhe besimtarëve”. (El Munafikunë, 8)

وَأُورِثَكُمْ أَرْضَهُمْ وَدِيَارَهُمْ وَأَمْوَالَهُمْ وَأَرْضًا لَمْ تَطَّوْهَا

“E juve ju la trashëgim tokën e tyre, shtëpitë e tyre, pasurinë e tyre dhe tokën që ende nuk e keni shkelur”. (El Ahzabë, 27)

كَتَبَ اللَّهُ لَأَعْلَبَنَّ أَنَا وَرُسُلِي ۚ إِنَّ اللَّهَ قَوِيٌّ عَزِيزٌ

“Allahu ka përcaktuar (shkruar në Levhi Mahvudh): “Unë dhe të Dërguarit e Mi, pa tjetër do të ngadhënjem!” Allahu është i fortë, ngadhënjyes”. (El Muxhadel, 21)

وَأُورِثْنَا الْقَوْمَ الَّذِينَ كَانُوا يُسْتَضَعُونَ مَشَارِقَ الْأَرْضِ وَمَعَارِبَهَا الَّتِي بَارَكْنَا فِيهَا

“E atij populli që ishte i nënshtruar, i trashëguam lindje e perëndim të tokës, që Ne e bekuam (me të mira)”. (El Arafë, 137)

2. Inkurajimi po ashtu paraqitet mbi atë që njerëzit jetojnë në siguri dhe i gëzohen dhuntisë së paqes dhe qetësisë.

فَلْيَعْبُدُوا رَبَّ هَذَا الْبَيْتِ الَّذِي أَطْعَمَهُمْ مِّنْ جُوعٍ وَآمَنَهُمْ مِّنْ خَوْفٍ

“Pra, le ta adhurojnë Zotin e kësaj shtëpie, i cili i ushqeu pasurisë dhe i siguroi prej çdo frike!” (Kurejsh, 3-4)

إِنَّ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ سَيَجْعَلُ لَهُمُ الرَّحْمَنُ وُدًّا

“Nuk ka dyshim se ata që bënë vepra të mira, atyre i Gjithëmshirshmi do t’u krijojë (në zemrat e tyre) dashuri.” (Merjem, 96)

Në hadithin që transmeton Ebu Hurejra, Muhamedi a.s. thotë: “Nëse Zoti e do një njeri, e thërret Xhibrilin: -O Xhibril, Unë e dua filanin, prandaj duaje edhe ti! E do edhe Xhibrili. Më pas Xhibrili thërret: -O banorët e qiellit, Zoti e do filanin, prandaj dojeni edhe ju dhe e duan edhe banorët e qiellit. Më pas dashuria i vendoset edhe në mes të njerëzve të tokë¹¹”.

¹¹ Muslimi në kapitullin bamirësia, vizita dhe kultura, 8/40-41.

3. Inkurajimi është edhe në faktin që njerëzit gëzojnë të mirat e kësaj bote, i përmbahen udhëzimit të drejtë dhe qëndrueshmërisë në ndjekjen e udhëzimeve hyjnore, ashtu siç e cek edhe Allahu në Kuran:

مَنْ عَمِلَ صَالِحًا مِّنْ ذَكَرٍ أَوْ أُنْثَىٰ وَهُوَ مُؤْمِنٌ فَلَنُحْيِيَنَّهٗ حَيَاةً طَيِّبَةً ۗ
وَلَنَجْزِيَنَّهُمْ أَجْرَهُمْ بِأَحْسَنِ مَا كَانُوا يَعْمَلُونَ

“Kush bën vepër të mirë, qoftë mashkull ose femër, e duke qenë besimtar, Ne do t’i japim atij jetë të mirë (në këtë botë), e (në botën tjetër) do t’u japim shpërblimin më të mirë për veprat e tyre”. (En-Nahl, 97)

وَأَن لَّوِ اسْتَقَامُوا عَلَى الطَّرِيقَةِ لَأَسْقِينَهُمْ مَّاءً غَدَقًا

“Sikur ata (idhujtarët) t’i përmbaheshin rrugës së drejtë, Ne do t’u lëshonim atyre ujë me bollëk”. (El Xhin, 16)

وَلَوْ أَنَّهُمْ أَقَامُوا التَّوْرَةَ وَالْإِنْجِيلَ وَمَا أُنزِلَ إِلَيْهِمْ مِّن رَّبِّهِمْ لَأَكَلُوا مِن فَوْقِهِمْ
وَمِن تَحْتِ أَرْجُلِهِمْ ۗ مِّنْهُمْ أُمَّةٌ مُّقْتَصِدَةٌ ۗ وَكَثِيرٌ مِّنْهُمْ سَاءَ مَا يَعْمَلُونَ

“Dhe, sikur ta zbatonin Teveratin, Inxhilin dhe Kuranin, që u zbritën nga Zoti i tyre, ata do të kishin furnizim me bollëk nga qielli dhe toka. Është një grup i drejtë (i matur) prej tyre, por është e keqe ajo që punojnë shumica prej tyre”. (El Maide, 66)

لِّلَّذِينَ أَحْسَنُوا فِي هَذِهِ الدُّنْيَا حَسَنَةٌ ۗ وَلَدَارُ الْآخِرَةِ خَيْرٌ ۗ وَلَنِعْمَ دَارُ الْمُتَّقِينَ

“Ata që bënë vepra të mira, edhe në këtë jetë kanë shpërblim të mirë, por shpërblimi i tyre në botën tjetër është shumë më i mirë, e sa vend i mirë është ai i të devotshmëve”. (En-Nahl, 30)

4. Nga elementet më të vlefshme në kuadër të inkurajimit është edhe të kujtuarit e së kaluarës së lavdishme që kishin muslimanët dikur, kur përhapën dije, drejtësi, liri, e paqe në tërë botën duke gjuhëzuar padrejtësinë dhe të keqen. Edhe pse kjo nga aspekti tjetër mund të mbjellë pesimizëm tek ata, por edhe këtu shfaqet mjeshtëria e komuni-

kimit të këtyre fakteve duke tërhequr paralel mes së kaluarës së bujshme dhe realitetit që po jeton bota islame.

5. Vlera e inkurajimit qëndron në adhurimin dhe dashurinë ndaj mirësisë dhe humanitetit, duke pasur për bazë faktin se adhurimi (ibadeti) na frenon nga të këqijat e gjërat negative sociale dhe ngre ndjenjat dhe vetitë e moralit të lartë dhe largon nga cytjet e shejtanit.

Ndjenja e frikës (terhibi)

Kjo metodë gjen zbatim në rastet kur masa është e predisponuar të mendojë vetëm rreth kënaqësive të kësaj bote të përkohshme. Këtu del në pah metoda që do të drejtojë vizionin e tyre kah bota e përjetshme, së cilës i duhet dhënë përparësi, edhe pse shpirtrat njerëzorë kënaqen me bukuritë dhe të mirat e kësaj bote kalimtare, që vazhdimisht tërheqin natyrën njerëzore rreth tyre, kundrejt veprave të larta e fisnike, të cilat janë pak në botën postmoderne. Forcat e errëta ngulmojnë për shkatërrimin e çdo të mire me qëllimin që të fitojnë një shpazim të ulët dhe të ndyrë dhe nuk pushojnë së vepruari për të ndryshuar udhëzimin me humbjen.

فَخَلَفَ مِنْ بَعْدِهِمْ خَلْفٌ وَرِثُوا الْكِتَابَ يَأْخُذُونَ عَرَضَ هَذَا الْأَدْنَىٰ وَيَقُولُونَ سَيُغْفَرُ لَنَا وَإِنْ يَأْتِهِمْ عَرَضٌ مِثْلُهُ يَأْخُذُوهُ ۗ أَمْ يُؤْخَذُ عَلَيْهِم مِّيثَاقُ الْكِتَابِ أَنْ لَا يَقُولُوا عَلَى اللَّهِ إِلَّا الْحَقَّ وَدَرَسُوا مَا فِيهِ ۗ وَاللَّهُ الْأَخِرُ خَيْرٌ لِلَّذِينَ يَتَّقُونَ ۗ أَفَلَا تَعْقِلُونَ

“E pas tyre erdhi brezi që trashëgoi librin. Këta merrnin mjete të pavlerë të kësaj bote (lakmues që nuk dallonin të mirën a të keqen) e thoshin: “Do të na falje”, e merrnin atë përsëri. A nuk është marrë prej tyre zotimi në librin (Tevratin) se nuk do të thonë ndaj Allahut tjetër pos të vërtetës dhe ata e dinim mirë se

çka në të (libër). Po, a nuk po kuptoni se bota tjetër është më e mirë (se ajo çka merrnit ju) për ata që ruhen". (El Arafë, 169)

Nisur nga këto premisa predikuesi (imami) duhet të ketë synim veprimin që të tërheqë vërejtjen e masës nga mburrja me të mirat e kësaj bote dhe dhënia pas egove anësore dhe për këtë Kurani na sinjalizon duke thënë:

إِنَّمَا مَثَلُ الْحَيَاةِ الدُّنْيَا كَمَاءٍ أَنْزَلْنَاهُ مِنَ السَّمَاءِ فَاخْتَلَطَ بِهِ نَبَاتُ الْأَرْضِ مِمَّا يَأْكُلُ النَّاسُ وَالْأَنْعَامُ حَتَّىٰ إِذَا أَخَذَتِ الْأَرْضُ زُخْرُفَهَا وَازَّيَّنَتْ وَظَنَّ أَهْلُهَا أَنَّهُمْ قَادِرُونَ عَلَيْهَا أَتَاهَا أَمْرُنَا لَيْلًا أَوْ نَهَارًا فَجَعَلْنَاهَا حَصِيدًا كَأَن لَّمْ تَغْنَبْ بِالْأَمْسِ ۗ كَذَٰلِكَ نُفَصِّلُ الْآيَاتِ لِقَوْمٍ يَتَفَكَّرُونَ

"Shembulli i jetës së kësaj bote është si i një shiu që e kemi zbritur nga qielli, e me anën e të cilit gërshetohen bimët e tokës (mbi një dhe shpeshetohen të gjitha llojet) prej nga hanë njerëzit e kafshët deri kur toka të ketë marrë stolinë e vet dhe të jetë zbukuruar (me bimë, pemë e behar), e banorët e saj të mendojnë se janë të zotët e saj, e asaj i vjen urdhri ynë, natën ose ditën, Ne e bëjmë atë (të mbjellat) të korrur sikurse të mos ekzistonte dje. Kështu Ne u sqarojmë faktet njerëzve që mendojnë". (Junus, 10)

Jetëgjatësia e kësaj bote është momentale dhe argëtuese e përkohshme. Çdo investim nga ana e njeriut për të qëndruar gjithnjë në të është një gabim shumë i rëndë.

اعْلَمُوا أَنَّمَا الْحَيَاةُ الدُّنْيَا لَعِبٌ وَهُوَ زِينَةٌ وَتَفَاخُرٌ بَيْنَكُمْ وَتَكَاثُرٌ فِي الْأَمْوَالِ وَالْأَوْلَادِ ۗ كَمَثَلِ غَيْثٍ أَعْجَبَ الْكُفَّارَ نَبَاتُهُ ثُمَّ يَهْبِجُ فَتَرَاهُ مُصْفَرًّا ثُمَّ يَكُونُ حُطَامًا ۗ وَفِي الْآخِرَةِ عَذَابٌ شَدِيدٌ وَمَغْفِرَةٌ مِّنَ اللَّهِ وَرِضْوَانٌ ۗ وَمَا الْحَيَاةُ الدُّنْيَا إِلَّا لَمَتَاعٌ الْعُرُورِ

"Ju njerëz dijeni se jeta e kësaj bote nuk është tjetër vetëm se lojë, kalim kohe në argëtim, stoli, krenari mes jush dhe përpjekje në shtimin e pasurisë dhe të fëmijëve, e që është shembull i një

përpjekjeje në shtimin e pasurisë dhe të fëmijëve, e që është she-mbull i një shiu prej të cilit bima habit bujqit, e pastaj ajo thahet dhe e sheh atë të verdhë, mandej të thyer e llomitur, e në botën tjetër është dënimi i rëndë, por edhe falje mëkatesh dhe dhurim i kënaqësisë nga Allahu; pra jeta e kësaj bote nuk është tjetër vetëm se përjetim mashtrues”. (El Hadid, 20)

Rezyme

Me anë të këtij studimi jam munduar të sqaroj rëndësinë dhe peshën e madhe që ka metodologjia në shpjegimin e mësimëve hyjnore. Tema ime “Realiteti i ndjenjës së frikës ndaj Zotit dhe inkurajimit për shpërblimin e Tij në misionin e davetit”, sidomos në inkurajimin (tergib) dhe dhënien shpresë njerëzve, në veçanti atyre që kanë bërë mëkate shumë dhe përdorimi i kësaj gjuhe me këtë kategori njerëzish, por edhe me të tjerat, do të ngjallte shpresën për jetë dhe mos humbjen e shpresës që mëshira e Allahut xh.sh. është e madhe. Por, nga ana tjetër nuk duhet neglizhuar as metoda e ndjenjës së frikës (terhibit), që dijetarët islamë sugjerojnë të përdoret në raste të caktuara.

Conclusions

Through this study I have tried to clarify the importance and great weight that methodology has in explaining the divine teachings. My topic is "The reality of feeling fear of God and encouragement for His reward in the mission of da'wah", especially in encouraging (tergib) and giving hope to people especially those who have committed many sins and the use of this language with this category of people but also with others would raise the hope for life and not to lose the hope that the mercy of Allah is great. But, on the other hand, one should not forget the method of feeling fear (terhibit) that even islamic scholars suggest to be used in certain cases.

Burimet dhe literatura:

1. Abdulkerim Zejdani, *Usuledda've*, Muesesetu errisale, bot.9, Bejrut, 1999.
2. Muhamed bin Mukrim bin Ebu el Fadl Xhemaludin Ibn Mendhur el Ensari eruvejfei el efrikij, *Lisan el arab*, Bejrut, botim i 2, 1997, v.3.
3. Tefvik el Vai, *Edda'vetu ilallah*, Daru -l- jekin, botimi dytë, Mensure, 1995.
4. Ramazan Kayan, *Thirrja islame akt profetik*, Fleta, Prizren, 2017.
5. Adnan AlAraur, *Menhexh ed-da'vefidev'iel vaki elmuasir*, Xhaizetu-l-Naif bin AbdulazizAl Saud el alemije lissuneti ennebevijje, vedirasat el islamiye elmuasire, Riad, 2005.
6. Muhamed Nexhati, *El Kuran ve ilmun-n-nefsi*, Darushuruk, botim i shtatë, Kajro, 2001.
7. Ibn Hisham, *Essiretu ennebevijje*, Daru-l- Ihja etturath el islami, botim i parë, Bejrut, 1995, vol. 2.
8. Imam Hafidh e bil Fida Ismaili bn Kethir el Kureshi Ed-dimeshki, *Tefsirul Kur'anil adhim*, Darul marife, Bejrut, 1993, v. 4.
9. Sahihu-l-Muslim, 904.
10. Xhevhëre Turejfi, *Fik'h da'veti el enbija*, Riad, pa vit botimi.
11. Muslimi në kapitullin bamirësia, vizita dhe kultura, 8/40-41.

Prof. ass. dr. Muhamed JUSUFI

ARTI NË LEGJISLACIONIN ISLAM DHE RELIGJIONET IBRAHIMIKE

Abstrakt

Arti islam, qoftë poezia, drama, muzika, arkitektura e piktura, apo përshkrimi i tyre mbi baza fetare të miratuara nga ligji islam, nuk duhet kuptuar se nuk është një formë e edukimit fetar. Përkundrazi, është një veprim që mbështetet në tradita, ku artistët për të kënaqur autoritetet ose për motive të veçanta sillnin si vepër arti ngjarjet fetare të përmendura në Kuran, në librat e biografisë, në librat e historisë ose biografitë e mbretërve ose sulltanëve.

Qëllimi nuk ishte thjesht fetar sepse këto vepra arti nuk ishin një mjet për të nderuar vetë personin ose për ta shenjtëruar atë, siç u bë në artin e krishterë. Imazhet ikonike arritën një shkallë të lartë nderimi, mirëpo bizantinët filluan t'i adhuronin ikonat dhe kjo u ndal vetëm pas luftërave të ikonoklasmës. Kjo ishte në Kostandinopojë edhe para Krishterimit, artet në civilizimin e lashtë egjiptian, rafidian, grek e romak u përpoqën të shprehnin besimet në një mënyrë ilustruese.

Qëllimi kulturor që fshihet pas këtyre risive na bën të pranojmë sot se artet islame u kanë siguruar myslimanëve mundësi të gjera për të ngritur nivelin e kulturës së tyre fetare dhe të kësaj bote, historike dhe shoqërore, dhe i kanë dhënë botës mundësi të tjera për të

mësuar mbi realitetin e fesë, pasi është një mesazh i civilizuar që ai e arriti përmes bashkëveprimit me kulturat e popujve që e dënuan Islamin. Ajo e zhvillon atë sipas aspiratave njerëzore që myslimanët përqipen gjithmonë të arrijnë.

***Fjalët kyçe:** Islam, art, ndjenja, përshtypje, frikë, bindje, haram, hallall.*

Hyrje

Përpara se të sjellim mendimin e juristëve rreth artit në Islam, me theks të veçantë muzikës, pikturës dhe skulpturës, më duhet t'ua përkujtoj lexuesve se detajet rreth kësaj teme i kemi shtjelluar te tema e muzikës, në veçanti nëntitulli a është kënga dhe muzika haram, si dhe kemi sjellë kriteret që çdo mysliman duhet të ketë parasysh përpara se të arrijë në përfundime rreth haramit dhe hallallit. Gjithmonë në këtë temë kam cituar edhe autorin e librit *Estetika Islame*, i cili thotë: "...të qenët e këtyre hyjnive në formë njeriu, pra antropomorfizmi, është një koncept të cilin myslimani kurrë s'mund ta pranojë".

Që do të thotë se myslimanët kanë disa vija të kuqe, për të cilat nuk pranojnë të negociohet. Duke qenë se tema është e ndjeshme, them se duhet t'ia rikujtoj vetes dhe lexuesve edhe një herë kohën e Lajmëtarëve të Allahut (paqja qoftë mbi ta), përpara se të sjell mendimin e dije-tarëve më eminentë të kohës dhe me ta të mjaftohemi rreth kësaj teme të ndjeshme për shoqërinë tonë.

Lajmëtarët e Allahut dhe përshkrimi artistik i të Dërguarit a.s.

Allahu na mësoi se Lajmëtarët e Tij janë njerëz si gjithë të tjerët. Dërguesit e mesazhit hyjnor ishin melekë. As qenia njerëzore e as melekët nuk shenjtërohen nga myslimanët, në këtë rast as të Dërguarit e Allahut. Islami jo vetëm njeriun, por të gjitha krijesat që ekzistojnë në univers për nga përbërja nuk i trajton të veçantë, por si krijesa të Allahut, edhe pse elementin krijues e kanë të ndryshëm.

Prandaj, them se duhet të jemi të përmbajtur përpara pikturave të shfaqura edhe në “Miraxh Name”, piktura që përfaqësojnë ngjarje të shumta në këtë rast edhe të Dërguarin e Allahut, Muhamed a.s., që është një vepër e guximshme, e cila u kritikua ashpër, por që njëherazi kishte edhe mendime ndryshe. Këta të dytët mendohet se janë mendime më të moderuara. Këta të fundit e shohin përshkrimin piktoresk të të Dërguarit a.s. në qiell si një vepër edukative dhe nder, kështu thotë Therwet Ukashe: “Ata që ia lejuan vetes ta përshkruanin të Dërguarin e Allahut a.s. me fjalë, edhe pse nuk e pikturuan atë, nuk shoh dallim midis atyre që folën dhe që e pikturuan¹”.

Gjithmonë i bazuar në këtë autor, ai përshkruan pikturën me fjalë dhe thotë se imazhi i të Dërguarit a.s. ishte shfaqur nëpër librat e hershëm si një figurë e qëndrueshme, fytyrë bardhë me një pije të kuqe. Pikturë e lustruar. Vetulla të gjata dhe të lakuara. Fytyra e tij me pak mish në fytyrë, pa njolla dhe e gjatë, jo e rrumbullakët. Shtrohet pyetja a ishin piktorët besnikë e të denjë ndaj atyre përshkrimeve të Lajmëtarit të Allahut xh.sh., siç e përshkruan sahabët ose personalitetet e tjera të njohura përgjatë historisë? Natyrisht që piktorët kishin përshkrime të ndryshme, disa shprehnin kujdesin e tyre duke ua lejuar vetes që fytyrat e Lajmëtarëve të Allahut të shkëlqenin nga drita që tregon shkëlqimin hyjnor, që kur shikuesi ta shikonte, të mbulohej i tërë

¹ UKASHE, Thervet, “Mewsuatu et tesvir el Islami”, b. Nashirun, Liban, 2001, f. 4.

trupi me devotshmëri. Mjekra e tij shfaqej e butë, ndërsa butësia ishte frymëzim i ndershmërisë. Tiparet e fytyrës së tij nxirrnin një nur, që rridhte nga thellësia e shpirtit. Portretizimi i njerëzve të zakonshëm ishte një bosht i thjeshtuar sipas koncepteve estetike të artistëve.

Pra, qëllimi i kësaj që u tha më sipër ishte t'i shërbente kulturës fetare duke filluar me misionin e të Dërguarit në Isra dhe Miraxh ose luftërave, i cili është një qëllim arsimor i inkurajuar nga Islami. Allahu i Lartmadhëruar e mësoi njeriun të recitojë dhe të shpjegojë dhe Ai, i Lartmadhëruari, ia mësoi atij të gjithë emrat:

الرَّحْمَنُ. عَلَّمَ الْقُرْآنَ . خَلَقَ الْإِنْسَانَ . عَلَّمَهُ الْبَيَانَ

“Mëshiruesi ia mësoi Kuranin (robërve të Tij). Krijoi njeriun dhe e mësoi ta ndiejë dallimin”².

Këto ishin tiparet e para të shfaqjes së karakterit njerëzor dhe nuk ishte vetëm e shkruar ose verbale, por çdo mënyrë e mundshme ishte e veçantë, simbol ose imazh. Kështu arti islam u shërbeu qëllimeve të fesë dhe historisë së saj. Ai nderoi figurat e Islamit duke shprehur shfrytëzimet, sjelljen dhe traditat e tyre. Qëllimi i tij pas gjithë kësaj nuk ishte të imitonte Zotin, për sa kohë që distancohej nga krahasimi dhe realizmi, si në simbolikë ashtu edhe në metaforë. “Në fund të epokës mongole, Shah Rukh Ibn Timurlenk kishte urdhëruar botimin e librit shumë të famshëm, i cili përfaqësonte historinë e të Dërguarit të Allahut, Muhamedit a.s., nën titullin: Miraxh Name (1436 g.), që ndodhet në Paris, dhe çfarëdo që thuhej në këtë dorëshkrim dhe këto vizatime kundërshtojnë parimin e ndalimit të fotografisë, veçanërisht portretizimin e të Dërguarit a.s.. Ky libër mbetet një udhëzues arsimor

² Kuran, 55, El Rahman, 1-4. (Allahu i Lartmadhëruar e mësoi atë të bën dallimin midis vetes, kafshëve dhe krijesave të tjera. E bëri që ta ndiejë dallimin me anë të folurit, kuptuarit dhe të shkruarit. Të dallojë gjësendet duke i skicuar ose pikturuar gjërat në mungesë shkrimi. E gjithë kjo, që të mund të shfaqë dallimin e tij nga të tjerët.)

që na drejton me anë të tregimeve historinë e tij, a.s. që kanë lënë gjurmë efektive³”.

Gjatë asaj periudhe u shfaqën përmbledhje me poezi të ilustruara, të tilla si pesë kasidet (poezitë) e Nizamiut, *El-Bustan* të Saadiut, *Tregimet mbi Jusufin dhe Zulejhanë*. Që të gjitha këto ishin të ilustruara në miniaturë, vepra të piktorëve të shquar si Behzadiu (1514 g.).

Në epokën osmane piktura më shumë u shpreh në shërbim të xhihadit dhe fitoreve të myslimanëve. Nëpërmjet artit figurativ dhe atij poetik përshkruheshin jetët e sulltanëve, siç është libri *Albumi el-Fatih* vizatuar nga Ahmed Musa. Ky libër sjell skena kuranore dhe vepra autentike të Muhamedit a.s. në të folur dhe është përshkruar portreti i Muhamedit a.s., sipas përshkrimit që ka treguar Imam Aliu.

Piktori tjetër, Muhamed Sabah Kalim, ka pikturuar portrete njerëzish dhe kafshësh, të cilat kishin të bënin me përditshmërinë e jetës njerëzore. Në librin *Jeta e Sulltanëve* (el-Hur nameh) dhe librin e *Festave* (Sur nameh), skenat e përditshme shfaqen në një mënyrë naive, por jashtëzakonisht ekspresive, dhe në libra të tjerë shfaqen betejat e xhihadit që shprehin pamje të luftëtarëve nëpër beteja. Ilustrimet e civilizimit të Islamit nxorën më të mrekullueshmen, lavdinë, arkitekturën dhe zbulimet e tyre. Këto vizatime u transmetuan nga një dorëshkrim te tjetri nëpër letra e mure, vetëm e vetëm që të mund t'i shohim dhe lexojmë.

Xhamia mbeti si gjithmonë me shkrime (kaligrafi), përgjithësisht me ajete kuranore dhe dekorime të tjera në mozaik, qeramikë dhe dru, vargje artistike që shprehin civilizimin mysliman. Nëse kalojmë nga arkitektura tek artet plastike, veçanërisht piktura dhe skulptura, do të zbulojmë se ky art që mbushi muret e shumë prej ndërtesave të para, të tilla si Pallati el-Hajr, Pallati el-Mufexher dhe Pallati i vogël Amra, pastaj pallatet abasite në Samarra, të tilla si Pallati el-Xhevsak, deri tek

³ <https://allalom.yoo7.com/t700-topic>

osmanët, përfaqësonte dy gjëra. Ato shprehnin pjesën dekorative të lumturisë, gëzimit dhe argëtimit, që është një qëllim i njohur në artet plastike dhe e dyta ishte përfaqësimi edukativ si ai fetar dhe shkencor.

Të gjitha këto shfaqeshin përmes pikturave të murit, vizatimeve nëpër dorëshkrime ose vizatimeve në mjetet ose veglat e përdorimit. Ato përfaqësonin manifestimet e praktikave islame, të tilla si adhurimi, xhihadi, dija dhe politika. Këto vizatime gjithashtu përfaqësoheshin me skena pelegrinazhi dhe rrethrotullimi dhe historitë e sahabëve të të Dërguarit a.s., për hir të thirrjes, në luftërat e zhvilluara nga sulltanët në Persi dhe Turqi, që mëtonin pushtimet ose çlirimet dhe për të mbrojtur kufijtë. Sa për historitë e mbretërve, artistët e zgjeruan portretizimin e tyre, me qëllim të fitoreve në të ardhmen dhe thurje lëvdash për arritjet nga këta mbretër ose sulltanë.

Llojet e dorëshkrimeve ishin të pajisura me ilustrime shumëngjyrëshe, më të vjetrit prej tyre ishin librat shkencorë të përkthyer në arabisht, të cilët u përkisnin shkencave të mjekësisë ose çka lidhej me to, libra për kafshët. Të gjithë këta libra ishin të zbukuruar, ku jepeshin shpjegime ose kishte poezi ose përshkrime të ngjarjeve të udhëtimeve, si për shembull libri *Mekamat el Hariri*, etj..

Njëri ndër librat më të njohur për historinë e mbretërve është libri *Shah-name* nga El-Ferdousi (vd. 1010 g.), libër që është kopjuar shpeshherë dhe përfshin tema ikonike nganjëherë me një stil ironik. Në Bagdad në vitin 1389 g. u shfaq libri *Gharaibul-ilm*, ndërsa në Egjipt dhe Siri qarkullonin shumë libra, mirëpo libri nga El-Jezri, *Mekanizmat e Lëvizjes*, ishte libër shkencor dhe arsimor, me vizatime që kishin të bënin me mekanikën⁴.

⁴ <https://allalom.yoo7.com/t700-topic>

الْحَمْدُ لِلَّهِ فَاطِرِ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ جَاعِلِ الْمَلَائِكَةِ رُسُلًا أُولِي أَجْنِحَةٍ مَثْنَى
وَتِلْكَ وَرُبَاعٌ يَزِيدُ فِي الْخَلْقِ مَا يَشَاءُ إِنَّ اللَّهَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ

“Lavdi i takon vetëm Allahut, Krijuesin e qiejve dhe tokës, i Cili dërgoi melekë, me nga dy, tri dhe katër flatra. (Ai) Shton në krijimin e Tij atë që Ai dëshiron. Vërtet, Allahu, është i pushtetshëm për çdo gjë”⁵.

Piktorët jomyslimanë melekëve u dhanë pamje me shëmbëlltyrë femërore të qenies njerëzore, ndërsa kjo në Islam është e papranueshme. Kurani na tregon se ka prej melekëve që kanë flatra, mirëpo nuk tregon se çfarë gjinie u takojnë. Çdo imazh tjetër qoftë në shkrim ose në pikturë që njeriu do t’u jepte melekëve përveçse ç’ka është thënë në Kuran, Islami distancohet prej tyre. Ndonëse shumë rrallë, piktorët myslimanë melekët i pikturonin me flatra, por gjithmonë duke ua mbuluar pamjen e fytyrës me qëllim që të mos krijonin imazhin e mashkullit ose të femrës.

Kështu është edhe me muzikën. Them se qëndrimi i fukahave për të ishte shumë i qartë, si i liberalëve ashtu edhe i ekstremistëve. Personalisht mendoj se zëri i bukur kënaq të gjithë ata që e dëgjojnë, qoftë citimin e Kuranit, poezitë ose kasidet me raste të veçanta. Ka zëra që e tërheqin njeriun e ka zëra që e mërzisnin.

Nëse feja nuk e ndalon që për të mirën e njerëzimit të merren shembuj krijesat e Allahut xh.sh., që të mund t’i prodhojë ai, kur kopjoi shpendët për të prodhuar aeroplanin, ose mori shembullin e pilivesës dhe prodhoi helikopterin, mori shembull peshqit për të prodhuar nëndetëset etj., atëherë cila logjikë fetare do ta ndalonte që njerëzit të mos prodhonin vegla muzikore, që si shembull artistët merrnin kanarinat ose zogjtë e tjerë të shumtë këngëtarë, që kënaqin veshin e njeriut dhe të relaksojnë?

⁵ Kuran, Fatir: 1.

Këta ishin mendimtarët myslimanë të cilët e lejonin muzikën, ndërsa prej atyre që e ndalonin atë për shembull kishin marrë hadithet e cituara nga transmetues të besueshëm, që janë në Buhari dhe Muslim. Prandaj kemi mendime pro et contra. Transmetohet nga Ebu Amiri dhe nga Ebu Malik Eshariu r.a.: “Në ymetin tim do të ketë njerëz që e mendojnë të lejuar mëndafshin, përzierjen e mëndafshit me leshin, si dhe harfën.” Ibën Hazimi këtë hadith e shpalli të dobët, ndërsa Ibën Davudi dhe Islamili e përmendin me varg transmetimesh të plotë.

Nga Xhevheriu, Ahmedi ka shënuar hadithin e thënë nga Ebu Umame r.a., ku thotë: “Allahu më ka urdhëruar që t’i shkatërroj fyejt dhe instrumentet me tela”, ndërsa nga Kajsi bën Sead ibën Ubade r.a. thotë: “Zoti im më ka ndaluar alkoolin, instrumentet me tela dhe këngëtarët”. Ebu Davudi e shënon nga Ibën Omeri r.a.: “E dëgjoji fyellin dhe i mbylli veshët me gishtërinj...”⁶

Legislacioni islam

Gadishulli Arabik në shekullin VII pësoi një ndryshim të madh. Banorët e këtij gadishulli ashtu edhe dy perandoritë e mëdha të botës u befasuan me organizimin dhe zhvillim e shpejtë të këtyre beduinëve. Dy vite para se të përmbylej shpallja hyjnore (610-632), Muhamedi a.s. do të nxirrte nga Qabeja të gjitha putat e vendosur në të, me përjashtim të një pikturë.

Këtë rrugë e vazhduan pasuesit e tij, të cilët kishim marrë për mision përhapjen e besimit islam - qëllim i së cilës ishte drejtësia dhe paqja njerëzore. Mirëpo, jo të gjithë banorët e këtyre zonave menjëherë e pranuan besimin islam. Liria e shprehjes dhe e besimit bëri që në të të vazhdojnë të jetojnë politeistët, zjarrputistët, zaradeshtët, të krishterët, hebrejntë dhe të tjerë. Kjo lë të kuptohet se pikturat dhe vepra e artit të

⁶ Hadithe të papranueshme ose mursel. Këto hadithe janë theksuar në *Ihja ulumd-din* (Libri 4, 131-137)...

“ndaluara” sipas mendimit të myslimanëve nuk do të shkatërrohen për shkak të etikës dhe lirisë së besimit, edhe pse numri i pikturave dhe veprave të artit në këtë gadishull ishte shumë i vogël për të mos thënë se nuk ekzistonin fare.

Kush e njeh në thelb fenë islame, e ka të qartë se besimtarët e këtij besimi në vitet ose në shekullin e parë të Islamit ishin të preokupuar me përhapjen e këtij besimi e asgjë më tepër. Të udhëzuar nga thëniet e Lajmëtarit a.s., ata do të janë më shumë të përkushtuar që të mos lënë asnjë shenjë që cenonte njëshmërinë e Allahut të Lartmadhëruar. Vetë Muhamedi a.s. nuk kishte lënë asnjë piktor që ta portretizonte fytyrën e tij, por kjo nuk duhet të kuptohet se i Dërguari i Allahut a.s. ishte kundër artit ose pikturave në përgjithësi. Besimtarët myslimanë kishin kujdes të madh, ata nuk lejonin në asnjë mënyrë që të pikturoheshin piktura që mund të linin pasoja në besim.

“Transmetohet nga Enesi se Aishja r.a. kishte vendosur një perde me figura të qenieve të gjalla, me të cilën mbulonte dollapin e dhomës. I Dërguari a.s. i tha: *“Largoje atë nga sytë e mi, sepse fotografitë e saj janë duke m’u shfaqur në namaz.”*⁷

Gjithashtu kemi një transmetim tjetër për të cilën tregohet se kur ajo kishte shkuar në shtëpinë e Muhamedit a.s., me vete kishte marrë edhe kukullat me të cilat luante. Kur e ka pyetur i Dërguari Allahut a.s. se çfarë simbolizonin ato, ajo i tha: “Janë kuajt e Sulejmanit a.s..” Muhamedi a.s. heshti dhe më s’e ka pyetur asnjëherë⁸.

Transmetohet nga disa transmetues se disa prej grave të Muhamedit a.s. “vishnin këmisha të qëndisura me portrete të njerëzve dhe të kafshëve”. Vazhdojnë transmetimet tek Taberiu, i cili thotë se kur Sead ibën Ebi Vekasi hyri në Tajsefun me ushtrinë e tij, para se të zhvillohej beteja e madhe e Kadisijes në të cilën u mund përgjithmonë perandoria

⁷ KARDAVI, Jusuf, “Arti dhe argëtimi në jetën e myslimanit”, b. Sira, Prishtinë, 2012, f. 87.

⁸ EL ZUHRIJ, Muhammed Ibën Sead Munia, “Tabakatul el Kubra të Ibën Seadit”, Mektebetul el Hanxhi, Kajro, 2001/1421 kap.42:8.

perse, ai dha urdhër që namazi të falej në Kështjellën e Bardhë. Aty kishte sixhade të shtruara që ishin me piktura gjallesash të llojlojshme, mirëpo, ai nuk urdhëroi të hiqen ato sixhade. Është vërtetuar se ato sixhade nuk janë hequr që aty edhe pas dy shekujsh, këtë e vërteton poezia e Buhterit⁹.

Gjenerata e parë e besimtarëve zbatonte urdhrat e Allahut dhe të Dërguarit të Tij që të bënin vepra të mira, nxisnin të pasurit të ndihmonin të varfrit, skamnorët dhe të gjithë ata që kishin nevojë për një jetë më të mirë, ata nuk kishin kohë për ndërtimin e pallateve luksoze e as t'i dekoronin ato. Myslimanët e hershëm do t'u qëndronin besnikë thënieve dhe veprës së Muhamedit a.s., i cili u kishte thënë se njëra prej disa shenjave të kiametit është edhe ngritja e pallateve shumëkatëshe.

Muhamedi a.s. ishte shumë i vëmendshëm. Ai kishte frikë që besimtarët të mos mashtroheshin nga jeta e përditshme dhe posaçërisht gjatë faljeve të tyre me gjëra që nuk duhet t'ua tërheqin vëmendjen. Atyre u kërkonte devotshmëri, ndërsa ajo arrihej vetëm nëse ishin të përkushtuar dhe të përqendruar në namaz. Besimtarët e besimeve ibrahimike, sidomos të krishterët në kishat e tyre, kishin vendosur ikona të ndryshme dhe kjo s' do mend se ua tërhiqte vëmendjen. "Shenjtori Bernar (923-1008) thotë se veprat e artit, pikturat e shumta dhe të bukura kanë ndikuar dukshëm te besimtarët gjatë faljeve të namazit të tyre¹⁰".

Qëndrimi i artit në Bibël

Islami nuk e luftoi tërësinë e artit, përveç veprave që kishin të bënin drejtpërdrejtë me njollosjen e akides islame, kështu është edhe me Biblën. Të gjitha versetet në Dhjatën e Vjetër ndalojnë putat, të cilat cenojnë ose njollosin njëshmërinë e Krijuesit. Ato janë të qarta dhe të prera. Në Dhjatën e Vjetër kemi versete që ndalojnë krijimin e putave

⁹ Për më shumë shih Ukashe, 5.

¹⁰ UKASHE, Thervet, "Mewsuatu et tesvir el Islami", b. Nashirun, Liban, 2001, f. 5.

me qëllim adhurimi: *“Nuk do të kesh perëndi të tjerë para meje. Nuk do të bësh skulpturë ose shëmbëlltyrë të asnjë gjëje që ndodhet aty në qiej ose këtu poshtë në tokë ose në ujërat nën tokë. Nuk do të përkulesh para tyre dhe as do t’i shërbesh sepse, unë, Zoti, Perëndia yt, jam një Perëndi xheloz që dënon padrejtësinë...”* (Bibla, Eksodi: 20/3-5)

Teksti biblik është shumë i qartë, ai aludon për gdhendjen e materialeve të ndryshme që japin imazhe me shëmbëlltyrë hyjnore, ato që tregojnë forcën hyjnore dhe që bën që njerëzit ta adhurojnë atë skulpturë. Pra, këtu kemi të bëjmë me ndalimin e çdo pamje që simbolizon shëmbëlltyrën e Zotit dhe ato pamje që bëjnë njerëzit ta adhurojnë atë si simbol të forcës mbinatyrore. Përveç këtij botëkuptimi, çdo gjë tjetër është e lejuar.

Kam përshtypjen se Allahu xh.sh. nuk ka sjellë ajete dublifikuere ndaj vendimeve të Tij. Kur një vendim i Allahut të Lartmadhëruar nuk ka pësuar devijim, në këtë rast në Tevrat, atëherë nuk ka pasur nevojë të silltet një i ngjashëm i tillë në Kuran. Pra, përderisa kemi një verset kaq të qartë në Dhjatën e sotme dhe si i tillë është në harmoni me tërësinë e shpalljes së Islamit, gjegjësisht në Kuran, nuk do të kishte nevojë për një përsëritje të tillë.

Disa të tjerë thonë se hebrenjtë nuk e kanë të ndaluar prodhimin e përmendoreve ose shtatoreve, por u është ndaluar adhurimi tyre. Në saje të këtyre argumenteve kemi pikturën e Musait a.s. me karubinët (melekët). (Bibla, Eksodi: 25/18-20, 35/7-9...e tj.) Pastaj karubinët e vendosur nga Sulejmani... (1 Mbr. 6/29), pastaj të Davudit e të Ezekielit... Për këto të Sulejmanit kemi edhe ajete kuranore që e vërtetojnë këtë:

يَعْمَلُونَ لَهُ مَا يَشَاءُ مِنْ مَحَارِبٍ وَتَمَاثِيلٍ وَجِفَانٍ كَالْجَوَابِ وَقُدُورٍ رَاسِيَاتٍ
اعْمَلُوا آلَ دَاوُودَ شُكْرًا وَقَلِيلًا مِنْ عِبَادِيَ الشَّكُورُ

“Ato bënë për të çfarë dëshiroi ai nga faltoret, statujat, koritat (e gjera) rezervuare dhe kazanët e mbërthyer fort. (Dhe Ne thamë):

“Punoni, o njerëzit e Davudit, me falënderim (ndaj Meje) dhe (mos harroni se edhe) midis robërve të Mi pak janë falënderuesit e vërtetë!”¹¹

Sipas disa historianëve të artit, si Lamens dhe Xhjum, thonë se janë të vonshme argumentet e hebrenjve rreth ndalesës së përpunimit të shtatoreve (skulpturave) të shëmbëlltyrave të qenieve të gjalla dhe njerëzore. Kështu, hebrenjtë të cilët pranonin Islamin, kishin aftësinë dhe kapacitetin intelektual të shtrinin ndikimin e tyre në shoqërinë e parë islame. Nëse ata të cilët para se të konvertoheshin kishin njohuri rreth Judaizmit të tyre dhe u përkisnin dijetarëve ose ishin përkrahës të idesë së ndalimit të shtatoreve, e kishin shtrirë ndikimin e tyre edhe të myslimanët, duke ua argumentuar atyre edhe me Tevrat.

Këto ide i zbarkuan te myslimanët, gjegjësisht, disa fukaha i morën si të mirëqena këto ide dhe i zbatuan në legjislacionin islam. Disa ish-priftëriinj hebrenj (rabinë) kishin pranuar Islamin që në kohën e Muhamedit a.s.. Gjithashtu edhe këta rabinë njiheshin si sahabë. I tillë ishte Abdullah Ibën Selam¹², ish-rabin i cili pasi pranoi Islamin që në kohën e Muhamedit a.s. mori emrin Abdullah, përveçse ishte rabin, ai njëkohësisht ishte edhe mësuesi i Ebu Hurejrës. Kështu është edhe me Ka’b el Ahbarin¹³, i cili ishte mësuesi i Ibën Abbasit, mirëpo në shumë vende Ibën Abasi nuk flet mirë për ‘mësuesin’ e tij.

¹¹ Kuran, Sebe’: 13.

¹² Abdullah ibën Selam (550-630), ishte ish-rabin nga fisi Kajnuka (hebrenj të qytetit të Medinës). Burimet e myslimanëve thonë se ky njeri ishte konvertuar në Islam që në ditën e parë kur Muhamedi a.s. fali xhumanë në Kuba. Ndërsa burime joislame thonë se pas tetë vitesh pranoi Islamin.

¹³ Ka’bi ishte një ish-rabin nga Jemeni i konvertuar në mysliman, jetoi mbi 100 vite. Konsiderohet si *tabi’in* sepse nuk e ka takuar Muhamedin a.s., edhe pse kishte deklaruar Islamin që në kohën e tij. Influenca e tij ishte në kohën e Omerit dhe Othmanit r.a. Migroi në Sham. Shiitët e konsiderojnë si besimtar të rremë, për shkak të israiliateve që ka futur në mendësinë e myslimanëve.

Qëndrimet e fukahave

Në mungesë të mexhllisit legjislativ të shoqërisë myslimane anembanë botës islame, edhe unë do të shfrytëzoj atë që sollëm në ligjëratën e kaluar, kur folëm për muzikën. Atje më në detaje pamë mendimin e autorit të librit “El Gina we el Meazif fil ealam el Muasir” nga dr. El Merashli, i cili kishte sjellë mendimet e 154 dijetareve të cilët kanë dhënë mendimet e tyre mbi ahengjet, këngën dhe muzikën. Ai e filloi me dijetarët më të zëshëm të kohës së hershme duke filluar me ata të shekullit të III hixhri deri te mendimtarët bashkëkohorë, të cilët ende po e japin kontributin e tyre në shoqërinë myslimane.

Si në çdo shoqëri të botës, mendimi ndryshe midis dijetarëve ka qenë dhe do të jetë i përhershëm. Kështu është edhe me dijetarët në shoqërinë myslimane, aq më tepër kur në brendi të këtij besimi janë integruar popuj të civilizimeve më të mëdha të botës. Dijetarët myslimanë mundohen që me çdo kusht t’u ikin ndasive të mëdha dhe ta ruajnë unitetin e ymetit me qëllim që të mos shpërbëhet ose të ndahet në disa civilizime, siç ndodhi me Krishterimin. Deri në këtë kohë dijetarët kanë treguar maturi dhe sukses, përderisa myslimanët vazhdojnë të jetojnë nën ombrellën e një civilizimi, pra, vetëm të civilizimit islam.

Imam Gazaliu (Allahu xh.sh. e mëshiroftë) në librin e tij *Ihja’ ulumu ed Din* paraqiti argumentet e tij të bazuara në Kuran dhe Traditë të Lajmëtarit a.s. dhe me të shkriu mendimet e shkollave të tjera juridike. Më vonë këtë mendim e ndihmoi edhe thënia e Imam Ibën Tejmijes (Allahu xh.sh. e mëshiroftë), i cili u tregua shumë i matur karshi kundërshtarëve të artit duke u thënë: “Të Dërguarit e Allahut ishin dërguar për ta theksuar dhe për ta përsosur instinktin njerëzor, e jo për ta ndryshuar apo modifikuar atë¹⁴”.

Myslimanët për një kohë të gjatë nuk kishin nevojë për mendime shtesë të kësaj natyre, atyre do t’u bëhet e domosdoshme të dalin me

¹⁴ KARDAVI, Jusuf, “Arti dhe argëtimi në jetën e myslimanit”, b. Sira, Prishtinë, 2012, f. 48.

fetva të reja për shkak të zhvillimit të madh në shkencë dhe teknologji. Prandaj, pas shumë shekujsh, dijetarët e fikhut dhe të tjerë u përpoqën që të sjellin mendimet bashkëkohore që besimtarët myslimanë të mund të hapërojnë së bashku me këto zhvillime.

Dijetarët islamë, si gjithmonë paraqiten me mendimet e tyre të pavarura, gjë që tregon se Islami pranon mendimin ndryshe, edhe pse kanë shkaktuar dhe po shkaktojnë pengesa të mëdha në ymetin tonë disa rryma ekstreme. “Shumica e dijetarëve të vonshëm janë zhgënjyer me një numër të madh të haditheve të dobëta dhe të fabrikuara që janë trashëguar. Duke mos qenë të kualifikuar për të bërë dallimin ndërmjet llojeve të ndryshme të haditheve dhe të vendosur nëse zinxhiri i transmetuesve është i besueshëm, ata përhapën këto hadithe. Injoranca dhe pohimi i përhapur nëse shumica e haditheve të dobëta kanë të bëjnë me të njëjtën temë dhe nëse janë të të njëjtit efekt, ato automatikisht arrijnë nivelin e vërtetë, gjë që e krijuan këtë argument zhgënjyes¹⁵”.

Nëse dikush pyet pse besimtarët e parë-selefi nuk lejonin që imazhet dhe idetë të hidheshin në vepra arti? Unë ndaj mendimin me ata dijetarë që thonë: Nuk është e mundur që imazhet të ndaloheshin në tërësinë e saj. Ata ishin shtylla e parë të cilët ruajtën drejtësinë dhe jurisprudencën islame, ata më shumë ishin të preokupuar për zhvillimin e shkencave të tjera të shumta, të cilat të gjitha si të tilla ishin të reja për ta. Ata sfidoreshin nga shumë anë dhe për shumë ngjarje duhej dhënë përgjigje rreth hakut dhe detyrimeve të tyre parësore në një shoqëri të re, të shumëllojshme dhe shumë të shtrirë në planet, sikur rreth dispozitave të martesës, rreth kthimit të borxheve (me ose pa kamatë), rreth trashëgimisë sipas Islamit (në kohën kur shumë shtresa në botë nuk gëzonin të drejtën e trashëgimisë)... etj..

Fillimi i angazhimit të tyre dallonte shumë nga banorët e perandorive të shek. VII dhe VIII. Bota përpëlitej me sistemin skllavopronar,

¹⁵ KARDAVI, Jusuf, “Arti dhe argëtimi në jetën e myslimanit”, b. Sira, Prishtinë, 2012, f. 67.

ndërsa myslimanët përhapnin idenë e një shoqërie të lirë, të hapur për të gjithë dhe pa dallime në llojin njerëzor. Të gjithë njerëzit ishin të barabartë. Ide që edhe sot e kësaj dite është atraktive dhe alternativë shumë e fuqishme e këtij rendi të sotëm botëror. Mësuesi, Muhamedi a.s., u kishte lënë vepra teorike të panumërta, ndërsa ata do të duhej t'i shndërronin në vepra praktike, secila në kohën e vet. Detyra parësore e tyre ishte të pastronin të metat e shoqërive politeiste dhe të gjitha praktikatat që nuk përputheshin me parimet e Islamit.

S'do mend se humbësit, edhe pse në dukje të jashtme dukeshin më të civilizuar sesa vetë fituesit (arabët), mundoheshin të gjenin elementë përputhshmërie midis praktikave të tyre dhe parimeve islame, kështu që në disa vende brenda shoqërisë islame ndodhën vepra me ideologji mikse, por që në esencë nuk përbënin shirk. Pra, kur filloi takimi i parë me këto tradita të "civilizuara", filloi të rrezikohej edhe pastërtia e Islamit dhe me të të shtoheshin edhe më shumë rreziqet. Veprat e artit nëse do të lejoheshin pa ndonjë censurë nga myslimanët e hershëm- *selefi*, dijetarët që në atë kohë do të duhej të merreshin më shumë me pasojat e keqbërësve, të cilët qëllimisht thurnin mendime për ta njollosur zhvillimin e madh që kishte filluar në shoqërinë islame.

Prandaj *selefi* kishte një parim, nëse veprat artistike në esencë parapëlqeheshin dhe nuk dëmtonin dispozitat juridike islame dhe si të tilla mund t'u shërbenin për qetësim ose shërim natyror ose u shërbenin për zbulime të reja shkencore, i merrnin për bazë, të tilla vepra ishin të dëshiruara edhe juridikisht. Nëse veprat artistike shërbenin vetëm për stolisje, zbukurim ose për argëtim, ato vendoseshin në kategorinë e mubahut-lejimit dhe nuk ndaloheshin. Ndërsa veprat që rreptësisht ndaloheshin ishin ato vepra që në esencë shërbenin për përrulje, mendjemadhësi, krenari dhe që ishin në kundërshtim me besimin islam.

Bazuar në këtë, numri i dijetarëve që lejonin veprat artistike në përgjithësi ishte shumë më i madh se i atyre që ndalonin shumicën e veprave me përjashtime të vogla. *Në esencë të gjitha veprat e artit lejohen*

me përjashtim të atyre veprave që cenojnë njëshmërinë e Allahut të Lartmadhëruar, pra, vepra që përshkrimi ose pikturimi i tyre përpiqet të japë imazhin e Allahut xh.sh.. Allahu, Krijuesi i botëve, ua bëri të qartë besimtarëve që në kohën e njeriut të parë, Ademit a.s., e deri të shpallja e fundit (Kuran), se i Lartmadhëruari, nuk i ngjason askujt, prandaj asnjëri le të mos tentojë të sjellë imazhin e Tij. Imam Shafiu (Allahu e mëshiroftë) thotë: “Një besimtar i cili hulumton për gjetjen e imazhit të Krijuesit, do të kalojë në idhujtari”.

Mirëpo kemi disa fukaha të cilët ndalojnë çdo lloj imazhi që përcejell qenie të gjalla. Bazuar në argumentet e përcjella nga dr. Ukashe, i cili ka sjellë transmetimet e disa historianëve të artit, thotë se “*sekreti i ndalimit të imazheve në përgjithësi buron nga esenca e fjalës imazh që konsiderohej se ishte pjesë e piktorit, i cili nuk arrinte t’ia jepte shpirtin asaj krijese*”. Mosdhënia e shpirtit sikur e brengoste veprën e krijuar, ashtu si vepronin orakujt ose magjistarët në kohët e lashta. Pasuesit e kësaj teorie mendohet se ishin pjesëtarë të këtij perceptimi të besimit, që në shumicën e rasteve vinte nga popuj gjenealogjia e të cilëve rridhte nga semitët¹⁶”.

Për këtë arsye edhe fukahatë me prejardhje semite (arabët), kërkonin që këto vepra artistike të shkatërroheshin me qëllim që të mos shndërroheshin në puta të vërtetë. Si duket ky ishte botëkuptimi i popujve të hershëm, por që në këtë fushë më së shumti veçoheshin popujt semitë dhe më pak lindorët. Mirëpo, kjo nuk duket të jetë e saktë sepse është në kundërshtim me realitetin historik. Popujt evropianë mbase jo të gjithë, por shumica dërrmuese e tyre, nuk i përkasin racës semite, mirëpo edhe këta ishin të ndikuar në ndalimin e këtyre veprave, sidomos mesjeta evropiane ishte e tillë.

Xhaston Vito mendon se kjo frikë ishte e trashëguar brez pas brezi ndër gjenerata. “...ishite shndërruar sikur të ishte pjesë e instinktit njerë-

¹⁶ UKASHE, Thervet, “Mewsuatu et tesvir el Islami”, b. Nashirun, Liban, 2001, f. 6.

zor te popujt semitë, gjë që ka lënë gjurmë të thella dhe mungesë të artit midis shoqërisë islame arabe dhe tërësisë së shoqërisë islame në botën josemite si te persët, mongolët, indianët, turqit etj.. Studiuesit e artit këto fakte i lidhin me artin pers ose shiit, të cilët nuk ishin të ndikuar nga transmetimet e haditheve të sunitëve që ndalonin pikturat¹⁷.

Thënë realitetin, disa fukaha shiitë ishin shumë të mprehtë në supozimet e tyre ndaj sunitëve rreth ndalimit të pikturave. Shiat me shumë fanatizëm ruanin tërësinë e haditheve të të Dërguarit të Allahut a.s., që përfundonin me ndalimin e tyre pa asnjë mëshirë. Prandaj nuk mund të thuhet se qeveritë shiite ishin më të mëshirshme ndaj artit sesa qeveritë e sunite. Mbase shkak esencial që njerëzit të mendojnë të kundërtën rreth tyre është se Irani konsiderohej çerdhe shiite, mirëpo Irani është deklaruar se e pason këtë medhheb vetëm pas shfaqjes së dinastisë safavite të vitit 1507.

Kjo mendësi dhe frikë, që buron thellë në parimet islame, kishte lënë gjurmë të thella edhe tek artistët. Shumica dërrmuese e tyre nuk i vendosnin emrat nëpër veprat e tyre të bëra, me përjashtim të një numri të vogël artistësh, emri i të cilëve ishte i panjohur. Si duket artistët më shumë zhyteshin në veprat e tyre e jo në emrat e tyre. Frika nuk kishte të bënte me qëndrimet e qeverive, por frika buronte nga modestia, se mos vallë emri i tyre do të kujtohej më shumë sesa vepra e tyre artistike qoftë në letërsi ose në artet plastike...

Në kohën e dinastisë emevite përkthyesit e veprave greke dhe të krishtera nuk kishin lënë gjurmët e tyre dhe si rezultat i modestisë së tyre edhe artistët nuk i vendosnin emrat e tyre. Masimiljani komenton vendimin e kalifit emevit (mendohet se ishte Jezid ibën Muavije), i cili kishte dhënë urdhër për ndalimin e pikturave. Ai thotë se ka pasur për qëllim pikturat e të krishterëve dhe politeistët, të cilat ishin një armë e fortë për forcimin e besimit të tyre. Ndërsa në të njëjtën kohë frikëso-

¹⁷ Po aty, Ukashe, 6.

hej se mos vallë po ndikoheshin myslimanët dhe devijonin besimin e tyre. Pra, ndalesa nuk vinte si burim i besimit islam, por nga frika e ndërhyrjeve në besimin islam dhe kthimin eventual në besimin e baballarëve të tyre.

Elitat myslimane në parim nuk debatonin shumë, as nuk e sulmonin artin. Atë e linin të lirë midis atyre që e refuzonin dhe atyre që e lejonin. Ashtu siç u tha edhe më sipër në këtë temë, selefi nuk u morr shumë me lejimin ose ndalimin e tij, mirëpo për shkak të goditjeve që morën myslimanët nga mongolët dhe në veçanti në kohën e Imam Neveviut, arti islam ishte sulmuar shumë. Për shkak të sulmeve të ashpra kemi edhe deklaratat e këtij imami shumë të ashpra. Ky dijetar ndaloi (quajti haram) veprat, hija e të cilave jepte imazhin e portretit të qenieve të gjalla. Ai kishte lejuar pikturat e jetës bimore (florën) dhe gjithçka që kishte të bënte me natyrën. Në librin e tij *El minhaxh fi sherh sahih Muslim ibën el Haxhaxh*, Imam Neveviu (Allahu e mëshiroftë) ndalonte të gjitha pikturat që kishin të bënin me faunën.

Sipas tij, artistët me vepra të tilla sikur ndërhynin në krijimtarinë e Krijuesit. Ai nuk përjashtonte as zbukurimet e kësaj natyre që paraqiteshin nëpër qilima, rroba ose orendi të tjera. Çuditërisht, ky dijetar artistëve u kishte lejuar që këto vepra me portrete njerëzish ose gjallesash të tjera të mund t'i shprehnin vetëm nëpër tualete. Ai konsideronte se vetëm në këto vende piktorët ishin të sinqertë në veprat e tyre. Sipas tij vetëm këtu mund të tregohet e bukura e tyre sepse këtu nuk e sfidonin veprën e Krijuesit¹⁸.

Kjo mendësi e ndalimit të këtyre veprave kishte përfunduar me rënien e dinastisë abaside (1258) nga ushtria mongole, por vazhdoi edhe në kohën e shteteve të vogla islame, edhe pse me një zbutje më të lehtë. Me ardhjen e dinastisë turke-selxhuke, dijetarët sikur i kishin zbutur qëndrimet e tyre dhe kështu kishte vazhduar edhe pas ardhjes së turqve

¹⁸ Po aty, Ukashe, 7.

osmanlinj (shek. XIII-XIX). Në shekullin XIX kemi disa artistë, të cilët shpërthyen dhe dolën me veprat e tyre artistike. Si duket edhe në kohën e osmanëve dijetarët që ndalonin pikturat kishin lënë gjurmë negative në shoqërinë myslimane.

Jusuf el Kardavi, njeri me bagazh të madh dhe kontribuues në literaturën islame, na solli mendimet e disa dijetarëve të hershëm që i kishin rezistuar kohës, mendimet më ekstreme ashtu edhe ato më liberale. Ky dijetar bashkëkohor solli argumente të qarta mbi artin në përgjithësi dhe degët e tij në veçanti. Ai argumentoi secilin zhanër të ndarë sepse secili zhanër ka autonominë e vet. Në përgjithësi arti është i lejuar në Islam thotë Kardavi: *“Çdo gjë është e lejuar - me përjash-time”* sepse secili zhanër e ka peshën e vet të ndikimit të tij pozitiv dhe atij negativ. Prandaj, në mënyrë të shkëlqyer sjell argumente për të cilat shfrytëzoj rastin t’i kërkoj secilit mysliman të lexojë librin e tij *“Arti dhe argëtimi në jetën e një myslimani”*.

Vazhdon ky dijetar të thotë: “Allahu xh.sh. është i Vetmi që vendos për hallallin dhe haramin. Ai nuk i lejon askujt që të marrë fuqinë e Tij dhe t’ia ndalojë vetes apo të tjerëve të mirat që i ka dhuruar. Allahu xh.sh. thotë:

قُلْ أَرَأَيْتُمْ مَا أَنْزَلَ اللَّهُ لَكُمْ مِنْ رِزْقٍ فَجَعَلْتُمْ مِنْهُ حَرَامًا وَحَلَالًا قُلْ اللَّهُ أَدْنَىٰ لَكُمْ أَمْ عَلَى اللَّهِ تَفْتَرُونَ

“Thuaj: A nuk i patë ato që Allahu zbriti për ju rizkun, ndërsa ju disa i ndaluat e disa i lejuat. Thuaj: “A keni marrë leje nga Allahu apo po shpifni për Allahun?”¹⁹

Në Kuran nuk kemi ajete që as për së afërmi e as për së largëti e ndalojnë përshkrimin e imazheve të florës, faunës dhe qenieve të tjera të krijuara, përkundrazi, kemi nxitje që ushqejnë besimtarët dhe i bëjnë kureshtarë të garojnë pas veprave të mira dhe ta shijojnë të bukurën. Kurani në shumë raste tregon se e bukura është ni’met - pra, një begati

¹⁹ Kuran, Junus: 59.

prej begative të Allahut xh.sh., që ushqen instinktin njerëzor dhe pengon njerëzit të lakmojnë mendimin opozitar të Allahut (shirkun).

Muhammed Amare thotë: “Qëndrimi i Islamit rreth imazheve të ndryshme dhe skulpturave të gjallesave shpjegohet në nivele²⁰, ai nuk është i përgjithësuar e as absolut. Në raste kur kemi të bëjmë me shirk ndaj Allahut xh.sh., qoftë ai shirk i hapur ose i fshehtë, për to nuk ka kurrfarë dileme se kemi të bëjmë me veprime të ndaluara *harame* dhe detyrohemi t’i shkatërrojmë ato..., mirëpo nëse përmbajtjet e tyre nuk cenojnë shirkun, atëherë ato janë begati prej begative të Allahut xh.sh., prej të cilave vetë Kurani ka sjellë shembuj të shumtë artistikë që kënaqin ndjenjat e myslimanëve²¹”.

Në temën e kaluar rreth ilustrimeve artistike në Kuran, vërejtëm sa e sa shembuj ose imazhe që na i ka dhënë Allahu xh.sh. në Kuran prej të cilave mbusheshin zemrat e myslimanëve. E bukura e thënë në Kur-an bën që imani i myslimanëve të lënduar të plotësohet. “Ndërsa ne jemi duke i lexuar këto ajete, sigurisht që na japin përshtypjen e imazheve sikur jemi duke shikuar piktura e skulptura. Kështu kur rrëfen Ku’rani kerim edhe për kaurët, të cilët janë dhënë pas kufrit të tyre, na jep imazhin thuajse jemi duke i parë ato në një pano të pikturuar me një precizitet të lartë. Kurani veprat e kaurëve i përshkruan si të paqena sepse ato i merr stuhia, që nuk mbetet asgjë dhe për askënd²²”.

Mirëpo, kur u kthehemi haditheve që flasin për ndalimin e tyre, hadithe që i qortonin besimtarët, themi se janë transmetime që u dedikoheshin atyre piktorëve ose skulptorëve të etapave të ndryshme të historisë që sillnin vepra artistike prej guri, druri ose materiale të tjera dhe i hyjnizonin ata. Nga Ibën Mesu’di transmetohet: “E kam dëgjuar të

²⁰ Dr. Jusuf el Kardavi në librin e tij “Arti dhe argëtimi”, vetëm për qëndrimin e artit plastik ka paraqitur nëntë pika, ndërsa për atë rimor është mjaftuar me pesë pikat e Imam Gazaliut.

²¹ UKASHE, Thervet, “Mewsuatu et tesvir el Islami”, b. Nashirun, Liban, 2001, f. 5.

²² AMARE, Muhmmmed, “el Islam we funun el xhemalije”, Dar el Shuruk, Kajro 1991 (për më shumë lexo ajetet kuranore: Ibrahim, 18 dhe Junus, 24).

Dërguarin e Allahut a.s. të thotë: “Njerëzit që do t’i nënshtrohen dënimit më të dhembshëm nga Allahu janë piktorët” ...në transmetime të tjera shtohet edhe shtesa: “ dhe atyre që krijojnë këto piktura, ashtu duke qenë në dënime të dhembshme, u thuhet ngjallni këto që krijuat.”

Si thamë më sipër, jo të gjithë piktorët do të dënohen. Këtu kemi të bëjmë me ata piktorë të cilët qëllimisht punojnë që njerëzimin ta nxjerrin nga rruga e besimit të vërtetë, që me anë të veprave të tyre artistike mundohen t’i drejtojnë drejt një hyji të rremë të trilluar prej tyre. Këto dhe hadithe të tjera kanë të bëjnë me këtë lloj karakteri, me ato piktura që janë rreptësisht të ndaluara në Islam. Si këto hadithe të kësaj natyre kemi shumë, mirëpo kemi edhe të atilla që ‘ekzagjerojnë’ dhe fusin frikën ndërmjet besimtarëve, por në esencë ato janë me zinxhir të transmetuesve mevdue’ - të dobët...

Conclusions

The Muslim society passionate about the development and progress of the country, has for a long time now lacked new thoughts and works of art. This will make it necessary for them to issue new fatwas only after they have started competing with nations around them in science and technology.

After several centuries, the scholars of fikh and others tried to bring contemporary thoughts so that the Muslim believers could walk along side these developments.

The Islamic scholars, as always, came out with their independent opinions, which shows that Islam accepts the opinion differently, although some extreme attitudes have caused, and are causing great obstacles in Muslim Ummah. The Salaf had a principle, if the works of art were in essence preferred and did not harm the Islamic legal provisions, as such they could serve for relaxation or natural healing or serve for new scientific discoveries, take them as a basis. Such works were desired and allowed by jurists. If the work of art was used only for decoration, ornamentation or entertainment, they were placed in the category of mubahit-permission and were not forbidden. While the works that were strictly forbidden were those works which in essence served for humility, arrogance, pride and which were contrary to the Islamic faith.

Literatura e shfrytëzuar:

1. Kurani.
2. UKASHE, Thervet, “Mewsuatu et tesvir el Islami”, b. Nashirun, Liban, 2001.
3. AMARE, Muhmmmed, “el Islam we funun el xhemalije”, Dar el Shuruk, Kajro, 1991.
4. KARDAVI, Jusuf, “Arti dhe argëtimi në jetën e myslimanit”, b. Sira, Prishtinë, 2012.
5. GAZALI, Ebu Hamid Muhammed, “Rilindja e shkencave fetare-Ihjau-ulumin-din”, b. Furkan, Shkup, 2017.
6. El ZUHRIJ, Muhammed Ibën Sead Munia, “Tabakatul el Kubra të Ibën Seadit”, Mektebetul el Hanxhi, Kajro, 2001/1421.
7. AJVAZOGLLU, Beshir, “Estetika Islame”, b. Logos-A, Shkup, 2009.
8. SHERIATI, Ali, “Shëmbëlltyra e Muhammedit”, b. privat, Sarajevë, 2000.
9. ADEL, Haddad Ali, “Kultura e zhveshjes dhe zhveshja e kulturës”, b. Drita e jetës, Gilan, 2004.
10. KUTB, Sejjid, “Ilustrimi artistik në Kuran”, b. Logos-A, Shkup, 2001.
11. KUTB, Muhammed, “*mihexh fen el Islamij*”, Dar Shuruk, Bejrut, 1983.
12. EBU ZEHRE, Muhammed, “*Nadharij-jetu el Harb el Islami*”, Daru el fikr el arabi, Kajro, 2004.<https://allalom.yoo7.com/t700-topic>

Prof. asoc. dr. Januz DËRVODELI

NDIKIMI I MEDIAVE DHE I RRJETEVE SOCIALE NË EDUKIMIN DEMOKRATIK TË TË RINJVE

Abstrakt

Duke parë se edukimi është një fenomen i rëndësishëm dhe i domosdoshëm për rininë dhe shoqërinë në përgjithësi, mendojmë se mediat, por së fundi edhe rrjetet sociale, mund të ndikojnë suksesshëm në edukimin e drejtë dhe demokratik të të rinjve. Në të kundërtën ato mund të ndikojnë edhe negativisht ndaj të rinjve tanë, të cilët mund t'u ekspozohen dukurive negative si rezultat i ndikimit negativ nga mediat, përkatësisht nga rrjetet sociale.

Studimi dhe njohja sa më e gjithanshme e këtij problemi në shoqërinë tonë lë shumë për të dëshiruar, si rezultat i mungesës së hulumtimeve në këtë fushë, për të cilën konsiderojmë se është aktuale dhe një sfidë permanente për shoqërinë, e sidomos për rininë.

***Fjalët kyçe:** media, rrjete sociale, edukim demokratik, të rinj.*

“Ndoshta kjo mund të duket si një mundësi e largët fantastike, por njohësit e TV medias na sinjalizojnë se së shpejti do të vijë koha që

pronari i televizorit nga kasete kompjuterike do të porosisë informatën e dirigjuar, qoftë ajo tekstuale, verbale etj..”¹

HYRJJE

Edukimi dhe arsimimi demokratik në shkollën tonë sot, pa e anashkaluar edhe ndikimin që kanë mediat dhe rrjetet sociale, synon që të rinjtë në radhë të parë t’i arrijë mbi të gjitha këto tri vlera që janë të vlefshme dhe jetike për shoqërinë. Ato janë:

- formimi i kulturës së të nxënit gjatë gjithë jetës
- formimi i kulturës së punës, dhe
- formimi i kulturës së sjelljes.

“Çështja e krijimit të demokracisë, thotë Sh. Monteske, është diçka shumë e mirë për popullin. Mirëpo ekziston një çështje tjetër, që është shumë më e mirë dhe më e rëndësishme për të, e ajo është çështja e edukimit të fëmijëve dhe të rinjve për demokraci”².

Mediat janë faktor i rëndësishëm për komunikim me njerëzit. Zhvillimi i teknikës dhe i teknologjisë kanë bërë që jeta dhe puna e njeriut të ndryshojë shumë. Mediat mund të jenë një mjet edukues shumë i vlefshëm, por duhet ditur kufiri i përdorimit të tyre. Ato ofrojnë mundësi për informimin dhe edukimin e përgjithshëm të njerëzimit. Mediat bëjnë pjesë në format dytësore të informimit, në **“të cilat përdoren mjetet teknike të lajmërimit, që u drejtohen një mase të madhe njerëzish, me qëllim të formimit të opinionit publik”**.

Mediat kanë luajtur dhe luajnë rol të madh në ndryshimin e mentaliteteve të vjetra sociale, kanë ndikuar që të ecë përpara shoqëria, kanë sjellë modele të një jete bashkëkohore, por kanë pasur edhe rolin e vet

¹ Vladimir Poturič, (1986), Audovizuelna sredstva u profesionalnom informisanju, Nastavnik i profesionalni rayvoj učenika, Priručnik ya nastavnike, Zagreb, f. 71.

² Mr. Shaip Kabashi (1999), Burokracia dhe burokratizmi në sistemin e qeverisjes, Prizren, f. 62.

negativ. Politizimi i mediave e vë shikuesin para debateve politike, të përcjella shpesh me acarime dhe me dhunë verbale e fizike.

Ndërkaq në rrjetet sociale, në dekadën e fundit, ndihet një çlirim të njerëzit nga varësia e mediave dhe televizionit, duke iu shmangur programeve politike dhe natyrës personale që marrin emisionet.

Nga ana tjetër, sot mediat duhet të kenë rol kompletues edukativ, duhet t'u hapim rrugë programeve që paraprijnë përgatitjen e shoqërisë për të ardhmen, në të kundërtën ndikimi negativ i mediave është mbase i dukshëm, sidomos në prezantimin e programeve kriminalistike, sjelljeve agresive, dhunës brenda familjes, vrasjeve, vetëvrasjeve etj..

Për më tepër, viktimë e ndikimeve negative të mediave/televizionit, por edhe të rrjeteve sociale mund të jenë të gjithë, në veçanti fëmijët, të cilët duhet të kenë përkujdesje nga prindërit në përcjelljen e këtyre emisioneve joedukative dhe të mos krijojnë varësi nga shikueshmëria e programeve televizive. Në lidhje me këtë po citojmë një mendim të Sami Frashërit, i cili ka thënë: “Fëmijës i duhet dhënë ajo që i duhet, jo ajo që kërkon³”.

Roli i mediave dhe i rrjeteve sociale në edukimin demokratik

Mediat dhe rrjetet sociale, për të pasur ndikim të efektshëm të rinia, duhet që në vazhdimësi të transmetojnë programe, debate, këshilla e mesazhe të larmishme edukative, të cilat ndikojnë në edukimin demokratik të të rinjve tanë. Qëllimi i këtyre programeve është që të formojnë qytetarë me botëkuptim të pavarur, me ide dhe bindje mjaft të qarta për teorinë dhe praktikën e demokracisë.

Për më tepër, për t'u edukuar të rinjtë nga mediat dhe rrjetet sociale në frymën e pikëpamjeve demokratike, do të duhej të konceptohen asi

³ Hektor, 12, Forumi: shqiperia.com (Tema shoqërore – Socialogjia), Fëmijët parashkollorë dhe televizioni (12 tetor), Tiranë, 2013, f. 11.

vlerash, përmbajtjesh e programesh, kursesh shkollore, të cilat në fakt do të formonin njeriun demokrat me pikëpamje të reja, me ndërgjegje, me ide, bindje dhe vetëdije demokratike dhe me liri e barazi të plotë.

Për ta arritur këtë qëllim kërkohet që në shkolla dhe mbase edhe në media të ndryshohen edhe më tej metodat e punës, përmbajtjet, pastaj të ndryshohet pozita e subjekteve në procesin e edukimit, mandej çrrënjësja e koncepteve tradicionale dhe zëvendësimi i tyre me ato të reja, siç janë demokratike, qytetëruese e pluraliste.

Siç jemi në dijeni të gjithë, arsimit është një shtyllë e progresit, është pjesë përbërëse e çdo shoqërie, sidomos e një shoqërie demokratike që është në konsolidim të vazhdueshëm.

Prandaj, qëllimi i edukimit dhe i arsimimit demokratik të pjestarëve të një shoqërie është që të formojë qytetarë me botëkuptim të pavarur, me një zhvillim të mendimit kritik dhe krijues, hulumtues e të arsyeshëm për një qytetari aktive, e cila merr pjesë në vendimmarrje dhe njëkohësisht me ide mjaft të qarta për teorinë dhe praktikën e demokracisë dhe për institucionalizimin e lirisë. Kontribut në arritjen e këtyre vlerave demokratike ka gjithsesi edhe roli i mediave dhe i rrjeteve sociale, të cilat me shkëmbimin dhe transmetimin e informacioneve dhe të programeve me karakter demokratik, ndikojnë pozitivisht sidomos në kultivimin dhe jetësimin e vlerave të edukimit demokratik të pjesëtarëve të një shoqërie.

Në të kundërtën, pa një shoqëri të mirëfilltë demokratike, siç thotë Albert Kamy, “njëherë do të mund të punonin dhe jetonin në një shtet që bazohet në gënjeshtër, në pasiguri e në dhunë⁴”.

Edukimi demokratik, i cili arrihet qoftë nga institucionet edukativo-arsimore, qoftë nga mediat dhe rrjetet sociale, qoftë edhe nga faktorët e tjerë edukativë, synon të krijojë kushte maksimale dhe të barabarta për zhvillimin dhe edukimin e të gjithëve, pa marrë parasysh

⁴ Mr. Shaip Kabashi (1999), Burokracia dhe burokratizmi në sistemin e qeverisjes, Prizren, f.56.

përkatësinë kombëtare, gjinore e konfesionale. Edukimi demokratik respekton lirinë e plotë dhe të drejtat individuale njerëzore të rinjve dhe të rriturve për pjesëmarrje të barabartë në procesin e edukimit. Mund të thuhet me të drejtë se “në një shtet demokratik, me kalimin e kohës, arsimit e bën vetë lirinë të lulëzojë, e mbronë lirinë më shumë sesa një ushtri dhe e ngre lart vetëdijen kombëtare⁵”.

Si mediat, ashtu edhe rrjetet sociale, sot duhet të bëjnë një luftë pa kompromis, lidhur me ndikimin që duhet të kenë në edukimin demokratik të pjesëtarëve të shoqërisë dhe se si përparësi të politikës së vet duhet të kenë zhdukjen e analfabetizmit, luftën kundër agresionit dhe okupimit të teritoreve të huaja, kundër aparthejdit dhe kundër të gjitha të formave të tjera të mbizotërimit dhe diskriminimit social, kundër pabarazisë socialo-ekonomike, etj.. Në lidhje me këtë Maksimilian Robespjeri lidhur me Deklaratën e Drejtave të njeriut shkruante: “Njerëzit e të gjitha vendeve janë vëllezër... ai që shtyp popullin tjetër, deklarohej armik i të gjithë popujve të tjerë⁶”.

Për më tepër, ka rëndësi zhvillimi dhe formimi i kulturës demokratike, ku njerëzit duhet të paktën të tregojnë vullmetin e mirë për të toleruar dallimet midis tyre, duke pranuar se argumentet e palës tjetër janë në të vërtetë më të drejta. Edhe debatet që ndjekim në media, në shtypin ditor, në parlament, pastaj përmes shkëmbimit të mesazheve dhe komunikimit në rrjetet sociale duhet të dominoi fryma e kompromisit, e tolerancës, e mirëkuptimit, e bashkëpunimit, e respektit, e diversitetit të mendimeve dhe gjithnjë i ngritur mbi parimin e qeverisjes demokratike në shoqëri.

Prandaj, sot roli i edukimit demokratik në shkolla, sikur edhe ndikimi i mediave dhe i rrjeteve sociale, nuk ka të bëjë me nxjerrjen e specialistëve të paditur, “akademikëve analfabetë”, të cilët nuk do të mund

⁵ ... (1995), Edukimi dhe Kultura e Demokracisë, Tiranë, f. 19.

⁶ Dr. Fehmi Agani (1990), Në rrjedha të mendimit sociologjik, “Rilindja”, Prishtinë, f. 94.

t'i dalin zot profesionit të vet, por me zhvillimin e aftësive dhe shkathësisive individuale të të rinjve, me nxjerrjen në jetë të njerëzve mendimtarë që do të mund të ballafaqohen me probleme të shumta sociale, kulturore, ekonomike, politike, globale etj..

Demokracia në të vëtetë nuk garanton asgjë. Ajo paraqet mundësi për të fituar, por edhe rrezik për të dështuar. Është edhe premtim, por edhe sfidë. Është një sërë rregullash për zgjidhjen e konfliktit. Sipas Tomas Xhefersonit, premtimi që bën demokracia është: **“Jeta, liria dhe kërkimi i lumturisë njerëzore”**⁷. Ajo është premtim se duke punuar bashkërisht njerëzit mund të vetëqeverisin në mënyrë të atillë që u shërben aspiratave për liri personale, zhvillim ekonomik dhe drejtësi shoqërore. Ajo mund të jetë edhe sfidë sepse sukcesi i nismës demokratike varet nga vetë shtetasit e saj dhe nga askush tjetër.

Ndërkaq, era e demokracisë vazhdon të fryjë nga Mongolia në Tajvan, kurse në Afrikë nga Senegali, Gaboni e Kongoja deri në Angolë, madje edhe në Afrikën e Jugut. Dhe kjo dallgë lirie që vihet re gjatë dhjetëvjeçarit të fundit nuk përbën kurrësi garanci për suksesin e saj përfundimtar. Në lidhje me këtë Çester Fini thotë: “Është më se e kuptueshme që populli për nga natyra parapëlqen më shumë lirinë sesa shtypjen. Por kjo nuk do të thotë se sistemet politike demokratike mund të krijohen dhe të mbrohen vetë për një kohë të gjatë. Përkundrazi, ideja e demokracisë është e qëndrueshme, por zbatimi i saj është i pasigurt”⁸.

Edhe ish-presidenti amerikan, Xhimi Karter, lidhur me demokracinë në thekson: “Përvoja e demokracisë është si përvoja e vetë jetës. Është në ndryshim të pandërprerë, e pafundme në larminë e saj, nganjëherë e vrullshme, por edhe më e vyer sa më shumë t’u ketë bërë ballë vësh-tirësive”⁹.

⁷ Edukimi dhe Kultura e Demokracisë, Tiranë, f. 31.

⁸ Po aty, f. 3.

⁹ Po aty, f. 30.

Për të pasur një demokraci të shëndoshë dhe për të arritur një kulturë demokratike varet shumë se sa është zhvillur kjo kulturë demokratike te qytetarët, pra sa janë përvetësuar dhe arritur sjelljet, praktikat dhe normat që e përcaktojnë aftësinë e një populli për t'u vetëqeverisur. Kultura demokratike duhet të tregojë vullmetin e mirë të qytetarëve për t'i toleruar dallimet midis tyre, për ta zotëruar kulturën e debatit, të fleksibilitetit në mendime, të pranimit të dymendësisë, etj..

Edukimi demokratik që arrihet sot përmes mediave dhe rrjeteve sociale, sikurse edhe përmes institucioneve të arsimit dhe edukimit, duhet t'i orientojë të rinjtë për një botë gjithnjë e më komplekse, moderne dhe pluraliste. Me qëllim për të siguruar të ardhmen e demokracisë si dhe për të kontribuar për zhvillimin e përhershëm të saj, bëhet i domosdoshëm përvetësimi sa më i hershëm i kompetencave të të vepruarit demokratik, të rregullave dhe normave të shoqërisë civile si dhe zhvillimi i një kulture demokratike, duke filluar që nga bankat e shkollës dhe të universitetit.

Një mënyrë tjetër me rëndësi për t'i përvetësuar këto kompetenca është të mësuarit përmes projekteve konkrete, që u mundësojnë të rinjve të provojnë në praktikë mundësitë e tyre të veprimit dhe të arrijnë përvoja individuale si dhe të nxisin drejtpërdrejtë angazhimin e tyre për shoqërinë civile, për edukimin demokratik, për edukimin për të drejtat e njeriut, për edukimin për një qytetari demokratike dhe për një pjesëmarrje aktive në vendimmarrje.

Në këtë drejtim ka rëndësi stimulimi i projekteve duke pasur si pikëmbështetje rolin e mediave dhe të rrjeteve sociale, që kanë për qëllim përgatitjen e të rinjve për të marrë përgjegjësi për shoqërinë si dhe për të respektuar normat dhe rregullat e demokracisë me moton "Mëso dhe jeto demokracinë", gjë që është synimi kryesor i shkollës demokratike.

Ndikimi i mediave dhe i rrjeteve sociale në përditshmëri te të rinjtë – të mirat dhe pasojat që mund të kenë

Bota sot po bëhet gjithnjë e më globale, ndërsa kjo shtrirje e saj ka përfshirë edhe Kosovën. Kanë vërshuar informacionet nga mediat, interneti dhe rrjetet sociale, ku të rinjtë kanë mundësinë të nxënë dije nga fushat e ndryshme, të marrin informacione të shpejta për botën, por edhe të shërbejnë si medium për ndërveprim social të pranueshëm në rrethin shoqëror.

Si medime më të frekentuara këto vitet e fundit nga të rinjtë janë interneti, televizioni dhe facebooku. Sipas disa hulumtimeve, sipas Agjencisë për Mbikqyrjen e Tregut ‘Nielsen’ në SHBA, shfrytëzimi i tepruar dhe i pakontrolluar i këtyre mediave dhe rrjeteve sociale mund të shfaqë disa ndryshime në formimin e personalitetit të të rinjve, si p.sh. në shëndet, në mungesë të sjelljeve, mungesë të komunikimit, mungesë të socializimit, të depersonalizimit, varësisë, etj..

Për më tepër, para shtatëmbëdhjetë vitesh në internet u shfaq rrjeti social Facebook, që sot është bërë rrjeti më i suksesshëm. Facebook-u dhe rrjete të ngjashme, si LinkedIn, Instagram apo Xing, Twiter, janë bërë sot për shumicën e njerëzve pjesë e jetës së përditshme.

Jo vetëm të rinjtë, por edhe të moshave më të pjekura, e fillojnë dhe e mbarojnë ditën duke hedhur një vështrim në Facebook. Prandaj postimi i lajmeve, i fotografive private, komentet, ftesat, debatet, organizimi i takimeve me miq e plot njoftime të tjera përmes Facebook-ut, janë bërë përditshmëri për miliona njerëz. Me rrjetet sociale lindi mundësia për të qenë gjatë tërë kohës i pranishëm dhe në kontakt me ngjarjet nga më të ndryshmet.

Por kurioziteti për shpikje të reja në fushën e komunikimit është kërcnimi më i madh për një rrjet social si facebook-u - thotë Leister.

Shkencëtarët bëjnë me dije se facebook-u do të mbetet edhe për të paktën për dhjetë vite një medium a rrjet social dominues, ai është bërë një ide epokale, është bërë mbase masmedia e gjithë botës.

Por, sot jeta mund të vihet edhe në rrezik nga interneti dhe rrjetet sociale përgjithësisht, ngase me një virus kompjuteri hakerët mund të shkaktojnë një aksident automobilistik. Kjo është dëshmuar nga studiu-esisit dhe në një botë ku gjithnjë e më shumë aparatura lidhen në internet, rreziku i sulmeve të tilla rritet.

Për më tepër, synimi i shumicës së hakerëve është rrëzimi i sistemeve kompjuterike dhe marrja e të dhënave dhe e fjalëkalimeve. Të prekura prej kësaj në të kaluarën kanë qenë edhe institucionet e mëdha si FBI dhe Ministria Amerikane e Mbrojtjes. Pra, sulmuesit kërkojnë një të çarë në sistem, hyjnë brenda dhe kryejnë pastaj sulmet e tyre. Ky parim funksionon te të gjitha aparaturat që komunikojnë me botën e jashtme, si: kompjuterët, avionët, anijet, makinat, por edhe paisjet shtëpiake.

Se sa të prekshme janë ato, e analizoi edhe shkencëtari Klaus Scherer, i cili theksoi: “Në shënjestër të hakerave, sa e rrezikshme është kjo. Edhe avionët mund të devijohen nga kursi i tyre i fluturimit, pastaj ndërhyrja në llogaritë bankare për qëllime përfitimi, etj..¹⁰”

Qasja në media, në internet dhe në rrjete sociale, siç shihet sot është rritur ndjeshëm. Kjo ju krijon mundësinë të rinjve për një edukim demokratik “online”, por këtu mund të paraqiten edhe sfida, pasi qasja në internet është e madhe, ndaj duhet të ndërmerren hapa konkretë për motivimin e tyre për përdorimin e ndërgjegjshëm të internetit dhe të rrjeteve të tjera sociale.

¹⁰ Jeta në rrezik nga rrjeti, Shkenca & Edukimi, DW.DE/, 22.07. 2014, f. 1.

Cilat janë dobitë e përdorimit të mediave dhe të rrjeteve sociale nga të rinjtë

Kuptohet se mediat sociale sot kanë hapur opsione të reja për zhvillimin e karrierës, duke e bërë komunikimin dhe jetën më të lehtë sepse krijojnë mundësi për të krijuar, për të bashkëpunuar, diskutuar për tema të ndryshme, të bësh biseda të lira me miq dhe të panjohurit, të gjesh shokun e shoqen e jetës, etj..

Ato përparësi janë:

- Komunikojnë lirshëm dhe shpejt me bashkëmoshtarë, miq, etj.
- Forcon marrëdhënie shoqërore
- Largon ndjenjën e turp-it dhe vetmisë
- Vizitojnë ueb-sajta me përmbajtje argëtuese
- Shfrytëzohet si burim informatash për projektet shkollore dhe për detyrat e shtëpisë
- Mundëson ruajtjen e anonimitetit, ku çdokush mund ta fshehtë identitetin e vet në internet
- Qasje e lehtë për të marrë informatat e nevojshme
- Blerje
- Komunikim i shpejtë pa marrë parasysh largësinë
- Lexim lajmesh
- Mundësi të pakufizuara për hulumtim
- Lojëra të karakterit të ndryshëm
- Kryerje të transaksioneve bankare
- Reklamime
- Ndikimi pozitiv psikologjik, social, politik, ekonomik, etj.
- Nxiti vetëvlerësimin, etj..

Por, mediat, interneti, rrjetet sociale, mund të kthehen në burime shqetësimesh ekstreme deri te keqtrajtimet, vjedhjet, kërcnimet, krimet kundër personit, terrorizmi, fanatizmi fetar, nacionalizmi, shovenizmi, dhuna verbale dhe fizike, kriminaliteti, vrasjet etj.. Rreziku nëse nuk jemi të kujdesshëm, mbetet i lartë, sidomos te të rinjtë, prandaj ve-

ndosja e një balance midis jetës reale dhe asaj virtuale rekomandohet si çelësi i suksesit.

Cilat janë rreziqet e përdorimit të mediave dhe të rrjeteve sociale nga të rinjtë

Lajmet në media nganjëherë mund të lënë përshtypjen se interneti është vatra e prepotentëve elektronikë, grabitqarëve seksualë dhe hajdutëve të identitetit. Duke e ditur se rrjetet sociale janë bërë pjesë e jetës së përgjithshme për mbi 60% të shqiptarëve, përdoruesit janë të moshave të ndryshme, sidomos në Facebook, Twiter, blogger, duke filluar nga adoleshentët e deri te personat mbi 50 vjeç.

Megjithatë interneti, sikurse edhe rrjetet e tjera sociale, nuk duhen shikuar si armiq, përkundrazi telashet vijnë nga përdorimi jo i mençur i tij.

Rreziqet apo efektet negative janë:

- Shkakton depresion
- Çrregullon mënyrën e të ushqyerjes
- Nxiti divorcin e çifteve
- Probleme mendore
- Probleme me varësinë
- Pornografi dhe materiale seksuale
- Probleme sociale
- Urrjejtje, drogë, armë, dhunë
- Fotografi të personave të vrarë, duke i vrarë, sjellje sadiste, etj..
- Të dhëna të pasakta dhe irrelevante
- Humbje e konfidencialitetit të të dhënave personale dhe keqpërdorim i tyre
- Ka hakerë dhe viruse
- Humbje e të dhënave nga mosfunksionimi i sistemit
- Rreziqe ligjore dhe finaciare
- Keqpërdorim i mundësisë për transaksione finaciare të paligjshme.

Conclusions

Moreover, as stated above, social media and web have their advantages and disadvantages. They have opened the possibility for information, that influence and educate us daily. It is understood that using it for the right purposes, in certain amount and in full awareness brings positive effects in every area of work and social life.

Their effect is also seen in the democratic education of young people, especially in the promotion of democratic culture, debate, diversity of thought, a culture of tolerance, cooperation, education for the rights of children and adults, active citizenship, education for democratic citizenship, gender equality, career education, etc.

Therefore, in order to have an even a greater positive impact of social media and web on young people and society, the media, social networks, parents, teachers, and perhaps the community should come up with ever more positive messages online, and some monitoring of internet should occur in order to avoid any risks, or other unpredictable negative consequences.

"Children and young people in general know more about technology, but parents know more about life" said **Perri Aftabi**, an internet security expert.

Taking notes of the various studies on the impact of media and social networks on the democratic education of young people, we have come up with recommendations that we think would have an effective impact on equitable and democratic education of young people, e.g:

- Family, school and all other social factors should have a greater impact on the awareness and education, keeping pace with the contemporary issues and concerns. For those who receive education, develop manners, have self-control, awareness and know-hows, refrain from thoughts of self-harming or harming others.
- Electronic media provide more shows, topics, documentaries, programs, debates etc, that positively affect the democratic education of young people, as well as the information about the risk of excessive use of the Internet by vulnerable groups/individuals.

- For schools to be more active in organizing debates and school and extracurricular activities, especially from the youth forum, with topics of this nature;
- National Curricula should provides for more content, whether through compulsory or elective courses, in order to make young people more aware of the danger that may be presented to them by not knowing the risks of media and social networks
- Restrict, or perhaps prevent, all those programs and websites that do not have educational content, which are criminal, pornographic, etc., because of the high risk of child abuses, as it is already happening;
- For a better social welfare, all people, especially young people should learn to love life, work for their lives, enjoy life and have less fear for the future than the present.

Bibliografia:

1. Memushi, Luan (2003), Reformimi i Shkollës Progres dhe Strategji, Tiranë.
2. Mailaret, Gostan, (1997), Pedagogjia e Përgjithshme, “ Koha “, Prishtinë.
3. ŠOOŠ, Dr. Edita (1987), Demokratizacija obrazovanja, Školske Novineć, Zagreb.
4. Akiyma,T, and Kodaira, S, (1987), Children and Television, Programs for Children Based on the Pilot of an Animated Produktion, Tokyo: NHK Broadcasting Culture Research Institute.
5. Meltzoff, A.N. (1988), Imitation of televised models by infants, Child Development, 59.
6. Ledingham, J.E - Ledingham C.A and Richardson J.E 1993. The Effects of Media and Violence on Children: A Background Paper. Ottawa: Health and Welfare Canada.
7. Vladimir Poturić, (1986), Audovizuelna sredstva u profesionalnom informisanju, Nastavnik i profesionalni rayvoj ućenika, Prirućnik ya nastavnike, Zagreb.

8. Mr. Mr. Shaip Kabashi ,(1999), Byrokracia dhe Byrokratizmi në sistemin e qeverisjes, Prizren.
9. ... (1995). Edukimi dhe Kultura e Demokracisë, Tiranë.
10. Agani, Dr. Fehmi, (1990), Në rrjedha të mendimit sociologjik, “ Rilindja “, Prishtinë.
- 11... (1995). Edukimi dhe Kultura e Demokracisë, Tiranë.

Jeta në rrezik nga Rrjeti, Shkenca & Edukimi/ DW.DE/, 22.07. 2014.

<http://www.kombtare.al/fëmijët-te-rrezikua-nga-perdorimi-i-internetit/>

<https://www.thinkuknow.co.uk/parents/>

<http://www.childnet-int.org/kia>

[http://www.kosovapres.com/http://www.kosovapres.com/sq/-mediat dhe demokracia-Arkiva KosovaPres](http://www.kosovapres.com/http://www.kosovapres.com/sq/-mediat-dhe-demokracia-Arkiva-KosovaPres)

...Jeta në rrezik nga Rrjeti/ Shkenca dhe Edukimi/DW, DE/

Dr. Selim SELIMI

JETA DHE POEZITË E JAHJA KEMAL BEJATLLIUT (SHKUPJANI)

Abstrakt

Jahja Kemali është një poet shumë i rëndësishëm, i cili ka bërë përcaktimin e linjave kryesore të poezisë turke. Është një poet që mendon për artin. Është një njeri i cili ka ditur të shikojë edhe nga Lindja edhe nga Perëndimi.

Jahja Kemali është njeri nga ata që zbuloi fazat e rëndësishme të jetës së tij në formën e kujtimeve.

Në këtë studim do të japim shembuj të gjërave që i konsiderojmë të rëndësishme nga poezitë e tij, bazuar në pikën e kontributit për sfondin e temës në jetën e Jahja Kemalit dhe përcaktimin e bazave të jetës së tij artistike. Emri i vërtetë i Jahja Kemalit është Ahmet Agah. Jahja Kemali lindi në Shkup më 1884 si fëmija i parë i një familjeje që mund të konsiderohej e pasur sipas kushteve të asaj kohe, e cila ishte e kulturuar dhe e përkushtuar ndaj traditave dhe vlerave të saj.

Ndër elementet që përbëjnë sfondin e personalitetit të Jahja Kemalit, përveç personaliteteve të njohura, ishte edhe mjedisi gjeografik dhe kulturor i Shkupit, Parisit dhe Stambollit. Poeti Jahja Kemal njihet si “poeti i Stambollit” duke jetuar me dashurinë e tij për Sta-

mbollin dhe duke e shprehur Stambollin në mënyrën më të mirë në poezitë dhe prozat e tij.

Fjalë kyçe: *Jeta e Jahja Kemalit, poezia, ideologjia, Shkupi, Stambolli*

Hyrje

Janë të njohura biografite e njerëzve si Jahja Kemali, që kanë kontribuar në kulturën intelektuale dhe artistike. Historitë jetësore të këtyre njerëzve mund të mësohen përmes kujtimeve, por edhe përmes biografive e autobiografive të tyre të shkruara apo të interpretuara. Mund të hasësh shumë njerëz të idesë, artit dhe shkencës, që e përshkruajnë jetën përmes kujtimeve të tyre. Jahja Kemali është njëri prej atyre që i zbuloi fazat e rëndësishme të jetës së tij në formën e kujtimeve¹. Ne e mësojmë këtë informacion veçanërisht në veprën e tij të jashtëzakonshme të titulluar *Çocukluğum, Gençliğim, Siyasi ve Edebi Hatıralarım* (Fëmijëria, rinia, kujtimet e mia politike dhe letrare) dhe në poezitë e tij, herë në mënyrë të qartë dhe herë në formën e kamufluar. Në këtë studim do të japim shembuj të gjërave që ne i konsiderojmë të rëndësishme², nga poezitë e tij, bazuar në pikën e kontributit për sfondin e temës në jetën e Jahja Kemalit dhe përcaktimin e bazave të jetës së tij artistike.

¹ Ömer Özden, *Estetik ve Tarih Felsefesi Açısından Yahya Kemal*, Kültür Bakanlığı Yayınları, Ankara, 2001, s. 26.

² Nihat Sami Banarlı, *Yahya Kemal'in Hatıraları*, İstanbul Fetih Cemiyeti, Yahya Kemal Enstitüsü Yayınları, İstanbul, 1960, s. 15.

Fëmijëria e Jahja Kemalit

Emri i vërtetë i Jahja Kemalit është Ahmet Agah. Jahja Kemali lindi në Shkup më 1884 si fëmija i parë i një familjeje që mund të konsiderohej e pasur sipas kushteve të asaj kohe, e cila ishte e kulturuar dhe e përkushtuar ndaj traditave dhe vlerave të saj. Jahja Kemali e mori arsimin fillor në familje. Për gjithçka që nga lindja e tij u kujdes dadëja, që quhej Fatma Hanım. Në atë kohë³ gruaja që ai e quajti “nana”, ishte angazhuar për arsimin dhe edukimin e tij. Nana ishte pa fëmijë dhe e donte dhe e llogariste atë si djalë të vetin. Ndërsa Nakiye Hanım, nëna e Ahmet Agah, ka një vend të jashtëzakonshëm në familjen e tij, i dha atij njohuritë e para fetare dhe kishte ndikim të madh në formimin e edukimit dhe arsimimit të tij. Jahja Kemali e shpreh këtë si në vijim: “Nëna ime ishte ajo që ndikoi më fort në edukatën time fetare dhe kombëtare. Nëna ime ishte një grua shumë myslimane. Ajo lexonte Muhamediyah dhe më mësonte Kuranin”. Ndër elementet që përbëjnë sfondin e personalitetit të Jahja Kemalit, përveç personaliteteve të njohura, ishte edhe mjedisi gjeografik dhe kulturor i Shkupit, Parisit dhe Stambollit.

Jahja Kemali në poezinë e tij “Açık Deniz - Deti i Hapur”, shprehet mirë se fëmijërinë e tij e kaloi në qytetet e Ballkanit:

*“Balkanlar şehrinde geçerken çocukluğum,
Her lahza bir alev gibi hasretti duyduğum.
Kalbimde vardı “Byron” u bedbaht eden melal
Gezdim o yaşta dağları, hulyam içinde lal,
Aldım Rakofça kırlarının hür havasını,
Duydum akıncı cedlerimin ihtirasını”.*⁴

³ Yahya Kemal, Çocukluğum, Gençliğim, Siyasi ve Edebi Hatıralarım, İstanbul Fetih Cemiyeti, Yahya Kemal Enstitüsü Yayınları, 3. Baskı, İstanbul, 1986, s. 12.

⁴ Yahya Kemal, Çocukluğum, Gençliğim, Siyasi ve Edebi Hatıralarım, İstanbul Fetih Cemiyeti, Yahya Kemal Enstitüsü Yayınları, 3. Baskı, İstanbul, 1986, s. 33.

“Fëmijëria ime ndërsa kaloja nëpër qytetin e Ballkanit,
 Kam dëshiruar çdo moment mallëngjimi si një flakë.
 Ishte në zemrën time mahnitëse, që e bëri “Bajronin” të mjeru-
 eshëm
 Unë endem nëpër male në atë moshë, tulipanët në ëndrrat tmia,
 Mora ajrin falas në fshatin Rakofça,
 Kam dëgjuar pasionin e “akincive” kalorësve të mi.

Shkupi është vendi ku zërat e ezanit nuk ndalen kurrë, kështu që nëna e tij nuk dëshiron të largohet nga ky vend, të cilin edhe ai e do shumë, ku formohet thelbi i botës së emocioneve që ai kurrë nuk e harron.

Shkupi ishte vendlindja e Jahja Kemalit⁵, e dashuronte shumë atë vend, megjithëse familja e tij u shpërngul në Shkup më vonë. Ai thotë: “Unë nuk jam nga Shkupi si familje, jam nga Nishi, por jam krenar që kam lindur në Shkup sepse Shkupi është vendi ku përfaqësohet turqishtja në Rumeli. Shkupi është aq turk, saqë fryma e kombësisë sonë formohet në çdo gur⁶.” Për vendlindjen poeti i shpreh ndjenjat e tij në rreshtat në vijim:

*“Üsküp ki Yıldırım Beyazid Han diyarındır.
 Evlad-ı fatihan’a onun yadigarıdır
 Firuze kubbelerle bizim şehrimizdi o;
 Yalnız bizimdi, çehre ve ruhiyle bizdi o.
 Üsküp ki Şardağı’nda devamıydı Bursa’nın.
 Bir lale bahçesiydi dökülmüş, temiz kanın”⁷*

“Shkupi është toka e Jildirim Beyazid Hanit.
 Hesht trashëgimia e tij për djalën e fatihanit

⁵ Nihat Sami Banarlı, YKH, s. 27-28.

⁶ Yahya Kemal, Çocukluğum, Gençliğim, Siyasi ve Edebi Hatıralarım, s. 33.

⁷ Yahya Kemal, Kendi Gök Kubbemiz, s. 14.

Ishte qyteti ynë me kupola bruz;
Ishte vetëm yni, ishte me fytyrën dhe shpirtin e tij yni.
Ishte vazhdimi i Bursës në Shardaği të Shkupit.
Ishte një kopsht me tulipanë, i derdhur, gjaku yt i pastër”.

Jahja Kemali përdor shprehjet e mëposhtme kur përshkruan këtë atmosferë të Shkupit, e cila përbën thellësitë shpirtërore të botës së tij të brendshme: “Në moshën time, unë isha duke u rritur me ezanet që ngriheshin nga minaret e Shkupit dhe ishin mbushur me këto zëra. Kur ezani fillonte në minare, në shtëpinë tonë do të kishte një heshtje shpirtërore. Unë mendoj se Shkupi dhe i gjithë qyteti sikur do të mbulohej nga heshtje për një çast...”⁸ Njëmijë e katërqind vjet më parë, ezani këndohet, qindra vjet më vonë ishte bërë një muzikë fetare dhe kombëtare në qiellin tonë.

Shkollimi i poetit

Dihet që Jahja Kemali e mori arsimimin e tij fillor nga familja e tij. Kur ishte pesë vjeç, ai u dërgua në Shkollën e Re me një ceremoni tradicionale. Megjithëse e ndoqi shkollën për tre vite, nuk mund t’i njihje shkronjat. Jahja Kemali ishte vetëm tetë vjeç kur babai i tij donte ta jargonte nga kjo shkollë dhe ta çonte në mekteb-i edeb me shqetësimin e “daljes nga Islami”. Ai nuk mundi ta refuzonte kërkesën e babait për të vazhduar shkollimin në mekteb-edeb, ku mësoi alfabetin dhe arriti të mësonte të lexonte për dy muaj.

Pa dyshim, këto përvoja shkollore kanë kontribuar në edukimin dhe aftësimin e tij, por ai nuk mund të kishte një jetë të qëndrueshme arsimore. Me insistimin e babait të tij, kur u vendosën në Selanik, u bë edhe transferimi i shkollës. Kur nëna e tij për një kohë të shkurtër u

⁸ Nihat Sami Banarlı, YKH, s. 27-28.

kthye përsëri në Shkup, edhe ai u transferua së bashku me nënën në Shkup. Mirëpo, me vdekjen e nënës së tij dhe martesën e babait të tij, ai u largua përsëri nga Shkupi për të vazhduar shkollën me konvikt Idadije në Selanik⁹. Jahja Kemali për këtë gjendje mërzie shprehet: "Vdekja e nënës sime shkaktoi konfuzion në arsimin tim".

I riu Jahja Kemal u dërgua në Stamboll për të studiuar në vitin 1902. Në moshë të re, Jahja Kemali mësoi përmendësh thujtje të gjitha poezitë e Mualim Naçit. Ai bëri krahasime duke lexuar poezitë e Ruhiut, Ziya Pasha, Mehmet Celal dhe Makberin e Abdülhak Hamid. Teksa lexonte të gjitha këto, vazhdoi të provonte së shkruari poezi me (aruz vezni) njëhsorin e prozodisë. Kur ishte në Selanik, u mor më shumë me poezi, ndoqi revistën "Servet-I Fünun" dhe shkroi poezi me pseudonimin "Esrar"¹⁰ dhe pasi erdhi në Stamboll, nuk u ndal së lexuari poezitë dhe veprat e Tevfik Fikret dhe Cenap Shahabettinit.

Jahja Kemali, i cili në vitin 1903 shkoi në Paris, takoi poetë të njohur si Sami Paşazade Sezai, Abdullah Cevdet dhe Abdulhalim Memduh. Ndërkohë, Jahja Kemali u takua me Jean Moreas. Ai gjithashtu mësoi poezitë dhe pikëpamjet e poetëve simbolistë si Stephane Mallarme, Arthur Rimbaud dhe Paul Clandel¹¹. Kur lexoi moton e Mallarmes, "Nëse të rinjtë francezë duan të mësojnë artin e poezisë, le të mësojnë përmendësh Fetes Galantesi të Paul Verlaine", ai u bë edhe më i interesuar për poezinë e vjetër turke dhe shkoi në Shkollën e Gjuhëve Orientale në Paris për ta studiuar. Gjatë studimeve ai përmirësoi dukshëm arabishten dhe persishten. Ai e trajnoi veten për të kuptuar poezinë e Divanit. Parisi tek ai ka lënë efekte dhe gjurmë të thella në të kuptuarit e poezisë dhe artit. Në poezitë e Divanit gjithmonë gjente gjuhën që kërkonte, thellësitë e botës së mendimit dhe emocioneve në

⁹ Yahya Kemal, *Kendi Gök Kubbeviz*, s. 77.

¹⁰ H. Ömer Özden, *Estetik ve Tarih Felsefesi Açısından Yahya Kemal*, MEB, Ankara, 2001, s. 50.

¹¹ Yahya Kemal, ÇGH, s. 21-29.

turqishten e vjetër. Parisi është vendi që Ahmet Agahun e shndërroi në poetin dhe mendimtarin Jahja Kemal. Vdekja e nënës së tij, martesë e babait të tij, paaftësia e tij për të gjetur mjedisin që ai mendonte në Stamboll, rezultoi me qëndrimin e tij në Paris.

Qyteti i parë i preferuar për të është pa dyshim Shkupi dhe kurrë nuk ka qenë në gjendje ta nxjerrë atë nga ëndrrat e tij. Pasi u kthye nga Parisi për në Stamboll, për një kohë prapë interesohej për Parisin dhe çdo lajm negativ që merrte nga Parisi, e shqetësonte dhe ia zvogëloi dashurinë për të. Me ndarjen nga Parisi, u lidh më shumë me Stambollin, qytetin e bukur, për të cilin çdo ditë i rritej dashuria.

Tani Stambolli është bërë një qytet i domosdoshëm për të. Poeti e ka përjetuar gjithmonë mallin për të. Duke u shkëputur nga jeta konservatore e shoqërisë turko-islamike, nga e cila doli në moshë të re, poeti për nëntë vite sa ishte në Perëndim u mësua me stilin e jetës moderne, jetoj dualitetin Lindje-Perëndim. Sidoqoftë, me emocionet, mendimet, artin dhe poezinë e tij, ai mbeti një bir që dëshironte të shkrihej në frymën kombëtare të kombit të tij dhe të kthehej në natyrshmërinë e vet, në shoqërinë turko-islame. Ai i pasqyroj ndjenjat e tij të qëllimit të mirë në poezitë e tij¹². Jahja Kemali ishte në gjendje të pasqyronte jetën turko-islamike në poezinë “Süleymaniye’de Bayram Sabahı” (Mëngjezi i Bajramit në Sylejmanije) dhe poezi të tjera.

¹² Nurullah Çetin, *Milletleşme Sürecinde Yahya Kemal Aydınlanması*, Öncü Kitap Yayınları, Ankara, 2008, s. 102.

Strofat e fundit të poezisë

Mëngjesi i Bajramit në Sylejmanije¹³

...

Nga vijnë tingujt e topave në qiell, një nga një?

Me siguri secili vjen nga një fitore tjetër:

Nga Kosva, Nigbolu, Varna, Stamboll.

Secili përkujton një rast me këtë moment;

A është nga Beogradi? A është Budin nga Egri dhe Uyvar?

A është nga vargmalet e ekzaltuara në kufijtë e fundit?

Nga vijnë këta tinguj topi në horizontin e detit?

Barbarossa, ndoshta, vjen nga ekspedita me marinën.

A është nga ishujt? A është nga Tunizia apo Algjeria?

Dyqind anije të armatosur në horizonte të lira

Vjen nga aty ku ata shikuan hënën e sapolindur.

Nga cila ditë vijnë ato anije të bekuara?

Unë u bashkova me unitetin e atdheut në tempullin e madh.

Falë Zotit pashë përsëri këto orë shpirtrat me të gjallët.

Zemra ime është plot drita këtë mëngjes feste.

¹³ Xhamia e Süleymaniye, si vepër madhështore e Mimar Sinanit, u ndërtua midis viteve 1551-1558 me urdhër të sulltanit osman Sulejmanit të Madhërisëm.

Kthimi nga Parisi në Stamboll

Fakti që ai do ta linte rininë e tij për deri në vitin 1912, kur u largua nga Parisi, tani e ndjen veten se do të shkojë drejt pjekurisë. Kjo nënkuptonte pjekurinë e tij jo vetëm për nga mosha, por edhe si artist¹⁴. Poeti Jahja Kemal, i cili gjeti atë që kërkonte në Paris, mund të thuhet se ka jetuar periudhën më të mirë dhe më të dobishme të jetës së tij në aventurën e tij nëntëvjeçare në Paris.

Kur Jahja Kemali u kthye nga Parisi si mësues në Darü'l-Fünun në Stamboll, udhëtoi rrethëqark Stambollit me studentët e tij nga lagjja në lagje, nga fshati në fshat për të parë për së afërmi bukuritë e Stambollit. Poeti, i cili studioi thellë historinë turke në drejtim të leksioneve të A. Sorel, arriti në përfundime duke analizuar fillimisht dhe më pas duke sintetizuar atë që lexoi dhe pa¹⁵, pastaj i zbatoi këto provoja kumulative në poezitë dhe prozat e tij të reja.

Përveç këtyre ai kërkoi një mënyrë për të kuptuar historinë e kombit turk. Përballë idesë osmane, që kishte mbizotëruar për shekuj, mendimi Turan mendonte se tani po zgjohej në disa qarqe. Për t'iu përgjigjur pyetjes: Cili do të ishte fundamenti i historisë kombëtare turke?, ai përdor tani një citim të famshëm nga historiani Camilla Julie, që hapi një horizont të ri edhe për të: “Toka franceze krijoi kombin francez për një mijë vite”. Kjo fjali u bë formula e filozofisë dhe historisë së Jahja Kemalit dhe e zbatoi atë në historinë turke. Kështu, në vend të pikëpamjes së Ziya Gökalp të bazuar në vlera racore, tani e tutje do të zbatohet koncepti për historinë kombëtare, ideja e Jahja Kemalit në tokat e atdheut të tij¹⁶. Ai besonte se një civilizim ishte brumosur midis kombit të sotëm turk dhe tokës anadollake dhe pranonte që civilizimi i ri që turqit kishin paraqitur pas mbërritjes së tyre në Anadoll dhe ele-

¹⁴ Yahya Kemal, ÇGH, s. 93-100.

¹⁵ Nihat Sami Banarlı, YKH, s. 43-45.

¹⁶ H.Ömer Özden, Estetik ve Tarih Felsefesi Açısından Yahya Kemal, KB. İstanbul, 2001, s. 58.

mentet që krijuan këtë civilizim duhet të janë në pajtim njëra me tjetrën.

Kur u kthye nga Parisi, ai nuk ishte shëruar ende nga mallëngjimi për të. Ndërsa udhëtonte dhe u njoh për së afërmi me Stambollin, ai e kuptoi thellësinë e këtij qyteti si nga ana gjeografike ashtu edhe nga historia. Ai deklaroi se qytetërimi turko-islam e bëri këtë qytet edhe më të turqizuar duke e qëndisur me xhami, varre, medrese, gurë varresh, madje arriti një aftësi të lartë përfaqësimi duke e qëndisur këtë qytet. Sidoqoftë, sipas Jahja Kemalit, Stambolli nuk u ndërtua vetëm nga sulltanët dhe banorët vendas, por edhe nga turqit myslimanë që erdhën nga të gjitha vendet dhe u vendosën këtu; me gratë e tyre, fëmijët, të moshuarit; me punëdorët, artizanatet, muzikën, folklorin dhe poezi divani; me arkitekturat e tyre të qytetit, rrugës, shtëpisë dhe dhomës, xhamitë, banjot dhe kupolat e tyre; në fakt, ata e ndërtuan këtë qytet së bashku me aftësitë dhe kujtimet që sollën nga çdo shekull për të pasuruar atdheun dhe historinë tonë¹⁷. Stambolli është qyteti ku turqishtja u shfaq si një sintezë. Ky kuptim rezulton në shikimin e Stambollit si atdheun e vërtetë dhe të vetmin vend që do t'i bëjë njerëzit të lumtur.

Duke shprehur unitetin me njerëzit e saj, arkitekturën, muzikën dhe rrethet, kjo sintezë është gjithashtu një simbol i unitetit, integritetit dhe fuqisë. Për shembull, një rreth si Koca Mustafapaşa nuk gjendet në Buhara ose Semarkandë, mund të gjendet vetëm në Stamboll. Integriteti arkitektonik këtu është gjithashtu një simbol i integritetit të atdheut.

Poeti Jahja Kemal njihet si “poeti i Stambollit” duke jetuar me dashurinë e tij për Stambollin dhe duke e shprehur Stambollin në mënyrën më të mirë në poezitë dhe prozat e tij.

¹⁷ H. Ömer Özden, age. s. 59.

Kuptimi i poezisë së Jahja Kemalit

Si çdo artist edhe Jahja Kemali kërkoi përsosmërinë. Siç dihet, ai shkroi si në zhanret e vargjeve, ashtu edhe në ato të prozës. Sidoqoftë, ai është më i famshëm për poezinë e tij sesa për proza. Në prozë të gjitha llojet e ideve dhe të gjitha aktivitetet e inteligjencës mund të shprehën me fjali që plotësojnë njëra-tjetrën. Sidoqoftë, poezia mund të mos jetë aq e përshtatshme sa proza për gjenerimin e ideve. Këto fjali të prera, të bashkuara në një strukturë tjetër, nuk ofrojnë shumë mundësi për të krijuar teori teologjike, herë duke i dhënë tingullit qëndrueshmërinë e një mermeri të gdhendur siç duhet, herë duke i dhënë ngjyrën dhe hijet e një peizazhi dhe duke udhëhequr një muzikë të papërshkrueshme.

Në këtë aspekt mund të thuhet se poezia dhe arti në përgjithësi është një kulm ku individi e percepton veten në mënyrën më absolute dhe të lirë.

Në traditën e poezisë turke janë shfaqur ide dhe lëvizje të ndryshme. Njëri prej tyre është edhe poezia e Divanit. Jahja Kemal është një nga ata që e njeh më së miri poezinë Divan, përdor më së miri aruz dhe zbaton më së miri aruz në turqisht¹⁸. Sipas Jahja Kemalit, i cili shkroi poezi në turqishten e vjetër, megjithëse gjuha ndryshon, modeli, masa, që është metri i prozodisë, është i njëjtë. Ashtu si të parët tanë që përdorën shijen e poezisë perse me aruz, së bashku me poetët si Tevfik Fikret dhe Mehmet Akif, edhe ai shkroi poezi në turqisht nën ndikimin e poezisë perse, në përputhje me modelet turke.

Shkrimet e poetit në poezitë "Topkapı Sarayı" (Pallati Topkapı), "Ezan ve Kuran" (Ezani dhe Kurani), "Ezansız Semtler" (Rrugët pa Ezan), " Bir Rüyada Gördüğümüz Eyub " (Në ëndërr që kemi parë Eju-pin) përmbajnë përkushtimin e kombit tonë ndaj Islamit nga perspek-

¹⁸ Nurullah Çetin, Milletleşme Sürecinde Yahya Kemal Aydınlanması, Öncü Kitap Yayınları, Ankara, 2008, s. 102.

tiva e historisë, zakoneve, arkitekturës, muzikës dhe si këto vlera të ngjashme mijërvjeçare kulturore të akumuluar. Ndër poezitë e tij "Süleymaniye'de Bayram Sabahı" (Mëngjes i Bajramit në Sylejmaniye), "Itri", "Ziyaret" (Vizitë), "Atık Valde'den İnen Sokakta" ("Mbeturina në rrugë që zbresin nga Atik Valde", "Koca Mustapaşa" (Kogja Mustafapasha), "Ufuk" (Horizonte), "O Taraf" (Ajo anë), "Selimname" dhe "Ezan-ı muhammedi" janë poezi që shprehin ndjenjat fetare të Jahja Kemalit.

Ai nuk bën dallim midis poezisë dhe muzikës. Ai përdor të gjitha mundësitë e njehsorit të prozodisë¹⁹, rimave, zërit dhe përsëritjes së fjalës për ta mbajtur poezinë e tij muzikore. Për poetin poezia ishte një mënyrë e bukur, harmonike dhe e këndshme për të thënë fjalët. Poezia duhej të ishte e ndryshme nga proza. Një nga elementët kryesorë që e dallon poezinë nga proza është muzika. Përveç kësaj, ai ka bërë përpjekje të jashtëzakonshme për t'i sjellë turqishtes një strukturë muzikore.

Sipas Ahmet Hamdi Tanpınar, "ai (Jahja Kemali) ka pastruar disa fjalë nga turqishtja e vjetër me një lloj prekje, domethënë me një ndjenjë të thellë. Ai jo vetëm që ka gjetur gjuhën e re, por gjithashtu ka hequr elementet e prozës, të cilat nuk përshtaten në trupin e turqishtes, e cila nuk e pranoi kënaqësinë e gjuhës në marshimin e vet shekullor."

Me pak fjalë, Jahja Kemali është poeti i kombit turk, i historisë, kulturës e i gjeografisë turke. Ai është një poet i vetëdijshëm që realizon vlerat dhe harmoninë e bukur të ekzistencës turke.

Jahja Kemali në poezitë e tij ka përpunuar historinë, muzikën, vlerat dhe tërë ekzistencën tonë kulturore në mënyrën më të bukur dhe artistike.

¹⁹ Nihat Sami Banarlı, YKB, s. 104.

Vepra të Jahja Kemalit

Veprat e Jahja Kemalit, poezitë dhe shkrimet e të cilit ishin shpërndarë në revista dhe gazeta, u tubuan dhe u botuan në libra nga Instituti Jahja Kemal²⁰, i cili u themelua në Stamboll pas vdekjes së tij. Seria me emrin “Yahya Kemal Küliyyatı” përbëhet prej trembëdhjetë librash. Këta janë:

- 1-) *Kendi Gök Kubbemiz* (1961)
- 2-) *Eski Şiir'in Rüzgârıyla* (1962)
- 3 ve 4-) *Rubailer ve Hayyam Rubailerini Türkçe Söyleyiş* (1963): 2 *kitap bir arada yayınlanmıştır.*
- 5-) *Aziz İstanbul* (1964)
- 6-) *Eğil Dağlar* (1966)
- 7-) *Siyasi Hikayeler* (1968)
- 8-) *Siyasi ve Edebi Portreler* (1968)
- 9-) *Edebiyata Dair* (1971)
- 10-) *Çocukluğum, Gençliğim, Siyasi ve Edebi Hatıralarım* (1973)
- 11-) *Tarih Musahabeleri* (1975)
- 12-) *Bitmemiş Şiirler* (1976)
- 13-) *Mektuplar-Makaleler* (1977)

1. Kupola jonë vetjake (Kendi Gök Kubbemiz)

Kupola jonë vetjake është mishërimi me tokën dhe qiellin e kombit dhe tërë botën e tij. Poezitë "Mëngjesi i Bajramit në Sylejmanije" dhe "Pranvera në Erenköy" kanë përmbajtje atdhedashurie, ndërsa në poezinë "Mihriyar"²¹, Jahja Kemali na paraqet të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen, pa i ndarë ato. Në këtë poezi prezentohen vlerat njerëzore, të cilat spikasin më shumë sesa dobësitë njerëzore:

²⁰ M. Orhan Okay, Beyatlı Yahya Kemal, TDV İslam Ansiklopedisi, C: 6 İstanbul, 1992, s. 38.

²¹ Yahya Kemal, Kendi Gök Kubbemiz, İstanbul Fetih Cemiyeti, İstanbul, 2008.

“Prej jush jam me zemër, gjuhë, gjakun dhe me temperamentin tim

Së bashku me bashkëvendësit e mi, në këtë botë dhe në ahiret”.

Ky libër përbëhet nga tre kapituj: Kupola jonë qiellore, Mendimi i rrugës dhe Vuslat. Në këtë pjesë ka poezi që trajtojnë kombësinë tonë dhe tema të tilla si feja, historia, heroizmi, muzika dhe arkitektura. Në pjesën e dytë ka poezi të ndjesisë dhe mendimit filozofik brenda kornizës së temave të lëkurës, vdekjes, përjetësisë, vdekshmërisë, horizontit. Pjesa e tretë përfshin poezi dashurie, malli dhe ekzotike.

2. Me erë të poezisë së vjetër (Eski Şiir’in Rüzgârıyle)

Me erë të poezisë së vjetër përbëhet nga poezi të shkruara në stilin klasik. Ky libër përbëhet nga gjashtë kapituj, përkatësisht: Selimname, Gazellet, Musammat, Kushtimi, Strofat dhe Bejtet. Në këtë libër ka poezi klasike të shkruara në turqishten osmane duke iu përmbajtur gjuhës, formës dhe frazeologjisë së poezisë sonë divan²².

Për sa i përket gjuhës, ky libër u shkrua në gjuhën e kohës së tyre, si në Selimname dhe Gazel Poezi për jeniçerët që pushtuan Stambollin. Jahja Kemali, ndërsa mbartte të kaluarën në të tashmen në gjuhën e shekujve të kaluar, në një kuptim, tregoi se ne mund ta mbajmë të gjallë të kaluarën tonë. Nuk duhet harruar se në këto poezi poeti ruan tiparet formale të poezisë klasike.

3. Rubairat (Rubailer)

Në këtë libër ka poezi të stilit rubai bazuar në shprehjen e ideve filozofike dhe mistike në modele të vogla poetike me katër rreshta²³. Ka dyzet e një rubaira në libër. Shumica e këtyre rubairave u dedikohen personaliteteve të ndryshme.

²² Yahya Kemak, Eski Şiirin Tügariyla, İstanbul Fetih Cemiyeti, İstanbul, 1985.

²³ Yahya Kemal, Rubailer, İstanbul Fetih Cemiyeti, İstanbul, 1963.

4. Të thuhen Rubairat e Hajamit në turqisht (Hayyam Rubailerini Türkçe Söyleyiş)

Përveç rubairave të tij, Jahja Kemal gjithashtu ka shkruar në turqisht rubairat e Omer Hajamit²⁴, i cili konsiderohet të jetë mjeshtri i stilit rubai. Ka pesëdhjetë e katër rubaira në këtë libër.

5. Poezi të papërfunduara (Bitmemiş Şiirler)

Ky libër përbëhet nga gjashtë kapituj: Malazgird, Rruga dhe nata, Përkthimi dhe Të ngjashmit, Përkushtimi dhe humori, Bejtet dhe vargjet dhe Poezitë e stilit Servet-i Funun²⁵.

Përveç poezive që Jahja Kemali shkroi, por edhe ato që nuk mundi t'i përfundonte, gjenden edhe poezi të shkruara në rininë e tij.

Përfundim

Në përfundim të këtij studimi mund të themi se arritëm të shohim që Jahja Kemali është një nga ata që zbuloi fazat e rëndësishme të jetës së tij në formën e kujtimeve. Ndër elementet që përbëjnë sfondin e personalitetit të Jahja Kemalit, përveç personaliteteve të njohura, ishte edhe mjedisi gjeografik dhe kulturor i Shkupit, Parisit dhe Stambollit.

Kur lexoi moton e Mallarmes, “Nëse të rinjtë francezë duan të mësojnë artin e poezisë, le të mësojnë përmendësh Fetes Galantesi të Paul Verlaine”, u bë edhe më i interesuar për poezinë e vjetër turke dhe shkoi në Shkollën e Gjuhëve Orientale në Paris për ta studiuar. Gjatë studimeve ai përmirësoi dukshëm arabishten dhe persishten. Ai e trajnoi veten për të kuptuar poezinë e Divanit. Parisi tek ai ka lënë efekte dhe gjurmë të thella në të kuptuarit e poezisë dhe artit. Në poezitë e Divanit gjithmonë gjente gjuhën që kërkonte, thellësitë e botës së mendimit dhe emocioneve në turqishten e vjetër.

²⁴ Yahya Kemal, Hayyam Rubaileri Türkçe Söyleyiş, İstanbul, 1963.

²⁵ Yahya Kemal, Bitmemiş Şiirler, İstanbul Fetih Cemiyeti, İstanbul, 1976.

Për t'iu përgjigjur pyetjes: Cili do të ishte fundamenti i historisë kombëtare turke?, ai përdor tani një citim të famshëm nga historiani Camilla Julie, që hapi një horizont të ri edhe për të: “Toka franceze krijoi kombin francez për një mijë vite”. Kjo fjali kuptimplote u bë formula e filozofisë dhe e historisë së Jahja Kemalit, të cilën ai e zbatoi në historinë turke.

Si çdo artist edhe Jahja Kemali kërkoi përsosmërinë. Siç dihet, ai shkroi vepra si në zhanret e vargjeve, ashtu edhe në ato të prozës. Sidoqoftë, ai është më i famshëm për poezinë e tij sesa për proza. Në prozë të gjitha llojet e ideve dhe të gjitha aktivitetet e inteligjencës mund të shprehen me fjali që plotësojnë njëra-tjetrën. Sidoqoftë, poezia mund të mos jetë aq e përshtatshme sa proza për gjenerimin e ideve.

Poeti Jahja Kemal njihet si “poeti i Stambollit” duke jetuar me dashurinë e tij për Stambollin dhe duke e shprehur Stambollin në mënyrën më të mirë në poezitë dhe prozat e tij.

Me pak fjalë, Jahja Kemali është poeti i kombit turk, i historisë, kulturës dhe i gjeografisë turke. Ai është një poet i vetëdijshëm që realizon vlerat dhe harmoninë e bukur të ekzistencës turke. Jahja Kemali në poezitë e tij ka përpunuar historinë, muzikën, vlerat dhe tërë ekzistencën tonë kulturore në mënyrën më të bukur dhe artistike.

Abstractk

Jahja Kema is a very important poet who has defined the main lines of Turkish poetry. He is a poet who thinks about art. He is a man who knew how to look both both towards the East and the West.

Jahja Kemal is one of those who discovered the important stages of his life in the form of memories.

In this study, we will give examples of things we consider important, from his poems, based on the point of contribution to the background of the theme in the life of Jahja Kemal and the definition of the foundations of his artistic life. Jahja Kemal's real name is Ahmet Agâh. Jahja Kemal was born in Skopje in 1884 as the first child of a noble family, adherent to its traditions, culture and value.

Among the elements that make up the background of Jahja Kemal's personality, a great impact in his personality, derives from Skopje, Paris and Istanbul, where he lived.

The poet Jahja Kemal is known as the "poet of Istanbul" living with his love for Istanbul and expressing Istanbul in the best way in his poems and prose.

Literatura:

- Banarlı, Nihad Sami (1997), Yahya Kemal'in Hatıraları, İstanbul Fetih Cemiyeti, İstanbul.
- Develioglu, Ferit (2011), Osmanlıca- Türkçe Ansiklopedik Lugat, Aydın Kitabevi, Ankara.
- Çetin, Nurullah (2008), Milletleşme Sürecinde Yahya Kemal Aydınlanması, Öncü Kitap Yayınları, Ankara.
- Kemal, Yahya, Aziz İstanbul, İstanbul, 2010.
- Kemal, Yahya (1999), Çocukluğum Gençliğim Siyasi ve Edebi Hatıralarım, YKE, İstanbul.
- Kemal, Yahya (2010), Kendi Gök Kubbemiz, 32 baskı, İstanbul.
- Kemal, Yahya (2010), Eğil Dağlar, İstanbul.
- Kemal, Yahya (2010), Eski Şiirin Rüzgarıyla, İstanbul.
- Kemal, Yahya (2006), Rubailer ve Hayyam Rubailerini Türkçe Söylemiş, İstanbul.
- Kemal, Yahya (2006), Siyasi ve Edebi Portreler, İstanbul Fetih Cemiyeti, İstanbul.
- Kemal, Yahya (2010), Bitmemiş Şiirleri, İstanbul.
- Kemal, Yahya (2001), Bütün Şiirleri, Yapı Kredi Yayınları,
- Korkmaz, Zeynep (2010), Gramer Terimleri Sözlüğü, TDK Yayınları, Ankara.
- Okay, Orhan (1992), Beyatlı Yahya Kemal, TDV İslam Ansiklopedisi, C: 6 İstanbul,
- Özden, Ömer (2001), Estetik ve Tarih Felsefesi Açısından Yahya Kemal, KB. İstanbul.
- TÜRKÇE SÖZLÜK, Türk Dil Kurumu, Ankara 1988.

PhD (c) Agron ISLAMI

TË DHËNA BURIMORE PËR DISA MEKTEBE TË RRETHIT TË KAZASË SË GJILANIT NGA VITI 1902

Abstrakt

Kosova gjatë kohës osmane karakterizohet nga një aktivitet i shtuar i edukimit. Prishtina, Prizreni, Gjakova, Peja, Vushtrria, Gjilani dhe shumë kaza të tjera të Kosovës ishin qendra të arsimit gjatë periudhës osmane. Ky fakt vërtetohet edhe nga numri i kuadrove të parë muslimanë të të arsimuarve, që bënë emër në fushën e letërsisë dhe poezisë së periudhës klasike dhe asaj moderne osmane, siç është rasti me Prishtineli Mesihun, Jahja Bej Dukagjini, Mehmet Akif Ersojin etj..

Aktiviteti i arsimit në Kosovën e sundimit osman zhvillohej nëpër institucionet arsimore të cilat njiheshin nga administrata osmane, andaj edhe studiuesit kanë mundësinë e gjurmimit të të dhënave zyrtare osmane mbi këtë aktivitet arsimor dhe kulturor të zhvilluar në sanxhaqe, kaza e fshatra të ndryshme të Kosovës. Aktivitetet arsimore në Kosovë janë pasqyruar mjaft mirë në dokumentacionin e kohës, duke filluar nga salnamet e Vilajetit të Kosovës dhe dokumente të tjera sikur shehadetnamet, listat e nxënësve apo edhe vendimeve të ndryshme të drejtorisë së arsimit.

Në këtë punim kemi trajtuar listat/dëftesat e nxënësve të mektebeve të Llashticës, Rekës (Pidiçit), Caravajkës dhe Remnikut në vitin 1902 dhe krah tyre kemi ofruar të dhëna edhe nga salnamet mbi numrin e nxënësve, emrat e myderrizëve që shërbyen në Medresenë e Gjilanit dhe të Doburçanit në fillimshekullin XX.

Fjalët kyçe: Kazaja e Gjilanit, mekteb, Llashticë, Pidiç. Caravajkë, Remnik.

Hyrje

Zhvillimi i aktivitetit kulturor-arsimor në Kosovë gjatë periudhës së hershme osmane është i lidhur ngushtë me imaretin (kompleks institucionesh), që quhej “kylije” (külliyeh), dhe përbëhej nga xhamia e rrethuar me institucionet e tjera përcjellëse, si hamami (banja publike), mektebi/mejtepi (shkolla filllore), medreseja (shkolla e mesme), biblioteka dhe ders-haneja (dhomë mësimi), të cilat shërbenin për arsimimin e fëmijëve të besimit islam¹. Supozohet se njëri ndër mektebet/mejtepet e para në Kosovë është ai i “Suzi Çelebiut” në Prizren, i ngritur para vitit 1513 nga poeti i mirënjohur Suzi Prizrenasi, që njëherazi deri në fund të jetës së tij punoi në këtë mekteb/mejtep si arsimtar². Pak vite më vonë, respektivisht më 1586, Koxha Sinan Pasha ndërtoi një mekteb/mejtep në Kaçanik³, ndërsa medresetë u ngritën së bashku me themelimin e sanxhaqeve, siç është rasti me medresenë (1455) Gazi Ali Bej në Vushtrri, e cila mban epitetin e medresesë më të hershme në

¹ Ahmet Vefa Çobanoğlu, “Külliyeh”, *Dianet Islam Ansiklopedisi (DIA)*, vëll. 26, (Ankara: 2002), 542.

² Hasan Kaleshi, “Prizren kao kulturni centar za vreme turskog perioda”, *Studime Albanologjike*, nr. 1, Prishtinë, 1962.

³ Hasan Kaleshi, XV. Asırdan XVII. Asrın Nihayetine Kadar Yugoslav Topraklarında Şark Medeniyeti, *Türk Dünyası Araştırmaları*, sayı 1, 73-129.

Kosovë⁴. Gjatë shekujve XV-XVIII në qytetet e Kosovës hasen më se 10 medrese, p.sh. Prizreni, Gjakova dhe Peja kishin nga dy medrese, ndërsa Vushtrria, Prishtina, Gjilani dhe Dragashi nga një⁵. Ndër medresetë më të njohura të kohës osmane në Kosovë ishin Medreseja e Mehmet Pashës në Prizren, e ndërtuar në gjysmën e parë të shek. XVI⁶, pastaj Medreseja e Madhe e Gjakovës e ndërtuar në vitin 1794⁷, Medreseja Atik (*Medrese-i Atik*)⁸ në Pejë, e ndërtuar në gjysmën e parë të shekullit XVI nga Mehmed Beu si dhe Medreseja Besharet Ket'hyda, e ndërtuar në vitin 1575 në Prishtinë⁹. Në këto shkolla të mesme krahas lëndëve fetare islame mëshoheshin edhe gjuhët e huaja (arabe dhe perse), matematika, gjeometria, logjika, bukurshkrimi etj..¹⁰

Mektebet/mejtepet dhe modernizimi i tyre

Emri mekteb rrjedh nga rrënja e foljës ketb/ketebe, që ka kuptimin e të shkruarit, ndërsa në terminologji me këtë shprehje nënkuptohet vendi apo ndërtesa e nxënies së dijes¹¹. Këto shkolla, që tek abasitet njiheshin si *kuttâb*, të selxhukët dhe osmanët e periudhës klasike (1300-1600) u njohën si *sibjan mektebi* (shqip: shkolla për fëmijë). Por më vonë, mektebi do të njihet me më shumë se një emër, varësisht nga na-

⁴ Iljaz Rexha, Monumentet Sakrale dhe Profane të Periudhës Osmane në Kosovë gjatë shek. XV-XVII, *Monumentet e Kosovës*, Instituti për Mbrojtje të Monumenteve në Kosovë, (Prishtinë: 2004), 78.

⁵ Maxhida Beqirbegoviç, просвјетни објекти исламске архитектуре, *Antikitete të Kosovës*, VI-VII, 1972-1973, 82.

⁶ Hasan Kaleshi, "Përmendoret e Arkitekturës Islame dhe Dorëshkrimet Orientale," *Kosova dikur e sot*, 470.

⁷ Mehmet Z. Ibrahimgil-Neval Konuk, *Kosova'da Osmanlı Mimari Eserler I*, (Ankara: 2006), 493.

⁸ Maxhida Beqirbegoviç, просвјетни објекти исламске, po aty, 94.

⁹ Jashar Rexhepagiç, Nevoja e studimit të arsimit të lartë të ne dhe disa sugjerime, *Edukata Islame*, nr. 74, (Prishtinë: 2004), 137.

¹⁰ Cahit Baltacı, XV-XVI. *Asırlarda Osmanlı medreseleri*, (Istanbul: 205), 172, 266.

¹¹ Ismail Hakki Zunuzarşılı, *Osmanlı Devletinin İlmîye Teşkilatı*, (Ankara: 1988), 11.

¹¹ Nebi Bozkurt, "Mektep", *Dianet İslam Ansiklopedisi (DIA)*, vëll. 29, (Istanbul: 2004), 5.

tyra e aktivitetit që ushtrohej aty, respektivisht në dokumentacionin zyrtar të kohës hasim termat “dârü’t-ta’lîm”, “dârü’l-‘ilm”, “mu’allim-hâne”, “mahalle mektebi”, “taş mektebi”, “mekteb-i ibtidâiyye” etj., ku nga vetë emërtimet e tyre nënkuptohet edhe aktiviteti i këtyre shkollave¹². Vlen të theksohet se mësimdhënësit e mektebeve quheshin “mu-alimë”¹³, ndërsa ndihmësit e tyre njiheshin si “kallfa”.

Mektebet/mejtepet deri në vitin 1847 funksiononin sipas programeve klasike, ku qëllim kryesor ishte mësimi i leximit të Kuranit si dhe njohuritë bazë të fesë islame, ndërsa pas kësaj date kemi tentativën e parë të modernizimit të shkollave fillore, të cilat ndaheshin në dy faza të shkollimit, atë të ulët dhe të lartë¹⁴. Në ciklin e ulët 4-vjeçar të shkollave fillore, të njohura si *mekteb-i sibjân*, mësoheshin këto lëndë: abetarja (elifba), Kurani, ilmihâli (njohuritë elementare të besimit islam), texhvidi (leximi i Kuranit sipas rregullave)¹⁵, gjuha osmane, ahlaku (etika), llojet e shkrimit nesih dhe sulus të gjuhës osmane. Në ciklin e lartë 3-vjeçar, të njohur si *mekteb-i ibtidâiyye*, mësoheshin këto lëndë: elif-baja, Kurani Fisnik (*Kur’an-i Kerim*), texhvidi, ilmihâli, ahlaku, gramatika e gjuhës osmane, shkrimi (*imla*), këndimi i Kuranit (*kirâetet*), historia e shkurtër osmane, gjeografia osmane, llogaritja-matematika dhe bukurshkrimi¹⁶. Siç do të shihet më poshtë, në fillimshkullin XX edhe në rrethinën e kazasë së Gjilanit edukimi fillor ishte zhvilluar sipas modelit të reformuar.

¹² Cahit Balltaci, “Mektep”, *Dianet Islam Ansiklopedisi (DIA)*, vëll. 29, (Istanbul: 2004), 6.

¹³ Sadik Mehmeti, *Shkollat dhe Arsimi në Kosovë 1830-1912* (Prishtinë: 2019), 83.

¹⁴ Mustafa Ergün- Barış Çiftçi, “Türk Dünyasının ilk Eğitim Ortak Reformu: Usul-ü Cedid Hareketi”, *I. Uluslararası Türk Dünyası Araştırmaları Kurultayı*, (İzmir9 -15, Nisan: 2006), 3-5.

¹⁵ Mësim i leximit të Kuranit me rregullat e posaçme të shqiptimit. Shih. Tahir N. Dizdari, *Fjalor i Orientalizmave në Gjuhën Shqipe*, (Tiranë: 2005), 1033.

¹⁶ Nebi Boykurt, “Mektep”, po aty. 7.

Mektebet/mejtepet dhe institucionet e tjera arsimore në kazanë e Gjilanit gjatë vitit 1900

Një burim të rëndësishëm për gjendjen e arsimit në Vilajetin e Kosovës e përbëjnë salnamet e vilajeteve, të cilat hartoheshin në formën e raporteve të detajuara mbi gjendjen e administratës, ushtrisë, arsimit dhe fushave të tjera me interes për zonat administrative që ishin nën sundimin osman. Nëse marrim për bazë të dhënat e Salnames së Kosovës nga viti 1900, shohim se kazaja e Gjilanit kishte *një medrese* me dy myderrizë/profesorë: Adem efendiun, i cili kishte 60 nxënës, dhe Jusuf efendiun, me 40 nxënës; *një mekteb rushdije* me 70 nxënës dhe me dy myderrizë, Shehabeddin efendiun dhe Kamber efendiun, si dhe mësuesin e shkrimit osman të llojit rika, Ali efendiun; *mektebin ibtidaijje* për meshkuj me 160 nxënës, me mualimët: Hafra Abdylhalim efendiun dhe Haxhi Osman efendiun; *Mektebin e Çarshisë për femra* me 45 nxënëse dhe me mësues Haxhi Ali efendiun; *mektebin ibtidaijje të lagjes Xhamia Atik* me 110 nxënës dhe me mualimët: Hajrullah efendiun dhe Hafëz Mustafa efendiun; *mektebin për femra në lagjen Xhamia Atik* me 30 nxënëse dhe me mualimin Tahir efendiun; *mektebin ibtidaijje të lagjes së re (cedid)* për meshkuj me 30 nxënës dhe me mualimin Hafëz Jusuf efendiun; *mektebin për të krishterë (hristiyan)* me 82 nxënës, prej tyre 30 meshkuj. Ndërsa në rrethinën e Gjilanit ishin aktivë 45 mektebe, prej tyre 40 fshatra muslimane dhe 5 jomuslimane¹⁷. Këto shkolla janë pasqyruar si në vijim:

¹⁷ *Kosova Vilayet Salnamesi H.1318*, (Pristine Kosova Vilayet Matbaasi: 1318), 618-621; Krahaso, Ali Riza Selmani, *Gjilani, Qendër e Anamoravës- nga themelimi deri në gjysmën e parë të shekullit 20*, Gjilan 2017.

Emri i mекtebit	Emri i mësuesit	Numri i nxënësve	
		Meshkuj	Femra
Mektebi i fshatit Llashticë	Fettah efendiu	25	
Remnik	Rexheb ef.	20	
Reka (Pidiç) ¹⁸	Bajram ef.	30	
Bresalc	Islam ef.	25	
Sllakoc i Muhaxherëve	Hasan ef.	45	
Cërrnicë	Jashar ef.	42	
Zhiti	Emin ef.	30	40
Pozhoran	Ramazan ef.	15	
Sllatinë e Epërme	Mustafa ef.	60	
Sadovinë e Çerkezëve	Ahmed ef.	20	
Komogllavë	Osman ef.	60	
Smirë	Ramadan ef.	25	
Novobërdë	Arif ef.	40	
Budrikë e Epërme	Fejzullah ef.	15	
Malishevë	Hasan ef.	80	
Pogragjë	Haxhi Salih ef. ¹⁹	48	15
Dobërçan	Zejnullah ef.	60	
Hodonoc	Jusuf ef.	20	
Karaçevë e Epërme	Shaban ef.	45	
Zarbicë	Hasan ef.	15	
Rogoçicë	Hasan ef.	20	
Hogosht	Hasan ef.	45	
Desivojcë	Jakub ef.	76	
Krilevë	Fazli ef.	20	
Koretinë	Behlül ef.	26	
Busavat	Sejdi ef.	15	
Përlepnicë	Salih ef.	30	

¹⁸ Fshati Rekë përbëhej nga fshatrat e sotëm: Pidiç, Shurdhan, Dunavë, Demiraj dhe Haxhaj, ndërsa mекtebi/mejtepi ka qenë në fshatin Pidiç dhe jo në fshatin Haxhaj, siç pretendohet nga disa studiues, që nuk kanë informacionin bazë për zonën në fjalë. Njëherazi edhe nga informacioni që kemi nga terreni jemi në dijeni se mекtebi i fshatit Pidiç ka qenë pranë xhamisë së fshatit Pidiç dhe në këtë shkollë kanë marrë mësim nxënës nga fshatrat Haxhaj, Demiraj, Pidiç, Shurdhan, Dunav, Stançiq etj..

¹⁹ Për më shumë detaje rreth personalitetit fetar dhe kombëtar të mësuesit Haxhi Salih efendiu shih: Fitim Rifati, *Mejtepi i Pogragjës (fundi i shek. XIX-XX)*, Kumtesat e konferencës shkencore: Medreseja “Alauddin” e Prishtinës 65 vjet në shërbim të arsimit fetar dhe kombëtar, organizuar nga Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë 17-19 maj, 2017.

Polïçkë	Shaban ef.	<i>Mungojnë të dhënat</i>	
Caravajkë	<i>Mungojnë të dhënat</i>		
Gumnishte	Islam ef.		
Marecë	Hasan ef.		
Svircë	Xhafer ef.		
Zajkocë	Hasan ef.		
Shipashnicë e Epërme	Sylejman ef.		
Kopernicë	Omer ef.		
Topanicë	Ejub ef.		
Vërbicë e Epërme	Hasan ef.		
Gjylekar	Iljas ef.		
Mirosal	Lytfi ef.		
Livoç i Poshtëm	Jashar ef.		
Viti	Hamirka? ef.	40	
Ranilluk	Jovan ef.	34	
Bostan	Risto ef.	20	
Kamenicë	Enço? ef.		
Pasjan	Sava		

Përveç salnameve të vilajeteve janë edhe salnamet/vjetarët e përgatitur nga ana e Ministrisë së Arsimit. Me këtë rast, në salnamen e Ministrisë së Arsimit të vitit 1321 hixhri/ 1903 miladi është regjistruar Medreseja e Gjilanit me myderriz Ademin, i cili kishte 80 nxënës. Sipas kësaj të dhëne medreseja gjendej në lagjen Atîk dhe donatorë të kësaj shkolle/medreseje ishin banorët e lagjes (*mahalle ahalisi*). Po ashtu një institucion edukativo-arsimor tjetër i ndërtuar po ashtu nga banorët (*karye ahalisi*) e fshatit është edhe medreseja e Dobërçanit, e cila gjendej në fshatin Dobërçan dhe kishte 55 nxënës nën drejtimin e profesor/myderriz Jusufit²⁰.

²⁰ *Salnâme-i Nezâret-i Maarif-i Umûmiyye*, İstanbul, 1321.

Conclusions

The data of the Ottoman records as prepared by the Ministry of Education and the administrations of the Ottoman Vilayets have the character of annual reports containing data on the number of students, myderris and any information on donors of school institutions, or even the location of these institutions, but the receipts we have received of this paper are much more detailed and as such, have a special importance in terms of the number of students, the program that was taught and the age of the students.

On these data for ibtidaiyye schools (primary schools) of villages; Llashticë, Rekë / Pidiç, Caravačkë and Remnikë, which, introduced here for the first time and we will give them translated into Albanian, show that in the mektabats of these respective villages in the first grade of the cycle of high (ibtidaijje) 4 courses were taught: alifbaja (abc book of the Arabic language), Reading of the Qur'an, Calculation and ilmihali (the book with some surah from the Quran).

In the second grade, 7 courses: Qur'an, ilmihal, Recitation of the Qur'an (Kirâet), Ottoman Grammar, Mathematics, Ethics (Ahlâk) and Syls type writing. While, in the third and last grade 9 courses were taught: Qur'an with tajwid, general ilmihal (Mufassal), History of Ottoman civilization (Medeniyyet-i târîh-i ottoman), Abbreviated Ottoman Geography (Muhtasar osmânî cografyası), Children's education / Civic education (Vezaif-i etfâl), Ottoman language syntax, Mathematics, Dictation (syllable) and syls type writing.

An important piece of information on the history of education during the early twentieth century is that of the grading system. Based on these information, we see that the highest grade was 8 and the lowest / passing was 5. According to the data in the assessment list, we also notice that the students of these schools had the highest grade in the subject of the Holy Quran.

Characteristic of these lists of transcripts is the fact of a strong respect for the authority of the knowledgeseekers (students) respectively the names of the students begin with the title efendi, (title) which in Ottoman times was used for those who were literate as to distinguish them from the illiterates e.g. Halit efendiu, son of Maliq.

Also, the ranking in the list was not done according to today's practices in alphabetical order, but according to the by the most successful student.

Within these data we see that in the village of Llashtica 31 students attended classes, of which 14 in the first grade, 11 in the second grade and 6 in the third grade.

Remnik School had 24 students, 11 in the first grade, 9 in the second grade and 4 in the 4th grade.

Reka School (Pidic) had 18 students, 9 in the first grade, 6 in the second grade and 3 in the third grade.

The Caravaĵka school had 15 students, 7 in the first grade, 5 in the second grade and 3 in the third grade

**Dëftesat e shqipëruara të mektebeve/mejtepeve
të Llashticës, Rekës (Pidiçit),
Caravajkës dhe Remnikut në vitin 1902**

1. Lista e provimeve të nxënësve të mektebit ibtidaije të fshatit Llashticë të nahijes Karadak në kazanë e Gjilanit, e cila është në varësi të sanxhakut të Prishtinës së Vilajetit të Kosovës.

Klasa e Tretë												
Nr. i nxënësve	Emri dhe llagapi	Mosha	Kuran me texhvid	Ilmihal i përgjithshëm	Histori e qytetërimit Osman	Gjeografi osmane e shkurtuar	Edukatë e fëmijëve	Gramatikë e gjuhës osmane	Matematikë	Diktim	Shkrimi Syllys	Nota përfundimtare
1	Salih efendiu, i biri i Arif Agasë	13	8	8	8	8	8	8	8	8	8	72
2	Salih ef. i biri i Hajdarit	14	8	8	8	8	8	8	8	8	7	71
3	Shevki ef., i biri i Banushit	15	8	8	8	8	8	8	8	8	7	71
4	Abdylhalim ef., i biri i Halitit	12	8	8	8	8	8	8	8	7	7	70
5	Selim ef., i biri i Ahmedit	14	8	8	8	8	8	7	7	6	6	66
6	Ismail ef., i biri i Mulla Rashitit	13	8	8	8	8	8	7	7	6	5	65

Klasa e Dytë										
Nr. i nxënësve	Emri dhe llagapi	Mosha	Kurani Kerim	Ilmihal	Këndim i Kuranit (Kiraet)	Gramatikë osmane	Llogaritje	Etikë (Ahlak)	Shkrimi Syllys	Nota përfundimtare
7	Ejub efendiu, i biri i Eminit	13	8	8	8	8	8	8	8	56
8	Omer ef., i biri i Bajramit	15	8	8	8	8	8	8	7	55
9	Azem ef., i biri i Ademit	14	8	8	8	8	8	7	7	54
10	Jusuf ef., i biri i Banushit	12	8	8	8	8	8	7	6	53
11	Ramazan ef., i biri i Mahmudit	15	8	8	8	8	8	6	6	52
12	Abdylhalim ef., i biri i Ahmedit	13	8	8	8	8	7	6	6	51
13	Esat ef., i biri i Hajdarit	14	8	8	8	8	6	6	6	50
14	Hajriz ef., i biri i Hasanit	15	8	8	8	8	6	6	5	49
15	Akif ef., i biri i Sinanit	14	8	8	8	7	6	6	5	48
16	Rexhep ef., i biri i Ahmedit	12	8	8	8	6	6	6	5	47
17	Ismail ef., i biri i Mustafës	15	8	8	7	6	6	6	5	46

Klasa e Parë							
Numri i nxënësve	Emri dhe llagapi	Mosha	Elifbaja osmane	Pjesë kuranore	Llogaritje	Ilmihal	Nota përfundimtare
18	Halim efendiu, i biri Hazir Agës	12	8	8	8	8	32
19	Halil ef., i biri i Ahmedit	14	8	8	8	7	31
20	Rifat ef., i biri i Mustafës	13	8	8	7	7	30
21	Qahil ef., i biri i Zahirit	15	8	8	7	6	29
22	Ismail ef., i biri i Halimit	15	8	8	7	5	28
23	Abdyl ef., i biri i Ramadanit	14	8	8	6	5	27
24	Xhemail ef., i biri i Hajredinit	12	8	7	6	5	26
25	Shaban ef., i biri i Xhemailit	13	8	7	6	5	26
26	Sadik ef., i biri i Zenunit	14	8	7	5	5	25
27	Fetah ef., i biri i Halimit	13	8	6	5	5	24
28	Zejnel ef., i biri i Omerit	15	8	6	5	5	24
29	Rashid ef., i biri i Halitit	14	8	5	5	5	23
30	Shaban ef., i biri i Azemit	13	7	5	5	5	22
31	Hysejn ef., i biri i Ismailit	15	7	5	5	5	22

Kjo listë provimesh e nxënësve të mекtebit ibtidai të fshatit Llashticë është përpiluar më datë 14 korrik 1902 ... vërtetuar më 23 korrik 1902 (mban vulën e mësuesve, të kajmakamit të Gjilanit, zëvendës naibit, drejtorit të financave, sekretarit dhe dy anëtarëve të komisionit).

2. Lista e provimeve të nxënësve të mektebit ibtidaije të fshatit Reka (Pidiç) të nahijes Karadak në kazanë e Gjilanit, e cila është në varësi të sanxhakut të Prishtinës së Vilajetit të Kosovës.

Klasa e Tretë												
Nr. i nxënësve	Emri dhe llagapi	Mosha	Kuran me texhvid	Ilmihali i përgjithshëm	Histori e qytetërimit osman	Gjeografi osmane e shkurtuar	Edukatë e fëmijëve	Gramatikë e gjuhës osmane	Matemat.	Diktim	Shkrimi Syllys	Nota përfundimtare
1	Bahtjar efendiu, i biri i Abdullahut	14	10	10	10	10	10	10	10	10	10	90
2	Qahil ef., i biri i Ibrahimit	15	10	10	10	10	10	10	10	10	9	89
3	Ibrahim ef., i biri i Munishit	14	10	10	10	10	10	10	10	9	9	88

Klasa e Dytë											
Nr. i nxënësve	Emri dhe llagapi	Mosha	Kurani Kerim	Ilmihal	Këndim i Kuranit (Kiraet)	Gramatikë osmane	Llogaritje	Etikë (Ahlak)	Shkrimi Syllys	Nota përfundimtare	
4	Hilmi efendiu, i biri i Qahilit	13	10	10	10	10	10	10	10	70	
5	Zylfi ef., i biri i Latifit	12	10	10	10	10	10	10	9	69	
6	Sherif ef., i biri i Fejzullahut	14	10	10	10	9	9	8	9	63	
7	Nezir ef., i biri Ajetit	13	10	10	10	9	9	8	8	62	
8	Bajram ef., i biri Sylejmanit	15	10	10	10	9	8	8	8	61	
9	Daut ef., i biri Ademit	14	10	10	10	9	8	8	7	60	

Klasa e Parë							
Numri i nxënësve	Emri dhe llagapi	Mosha	Elifbaja osmane	Pjesë kuranore	Llogaritje	Ilmihal	Nota përfundimtare
10	Fejzullah efendiu., i biri i Mahmudit	12	10	10	10	10	40
11	Shaban ef., i biri Rexhebit	14	10	10	9	9	38
12	Shevki ef., i biri i Hafizit	12	10	10	9	8	37
13	(?) ef., i biri i Demirit	13	10	10	8	8	36
14	Bajram ef., i biri i Demirit	15	10	10	8	7	35
15	Beqir ef., i biri i Sylejmanit	14	10	10	8	7	35
16	Halit ef., i biri i Maliqit	12	10	10	8	7	34
17	Murtez ef., i biri i Mustafës	13	10	9	7	6	32
18	Recep ef., i biri i Tahirit	14	10	9	7	6	32

Kjo listë provimesh e nxënësve të mektebit ibtidai të fshatit Reka (Pidiç) është përpiluar më datë 13 korrik 1902 ... vërtetuar më 23 korrik 1902 (mban vulën e mësuesve, të kajmakamit të Gjilanit, zëvendës naibit, drejtorit të financave, sekretarit dhe dy anëtarëve të komisionit).

3. Lista e provimeve të nxënësve të mektebit ibtidaije të fshatit Remnik të nahijes Karadak në kazanë e Gjilanit, e cila është në varësi të sanxhakut të Prishtinës së Vilajetit të Kosovës.

Klasa e Tretë												
Nr. i nxënësve	Emri dhe llagapi	Mosha	Kuran me texhvid	Ilmihali i përgjithshëm	Histori e qytetërimit osman	Gjeografi osmane e shkurtuar	Edukatë e fëmijëve	Gramatikë e gjuhës osmane	Matemat.	Diktim	Shkrimi Sylys	Nota përfundimtare
1	Abdullah efendiu, i biri i Tahirit	15	10	10	10	10	10	10	10	10	10	90
2	Hamit ef., i biri i Qerimit	16	10	10	10	10	10	10	10	9	9	88
3	Hajrullah ef., i biri i Aliut	13	10	10	10	10	10	9	9	9	9	86
4	Bajram ef., i biri Musliut	14	10	10	10	9	9	9	9	9	9	84

Klasa e Dytë										
Nr. i nxënësve	Emri dhe Ilagapi	Mosha	Kurani Kerim	Ilmihal	Këndim i Kuranit (Kiraet)	Gramat. osmane	Llogaritje	Etikë (Ahlak)	Shkrimi Syllys	Nota përfundimtare
5	Hajrullah efendiu, i biri i Shehabit	13	10	10	10	10	10	10	10	70
6	Bahtjar ef., i biri i Aiut	14	10	10	10	10	10	10	09	69
7	Shaban ef., i biri i Maliqit	13	10	10	10	10	10	9	9	68
8	Halim ef., i biri i Ademit	12	10	10	10	10	9	9	9	67
9	Hamdi ef., i biri i Abdurrahimit	14	10	10	10	9	9	9	9	66
10	Numan ef., i biri i Sefisë	15	10	10	10	9	9	9	8	65
11	Ramadan ef., i biri Hasanit	14	10	10	9	9	9	9	8	64
12	Qerim ef., i biri i Sylejmanit	13	10	10	9	9	9	8	8	63
13	Edhem ef., i biri i Qerimit	14	10	10	9	9	8	8	7	61

Klasa e Parë							
Numri i nxënësve	Emri dhe llogari	Mosha	Elifbaja osmane	Pjesë kuranore	Llogaritje	Ilmihal	Nota përfundimtare
14	Shuajb (Shaip) efendiu, i biri i Islamit	13	10	10	10	10	40
15	Shaban ef., i biri i Maliqit	12	10	10	10	9	39
16	Osman ef., i biri i Bislimit	13	10	10	9	9	38
17	() ²¹ i biri i Halilit	14	10	10	9	8	37
18	Zejneli ef., i biri i Shehabit	12	10	10	8	8	36
19	Ali ef., i biri i Vejselit	13	10	10	8	7	25
20	Beqir ef., i biri i Ajetit	14	10	10	8	6	34
21	Jakup ef., i biri i Ibrahimit	13	10	10	8	6	34
22	Abdullah ef., i biri i Bejazitit	12	10	9	8	7	34
23	Kadri ef., i biri i Ramadanit	14	10	9	8	6	33
24	Ali ef., i biri i Shabanit	13	10	8	8	6	32

Kjo listë provimesh e nxënësve të mektebit ibtidai të fshatit Remnik është përpiluar më datë 18 korrik 1902 ... vërtetuar më 23 korrik 1902 (mban vulën e kajmakamit të Gjilanit, zëvendës naibit, drejtorit të financave, sekretarit dhe dy anëtarëve të komisionit).

²¹ Mungon emri.

4. Lista e provimeve të nxënësve të mektebit ibtidaije të fshatit Ceravajkë të nahijes Karadak në kazanë e Gjilanit, e cila është në varësi të sanxhakut të Prishtinës së Vilajetit të Kosovës.

Klasa e 3												
Nr. i nxënësve	Emri dhe llagapi	Mosha	Kuran me texhvid	Ilmihali i përgjithshëm	Histori e qytetërimit osman	Gjeografi osmane e shkurtuar	Edukatë e fëmijëve	Gramatikë e gjuhës osmane	Matematikë	Diktim	Shkrimi Syllys	Nota përfundimtare
1	Abdylatif efendiu, i biri i Aliut	14	10	10	10	10	10	10	10	10	10	90
2	Bekdash ef., i biri i Arifit	15	10	10	10	10	10	10	10	10	9	89
3	Rexhep ef., i biri i Aliut	16	10	10	10	10	10	10	10	10	8	88

Klasa e Dytë										
Nr. i nxënësve	Emri dhe llagapi	Mosha	Kurani Kerim	Ilmihal	Këndim i Kuranit (Kiraet)	Gramatikë osmane	Llogaritje	Etikë (Ahlak)	Shkrimi Syllys	Nota përfundimtare
4	Idris efendiu, i biri i Aliut	13	10	10	10	10	10	10	10	70
5	Idris ef., i biri i Veliut	12	10	10	10	10	10	09	09	68
6	Ismaili ef., i biri i Aliut	14	10	10	10	10	9	9	9	67
7	Numan ef., i biri i Jahjasë	15	10	10	10	10	9	9	8	66
8	Numan ef., i biri i Hasnit	13	10	10	10	10	9	8	8	65

Klasa e Parë							
Numri i nxënësve	Emri dhe llagapi	Mosha	Elifbaja osmane	Pjesë kuranore	Llogaritje	Ilmihal	Nota përfundimtare
9	Jahja efendiu, i biri i Ajetit	13	10	10	10	10	40
10	Zylfi ef., i biri i Ajetit	12	10	10	10	9	39
11	Ibrahim ef., i biri i Zahirit	14	10	10	8	8	39
12	Arsllan ef., i biri i Bajramit	13	10	10	8	7	35
13	Celaledin ef., i biri i Zeqirit	15	10	10	8	6	34
14	Abdi ef., i biri i Ajetit	12	10	10	7	6	33
15	Ibrahim ef., i biri i Ahmetit	13	10	9	7	6	32

Kjo listë provimesh e nxënësve të mektebit ibtidai të fshatit Caravajkë është përpiluar më datë 11 korrik 1902 ... vërtetuar më 23 korrik 1902 (mban vulën e mësuesve, të kajmakamit të Gjilanit, zëvendës naibit, drejtorit të financave, sekretarit dhe dy anëtarëve të komisionit).

T.C. BASBAKANLIK OSMANLI ARSIVI DARE BASKANLIĞI (BOA)


قوتون و دلابره شیدی بر شش خطی خطه و کتبی قوتی قوت ع نامیه سونکی روقیب اینیه شکار دله اتونین بیه جدیدله

رقم صنف	رقم سن کاروانی	رقم سن کاروانی	رقم سن کاروانی	رقم سن کاروانی	رقم سن کاروانی	رقم سن کاروانی	رقم سن کاروانی	رقم سن کاروانی	رقم سن کاروانی
سازمان خاصه ایتر	۹	۱۱	۱۲	۱۳	۱۴	۱۵	۱۶	۱۷	۱۸
۸۴	۹۱	۱۱۱	۱۲۱	۱۳۱	۱۴۱	۱۵۱	۱۶۱	۱۷۱	۱۸۱
۸۱۵	۹۱۵	۱۱۱۵	۱۲۱۵	۱۳۱۵	۱۴۱۵	۱۵۱۵	۱۶۱۵	۱۷۱۵	۱۸۱۵

اینجا سه شکاروانی
۱- کاپان خانه
۲- کاپان خانه
۳- کاپان خانه
۴- کاپان خانه
۵- کاپان خانه
۶- کاپان خانه
۷- کاپان خانه
۸- کاپان خانه
۹- کاپان خانه
۱۰- کاپان خانه

اینجا صنف
۱- کاپان خانه
۲- کاپان خانه
۳- کاپان خانه
۴- کاپان خانه
۵- کاپان خانه
۶- کاپان خانه
۷- کاپان خانه
۸- کاپان خانه
۹- کاپان خانه
۱۰- کاپان خانه

سایه طایفه خور بلبرشته و کیده قوتی قوت ع نامیه سونکی روقیب اینیه شکار دله اتونین بیه جدیدله اولده کون عطف حیرت و غریزه
اجاق حیرت اتونین بیه دله جدیدله اولده کون عطف حیرت و غریزه
ابوبکر اولاد سید حیرت و غریزه صحت و موافقه معیت اولده شین و نقد بیه صفت سینه
اعضا اعضا کانسرازه درمال کونمانت صفا کونته فایده



Lista e mektebit të Rekës (Pidiçiti)

T.C. BASBAKANLIK OSMANLI ARSIVI DARE BASKANLIĞI (BOA) ©

فصلی در بیان سالیانه کسب نفی قره صه فی نام سده که در سال عتبت این مکتب در آن مکتب امضای میرجه و لیس

رقم شماره	اسم مکان										رقم شماره
	مکتب	مکتب	مکتب	مکتب	مکتب	مکتب	مکتب	مکتب	مکتب	مکتب	
	۹	۹	۹	۹	۹	۹	۹	۹	۹	۹	۹
	۸	۸	۸	۸	۸	۸	۸	۸	۸	۸	۸
	۷	۷	۷	۷	۷	۷	۷	۷	۷	۷	۷
	۶	۶	۶	۶	۶	۶	۶	۶	۶	۶	۶
	۵	۵	۵	۵	۵	۵	۵	۵	۵	۵	۵
	۴	۴	۴	۴	۴	۴	۴	۴	۴	۴	۴
	۳	۳	۳	۳	۳	۳	۳	۳	۳	۳	۳
	۲	۲	۲	۲	۲	۲	۲	۲	۲	۲	۲
	۱	۱	۱	۱	۱	۱	۱	۱	۱	۱	۱

رقم شماره	اسم مکان										رقم شماره
	مکتب	مکتب	مکتب	مکتب	مکتب	مکتب	مکتب	مکتب	مکتب	مکتب	
	۹	۹	۹	۹	۹	۹	۹	۹	۹	۹	۹
	۸	۸	۸	۸	۸	۸	۸	۸	۸	۸	۸
	۷	۷	۷	۷	۷	۷	۷	۷	۷	۷	۷
	۶	۶	۶	۶	۶	۶	۶	۶	۶	۶	۶
	۵	۵	۵	۵	۵	۵	۵	۵	۵	۵	۵
	۴	۴	۴	۴	۴	۴	۴	۴	۴	۴	۴
	۳	۳	۳	۳	۳	۳	۳	۳	۳	۳	۳
	۲	۲	۲	۲	۲	۲	۲	۲	۲	۲	۲
	۱	۱	۱	۱	۱	۱	۱	۱	۱	۱	۱


سایه مکتبها در قره صه کسب نفی قره صه فی نام سده در این مکتب امضای میرجه و لیس در این مکتب امضای میرجه و لیس در این مکتب امضای میرجه و لیس

قره صه در مکتب امضای میرجه و لیس در این مکتب امضای میرجه و لیس در این مکتب امضای میرجه و لیس

اشود در مکتب امضای میرجه و لیس در این مکتب امضای میرجه و لیس در این مکتب امضای میرجه و لیس

Lista e mektebit të fshatit Remnik

T.C. BAŞBAKANLIK OSMANLI ARŞIVI DARE BAŞKANLIĞI (BOA) ©



Lista e mektebit të fshatit Caravajkë

Literatura:

- Ahmet Vefa Çobanoğlu, “Külliyе”, *Dianet Islam Ansiklopedisi (DIA)*, vëll.26, (Ankara: 2002), 542.
- Hasan Kaleshi, “Prizren kao kulturni centar za vreme turskog perioda” *Studime Albanologjike*” nr.1, Prishtinë, 1962.
- Hasan Kaleshi, “Përmendoret e Arkitekturës Islame dhe Dorëshkrimet Orientale”, *Kosova dikur e sot*, 470.
- Hasan Kaleşi, XV. Asırdan XVII. Asrın Nihayetine Kadar Yugoslav Topraklarında Şark Medeniyeti, *Türk Dünyası Araştırmaları*, sayı 1, 73-129.
- Iljaz Rexha, Monumentet Sakrale dhe Profane të Periudhës Osmane në Kosovë gjatë shek.XV-XVII, *Monumentet e Kosovës*”, *Instituti për Mbrojtje të Monumenteve në Kosovë*, (Prishtinë:2004), 78.
- Maxhida Beqirbegoviç, просвјетни објекти исламске архитектуре, *Antikitete të Kosovës*, VI-VII, 1972-1973, 82.
- Mehmet Z. Ibrahimgil-Neval Konuk, *Kosova'da Osmanlı Mimari Eserler I*, (Ankara: 2006), 493.
- Maxhida Beqirbegoviç, просвјетни објекти исламске, po aty, 94.
- Jashar Rexhepagiç, Nevoja e Studimit të arsimit të lartë tek ne dhe disa sugjerime, *Edukata Islame*, nr. 74, (Prishtinë:2004), 137.
- Cahit Baltacı, XV-XVI. *Asırlarda Osmanlı medreseleri*, (Istanbul:205), 172, 266.
- Ismail Hakki Uzunçarşılı, *Osmanlı Devletinin İlmiye Teşkilatı*, (Ankara: 1988), 11.
- Nebi Bozkurt, “Mektep”, *Dianet Islam Ansiklopedisi (DIA)*, Vëll. 29, (Istanbul 2004), 5.
- Cahit Balltacı, “Mektep”, *Dianet Islam Ansiklopedisi (DIA)*, Vëll. 29, (Istanbul 2004), 6.
- Sadik Mehmeti, *Shkollat dhe Arsimi në Kosovë 1830-1912*, (Prishtinë: 2019), 83.

- Mustafa Ergün- Barış Çiftçi, “Türk Dünyasının ilk Eğitim Ortak Reformu: Usul-ü Cedid Hareketi”, *I. Uluslararası Türk Dünyası Araştırmaları Kurultayı*, (İzmir9 -15 Nisan:2006), 3-5.
- Tahir N. Dizdari, *Fjalor i Orientalizmave në Gjuhën Shqipe*, (Tiranë:2005), 1033.
- *Kosova Vilayet Salnamesi H.1318*, (Priştine Kosova Vilayet Matbaası: 1318), 618-621.
- *Salnâme-i Nezâret-i Maarif-i Umûmiyye*, İstanbul 1321.

PhD (c) Melihate ZEQRIRI

ÇËSHTJE TË LEKSIKUT TË GJUHËS SHQIPE NË KOHËN MODERNE

Abstrakt

Gjuha shqipe, për shqiptarët ka qenë dhe duhet të mbetet gjithmonë gjuha më e dashur, e para mbi të gjitha të tjerat, e para, jo vetëm në të shpallur, me deklarime e pohime, por edhe realisht në kujdesin ndaj saj, e para në synimin dhe në përpjekjet që t'ia njohim e t'ia nxjerrim në pah huret e saj, bagëtinë dhe hijeshinë e saj.

Në shqipen e sotme, këta dhjetëvjeçarët e fundit, është krijuar një regjistër fjalësh dhe shprehjesh të reja, të cilat nuk përfshihen në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe (FGJSSH), por kanë përfshirë sidomos gjuhën e folur dhe gjuhën e shkruar publicistike. Nga fondi i fjalëve dhe i shprehjeve të tilla një numër sosh kanë një përdorim më të përditësuar, sidomos në gjuhën e shtresave të ndryshme të politikanëve, intelektualëve, gazetarëve, publicistëve, nxënësve, studentëve, etj., të cilët janë në kontakte më të shpeshta përdorimi me anglicizmat, si të thuash i kanë ato “në majë” të gjuhës.

Vendin e parë në prurjet nga anglishtja pa dyshim e zënë termat e teknologjisë informatike e të internetit. Këtu të gjithë termat janë të rinj, siç është vetë kjo fushë e teknologjisë moderne, dhe kanë hyrë bashkë me sendet që shënjojnë dhe veprimet e lidhura me to, që nga *kompjuter*, *printer*, *skaner*, *maus*, *toner*, pastaj një numër

foljesh që shënjojnë proceset e ndryshme të punës me kompjuterin, si: *startoj, selektoj, cekoj, klikoj, printoj, skanoj*, nganjëherë edhe *sejvoj* për *ruaj*, por që duket se po tërhiqet nga përdorimi. Në ekspansion të shpejtë janë tani së fundi termat që lidhen me internetin: *e-mail, ueb sajt, link, logoj, catoj* deri dhe *donlojoj* nga *download*, fjalë të sajuara pa e vrarë mendjen, nga nevoja e çastit.

Sipas analizave interesante që i janë bërë shtypit shqiptar nga ana e disa gjuhëtarëve, del që në mediet tona të informacionit numri i fjalëve të huaja rritet çdo ditë e më tepër. Sipas analizave të bëra, çdo ditë në përdorim janë afërsisht rreth 1500-2000 fjalë.

Fjalë kyçe: *gjuhë, term, fjalë të huaja, fjalorë, leksik.*

Hyrje

“Shmangni çdo fjalë të panevojshme. Thjeshtroni fjalinë. Thjeshtoni idenë. Kjo është formula e shkrimit të mirë.” - Noel Klaraso.

Fjalët e huaja të panevojshme, terminologjia e pasaktë dhe deri fjalët e pista e ligjërimet krejt të pagdhendura, kanë pasur vend aq shpesh, sa ua kanë neveritur shqiptarëve edhe politikën, edhe funksionet zyrtare të Shtetit. Gabimet janë të rënda e ndonjëherë trashanike dhe tregojnë se niveli i formimit gjuhësor të punonjësve e zyrtarëve të Shtetit Shqiptar lë për të dëshiruar dhe nuk mund të vazhdohet më kështu¹.

Pasurimi është shfaqje e zhvillimit dhe përparimit të gjuhës dhe buron pikërisht nga zhvillimi i gjithanshëm i jetës dhe i vendit; zhvillohen ekonomia, arsimi, shkenca e kultura dhe letërsia; zhvillohen artet e mjetet e komunikimit masiv, hyjnë në përdorim e në shkrimtari mjete të elektronikës së sotme.

¹ Shkurtaj, Gjovalin; *Urgjenca gjuhësore* – huazime të zëvendësueshme me fjalë shqipe- Fjalorth, botimet ada, Tiranë, 2015: 22/23.

“Ardhtë dita që dhurata më e shpeshtë që shqiptarët kur kanë ditëlindjen të jetë Fjalori i Gjuhës Shqipe, Gramatika, e cila u duhet për gjithë jetën, se kështu veprojnë gjithë kombet e qytetëruara.” - Gjovalin Shkurtaç.

Çështje të leksikut të gjuhës shqipe në kohën moderne

“Nëse e mbizotëron gjuhën tënde, do të fitosh shumë miq” - Catoni

“Gjuha përcjell një kulturë. Kur flet gjuhën e tjetrit, njeh mënyrën e tij të të menduarit dhe të të jetuarit.” - Françoise Retif.

Gjuha shqipe, për shqiptarët ka qenë dhe duhet të mbetet gjithmonë gjuha më e dashur, e para mbi të gjitha të tjerat, e para, jo vetëm në të shpallur, me deklarime e pohime, por edhe realisht në kujdesin ndaj saj, e para në synimin dhe në përpjekjet që t’ia njohim e t’ia nxjerrim në pah huret e saj, bagëtinë dhe hijeshinë e saj.

Pasurimi i gjuhës është proces ligjësor objektiv, në të cilin marrin pjesë e veprojnë çdo ditë njerëzit e thjeshtë, teknikët, specialistët e degëve të ndryshme të shkencës e të prodhimit, si dhe, më së shumti, artistarët, shkrimtarët, artistët, ushtarakët, gazetarët dhe përgjithësisht punonjësit e fushës politiko-shoqërore etj. Të gjithë këta, gjatë punës në sektorët dhe mjeshtëritë përkatëse, sa më shumë t’i zhvillojnë ato, aq më tepër do të kenë nevojë për emërtime të reja të mjeteve e veglave të prodhimit, për fjalë, shprehje a mënyra të thëni, që u përgjigjen më mirë, që japin më me përpikëri nocionet dhe idetë, që shprehin më me forcë e me plotëri jetën dhe botën shpirtërore të njeriut.

Ky pasurim i shqipes ka gjetur pasqyrim të mirë në veprat e mëdha normative *“Fjalori i gjuhës së sotme shqipe”* (1980), me rreth 40 000

fjalë, dhe në “*Fjalor i shqipes së sotme*” (1984), me rreth 34 000 fjalë; “*Fjalor i gjuhës shqipe*” (2006) etj².

“*Ardhtë dita që dhurata më e shpeshtë që shqiptarët kur kanë ditëlindjen të jetë Fjalori i Gjuhës Shqipe, Gramatika, e cila u duhet për gjithë jetën, se kështu veprojnë gjithë kombet e qytetëruara.*” - Gjovalin Shkurtaç.

Rruga kryesore e pasurimit të gjuhës me fjalët që i duhen, është formimi i fjalëve të reja me brumin e vetë gjuhës dhe sipas modeleve prodhimore të sistemit fjalëformues të shqipes, ose nëpërmjet shqipërimit të pjesëve përbërëse të fjalëve të huaja. Sot, numri i fjalëve të reja të formuara me rrugët e mësipërme është i madh, në të gjitha sferat e veprimtarisë së shqiptarëve. Të tilla, janë, p.sh.: *domosdoshmëri, gatishmëri, qëndrueshmëri, mbingarkoj, mbishtresë, mbivlerë, nëncmoj, nëndetëse, nënujor, përvetësim, përparësi, i përfaqësuar, përvijoj, përuroj, ideor, parimor, burimor* etj.

Formimi i fjalëve të reja bëhet me anën e parashtrësive, prapashtrësive ose duke bashkuar dy tema fjalësh (fjalë të përbëra): *përgëztoj, bashkëveprim, falënderoj, marrëveshje, kokëçarje, mirëqenie, mirëkuptim, keqtrajtim, keqpërdorim*. Kjo ka qenë dhe mbetet rruga kryesore për pasurimin e gjuhës shqipe.

Rruga apo burimi për pasurimin e gjuhës shqipe është përdorimi më i gjerë i fjalëve dhe frazeologjizmave nga goja e popullit. Këto fjalë, në mjaft raste, mund të shërbejnë edhe për të zëvendësuar fjalë të huaja të panevojshme, p.sh.: *grimcë* në vend të partikulë, *kah-u* në vend të sens-i, *pëshqjellë* në vend të spirë, *gërryerje* në vend të erosion, mjedis në vend të ambient, *shterp e shterpëz* në vend të steril, sterilizoj; *tatëpjetë* ose *teposhtë* në vend të dekadencë etj.

Për pasurimin e leksikut të gjuhës letrare mund të rimerren edhe fjalë të bukura, që kanë qenë krijuar në epoka të mëparshme por që,

² Po aty, 57.

për arsye të ndryshme, nuk kanë gjetur përdorim e kanë mbetur mënjane. Të tilla janë, p.sh.: *trimëroj*, që mund ta zëvendësojë më së miri fjalën e huaj *inkurajoj*; *nismë* e *nismëtar* për të shmangur fjalët e huaja *iniciativë*, *iniciator*; *miratoj* në vend të *aprovoj*, *miratim* në vend të *aprovim*; *tubim* në vend të *miting*, *kushtrim* në vend të *alarm*, *kushtrimoj* në vend të *alarmoj* etj,

Fjalë të huaja të panevojshme, të cilat janë zëvendësuar e po zëvendësohen me fjalët shqipe ekzistuese ose të krijuara me burimin e shqipes, sipas gjedheve të gjuhëve të tjera. Të tilla janë, p.sh.: *weekend*, që po zëvendësohet me sukses me fjalën *fundjavë*, e krijuar sipas modelit të anglishtes, por me mjete të shqipes. Madje, ky model po shihet i frytshëm dhe po shtrihet edhe në krijime të tjera, si: *fundvit*, *fundshekull*; *ambient-mjedis*; *eksperiencë-përvojë*; *influencë-ndikim*; *koordinoj-bashkërendoj*; *respektiv-përkatës*; *reciprok-ndërsjellë*; *ekstrem-skaj etj*³.

Duhet bërë përpjekje për të zëvendësuar ose për t'ua ngushtuar më tej përdorimin një numër fjalësh të leksikut të përgjithshëm me burim nga gjuhët slave, nga greqishtja e turqishtja, si: *akoma*, *nikoqillëk*, *vadit*, *godinë* etj.

“Banka” kryesore e huazimeve dhe e prurjeve të huaja në shqipen sot është anlishtja. Anglicizmat janë fjalët dhe njësitë e tjera më të gjera gjuhësore angleze (lokucione, togfjalësja, shprehje), që kanë hyrë drejtpërdrejt në gjuhën shqipe. Ndryshimet tashmë të ditura, që kanë ndodhur në gjuhën shqipe këta dy dhjetëvjeçarët e fundit, për shkak të ndikimit të faktorëve jashtëgjuhësorë, kanë bërë të nevojshëm rivlerësimin e vendit dhe të peshës së anglicizmave, krahasuar me shtresat e tjera të huazimeve, ndër të cilat më të theksuarat mbeten: latinizmat, greqizmat, turqizmat dhe italianizmat. Anglishtja tashmë është bërë jo vetëm gjuhë e dytë kryesore në shkollimin e shqiptarëve, por edhe

³ Po aty, 69-70.

mjeti më i pëlqyeshëm e i ushtruar gati masivisht nga rinia edhe si mjet i shprehjes artistike, me përhapje të gjerë në këngët, në mediet etj.

E para që duhet të bëhet, ashtu si edhe ndaj të gjitha huazimeve të tjera në shqipen, është ndarja e anglicizmave në të pazëvendësueshëm dhe të zëvendësueshëm. Kriteri për këtë ndarje do të ishte: si anglicizma të pranueshëm, sepse janë edhe të pazëvendësueshëm, duhet të pranohen ata, që, në asnjë kuptim të tyre, nuk do të mund të gjenin zëvendësim me një fjalë të vetme përkatëse.

Duhet të jemi realistë dhe ta pranojmë që, pa fjalë të huaja, edhe pa anglicizma, nuk mund të mbetet as shqipja. Futja e teknologjisë kompjuterike dhe në hapësirën shqiptare është shoqëruar me vërshim të termave anglezë ose të fjalëve me veçori terminologjike, si: *maus, drajver, haker, disk, disketë, harduer, emitter, softuer, internet, printer, audiotekë, feisbuk, instagram* etj. Numri i tyre është relativisht i madh. Mund të thuhet, madje, se në rrethe të caktuara flitet për një gjuhë të re - për “gjuhën e internetit”- këtu përfshihen emërtimet për nocionet e informatikës, për nocionet e internetit dhe të ueb-it, të marketingut dhe të biznesit të internetit, pastaj fjalori i përpunimit modern të të dhënave informatike, publikimet elektronike, fjalorët e bazave të të dhënave, terminologjia e postës elektronike, ueb-disajni etj. Është e qartë që shumë nga anglicizmat në shqipen hyjnë jo vetëm si fjalë të huaja, po edhe si neologjizma (fjalë të reja) dhe, si të tilla, ata marrin veçori të ndërkombëtarizmave⁴.

Neologjia përbën një nga format më prodhimtare për pasurimin e gjuhës me lëndë të re. Kjo mënyrë e krijimit të fjalëve të reja nga shkrihtarë, letrarë, publicist, si dhe nga gjeniu popullor, si rrjedhojë e nevojës kulturologjike dhe e aspekteve të tjera që lidhen me zhvillimin e shoqërisë njerëzore, mund të thuhet se ka qenë dhe është prodhimtare edhe për shqipen. *Kulturat janë në kontakt, kështu që dhe gjuhët janë*

⁴ Po aty, 71-72.

në kontakt⁵, prandaj dhe *energija kreative* e gjuhës është e pashtershme jo vetëm për të riprodhuar vetveten, por dhe shoqërinë. “*Gjuha i prodhon njerëzit më shumë se sa njerëzit e prodhojnë atë*” - thotë Johann Wolfgang von Goethe.

“Neologjizmat që janë formuar gjatë historisë së gjuhës me anë përkthimi prej gjuhëve të tjera, si populloret *e diel, e hënë, peshkaqen, mollatartë, vajgur-i, ose përndjek “persekutoj”* te Pjetër Budi, *hapërsirë, vetëdije, ndërgjegje*, e te tjera në shekullin e kaluar, *botoj e shkrimtar* pak më vonë, *botëkuptim, hekurudhë, largpamës, mbinjerëzor, ndërlidhje, pararrojë, përballoj, përvetësoj, i pranishëm, prapavijë, rilindje* e të tjera në ditët tona, përbëjnë një pasurim pozitiv të gjuhës; aty gjedhja e formimit është e huaj, lënda është e vendit. Në këtë radhë mund të vazhdohet e te shkohet përpara, duke pastruar e duke pasuruar; duke zëvendësuar ndër të tjera *fenomen* me *dukuri, efekt* me *duk, persekutim* me *përndjekje, krijoj* me *lentoj, tekstile* me *veglore*, fjalë shumica të gjalla edhe sot nëpër dialekte”- shprehet E. Çabej⁶.

Fjalori i përditshëm dhe terminologjia ndryshojnë, ashtu siç ndryshon dhe shoqëria në të gjitha sferat e në periudha të ndryshme të zhvillimit të saj, por kryesisht më së tepërmi në ekonomi, në politikë etj. Dhe ky nuk është fenomen shqiptar, por ndërkombëtar. Në shoqërinë shqiptare, për arsye të caktuara politike, fjalët më në modë kohët e fundit kanë qenë “*demokraci*”, “*korrupsion*”, “*transparencë*”, etj. Flitet për *transparencë* në qeveri, prokurori, gjykata, dhe në çdo institucion. Flitet për *transparencë* për çdo proces, për çdo dukuri, tek çdo njeri, madje ka filluar të përdoret edhe si terminologji në familje: po kërkohet edhe “*transparencë familjare*”⁷.

⁵ Cit. Murati 2018: 19/ Radovanovic 1997: 66.

⁶ Murati, Qemal; *Fjalor i medieve – Fjalëkrijime të reja, huazime leksikore dhe kalke në mediet shqipe*, Instituti i trashëgimisë shpirtërore e kulturore të shqiptarëve, Shkup, 2018: 19.

⁷ Po aty, 20.

Gjuha shqipe zhvillohet pareshtur jo vetëm së brendshmi, por edhe së jashtmi, duke dhënë e marrë nga gjuhët e tjera. “*E rëndësishme është të kihet parasysh nëse ndërtimi është në pajtim me tipologjinë e gjuhës shqipe*” (S. Mansaku), dhe nëse kalket dhe huazimet integrale i përdorim drejt e me terezi- *cum grano salis*. Imitimi i modeleve të gjuhëve të huaja është bërë “trend” në gjuhën tonë të përditshme. Ndikimin që ushtronte dikur serbishtja, tani është zëvendësuar me ndikimin globalizues të anglishtes dhe të gjuhëve të romanitetit perëndimor, si të thuash me hibride anglo-shqipe, dhe është për të ardhur keq që në mediet tona tërhiqen nga përdorimi veçori thjeshtë shqipe duke u lëshuar vend ndërtimeve të huaja.

Në shqipen e sotme, këta dhjetëvjeçarët e fundit, është krijuar një regjistër fjalësh dhe shprehjesh të reja, të cilat nuk përfshihen në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe (FGJSSH), por kanë përfshirë sidomos gjuhën e folur dhe gjuhën e shkruar publicistike. Nga fondi i fjalëve dhe i shprehjeve të tilla një numër sosh kanë një përdorim më të përditësuar, sidomos në gjuhën e shtresave të ndryshme të politikanëve, intelektualëve, gazetarëve, publicistëve, nxënësve, studentëve, etj., të cilët janë në kontakte më të shpeshta përdorimi me anglicizmat, si të thuash i kanë ato “në majë” të gjuhës.

Vendin e parë në prurjet nga anglishtja pa dyshim e zënë termat e teknologjisë informatike e të internetit. Këtu të gjithë termat janë të rinj, siç është vetë kjo fushë e teknologjisë moderne, dhe kanë hyrë bashkë me sendet që shënjojnë dhe veprimet e lidhura me to, që nga *kompjuter, printer, skaner, maus, toner*, pastaj një numër foljesh që shënjojnë proceset e ndryshme të punës me kompjuterin, si: *startoj, selektoj, cekoj, klikoj, printoj, skanoj*, nganjëherë edhe *sejvoj* për *ruaj*, por që duket se po tërhiqet nga përdorimi. Në ekspansion të shpejtë janë tani së fundi termat që lidhen me internetin: *e-mail, ueb sajt, link,*

logoj, catoj deri dhe *donlodoj* nga *download*, fjalë të sajuara pa e vrarë mendjen, nga nevoja e çastit⁸.

Sipas analizave të bëra, çdo ditë në përdorim janë afërsisht rreth 1500-2000 fjalë. Më poshtë do të japim 100 fjalë që hasen më shpesh të përdorura në gjuhën tonë: *absorboj - thith, aprovoj - miratoj, adaptim/adaptoj - përshtas/përshtatje, aksion - veprim, amendoj - ndryshoj, akseptoj - pranoj, akseleroj - përshpejtoj, aplikim - kërkesë, aktivitet - veprimtari, aproksimim - përafrim, approach - përqasje, asete - pasuri, atraktiv - tërheqës, bilateral/multilateral - dypalësh/ shumëpalësh, benefic - përfitim, civilizim - qytetërim, curriculum vitae - jetëshkrim, deadline - afat kohor, definicion - përkufizim, deskripcion - përshkrim, determinoj - përcaktoj, draftoj/draftim - hartoj/hartim, elaboroj - përpunoj, elektoral - zgjedhore, eskalacion - përshkallëzim, eveniment - ngjarje, esencial - thelbësor, ekselent - i shkëlqyer, ekspansion - zgjerim, eksplozion - shpërthim, ekspoze - paraqitje, eksepsion - përjashtim, ekstrem - i tejskajshëm, ekskluzivisht - përjashtimisht, follow - vijues, fundamental - themelor, fluktuacion - luhatje, fraxhil - i brishtë, implementoj - zbatoj, impakt - ndikim, incentive - stimul, interlokutor - bashkëbisedues, imazh - pamje, interferencë - ndërhyrje, imediat - i menjëhershëm, impresionant - mbresëlënëës, inicioj - nis/filloj, indikacion - tregues, inkludoj/ inkluziv - përfshij/ përfshirës, kalkulim - përlllogaritje, kooperim - bashkëpunim, kontemporan - bashkëkohor, koordinoj - bashkërendoj, kualitativ - cilësor, kuantitativ - sasior, kolokium - bashkëbisedim, konkluzion - përfundim, konkludoj - përfundoj, komerc - tregti, kompeticion/ kompetitiv - garë/konkurencë, komprehensiv - tërësor, koncension - lëshim, koshient/ koshienca - i ndërgjegjshëm/ ndërgjegja, konfrontim - ballafaqim, kreativ - krijues, lokal/e - vendor/e, lancoj - nis/ lëshoj, legal/e - ligjor/e, materializoj - sendërtoj, menaxheriale - drejtuese, minoritet - pakicë,*

⁸ Cit. Murati 2018: 269/ Omari 2009.

mazhorancë - shumicë, manierë - mënyrë, mediator - ndërmjetësues, nacionalitet - kombësi, nuklear - bërthamor, opinion - mendim, parafinoj - sigloj/ nënshkruaj, performancë - paraqitje, poll - anketim, procedim penal - ndjekje penale, prominent - i shquar, promocion - paraqitje, relata - raporte, servis - shërbim, star - yll, solucion - zgjidhje, supervision - mbikëqyrje, stabil - i qëndrueshëm, shou - shfaqje, shokues/ shokant - tronditës, trend/ tendencë - prirje, trafik i automjeteve - qarkullimi i automjeteve, tentativë - përpjekje, tete a tete - kokë me kokë, updejtoj - përditësoj, xhenuine - i vërtetë⁹.

Gjuhëtarët tanë kanë bërë dhe po bëjnë përpjekje të vazhdueshme që edhe në fushën e terminologjisë teknike-shkencore t'i luftojnë termat e huaj dhe t'i zëvendësojnë me terma përkatës të shqipes. Në ato përpjekje të tyre, gjithmonë të vështira, ata janë treguar shpeshherë dorëmbarë, duke farkuar drejt terma të rinj me mjete të brumit vetjak dhe duke i shtënë ato në qarkullim, por ndonjëherë rrëshqasin në purizëm të skajshëm kur propozojnë që çdo termë i huaj të zëvendësohet me gjegjësen shqipe, si p.sh.: grant - me fond ndihme, evazion fiskal - me shmangie nga pagimi i taksave, input-output - me hyrjet dhe daljet (në prodhim) dhe të ardhurat (në kontabilitet), tender - me ofertë konkurruese, etj¹⁰.

Gjuha si mjet komunikimi synon gjithmonë që me minimumin e thënies të arrijë maksimumin e shprehjes, pra të përdorë një fjalë për një term a nocion të caktuar, dhe jo një togfjalësh a një fjali. Prandaj në shembujt e mësipërm nuk mund të zëvendësohen aq lehtë termat e huaj me togfjalësha dhe me fjali të shqipes.

Në epokën e sotme të globalizimit politik, ekonomik e lingvistik, anglishtja është jo vetëm një dritare kah bota, ajo është krejt bota. Por ky fakt nuk do të thotë që shqipen ta përziejme e ta bëjmë anglishte,

⁹ Murati, Qemal; *Fjalor i medieve* - Fjalëkrijime të reja, huazime leksikore dhe kalke në mediet shqipe, Instituti i trashëgimisë shpirtërore e kulturore të shqiptarëve, Shkup, 2018: 271-272

¹⁰ "Gjuha Shqipe", 1-2, Tiranë, 2000, 44.

kaçamak e kryelanë. Përkundrazi, *anglishten ta flasim korrekt kur të flasim anglisht, dhe shqipen ta flasim korrekt kur të flasim shqip*. Më në fund, edhe vetë ndajfolja *shqip*, siç e shpjegojnë gjuhëtarët, do të thotë “*flas kuptueshëm, qartë*”.

Futja e fjalëve të huaja është një problem i vazhdueshëm që haset në pjesën më të madhe të gjuhëve. Si shembull mund të përmendim këtu numrin e fjalëve angleze që përdoren në gjuhën e folur italiane, i cili sipas gjuhëtarit të njohur italian Tullio de Mauro ka kapur shifren e 5000 fjalëve, e që në të shumtën e rasteve këto fjalë nuk i përshtaten gramatikës së gjuhës në të cilën përdoren. Fjalët e huaja nuk do të thotë që të mos përdoren, aq më tepër kur ato zëvendësojnë një boshllëk në fjalor, veçse ato duhet të adaptohen sipas ligjeve gjuhësore të gjuhës marrëse¹¹.

Kështu, fjalurtë latine, si: “*Kur shkruan gjithkush, atëherë shkruhet gjithçka.*” “*Kur flet gjithkush, atëherë flitet gjithçka.*”

- Dashtë e padashtë apo dashur pa dashur?

*Është e patolerueshmë zhagjitja e procesit në infinit, që **dashtë e padashtë** e mban Kosovën dhe qytetarët e saj pezull... (“Pavarësia”)*

Po ta shprehim këtë fjali shqip, do të thoshim kështu:

*Është e palejueshme zvarritja e procesit në pafundësi, që **dashur pa dashur** e mban Kosovën dhe qytetarët e saj pezull...*

- Detajizuar apo detajuar?

Nuk mjafton vetëm fjala pavarësi. Duhet të punohet në shumë çështje të *detajizuara* për statusin (Express)

Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe ka *detaj, detajim, detajoj, detajohet*, por jo *detajizoj*, prandaj kjo forma e fundit të shmanget nga përdorimi.

¹¹ Po aty, 276.

- Disiplinë apo disiplinë?

Komisioni disiplinor...

Në disiplinën e orientalistikës... (Shtypi)

Nga ndikimi i formës grafike të frëngjishtes *discipline*. Shqipja ka *disiplinë*, jo *disciplinë*.

- Falemnderës apo falemnderit?

Shumë falemnderës që ishit të pranishëm në Televizionin e Kosovës (RTK).

Gjuha letrare nuk ka *falemnderës*, as *ju falemnderojmë*, por ka *falemndrit*, *ju falënderojmë*.

- Konkurim/ konkuroj apo konkurrim/ konkurroj?

Të drejtë *konkurimi* kanë të gjithë të interesuarit... (Shtypi)

Afati i *konkurimit* është deri më... (TV 21)

Format e dala prej fjalës *konkurs* shkruhen me rr e jo me r: *konkurrim*, *konkurroj*, *konkurrencë*, *konkurrues*, *konkurrent*. Vetëm *konkurs* shkruhet me r.

- Mirësevini apo mire se vini?

Top-channel. Tv- Mirësevini (në faqen e Internetit).

Si duhet të shkruhet pasthirrma *mirësevini* apo *mirë se vini*? Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe rekomandon trajtën *mirë se vini* (*mirë se vjen*, *mirë se na erdhët*). Atëherë përse të biem ndesh me rregullat drejtshkrimore të shqipes që i kemivendosur vetë?

- Mirë u pafshim apo mirupafshim?

Në fund ju dëshiroj: *Mirë u pafshim* në Seminarin e 24-të Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kluturën Shqiptare!¹²

¹² Po aty, f. 480.

Kjo pasthirmë e shqipes duhet të shkruhet dhe të shqiptohet bashkë: *Mirupafshim*.

- Musliman apo mysliman?

Veprat kodifikuese të gjuhës së sotme letrare shqipe (Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, 1973, Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe, 1976, FGSSH) kanë pranuar shkrimin me y për fjalën *mysliman*, kurse në disa shkrime e botime, përfshirë edhe organet fetare islame, fjala *mysliman* shkruhet e shqiptohet me u: *musliman*. Në arabishten, prej së cilës e ka burimin, fjala shkruhet me u: *musliman*. Por, siç dihet, kjo fjalë është marrë nëpërmjet turqishtes *musulman*.

Shkrimi i kësaj fjale me y në veprat kodifikuese të shqipes nuk është zgjedhje, as zgjidhje e veçuar. Ajo është zgjidhje në sistem. Shkruhen me y dhe jo me u edhe fjalë të tjera të huazuara nga turqishtja a nëpërmjet turqishtes: *bylyk, byrazer, çyrek, dyfek, dyqan, dyshek, gjynah, myfti, myshteri, mytesarif, synet, tyrbe: Myslim, Myftar* etj. Shqiptimi i fjalëve të mësipërme me u (burek, dufek, Husni) ndodh në disa të folme ku mungon fonema y.

- Museum apo muze?

Parisi, qyteti i *muzeumeve* (VIP, Ekskluzive)

FGSSH nuk ka *muzeum*, por *muze*. *Parisi, qytet i muzeve*.

- Profesor i asocuar apo i asociuar?

Profesor i asocuar (titull akademik që i jepet një pedagogu në universitet, dr. shkencash, i cili së paku duhet të ketë pesë vjet që të ketë mbaruar doktoratën; profesor inordinar).

Më drejt: Profesor i asociuar.

- Bleni nga shtëpia apo blini nga shtëpia?

Top Shop – *bleni nga shtëpia* (KTV)

Biletat *blehen te arka* (shpallje, njoftime).

Trajta të gabuara foljore që përdoren shpesh në gjuhën e folur dhe në gjuhën e shkruar shqipe. Folja *blej* në kohën e tashme të zgjedhimit jovepror del me trajtën *blihet, blihen: Biletat blihen te arka* (jo blehen). Ndërkaq, *blej* në urdhërore bën *blini: Blini nga shtëpia*.

- Diplomoj / doktoroj apo diplomohem / doktorohem?

Kam diplomuar në Degën e Gjuhës Shqipe.

Ka magjistruar në shkencat filologjike.

Doktoroi në shkencat e mjekësisë.

Ka specializuar në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare.

Foljet e tilla duhet të përdoren në diatezën vetvetore: *diplomohem, u diplomova, u diplomua, është diplomuar* “marr diplomën kur mbaroj shkollën e lartë ose një kurs”; *U dilpomua në Universitetin e Prishtinës; magjistrohem, u magjistrua, është magjistruar, doktorohem, u doktorua, është doktoruar, specializohem, u specializua, është specializuar, dhe jo në diatezën veprorë: kam diplomuar, ka diplomuar, diplomoj, kam magjistruar, ka magjistruar, magjistroi etj.*

- Këshilli organizativ apo këshilli organizues?

Këshilli organizativ

Te mbiemrat e këtij lloji në vend të prapashtesës –iv duhet përdorur prapashtesa – ues:

Këshilli organizues: ashtu sikurse dhe te: *ilustrativ* (ilustrues), *stimulativ* (stimulues), *komunikativ* (komunikues), *konkluziv* (konkludues), *korruptiv* (korruptues), *afirmativ* (afirmues), *rregullativ* (rregullues).

- Përgjegje apo përgjigje?

Në përgjegjen e tij... (RTK)

Gjuha letrare shqipe nuk ka *përgjegje*, por *përgjigje*?
Në përgjigjen e tij; Përgjigje e shpejtë; (Dha) i kthen përgjigjë;
*Pres përgjigjen*¹³.

Disa emra të institucioneve të Kosovës me përdorim të gabuar

Një numër i madh i emërtimeve të agjencive dhe të institucioneve të reja, të krijuara në këta **dhjetëvjeçarët** e fundit në Kosovë, dalin të përdoren me forma të gabuara me përcaktorin *kosovare* pas emrit, në vend të përcaktorit procesiv e *Kosovës* në fund të emërimit, si:

- Agjencia Kosovare e Inteligjencës

Agjencia Kosovare e Inteligjencës, institucioni më i lartë i sigurisë, është përmendur për disa skandale e situata të jashtëzakonshme...E, së fundmi shefi i AKI-së...(Gazeta Exspres)

Drejt: *Agjencia e Inteligjencës e Kosovës*, njëjtë sikurse: Akademia e Shkencave e Kosovës, dhe jo: Akademia Kosovare e Shkencave dhe e Arteve.

- Agjencia Kosovare e Privatizimit

Propozohet mbyllja e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (titull).

“Deputetët e Kuvendit të Kosovës po diskutojnë lidhur me shqyrtimin e Raportit vjetor të punës së Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2017” (Gazeta Exspress)

Drejt: *Agjencia e Privatizimit e Kosovës*.

- Angjencia Kosovare e Standardizimit

Agjencia Kosovare e Standardizimit është organ kombëtar që miraton standarde, i harmonizon ato dhe si rezultat stimulon fuqishëm zhvi-

¹³Murati, Qemal; *Gjuha e medievet* – Fjalor i gabimeve gjuhësore, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2008, 55-255.

llimin ekonomik, duke krijuar bazë për konkurrencë në rajon dhe më gjerë.

Drejt: Agjencia e Standardizimit e Kosovës.

- Agjencia Kosovare e Akreditimit

Një organizatë ndërkombëtare, “European Quality Assurance Register for Higher Education” (EQAR), e ka përjashtuar Agjencinë Kosovare të Akreditimit nga anëtarësia për shkak të shkarkimit të bordit të kësaj agjencie që ishte bërë më kërkesë të Kryeministrit, Ramush Haradinaj.

Drejt: Agjencia e Akreditimit e Kosovës.

- Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (ang. Kosovo Trust Agency)

Drejt: Agjencia e Mirëbesimit e Kosovës¹⁴.

Shembulli e ndihmesa e Ismail Kadresë për krijimin dhe përdorimin e fjalëve shqipe në vend të fjalëve të huaja

Po japim një pjesë të fjalëve shqipe, të cilat shkrimtari i shquar, Ismail Kadare, i ka krijuar vetë ose i ka marrë në gojën e popullit, si dhe nga shkrimet e mëhershme, por gjithmonë të përdorura me mëtime mirëfilli gjuhëpastruese. Në veprat e Kadresë ndeshim një sasi mjaft të konsiderueshme fjalësh, të cilat ai i përdor për të mënjeluar fjalët e huaja përkatëse, apo, kur nuk ka mundësi tjetër, së paku shqipëron pjesë të tyre, si p.sh. parashtresën **anti-**, prapashtesën **-xhi** etj.

Asnjansuar (i,e) në vend të neutralizuar (i,e).

Atdhesia në vend të patriotizmi.

Ballinë në vend të kopertinë.

¹⁴ Murati, Qemal; *Kulturë gjuhe e komunikimi dhe gramatikë drejtshkrimore*, Instituti i trashëgimisë shpirtërore e kulturore të shqiptarëve, Shkup, 2019: 360.

Barnatore në vend të farmaci.
Bujtja në vend të akomodimi.
Çmartua (u) në vend të divorcua (u).
Dysia në vend të dublimi.
Flijimtari në vend të sakrificë.
Foltore në vend të tribunë, vend ku dilet për të mbajtur një fjalim.
Gënjim në vend të iluzion.
Gufmohej në vend të entuziazmohej.
Gjithësishme në vend të universale.
Hamendësia në vend të intuita.
Kafetar në vend të kafexhi.
Kombëtarizëm në vend të nacionalizëm.
Kumtim në vend të komunikim.
Kundërthënës në vend të kontradiktor.
Kupëz në vend të filxhan.
Mallëngjyeshëm në vend të emocionalisht.
Mëtoj në vend të pretendoj; ai që mëtonte trashëgiminë.
Mosdurim në vend të intolerancë.
Ndërdije në vend të subkoshiençë.
Ngazëllimtar në vend të entuziast.
Ngrehinë në vend të pallat.
Njehsim në vend të numërim, llogaritje.
Njeridashës në vend të human.
Njemendësim në vend të certifikim.
Përkitaz në vend të respektivisht.
Qafëzë në vend të jakë.
Qytetë në vend të urban.
Sendërtoj në vend të konkretizoj.
Shitore në vend të dyqan.
Tërthorëzim në vend të aludim.
Tretësirë në vend të solucion.

*Yjkuptues në vend të astrolog.
Zanafillë në vend të origjinë¹⁵.*

Përfundime

E gjithë bota e qytetëruar, të gjitha shtetet e organizuara e me emër të mirë në botë, që nga SHBA, Franca, Britania e Madhe, Gjermania, Italia etj., kanë edhe kode të caktuara të formulave dhe mënyrave të shprehjes shtetërore, zyrtare, të cilave duhet t'u përmbahen me rreptësi të gjithë funksionarët e shtetit. Pra, është pikërisht koha ta jetësojmë këtë ide dhe duhet të ketë edhe një kod për shkrimin dhe komunikimin zyrtar në Republikën e Shqipërisë.

Ky ligj, natyrisht, mund të mbështetet edhe në modelet ekzistuese të SHBA-së a vendeve të tjera, por rëndësi ka që të jetë i miratuar dhe të zbatohet nga të gjithë dhe, mbi atë bazë, edhe redaktorët e korrektorët që do të caktohen në zyrat e shtetit, do ta kenë të qartë dhe më të lehtë kryerjen e detyrës së tyre¹⁶.

Veprimtarët e shquar të Rilindjes, duke ecur më tej në atë traditë të pararendësve, e ripërtërinë gjuhën tonë letrare dhe e vunë atë në udhë të mbarë, të cilën do ta vijonin edhe mjaft lëvrues e mësues të shqipes. Në kohën tonë, kjo lëvizje gjuhësore është vënë në baza shkencore më të përparuara, që i përgjigjen epokës së sotme. Ajo ka marrë edhe përmasa shumë më të gjera shoqërore. Porosia e madhe dhe e urtë e E. Çabejt duhet të na prijë udhën për mot e jetë: *“Gjuha pasqyron një kombësi, ajo është pasqyra më e qartë e një kombësie dhe e kulturës së saj. Shkalla e pasurisë dhe e pastërtisë së gjuhës është tregues i nivelit të kësaj kulture. Prandaj ringjalljet nacionale kudo e në çdo kohë kanë shkruar hap më hap me pasurimin e pastrimin e gjuhës me elemente të*

¹⁵ Shkurtaj, Gjovalin; *Urgjenca gjuhësore – huazime të zëvendësueshme me fjalë shqipe*- Fjalorth, botimet ada, Tiranë, 2015, 173-178.

¹⁶ Po aty, 23.

gurrave vetjake dhe spastrimi i saj prej fjalëve të huaja që kanë vërshuar së jashtmi dhe që po vazhdojnë edhe në ditët tona... Pastrimi i gjuhës nga ky mish i huaj është një detyrë shkenore, njëkohësisht edhe kombëtare”¹⁷

Shmangia e fjalëve të huaja të panevojshme e bën gjuhën letrare kombëtare më homogjene e më popullore, më të qartë e më të kuptueshme.

Gjovalin Shkurtaç ka thënë: *“Shqipja është gjuhë e hapur, por ne jemi më imitues se ç’duhet, pa qenë nevoja. Shqipja është shumë e pasur dhe i ka vetë shumë prej fjalëve, që folësit i huazojnë nga gjuhët e huaja.”*

“Gjuha jote është kali yt; nëse e ruan, të ruan.” - Arabe

¹⁷ Shih: E. Çabej, Për pastërtinë e gjuhës, në “Gjuha jonë” 1, 1981, f. 36-47.

Conclusions

The whole civilized world, all the organized and well-known countries in the world, from the USA, France, Great Britain, Germany, Italy, etc., also have certain codes of formulas and ways of state and official code of conduct, to which all state officials must strictly adhere. In this regard, it is appropriate to have this practice implemented in other countries as well, respectively to enact a code for official writing and communication in the Republic of Albania. This law, of course, can be based on existing models of the US or other countries, but it is important that it has to be approved and implemented by all and, on that basis, the editors and proofreaders who will be appointed in state offices, will have a clearer and easier performance of their duty. (Shkurtaç, 2015: 23)

The prominent activists of the Renaissance, going further in that tradition of the predecessors, renewed our literary language and put up a standard to be followed by many researchers and teachers of the Albanian language.

In our time, this linguistic movement has been put on the most advanced scientific basis, corresponding to the present era. It has also taken on much broader social dimensions.

The great and wise message of E. Çabej should lead us on the path of time and life: "Language reflects a nationality, it is the clearest reflection of a nationality and its culture. The degree of richness and purity of language is an indicator of the level of this culture.

That is why the national revivals everywhere and at all times have written step by step with the enrichment and purification of the language with elements of personal inflows and its purification from foreign words that have come from outside and that are continuing even today... Purification of the language from this foreign countries is a scientific task, at the same time a national one"

Avoiding unnecessary foreign words makes the national literary language more homogeneous and popular, clearer and more understandable.

Gjovalin Shkurtaç said: "*Albanian is an open language, but we are more imitators than necessary, without being necessary. Albanian is very rich and has many of the words that speakers borrow from foreign languages.*"

"*Your tongue is your horse; if you save it, it saves you.*"- Arabic

Literaturë:

- Shkurtaç, Gjovalin; *Urgjenca gjuhësore* - huazime të zëvendësueshme me fjalë shqipe- Fjalorth, botimet ada, Tiranë, 2015
- Murati, Qemal; *Gjuha e medieeve* - Fjalor i gabimeve gjuhësore, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2008.
- Murati, Qemal; *Kulturë gjuhe e komunikimi dhe gramatikë drejtshkrimore*, Instituti i trashëgimisë shpirtërore e kulturore të shqiptarëve, Shkup, 2019.
- Hamiti, Asllan; *Kultura e gjuhës për të gjithë*, Shkup, 2018.
- Murati, Qemal; *Fjalor i medieeve* - Fjalëkrijime të reja, huazime leksikore dhe kalke në mediet shqipe, Instituti i trashëgimisë shpirtërore e kulturore të shqiptarëve, Shkup, 2018.
- Murati, Qemal; *Shqiptarët dhe shqipja* - në një botë emrash të përvecëm, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2015.
- Pllana, Gani; *Formimi i terminologjive teknike shqipe mbi bazën e leksikut të përgjithshëm* - Procese të krijimit, të pasqyimit në gjuhë dhe të standardizimit, Botimet Albanologjike Tiranë, 2017.

KRONIKË

Mr. Vedat SHABANI

AKTIVITETET E FAKULTETIT TË STUDIMEVE ISLAME - PRISHTINË GJATË VITEVE 2019-2020

I. Konferenca shkencore, tryeza, ligjërata, trajnime

Në vazhden e aktiviteteve të Fakultetit të Studimeve Islame në fushën e ngritjes së kapaciteteve shkencore dhe hulumtuese janë edhe aktivitetet në vijim, të cilat janë realizuar gjatë vitit kalendarik 2019-2020:

Më datë 26.02.2019, dekanati i FSI-së ka organizuar akademi përkujtimore me rastin e kalimit në amshim të profesorit të FSI-së, njëherazi edhe njërit prej themeluesve të saj, mr. Qemajl Morina.

Më datë 01.03.2019, dekanati i FSI-së ka organizuar trajnim njëditor për stafin akademik të FSI-së. Temë e trajnimit ishte: “Përdorimi i teknologjisë informative për përmirësimin e mësimdhënies dhe mësimin”. Trajneri ishte z. Feim Kabashi. Gjatë këtij trajnimi u trajtuan këto pika:

1. Stilet e mësimin, metodat e mesimit, ciklet e të mësuarit të Kolbit, mendimi kritik, vlerësimi, etj..
2. Hyrje dhe demonstrim i përdorimit të PowerPoint për të krijuar një prezantim për një mësim më efikas dhe interaktiv.

3. Excel - si ta përdorim Excel-in, formulat, si të regjistrojmë dhe raportojmë progresin e studentëve në një mënyrë më efektive.
4. Word - si ta përdorim Word-in që të krijojmë dokumente të ndryshme për punë dhe studentët, p.sh. tabelat e përmbajtjeve, format elektronike, tabela të thjeshta, formatizimi i dokumenteve që ta lehtësojmë kuptimin, etj..

Nga data 22 prill 2019 deri më datë 03 maj 2019 është mbajtur trajnimi në metodologjinë e mësimdhënies nga profesoresha e Universitetit të Karolinës së Veriut në New York, Dr. Diane Chapman. Ndër temat kryesore gjatë trajnimit ishin: *përdorimi i studimeve të rasteve në mësimdhënie, përfshirja e hulumtimit në mësimdhënie, përdorimi i një moduli të bazuar në hartimin e kursit, teknikat e vlerësimit në klasë, praktikat e vlerësimit të bazuara në kompetenca dhe inkorporimi i nivelit të Bloomit të njohjes në mësimdhënie dhe vlerësim*, etj.. Ky trajnim sipas profesorëve të FSI-së ishte mjaft me interes dhe i dobishëm për ta, duke sjellë inovacione në metodologjinë e mësimdhënies, duke futur metoda të reja dhe nxitje për përdorim më të shpeshtë të teknologjisë nga ana e tyre.

Më datë 02.06.2019 në ambientet e Fakultetit të Studimeve Islame u bë promovimi i librit “*Studime kontrastive ndërmjet arabishtes dhe shqipes në fushën e fonologjisë*” të autorit, tashmë të ndjerë, ish-profesorit të Fakultetit të Studimeve Islame, mr. Qemajl Morina. Në këtë eveniment morën pjesë: myftiu i Republikës së Kosovës, Naim ef. Tërnavë me bashkëpunëtorë, përfaqësuesi nga kisha katolike, Dom Lush Gjergji, drejtori i Institutit Shqiptar të Mendimit dhe Qytetërimit Islam, z. Ardian Muhaj, drejtori i Medresës së Mesme “Alauddin”, z. Jakup Çunaku, familjarë të profesorit, mr. Qemajl Morina, profesorë të FSI-së dhe shumë mysafirë të tjerë.

Më datë 27.11.2019 në ambientet e Fakultetit të Studimeve Islame në Prishtinë u mbajt konferenca shkencore njëditore “Jeta e Pejgam-

berit a.s. prej lindjes deri në shpalljen hyjnore” të organizuar nga Fakulteti i Studimeve Islame i Prishtinës. Në këtë konferencë me punimet e tyre ishin paraqitur 21 referues, nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia dhe Novi Pazari. Konferenca punimet i zhvilloi në katër seanca të ndara. Çdo seancë përbëhej nga pesë referues, në kuadër të seancës ishte edhe kryesuesi i seancës.

Seanca e parë i filloi punimet në orën 10.20 për t’i përfunduar në orën 11.15. Pjesë e kësaj seance ishin referuesit:

1. Prof. asoc. dr. Muhamed Ali, profesor në Universitetin “Nënë Tereza” Shkup, me temën: *“Rrethanat politiko-shoqërore tek arabët para shpalljes”*.
2. MA Ledian Cikalleshi, myfti i zonës së Korçës, Republika e Shqipërisë, me temën: *“Pozita gjeografike dhe rrethanat shoqërore-politike tek arabët para shpalljes”*.
3. Dr. Ardian Muhaj, drejtor i Institutit të Mendimit dhe Qytetërimin Islam në Tiranë, me temën: *“Një vështrim mbi historinë e Mesdheut në shekullin e parë të Islamit”*.
4. Dr. Hajrudin Balic, profesor në Fakultetin e Studimeve Islame në Novi Pazar, me temën: *“Rëndësia e përzgjedhjes së Gadi-shullit Arabik për zbritjen e shpalljes së fundit”*.
5. Prof. ass. dr. Lulzim Esati, profesor në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë, me temën: *“Personaliteti i Pejgamberit a.s. në librat e shenjtë – hebrenj dhe të krishterë”*.

Seanca e dytë i filloi punimet në orën 11.30 për t’i përfunduar në orën 12.30. Referues në këtë seancë ishin:

1. Prof. asoc. dr. Fahrush Rexhepi, dekan i Fakultetit të Studimeve Islame në Prishtinë, me temën: *“Paralajmërimi i ardhjes së Pejgamberit a.s. në librat e shenjtë”*.
2. Enisa Bekteshi, përfaqësuese e studentëve të FSI-së, me temën: *“Fetë dhe besimet tek arabët para Islamit”*.

3. Dr. Xhemal Es Seferti, lektor në Universitetin “Bedër” në Tiranë, me temën: *“Jeta e Pejgamberit a.s. para shpalljes”*.
4. MA Aorel Senja, lektor në Universitetin “Bedër” në Tiranë, me temën: *“Muhamedi a.s., fëmijëria, rritja, edukimi dhe pjesëmarrja e tij në aktivitetet shoqërore”*.
5. Dr. Ajni Sinani, profesor në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë, me temën: *“Pejgamberi a.s. nën mbikëqyrjen hyjnore që nga lindja”*.

Pas përfundimit të seancës së dytë, në bazë të programit të konferencës ishin paraparë dhjetë minuta për diskutime. Gjatë kësaj periudhe ishin disa pyetje të cilat iu parashtruan panelistëve në lidhje me kumtesat e tyre.

Seanca e tretë i filloi punimet në orën 13.15 për t’i përfunduar në orën 14.15. Referues në këtë seancë ishin:

1. Prof. ass. dr. Musa Vila, profesor në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë, me temën: *“Virtytet dhe karakteri i Muhamedit a.s. para shpalljes”*.
2. Prof. Xhemal Balla, Instituti i Mendimit dhe Qytetërimit Islame në Tiranë, me temën: *“Profeti Muhamed simbolizonte vlerat e larta për zhvillimin e shoqërisë njerëzore”*.
3. Prof. asoc. dr. Musa Musai, profesor në Universitetin e Tetovës, Tetovë, me temën: *“Muhamedi a.s. paratrajtë qiellore e virtytisë njerëzore; shekujt të përmalluar për të”*.
4. Prof. asoc. dr. Sulejman Osmani, profesor në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë, me temën: *“Familja e Pejgamberit a.s. dhe pozita e saj në shoqëri”*
5. Dr. Violeta Smajlaj, Departamenti i Gruas, Gjakovë, me temën: *“Jeta bashkëshortore e Pejgamberit a.s.”*.

Seanca e katërt i filloi punimet në orën 14.30 për t'i përfunduar në orën 15.30. Referues në këtë seancë ishin:

1. Dr. Ilmije Kuqi, profesoreshë në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë, me temën: “Rëndësia e njohjes së jetës së Pejgamberit a.s.”
2. Mr. Samir Ahmeti, profesor në Medresenë e Mesme “Alauddin” në Prishtinë, me temën: “Burimet relevante rreth historiografisë pejgamberike të Muhamedit a.s.”.
3. Prof. Sabri Bajgora, kryeimam në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, me temën: “Përshkrimi i lindjes së Muhamedit a.s. në mevludet e gjuhës shqipe”.
4. Prof.dr. Hysen Matoshi, drejtor i Institutit Albanologjik në Prishtinë, me temën: “Lindja e Muhamedit a.s. te mevludshkruesit shqiptarë”.
5. Prof. asoc. dr. Isa Memishi, profesor në Fakultetin e Orientalistikës pranë UP-së në Prishtinë, me temën: “Personaliteti i Pejgamberit a.s. nga prizma e orientalistëve evropianë”.

Me përfundimin e punimeve të konferencës, dekani i FSI-së, prof. asoc. dr. Fahrush Rexhepi, mbajti fjalën përmbyllëse, ku falënderoi referuesit për kontributin e tyre shkencor të dhënë në këtë konferencë. Dekani Rexhepi në veçanti falënderoi pjesëmarrësit nga Shqipëria.

Në fund referuesit u pajisen me nga një certifikatë në shenjë mirënjohjeje për kontributin e tyre shkencor në këtë konferencë.

Në kuadër të aktiviteteve hulumtuese dhe shkencore të Fakultetit të Studimeve Islame, më datë 23.01.2020 janë përruruar dy vëllime të botimeve të projekteve hulumtuese me titull:

1. Epitafet në gjuhën osmane - deshifrimi dhe përkthimi i tyre, Regjioni i Prishtinës
2. Epitafet në gjuhën osmane - deshifrimi dhe përkthimi i tyre, Regjioni i Mitrovicës

Në këtë promovim, përveç stafit të FSI-së, morën pjesë edhe kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef.Tërnavë me bashkëpunëtorë, përfaqësues nga ambasada e Turqisë, Diyanetit, institutit Yunus Emre, përfaqësues nga Instituti i Historisë, Instituti Albanologjik, profesorë, studiues, intelektualë, dashamirë të librit e të kulturës, si dhe shumë të ftuar të tjerë.

Më datë 05.03.2020, prodekani i FSI-së, prof. ass. dr. Zija Abdullahu dhe sekretari i Fakultetit, mr. Vedat Shabani, morën pjesë në Konferencën e Tretë Ndërkombëtare për Studimet Islame, të organizuar nga Universiteti “Bedër” – Departamenti i Shkencave Islame, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë dhe Këshilli Botëror i Komuniteteve Myslimane me seli në Abu Dabi të Emirateve të Bashkuara Arabe.

Në këtë konferencë prezentë ishin shumë akademikë dhe studiues nga Shqipëria, Kosova, Gjermani dhe Turqia. Tema e konferencës ishte: *“Islami dhe sfida të familjes në shoqërinë bashkëkohore”*, ku me kumtesat e tyre u paraqitën 21 referues dhe studiues nga vendet e lartpërmendura.

Prodekani i FSI-së, prof. ass. dr. Zija Abdullahu, u paraqit me temën: *“Roli i familjes në ngritjen e imunitetit shoqëror”*, e cila zgjoi një interesim të jashtëzakonshëm tek audienca.

Më datë 25.07.2020 u mbajt konferenca shkencore ndërkombëtare përmes prezantimeve online me temë: *“Multikonfesionalizmi në shoqërinë multietnike dhe multikonfesionale”*, organizuar nga Fakulteti i Shkencave Islame në Shkup. Përveç studiuesve shqiptarë dhe maqedonas nga Maqedonia e Veriut, në këtë konferencë morën pjesë edhe studiues nga Kosova, Shqipëria dhe Mali i Zi. Në konferencë kryesisht u diskutua rreth ndërtimit të paqes dhe tolerancës në shoqëritë multietnike dhe multikonfesionale të vendeve ballkanike të përfshira në luftërat e fundit. Në këtë konferencë dekani i Fakultetit të Studimeve Isla-

me, prof. asoc. dr. Fahrush Rexhepi mori pjesë me temën: “Roli i fesë në shoqëritë multikonfesionale”.

Më datë 3 dhe 4 tetor 2020 u mbajt konferenca ndërkombëtare me temë: “Mësimi përgjatë jetës në epokën digjitale”. Në këtë konferencë mjaft frytdhënëse morën pjesë 25 prezantues nga Shqipëria, Bosnja, Turqia, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Lugina e Preshevës. Nga Fakulteti i Studimeve Islame pjesëmarrës në këtë konferencë ishin dekani i FSI-së, prof. asoc. dr. Fahrush Rexhepi, në cilësinë e udhëheqësit të panelit, dhe sekretari mr. Vedat Shabani, i cili u paraqit me kumtesën “Vlera e të mësuarit përgjatë tërë jetës sipas koncepteve islame (*Perspektiva e Fakultetit të Studimeve Islame ndaj këtij koncepti*)” ndërsa përmes paraqitjes online mori pjesë edhe mr. Muzaqete Kocumi.

II. Vizitat dhe bashkëpunimi rajonal-ndërkombëtar

Më datë 05.03.2019 sekretari i FSI-së, mr. Vedat Shabani, në emër të Fakultetit të Studimeve Islame, mori pjesë në takimimin e realizuar në Kryesinë e Bashkësisë Islame me rektorin e Universitetit “Management & Science University” të Malezisë, prof.dr. Mohamed Shukri Jaxhid. Sekretari i FSI-së e informoi rektorin Shukri për historikun e FSI-së, stafin akademik, numrin e studentëve dhe programet që ofron FSI. Gjithashtu u bisedua edhe për mundësinë e bashkëpunimit dhe lidhjes së ndonjë marrëveshjeje mes dy institucioneve.

Më datë 27.03.2019 dekani i FSI-së, prof. asoc. dr. Fahrush Rexhepi, së bashku me profesorin e hadithit, prof. ass. dr. Musa Vila dhe sekretarin e Fakultetit, mr. Vedat Shabani vizituan Institutin AIITC në Tiranë. Me këtë rast dekani Rexhepi falënderoi drejtorin e Institutit, Dr. Ardian Muhaj, për mbështetjen e dhënë me rastin e botimit të librit të mr. Qemajl Morina “Studime kontrastive mes arabishtes dhe shqipes

në fushën e fonologjisë”. Kontakti i vazhdueshëm mes AIITC dhe FSI-së, deri në botimin e librit, u finalizua me një vizitë të dekanit të FSI-së, prof. asoc. dr. Fahrush Rexhepi, pedagogut prof. ass. dr. Musa Vila dhe sekretarit, z. Vedat Shabani. Ata u pritën nga drejtori i AIITC-së, Dr. Ardian Muhaj, nëndrejtori z. Alban Kodra dhe stafi i këtij instituti.

Më datë 23.04.2019, Presidenti i Këshillit për Çështje Publike të Myslimanëve në Amerikë (MPAC), z. Salam Al-Marayati, vizitoi Fakultetin e Studimeve Islame. Mysafirin e priti Dekani i FSI-së, prof. asoc. dr. Fahrush Rexhepi me bashkëpunëtorë. Z. Salam Al-Marayati mbajti një ligjëratë para studentëve të FSI-së me temën “Marrëdhëniet mes qeverisë dhe institucioneve fetare në shoqëri sekulare - shembulli i SHBA-ve”.

Më datë 12.12.2019, një delegacion i përfaqësuesve të Bashkësisë Islame në Suedi, nën udhëheqjen e z. Ismail Ebu Helal, vizituan FSI-në, ku u pritën nga dekani i FSI-së, prof. asoc. dr. Fahrush Rexhepi, i cili i informoi ata për ecurinë e punëve në FSI.

Më datë 30.09.2020 për vizitë në FSI ishte Kapelani i Ushtrisë së KFOR-it amerikan, Nënkolonel Jakob Scott, i shoqëruar nga Rreshteri z. Hamby dhe këshilltari, njëherazi edhe përkthyesi i tij, z. Naim Bajrami. Dekani i FSI-së, prof. asoc. dr. Fahrush Rexhepi, i njoftoi mysafirët për historikun dhe zhvillimet në FSI, reformat, kurrikulat, kuadrin dhe punën e FSI-së në rrafshin akademik dhe shkencor. Në vazhdim dekani Rexhepi foli edhe për rolin e FSI-së në promovimin e vlerave tolerante dhe paqësore në shoqërinë tonë duke theksuar se misioni i FSI-së, përveç arsimimit dhe edukimit të brezave të rinj në fushën e studimeve islame, është edhe ndërtimi i paqes, tolerancës dhe dialogut ndërfaqetarak dhe ndërkulturor.

Më datë 13.11.2020, dekani i Fakultetit të Studimeve Islame në Prishtinë, prof. asoc. dr. Fahrush Rexhepi me bashkëpunëtorë priti në takim drejtorin e Organizatës “Human Appeal International Australia” (HAIA), z. Bashar al Jamal, i cili ishte i shoqëruar nga z. Naser Gashi,

drejtor i shoqatës "Human Appeal International" zyra në Kosovë. Në këtë takim dekani i FSI-së njohu z. Jamal me historikun e FSI-së, stafin akademik, studentët dhe programet që ofron FSI për studentët e interesuar. Edhe Bashar al Jamal, drejtor i Human Appeal International Australia (HAIA), falënderoi dekanin për pritjen duke theksuar në të ardhmen ky bashkëpunim do të intensifikohet në realizimin e projekteve të përbashkëta në të mirë të vendit.

Nga data 11.12.2019 deri më datë 17.12.2019, prof. ass. dr. Xhabir Hamiti qëndroi në Universitetin "Freiburg" të Gjermanisë, në cilësinë e profesorit vizitor. Gjatë kësaj kohe ai zhvilloi ligjërata me kandidatët e shkallës master të këtij universiteti. Vizita është realizuar në kuadër të programit për shkëmbim Erasmus +.

III. Bashkëpunimi me institucionet vendore relevante

Më datë 15.01.2019, dekani i Fakultetit të Studimeve Islame, prof. asoc. dr. Fahrush Rexhepi me bashkëpunëtorë priti në takim Kryetarin e Komunës së Vitisë, z. Sokol Haliti.

Më datë 19.04.2019, dekani i FSI-së, prof. asoc. dr. Fahrush Rexhepi dhe prodekani prof. ass.dr. Zija Abdullahu morën pjesë në takimin e organizuar nga MASHT në bashkëpunim me zyrën Erasmus+. Në takim u diskutua për koordinimin e veprimeve që institucionet tona të jenë përfituese të programit ERASMUS+ përmes realizimit të projekteve kërkimore ndërkombëtare.

Më datë 25 dhe 26 qershor 2019, sekretari i FSI-së, mr. Vedat Shabani, dhe koordinatorja për marrëdhënie me jashtë, mr. Muzaqete Kosumi, morën pjesë në trajnimin dyditor "Si të shkruajmë një projekt të suksesshëm për ngritjen e kapaciteteve në arsimin e lartë (KA2 - CBHE) në kuadër të programit Erasmus+", për të kualifikuar stafin akademik për shkrimin e projekteve, të organizuar nga Zyra Erasmus+ në Kosovë në bashkëpunim me Zyrën e Bashkimit Evropian.

Më datë 15.10.2019, sekretari i FSI-së, mr. Vedat Shabani, merr pjesë në punëtorinë lidhur me krijimin e NREN në Kosovë, në kuadër të Projektit për Ekonominë Dixhitale të Kosovës, Projekti KODE. Objektivi Zhvillimor i Projektit (KODE) është të përmirësojë qasjen në infrastrukturën e teknologjisë së lartë dhe më cilësore në zonat e projektit dhe qasjen e qytetarëve, institucioneve publike dhe botës akademike në informatat, njohuritë dhe tregjet e punës online. Ky projekt është financuar nga BE dhe implementohet nga Ministria e Financave të RKS-së.

IV. Veprimtaria botuese

Një nga objektivat, kërkesat dhe nevojat e FSI-së pa dyshim është edhe botimi i literaturës, përkatësisht i teksteve për nevojat e studentëve dhe botimi i revistës së FSI-së “Buletini”, ku pedagogë dhe bashkëpunëtorë të FSI-së botojnë punimet dhe arritjet e tyre shkencore. Kështu, FSI gjatë viteve kalendarike 2019-20 ka botuar këto vepra:

1. “Studime kontrastive ndërmjet arabishtes dhe shqipës në fushën e fonologjisë”, të autorit mr. Qemajl Morina.
2. “Epitafet në gjuhën osmane - deshifrimi dhe përkthimi i tyre”, Regjioni i Mitrovicës.

Fakulteti i Studimeve Islame gjithashtu ka nxjerrë edhe numrin 6 të revistës “*Buletini*”, i cili përfshin tema nga fusha të ndryshme:

Mr.hfz. Safet HOXHA: LEXIMET E ÇRREGULLTA TË KURANIT Dispozitat dhe ndikimet e tyre

Prof. ass. dr. Lulzim ESATI: FILOZOFIA E ADHURIMIT SIPAS KURANIT FAMËLARTË

Prof. ass. dr. Musa VILA: METODA GOJORE APO TEORIKE E THIRRJES

- Dr. Valon MYRTA: HYRJE KONCEPTUALE NË SHKENCËN E
“MEKASIDU ESH-SHERIATI” - QËLLIMET E SHERIATIT
- Prof. asoc. dr. Sulejman OSMANI: LUTFI PASHA - BURRË
SHTETI DHE DIJETAR
- Prof. ass. dr. Shefqet KRASNIQI: FAHRUDIN ER-RAZI (544h-
606h; 1149g-1210g) Ripërtëritës i fesë i shekullit VI
- Dr. Islam HASANI: NJË PASQYRË E SHKURTËR E SISTEMIT
FINANCIAR ISLAM
- Dr. Rexhep SUMA: ROLI I SHTYPIT FETAR NË TOLERAN-
CËN NDËRFETARE
- Dr. Selim SELIMI: TRASHËGIMIA E PERIUDHËS OSMANE
NË DOBËRÇAN TË GJILANIT
- Mr. Vedat SHABANI: AKTIVITETET E FAKULTETIT TË STU-
DIMEVE ISLAME -
PRISHTINË GJATË VITIT 2018

V. Promovime

Në kuadër të aktiviteteve hulumtuese dhe shkencore të Fakultetit të Studimeve Islame, më datë 23.01.2020 janë përruruar dy vëllime të bo-timeve të projekteve hulumtuese me titull:

1. Epitafet në gjuhën osmane - Dëshifrimi dhe përkthimi i tyre, Regjioni i Prishtinës
2. Epitafet në gjuhën osmane - Dëshifrimi dhe përkthimi i tyre, Regjioni i Mitrovicës

Në këtë promovim, përveç stafit të FSI-së, morën pjesë edhe kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë me bashkëpunëtorë, përfaqësues nga ambasada e Turqisë, Diyanetit, institutit Yunus Emre, përfaqësues nga Instituti i Historisë, Instituti Albanologjik, profesorë, studiues, intelektualë, dashamirë të librit e të kulturës, si dhe shumë të ftuar të tjerë.

Fakulteti i Studimeve Islame punën kërkimore dhe shkencore e realizon në harmoni me misionin dhe vizionin që ka për zhvillimin e shkencës së teologjisë në vend duke kontribuar gjithmonë në disa fusha dhe tema specifike.

Në cilësinë e nikoqirit të pranishmëve iu drejtua dekani i FSI-së, prof. asoc. dr. Fahrush Rexhepi, i cili fillimisht përshëndeti të pranishmit duke i falënderuar ata për kohën e ndarë për këtë eveniment. Dekani më tutje tha: “Botimi i dy vëllimeve të epitafeve që po promovojmë sot i shtohet vargut të disa aktiviteteve të tjera kërkimore shkencore si dhe 12 titujve të tjerë që ka botuar Fakulteti i Studimeve Islame gjatë tre viteve të fundit. Mirëpo, botimi i vëllimeve të epitafeve të regjionit të Prishtinës dhe Mitrovicës është i një rëndësie të veçantë jo vetëm për faktin se janë shkrime komplekse dhe delikate, por për faktin se epitafet (mbishkrimet në gurët e varreve) janë dëshmi mbi praninë e kulturës, civilizimit, fesë, traditës, artit dhe arkitekturës së një populli. Tekstet e shkruara në këta gurë japin njohuri për të kaluarën dhe historinë e popullit tonë duke shërbyer si ura lidhëse mes të kaluarës dhe të sotmes. Pra, epitafet konsiderohen si rojtarët e një qytetërimi të heshitur”. Në fund të fjalimit dekani Rexhepi tha: “Për realizimin e këtij projekti të epitafeve shpreh falënderimet e sinqerta për përkthyesit Agron Islami dhe Selim Selimi, për punën profesionale dhe përkushtimin e tyre, sikur edhe recensentin e vëllimit të parë, përkatësisht ekspertin e shkrimeve osmane nga arkivi osman në Stamboll, Dr. Mustafa Kyçyk. Falënderojmë edhe recensentët e vëllimit të dytë Dr. Ermal Nurja nga Tirana dhe Besir Neziri. Falënderojmë Prof. dr. Jusuf Osman, i cili ka përgatitur nga një historik të shkurtër për secilin vendbanim ku janë identifikuar epitafet. Për mbështetje financiare falënderojmë institutin Yunus Emre dhe Dijanetin e Turqisë”.

Të pranishmëve me një fjalë rasti iu drejtua edhe Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i cili foli për vlerën e këtyre veprave. Ai më tej vazhdoi duke thënë se “veprat që po

promovojmë sot paraqesin një rëndësi të veçantë për njohjen e së kaluarës sonë, sepse përmes gurëve të varrezave myslimane që mbajnë epigrafet në gjuhën osmane arrijmë të gjejmë të dhënat të rëndësishme burimore për të parët tanë që jetuan e vepruan gjatë periudhës së administrimit osman të viseve tona, kur siç dihej gjuhë zyrtare ishte gjuha osmane” - tha Myftiu Tërnavë.

Për veprat referuan prof. dr. Ertugrul Karakus nga Universiteti “Kurklareli” i Turqisë dhe dr. Ermal Nurja nga Tirana si dhe përkthyesi, Phd Agron Islami.

Në këto dy vëllime janë trajtuar mbi 200 gurë varresh me mbishkrim osman, ku së bashku me fotografinë origjinale i është dhënë transkriptimi dhe përkthimi i teksteve mbi varrezore (epitafëve), të cilat në vetvete përmbajnë të dhëna me interes për historinë, gjuhën dhe kulturën shpirtërore të të parëve tanë.

Promovimi i këtyre dy vëllimeve u vlerësua shumë duke e konsideruar si një pasuri të historisë dhe dëshmisë sonë për brezat e ardhshme, që do ta shfrytëzojnë dhe do ta ruajnë në kujtesën historike për të kaluarën tonë.

VI. Aktivitetet e Unionit të Studentëve

Nga data 9 deri më 14 mars 2019, në Mbretërinë Hashimite të Jordanit, u mbajt edicioni i 14-të i Garave Ndërkombëtare të Kuranit për femra. FSI për herë të parë në këto gara u përfaqësua nga një hafëze, studentja Vildane Zeqiri. Përfaqësuesja e Kosovës, hafëze Vildane Zeqiri, në këto gara u dekorua me një mirënjohje, të cilën ia dhuroi kryetari i Vakëfit, Abdunasir abu Basar, i cili shprehu mirënjohje dhe falënderim të veçantë për pjesëmarrjen e Kosovës në këto gara.

Nga data 15-20.03.2019, në Doha të Katarit, studentët e FSI-së morën pjesë në “QATAR DEBATE” së bashku me 106 universitete nga 52 shtete të botës. Nën përkujdesin e zonjës Hind Bint Hamed El Tha-

ni, nënkryetare e Bordit dhe Kryeshefe Ekzekutive e FONDACIONIT TË KATARIT për Arsim, Shkencë dhe Zhvillim të Komunitetit u zhvillua kampionati i pestë ndërkombëtar i debatit në gjuhën arabe për universitete. Në këtë garë morën pjesë gjithsej 106 universitete dhe fakultete nga 15 shtete arabe dhe 37 shtete joarabe, gjithsej nga 52 shtete nga mbarë bota. Nga rajoni ynë pjesmarrës ishte Fakulteti i Studimeve Islame, Universiteti i Tetovës, Fakulteti i Studimeve Islame nga Novi Pazari, 2 universitete nga Bulgaria, 3 nga Turqia, si dhe nga Gjermania, Polonia, Spanja etj.. Ekipi i FSI-së drejtohej nga prof. Fadil Hasani dhe kishte në përbërje 4 studentë: Blerim Murati, Bunjamin Emini, Rineta Nitaj dhe Fatime Nitaj.

Më datë 21.03.2019, një grup studentësh të FSI-së kanë zhvilluar një takim me Ambasadorin e SHBA-së në Kosovë, z. Philip S. Kosnett. Studentët pjesëmarrës ishin: Enisa Bekteshi, Dardan Breznica, Samire Bilalli, Abdullah Bahtiri, Ubejd Luma dhe Behar Bushi.

Më datë 18.04.2019 studenti i Fakultetit të Studimeve Islame, Mendim Sllamniku, merr pjesë në Garat Ndërkombëtare të leximit të Kuranit në Kuvajt.

Më datë 12.06.2019 studentët Aida Maloku, Samir Gjoni dhe Artin Shala, studentë të vitit të tretë, bënë prezantimin e projektit me titull: “Dhuna në familje”. Ky projekt ishte realizuar në kuadër të lëndës së sociologjisë.

Më datë 29.10.2019 në Mitrovicë u mbajt një trajnim nga OSCE. Pjesëmarrës në këtë trajnim nga studentët e FSI-së ishin Enisa Bekteshi, Samire Bilalli, Abdullah Bahtiri dhe Enis Sinani.

Më datë 19.12.2019, për nder të 27-vjetorit të themelimit të Fakultetit të Studimeve Islame, studentet e fakultetit organizuan një aktivitet humanitar në parkun e qytetit me moton: “Nëse ke ftohtë, merre këtë. Nëse mendon që askush nuk kujdeset për ty, ne kujdesemi”.

Më datë 06.01.2020, në kuadër të Fakultetit të Studimeve Islame është formuar grupi hulumtues i studentëve. Grupi hulumtues ka për

qëllim studimin e temave me rëndësi të veçantë, që lidhen me jetën e përditshme në përgjithësi e me të ardhmen e të rinjve në veçanti, tema të lëmive të ndryshme fetare dhe shoqërore.

Më datë 22.10.2020, në ambientet e FSI-së u bë dhe prezantimi i hulumtimit shkencor nga Grupi Hulumtues i studentëve të FSI-së në prezencë të dekanatit, profesorëve dhe studentëve të këtij fakulteti. Prezantimi në fjalë ishte paraparë të mbahej në muajin mars të këtij viti, por për shkak të paraqitjes së virusit Covid-19, u anulua për faktin se nuk ishte e mundur të realizohet duke e shtyrë deri në ditët e sotme.

Tema e studimit është *‘Ndikimi i rrjeteve sociale te të rinjtë’* dhe synon hulumtimin dhe identifikimin e efekteve negative që ushtrojnë rrjetet sociale te të rinjtë, krahas efekteve pozitive. Disa nga hipotezat e studimit ishin se përdorimi i tepruar i rrjeteve sociale ka ndikuar edhe në zbrazjen e bibliotekave, në të cilat numri i lexuesve është i vogël, ndërkohë më i pëlqyeshëm për të riun është bërë passwordi i WI-FI-së sesa titulli i një libri “Best Seller”; po ashtu edhe qëndrimi me familjen, si pjesa më e bukur e jetës, është zëvendësuar me biseda të herë-pashershme nëpërmjet telefonave të mençur, ndërsa takimet fizike me të dashurit e zemrës bëhen përmes kamerave dhe përqafimet janë zëvendësuar me “stickers”, e gjithë kjo për shkak të “dashurisë” ndaj rrjeteve sociale.

Metoda e hulumtimit e zbatuar për të mbledhur të dhëna për këtë studim ishte ajo *empirike*, ndër të cilat kemi përdorur metodën kualitative dhe kuantitative, si dhe metodat *teorike*, pasi kemi shfrytëzuar libra të së njëjtës fushë si dhe studime të mëhershme lidhur me këtë temë. Në këtë studim janë përfshirë afër 1500 pjesëmarrës nga shtatë qytetet më të mëdha të Kosovës, Prishtina, Prizreni, Mitrovica, Gjakova, Gjilani, Ferizaji dhe Podujeva. Mosha e tyre ishte 13-29 vjeçe. Pyetësi përmbante tetë pyetje, me nga 3, 4 dhe 5 opsione.

Nga rezultati i studimit hipoteza e studimit u mbështet sepse të anketuarit ranë dakord se ndikimi i rrjeteve sociale, si në aspektin e mos-

leximit, ndikimit psikik dhe fizik, humbjes së kohës dhe moskalimit të kohës me familje e me të afërm është i pranishëm dhe po ashtu e pranishme është edhe varësia te pothuajse gjysma e atyre që kishin menduar të largoheshin nga ndikimi i rrjeteve sociale, por nuk ia kishin dalë.

PËRMBAJTJA

Prof. asoc. dr. Fahrush REXHEPI THEKSIME TË KOMPLEKSITETIT TË ÇËSHTJES KOMBËTARE NË BURIMET THEMELORE TË ISLAMIT	5
Dr. hfz. Safet HOXHA TERMINOLOGJIA NË SHKENCËN E KIRAETEVE DHE NËNFUSHAVE TË SAJ	27
Prof. ass. dr. Zija ABDULLAHU KONCEPTI KURANOR NDAJ “ <i>TJETRIT</i> ”	49
Prof. ass. dr. Lulzim ESATI ROLI DHE PËRGJEGJËSIA E NJERIUT NË TOKË SIPAS SURES “ <i>El-Bekare</i> ”	73
Prof. asoc. dr. Sulejman OSMANI SJELLJET SOCIALE NË KOHË PANDEMIE - NJË VËSHTRIM NGA PIKËPAMJA ISLAME.....	91
Ali Suleiman ALI LINDJA E TEFSIRIT DHE VEÇORITË E TIJ DERI NË KOHËN E TABIINËVE - GJENERATËS SË DYTË MYSLIMANE PAS KALIMIT NË AMSHIM TË MUHAMEDIT a.s.....	119
Dr. Fidan XHELILI AGJËRIMI I DITËS SË ASHURËS DHE PROBLEMATIKAT RRETH SAJ	137
Dr. Ajni SINANI INSTITUCIONI I FETVASË DHE I MYFTIUT	155
Dr. Valon MYRTA HYRJE KONCEPTUALE NË SHKENCËN “QËLLIMET E SHERIATIT” - (2).....	177
Prof. ass. dr. Musa VILA KOMUNIKIMI MASIV NË THIRRJEN ISLAME	195
Prof. ass. dr. Rexhep SUMA REALITETI I NDJENJËS SË FRIKËS NDAJ ZOTIT DHE INKURAJIMIT PËR SHPËRBLIMIN E TIJ NË MISIONIN E DAVETIT	211

Prof. ass. dr. Muhamed JUSUFI ARTI NË LEGJISLACIONIN ISLAM DHE RELIGJIONET IBRAHIMIKE	231
Prof. asoc. dr. Januz DËRVODELI NDIKIMI I MEDIAVE DHE I RRJETEVE SOCIALE NË EDUKIMIN DEMOKRATIK TË TË RINJVE.....	255
Dr. Selim SELIMI JETA DHE POEZITË E JAHJA KEMAL BEJATLLIUT (SHKUPJANI).....	269
PhD (c) Agron ISLAMI TË DHËNA BURIMORE PËR DISA MEKTEBE TË RRETHIT TË KAZASË SË GJILANIT NGA VITI 1902	287
PhD (c) Melihate ZEQRIRI ÇËSHTJE TË LEKSIKUT TË GJUHËS SHQIPE NË KOHËN MODERNE	311
Mr. Vedat SHABANI AKTIVITETET E FAKULTETIT TË STUDIMEVE ISLAME - PRISHTINË GJATË VITEVE 2019-2020	332
PËRMBAJTJA.....	349